AKADEMIJA NAUKA I UMETNOSTI KOSOVA

Posebna izdanja

Knjiga IX

ODELJENJE DRUŠTVENIH NAUKA

Knjiga 3

MARK KRASNIĆI

BARANSKI LJUG

Etno-geografska monografija

Primljeno na sednici Odeljenja društvenih nauka
od 21. III 1983. godine, na osnovu referata
akademika *Ali Hadrija,* akademika *Surja Pupovcija*
i dr *Enver Dukađinija*

Urednik

Akademik *Jašar Redžepagić*

PRIŠTINA
1984

AKADAMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Botime të veçanta

Libri IX

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Libri 3

MARK KRASNIQI

LUGU I BARANIT

Monografi etno-gjeografike

Miratuar në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 21. III. 1983, në bazë të recensioneve të
akademik *Ali Hadrit,* akademik *Syrja Pupovcit*
dhe Dr. *Enver Dukagjinit*

Redaktor

Akademik *Jashar Rexhepagiqi*

PRISHTINË
1984

ACADÉMIE DES SCIENCES ET DES ARTS DE KOSOVO

Publications spéciales

Tome IX

CLASSE DES SCIENCES HUMAINES

Livre 3

MARK KRASNIQI

LUGU I BARANIT

Monographie éthno-géographique

Reçu à la séance de la Classe des Sciences Humaines, le 21 mars 1983, à la base des rapports des académiciens *Ali Hadri*, académiciens *Syrja Pupovci* et Dr. *Enver Dukagjini*

Rédacteur

Acad. *Jashar Rexhepagiq*

Bayerische Staatsbibliothek München

PRICHTINA
1984

PËRMBAJTJA

Parathënie 7

HYRJE 9

KUSHTET NATYRORE 12

- Pozita gjeografike 12
- Relievi 12
- Kushtet klimatike 15
- Ujërat 15
- Përbërja e tokës 17
- Bota bimore e shtazore 18

KUSHTET SHOQËRORE 22

- Zhvillimi historik 22
- Familja, fisi, bajraku e katundi 38

POPULLSIA 52

- Migrimet e popullsisë 68

VENDBANIMET 77

- Krysheci 80
- Rashiqi 84
- Broliqi 86
- Turjaka 88
- Barani i Epërm 90
- Barani i Poshtëm 92
- Kotradiqi 96
- Vranoci 98
- Çellopeku 101
- Kosuriqi 104
- Buqani 108
- Llugaxhia 111
- Gllogjani 113
- Nepolja 116
- Çeskova 118
- Kpuzi 121

PROCESI I URBANIZIMIT TË POPULLSISË DHE TË VENDBANIMEVE 125

TRADITA POPULLORE DHE NDRYSHIMI I SAJ BASHKËKOHOR . 131

Kultura shpirtërore popullore 132
Kultura materiale popullore 149

LUGU I BARANIT NË EPIKËN POPULLORE 162

Përfundimi 172
Rezime 175
Résumé 182

PARATHËNIE

Punën kërkimore në terrenin e Lugut të Baranit e kam filluar në muajin gusht të vitit 1951, si asistent i Institutit Etnografik të Akadamisë së Shkencave në Beograd. Megjithëse këta ishin hapat e parë në punën time kërkimore në terren, prapë, në saje të mirëkuptimit e të ndihmës së gjithanshme të fshatarëve, mblodha materiale e të dhëna të tjera të vlefshme etnografike e antropogjeografike për këtë trevë.

Vetëm mbas 20 vjetësh pata rastin të kthehem përsëri në Lug të Baranit, në shkurt të vitit 1972. Punën kërkimore në këtë zonë e vazhdova herëpasherë gjatë viteve 1979 e 1980, duke mbledhur materiale të reja e duke plotësuar e kontrolluar shënimet e mëparshme. Edhe në këto raste gëzova përkrahjen e përzemërt e mikpritjen tradicionale të banorëve të Lugut të Baranit, e sidomos të punëtorëve të arsimit — Beqir Krasniqi, Hil Desku, Emin Krasniqi, Rexhep Selmanaj dhe shumë të tjerëve. Me këtë rast të gjithë atyre fshatarëve e arsimtarëve të kësaj treve të cilët më ndihmuan në punën kërkimore në terren u shpreh mirënjohje qysh në fillim të këtij libri, i cili, edhe në saje të ndihmës së tyre, doli në dritë.

Për studime të këtilla etnografike e antropogjeografike, puna kërkimore në terren është e domosdoshme, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të mblidhen të dhëna e materiale të reja, burimore nga jeta dhe goja e popullit — për të kaluarën e tij e për gjendjen e tanishme, për doket e zakonet, për kulturën e tij materiale e shpirtërore. Mirëpo, natyra e kësaj pune është e tillë, që gjithmonë mund të mbetet diçka mangut, mund të mbesin boshllëqe, lëshime e gabime të ndryshme. Të meta të tilla mund të ketë edhe ky libër, me gjithë përpjekjet tona që pesha e tyre të jetë sa më e vogël.

Prishtinë, mars 1981. *Autori*

HYRJE

Në Rrafshin e Dukagjinit janë tri zona të njohura etno-gjeografike të cilat quhen „lug", përkatësisht — Lugu i Drinit, Lugu i Leshanit dhe Lugu i Baranit, si edhe disa të tjera më të vogla — Lugu i Pishtanit, Lugu i Tërstenikut etj. Këto zona janë të përcaktuara nga elementet natyrore si tërësi gjeografike, siç tregon edhe emri e pozita gjeografike e tyre, sepse, nga aspekti morfologjik, këto janë lugje të krijuara gjatë shumë shekujsh nga gërryerja e lumenjve, të cilët rrjedhin nëpër to.

Pra, edhe Lugu i Baranit është një tërësi e tillë etno-gjeografike, shumë e ngjashme me lugjet e tjera, por gjithësesi me disa veçanti të natyrës gjeografike e sidomos të aspektit shoqëror. Për këtë zonë nuk është botuar deri tash asnjë punim nga aspekti etno-gjeografik. Mirëpo, disa nga fshatrat e saj përmenden në dokumentat e shekullit XIV, ndërsa disa të dhëna arkivore të shekullit XV janë me interes të madh për studimin e kushteve shoqërore e ekonomike të asaj periudhe. Për periudha të mëvonëshme, që nga fundi i sh. XV e deri kah fillimi i sh. XX, ka pak të dhëna të botuara, përsa e dimë ne. Burimi kryesor i të dhënave për hartimin e kësaj monografie është materiali i mbledhur në terren, tradita popullore dhe shënimet statistikore.

Në këtë monografi do të shqyrtojmë Lugun e Baranit nga aspekti etno-gjeografik, ku objekt kryesor i studimit janë popullsia dhe vendbanimet, veçantitë dhe zhvillimi historik i tyre, sidomos në kushtet bashkëkohore, kultura materiale e shpirtërore e popullsisë. Kuptohet se në një punë të këtillë nuk mund të shqyrtohen problemet e dukuritë e ndryshme në mënyrë statike dhe të veçuara njëra nga tjetra. Problemet e ndryshme etno-gjeografike lindin e zhvillohen në kuadrin e kushteve të përgjithshme shoqëro-re-ekonomike të kohës dhe të ambientit gjeografik. Prandaj të gjitha këto duhet të shqyrtohen nga aspekti i vartësisë, i ndikimit dhe i zhvillimit reciprok, për të nxjerrë në dritë të vërtetën shkencore.

Për vise të ndryshme të Kosovës, dhe për disa vise të tjera në Mal të Zi e Maqedoni me popullsi shqiptare, janë botuar disa studime monografike nga aspekti antropogjeografik dhe etnografik dhe studime të tjera me tematikë historike, gjuhësore e arkeologjike, nga autorë të ndryshëm joshqiptarë. Gati të gjithë këta në punën e tyre e kanë lënë pas dore metodologjinë dialektike dhe të

vërtetën shkencore. Për Lugun e Baranit dhe për disa zona të tjera të ngjashme të Rrafshit të Dukagjinit, as nga ky aspekt nuk është të botuar ndonjë punim i tillë.

Është detyrë e shkencës sonë bashkëkohore të bëjë përpjekje për të studiuar viset tona të ndryshme, popullsinë e vendbanimet e tyre nga aspekte të ndryshme, duke i dhënë përparësi studimit të kulturës popullore, traditës, e cila po varfërohet dita-ditës nga vërshima e mjeteve teknike dhe jeta bashkëkohore. Në këtë punë mund të japin kontribut të mirë punonjësit e arsimit dhe të tjerët, të cilët janë në kontakt të përhershëm me popullsinë fshatare. Ata do të bënin punë të mirë sikur t'i mbledhnin me kujdes të gjitha toponimet (emrat e ndryshem në fushë, në mal e në fshat), doket, zakonet, folklorin etj., sepse këto po zhduken dhe mund të harrohen fare, pa lënë gjurmë pas veti. Kjo punë është me interes edhe për studime të mëtejshme nga aspekti i disa disiplinave shkencore (gjuhësore, etnografia, historia, gjeografia etj.). Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe disa institucione të tjera shkencore e kulturore të Prishtinës, do ta përkrahnin punën e vlefshme të bashkëpunëtorëve të këtillë me konsultime, udhëzime e në mënyra të tjera përkatëse.

Botimi i monografisë së Lugut të Baranit, i monografisë etnografike të Rugovës, si edhe disa punime të botuara më parë, mund të jenë një ndihmë për hulumtuesit e rinj në punën e tyre kërkimore në terren për të mbledhur sa më shumë e sa më mirë materiale të ndryshme nga goja e përvoja e popullit, për t'i ruajtur për brezat e ardhshëm vlerat e thesarit të pasur të kulturës sonë të lashtë popullore. Kjo monografi për Lugun e Baranit, përveç të tjerash, ka edhe këtë qëllim, këtë porosi. Kushtet e tanishme janë të volitshme për një punë të frytshme kësisoji. Varet nga njerëzit, nga vullneti dhe entuziazmi i tyre, se si dhe sa do të shfrytëzohen ato. Koha po e bën të veten, prandaj duhet të nxitojmë e të shpëtojmë nga vërshima e saj atë pjesë të kulturës sonë popullore, të cilën ende nuk e ka marrë lumi — „mos ta lamë soden për nesër" — siç thotë rapsodi popullor, sepse nesër mund të jetë tepër vonë.

Dukuritë, gjërat dhe ngjarjet bashkëkohore, ose nga e kaluara e afërme, nuk i vërejmë as nuk i çmojmë sa duhet, sepse ato na duken të përditshme, të zakonshme, të parëndësishme. Prandaj ato nuk e tërheqin vëmendjen tonë sa duhet. Mirëpo nëse këto shënohen e botohen, madje edhe si material i thjeshtë, si të dhëna të thata, dikur për gjeneratat e ardhshme, edhe këto do të jenë shumë interesante, të rëndësishme e të dobishme për ta njohur kohën tonë, kushtet dhe jetën tonë në përgjithësi. Ja p.sh., këtu kemi shfrytëzuar një defter turk të vitit 1485, në të cilin janë shënuar të dhëna fare të thjeshta: emri i fshatit, emrat e kryefamiljarëve dhe detyrimet e tyre ndaj pushtetit. Mirëpo, sot këto gjëra të thjeshta për ne janë shumë të rëndësishme për ta njohur Lugun e Baranit, jetën e tij ekonomike e shoqërore të para pesëqind vjetësh. Nga këto të dhëna ne sot dimë se kush ka jetuar p.sh. në

fshatin Kosuriq para pesë shekujsh, sa shtëpi ka pasur, çka kanë mbjellë fshatarët dhe sa prodhime bujqësore kanë qenë të detyruar të dorëzojnë si tatim etj.

Tash ne jemi në gjendje të japim jo vetëm të dhëna të thata, por edhe studime komplete e të gjithanshme për fshatra e vise të tëra, për popullsinë e tyre, për gjendjen e tyre të tashme e të kaluar, për historikun e tyre, gjuhën që e flasin, për doket e zakonet, shkurt — për kulturën materiale e shpirtërore të popullit.

KUSHTET NATYRORE

Pozita gjeografike. — Lugu i Baranit është një tërësi gjeografike e përbërë nga 15 fshatra, të cilat shtrihen në lugun e Bistricës së Deçanit dhe në shpate ose kodra gjatë kësaj lugine.* Kjo zonë ndodhet afër Bjeshkëve të Nemuna, të cilat ngrihen pjerrët mbi Pejë, Deçan, Junik etj. Qyteti i Pejës ndodhet në perëndim të kësaj zone, rreth 10 km larg fshatit Kryshec, me të cilin fillon Lugu i Baranit nga kjo anë. Në drejtim të lindjes kjo zonë kufizohet me Drinin e Bardhë, në anën e majtë të cilit shtrihet zona kodrinore Prekorupa, përkatësisht Llapusha. Në veri Lugu i Baranit kufizohet me pjesën e poshtme të Lugut të Leshanit dhe me fushën e Pishtanit. Kah jugu kjo zonë kufizohet me rrjedhën e Bistricës së Deçanit, në anën e djathtë të cilës shtrihet Dushkaja, një zonë kodrinore që fillon nga kodrat e Dashinocit e mbaron në Dri të Bardhë në lindje. Pra, Lugu i Baranit zë vend qendror në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit. Nëse e përcaktojmë pozitën gjeografike të Lugut të Baranit në kuptim më të ngushtë, në relacion përkatës me vendbanime kufitare, atëherë kah perëndimi duhet ta marrim fshatin Kryshec si pikënisje dhe në lindje Kpuzin e Çeskovën, në breg të Drinit — si pikëmbarimi të kësaj zone, ndërsa nga të dy anët e lugut shtrihen kodra të ulta, pjesët e ndryshme të cilave mbajnë emrin e fshatit më të afërm. Kështu i kufizuar, Lugu i Baranit ka një gjatësi rreth 15 km dhe gjerësi rreth 2 km mesatarisht. Sipërfaqja e kësaj zone kap rreth 75 km.[2]

Relievi. — Lugu i Baranit ka reliev mjaft të thjeshtë, sepse përbëhet nga një rrafshinë gjatë lumit Bistricë dhe nga kodrat gjatë saj. Ky është makrorelievi i kësaj zone. Por mikrorelievi paraqitet me më shumë elemente, sidomos në pjesën kodrinore, ku ka grrella, gropa, lugje, shpate etj. Kodra më e lartë është në malin Duboçakë (522 m) dhe në Turjakë (503 m). Kodrat e tjera që shtrihen në anën e majtë të luginës, domethënë të zonës fushore, janë më të ulta duke shkuar kah lindja, në drejtim të rrjedhës së

* Fshati Rosuje nga aspekti shoqëror i takon Lugut të Baranit, por nga aspekti gjeografik i takon Lugut të Pishtanit, prandaj nuk e kemi përfshirë këtu si pjesë të zonës në shqyrtim. Rosuja është fshat i vogël i tipit të shpërndarë, në pjesën e poshtme të Lugut të Pishtanit, buzë Bistricës së Pejës, mjaft i izoluar nga fshatrat e tjera. Më 1931 ka pasur 210 banorë (184 shqiptarë, 21 malazezë, 9 myslimanë („boshnjakë") dhe 1 serb).


Bistricës. Kështu Kodra e Baranit është e lartë 499 m, mali i Çeskovës 485 m, ndërsa Kodra e Kpuzit 457 m. Nga ana e majtë e Bistricës, në Dushkajë, kodrat kanë po këtë lartësi, me përjashtim të Sukës së Cërmjanit, e cila dominon në këtë pjesë të Rrafshit të Dukagjinit me lartësi prej 701 m. Vetë lugu, fusha, ka lartësi mbidetare rreth 400 m. Kështu fusha e fshatrave Gllogjan e Nepole është e lartë 396—398 m, ndërsa ajo e fshatrave në perëndim nga këto është nja 50 m më e lartë. (Fusha e Vranocit p.sh. ka një lartësi prej 452). Midis kësaj ultësire, pranë fshatit Vranoc, ngrihet një kodër e izoluar, Kodra e Vranocit, e lartë rreth 495 m, e cila duket si ishull i vetmuar në këtë zonë fushore.

Lugu i Baranit shtrihet në një terren, i cili në perëndim është relativisht i lartë, e në lindje i ulët. Kështu një pjesë e fshatit Kryshec është në kodër, në lartësi prej 527 m, ndërsa pika e derdhjes së Bistricës në Dri është 349 m.[1] Pra, diferenca e lartësisë midis dy pikave nga të dy anët e kundërta të kësaj zone është 76 m. Kjo është pjerrësia e terrenit në drejtim perëndim-lindje. Lugina është më e gjerë (rreth 2 km) midis Çellopekut e Vranocit, përkatësisht në fushën e këtyre fshatrave, ndërsa më e ngushtë në lindje të fushës së Nepoles, ku Bistrica fillon të dëpërtojë ndërmjet kodrinave të Kralanit e të Kpuzit, në të cilat kjo e ka thelluar shtratin e vet, kështu që deri në derdhje të saj në Dri (afër fshatit Mrasor) kalon nëpër ngushtica, me një gjatësi prej rreth 4 km.

Përveç dy elementeve kryesore të relievit — luginës dhe kodrave gjatë saj, ka edhe forma të tjera sekundare të relievit në pjesën kodrinore të kësaj zone. Këto kodra, që kanë pamjen e një rrafshnalte, janë të përthyera me lugje të ngushta, me lugina të formuara nga përrënjtë e shumtë, të cilët tash zakonisht kanë ujë vetëm kur shkrihet bora, ose kur bie shi. Pjesa e epërme e këtyre lugjeve, të cilat nuk janë të gjata, është e ngushtë, ndërsa pjesa e poshtme e gjerë, kështu që bashkohen me zonën fushore të kësaj treve. Disa lugje të tilla janë më të ngushta, kështu që populli këto i quan „gryka". Një grykë e tillë, por më e ngushtë e më e thellë se të gjitha të tjerat, është gryka e Bistricës, të cilën e përmendëm më parë, në lindje të fushës së Nepoles. Lugjet në zonën kodrinore kanë emrat e tyre, të cilët bëjnë pjesë në toponominë e pasur të Lugut të Baranit.

Në përgjithësi relievi i Rrafshit të Dukagjinit, ku bën pjesë edhe ky i Lugut të Baranit, është krijuar nga lumenjtë e tij, të cilët pas zhdukjes së liqenit të madh, i cili e mbulonte këtë trevë në tërësi në periudhën gjeologjike miocen i mesëm, pas tharjes së liqenit, në sipërfaqen e pllajës së krijuar nga ai, lumenjtë e kanë thelluar shtratin e tyre, si p.sh. Drini i Bardhë, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, Ereniku, Krena dhe shumë rrjedha të tjera më të vogla. Këta lumenj e kanë gërryer dhe e kanë përthyer fushëgropën e Rrafshit të Dukagjinit duke krijuar kështu kodra

[1] Harta topografike, seksioni „Metohija", shkalla 1:50000, botim i Vojno-geografski institut, Beograd, 1958.



Harta gjeografike e Lugut të Baranit

jo të larta dhe lugje jo të thella.[2] Terreni në pellgun e Bistricës së Deçanit, në pjesën e rrjedhës së saj gjatë Lugut të Baranit, është i përbërë nga tarracat e liqenit dhe tarracat e lumenjve. Pjesa e rrjedhës së poshtme të Bistricës është thelluar midis tarracave të lumenjve në veri dhe tarracave të liqenit në jug.[3]

Kushtet klimatike. — Për një trevë relativisht të vogël, e cila bën pjesë në një tërësi më të madhe gjeografike, me të cilën i ka të përbashkët ose të ngjashem elementet natyrore, nuk mund të flitet për kushte të posaçme klimatike, sepse ato janë po ato që mbreterojnë në ambientin më të gjerë gjeografik. Kështu, të dhënat për kushtet klimatike të Pejës vlejnë edhe për rrethet e saj, pra edhe për Lugun e Baranit. Në përgjithësi këto vise kanë klimë të mesme kontinentale. Temperatura mesatare vjetore në Pejë arrin rreth 11,6° C. Vera është e gjatë dhe e ngrohtë. Borë bie kah mesi i dhjetorit e shkrihet në fillim të marsit.[4] Temperatura mesatare e janarit është 0,5° C, e korrikut 22° C. Mesatarja vjetore e reshjeve atmosferike në Pejë arrin rreth 46 mm në muajin korrik, kurse mesatarja vjetore e tyre për Rrafshin e Dukagjinit është 879 mm. Shi bie më shumë në dhjetor, kur mesatarja e reshjeve është 116 mm, ndërsa më pak në korrik e në gusht, kur fusha ka më shumë nevojë për lagështi.[5] Popullsia e kësaj ane thotë se kur retë e zeza e mbushin Grykën e Deçanit dhe e mbulojnë Majën e Strellcit, atëherë duhet të bjerë shi edhe në Lug të Baranit. Kuptohet se afërsia e këtyre maleve kushtëzon shfaqjen edhe të disa elementeve të tjera të klimës (p.sh. erën, vesën, brymën, lagështinë etj.). Rrafshi i Dukagjinit (Dukagjini) është i mbrojtur nga erërat e ftohta në veri me vargmalet e larta të Bjeshkëve të Nemuna, prandaj klima në përgjithësi këtu është më e butë se ajo në Kosovë. Përveç kësaj këto anë kanë lartësi më të ulët mbidetare dhe nëpërmes të luginës së Drinit depërton ajri më i ngrohtë, kështu që ndihet në disa vise edhe ndikimi i klimës mesdhetare.[6] Kjo ndihet deri diku edhe në rajonin ku ndodhet Lugu i Baranit, gjë që shihet nga pyjet e mëdha të gështenjes rrëzë Bjeshkëve të Nemuna që nga Strellci, Lëbusha, Deçani e deri në Junik.

Në përgjithësi kushtet klimatike në Lug të Baranit janë të volitshme si për njerëz, ashtu edhe për botën shtazore e bimore. Mungesa e reshjeve të mjaftueshme gjatë verës plotësohet me ujitje artificiale nga rrjedhat e burimet e shumta, e sidomos nga Bistrica e Deçanit, të cilat gjatë gjithë verës kanë mjaft ujë.

Ujërat. — Rrjedha kryesore në Lug të Baranit është Bistrica e Deçanit. Këtë lumë popullsia e këtushme e quan vetëm Bistri-

[2] Jovan Marković, *Geografske oblasti SFR Jugoslavije*, Beograd, 1967, f. 382.
[3] Riza Çavolli, *Dukadjin (Metohija), Fizionomska i nodalno-funkcionalna regionalizacija*, Priština, 1977, 17.
[4] J. Marković, *vepra e cituar*, 384.
[5] Bojko Bojović, *Metohija (monografija)*, Priština, 1979, 20—22.
[6] Jovan Cvijić, *Osnovne za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*, knj. III, Beograd, 1911, 1139.

që, ndërsa fshatrat përjashta Lugut të Baranit e quajnë Bistricë e Deçanit, për ta dalluar nga Bistrica e Pejës, e cila rrjedh gjatë Lugut të Leshanit. Bistrica e Deçanit është lumë i vogël, i cili buron nga malet e afërme të larta në Bjeshkën e Isniqit Roshkodol, në një lartësi prej 2530 m. Nga kjo lartësi Bistrica rrjedh vrullshem midis Bjeshkëve të Rekës dhe Bjeshkës së Deçanit. Në pjesën e epërme ky lumë ka të gjitha veçoritë e rrjedhave malore. Ai ka thelluar në shkëmbinj shtratin e tij me brigje shumë të larta e të pjerrta nga të dyja anët. Në këtë pjesë ai rrjedhë shumë shpejt, sepse pjerrësia e shtratit është shumë e madhe. Këtu ai kalon nëpër ngushtica që kanë pamjen e grykës. Kur e kalon Deçanin, Bistrica fillon të rrjedhë si lumë fushor — me shpejtësi shumë më të vogël, krijon meandra (dredhë lumi), zgjeron shtratin, gërryen brigjet dhe kështu dëmton fushat, sidomos gjatë bregut të majtë të saj. Në disa vende shtrati është më se 100 m i gjerë. Nga malet e larta ajo sjell gurë, zhavor, rërë dhe materiale të ndryshme. Bistrica e Deçanit nga burimi deri në derdhjen e saj në Dri të Bardhë është e gjatë 53 km. Rënia e saj vertikale është 1832 m (diferenca e lartësisë mbidetare midis burimit e derdhjes), kështu që pjerrësia e rrjedhës është 36 promil. Kjo ka rëndësi për energjetikë, e cila deri tash është shfrytëzuar vetëm me ndërtimin e një hidrocentrali të vogël në Kozhnjer (6,40 MW), megjithëse në pjesën malore ky lumë disponon një bazë energjetike prej 80 milionë KWh, sipas llogaritjeve të ekspertëve.[7]


Njëra nga degët kryesore të Bistricës së Deçanit është Bistrica e Kozhnjerit, e cila buron dhe derdhet në viset malore. Edhe kjo bart shumë material malor në shtrat të Bistricës së Deçanit. Llogaritet se gjatë një viti kjo grumbullon rreth 900 m^3 material të tillë në 1 km^2, gjë që dëmton në masë të madhe fushat pjellore në rrjedhën e poshtme të saj.[8] Përroi Behoc është një nga degët e majta të Bistricës. Ky buron nga Bjeshka e Strellcit, është shumë i rrëmbyeshëm, sidomos pas shkrirjes së borës dhe pas shirave. Nga malet e larta sjell shumë material, madje edhe gurë të mëdhej disa tonash, kështu që në fushën pjellore të Strellcit, Isniqit, Dubovikut dhe të disa fshatrave të tjera, bën dëme tepër të mëdha, madje shumë më të mëdha se Bistrica, megjithëse gjatë verës ka pak ujë ose shterret fare. Në Bistricë derdhen edhe shumë përrenj të tjerë, qoftë nga Dushkaja në anën e djathtë, qoftë nga kodrat që shtrihen në anën e majtë të Lugut të Baranit, përkatësisht të Bistricës. Këta përrenj janë të vegjël, disa verës shterren, rrjedhën e kanë të shkurtër, sepse shumë nga këta burojnë nga kodrat e afërme. Ata zakonisht quhen me emrin e fshatit afër të cilit burojnë (p.sh. Prroni i Dashinocit, Prroni i Bardhaniqit, i Broliqit, Vranocit, Kosuriqit etj.). Në rrjedhën e sipërme, në viset malore, në Bistricë derdhen disa përrenj të vegjël: Përroni i Gjesë, Përroni i Belegut, Përroni i Zallit, Përroni i Rupës etj.

[7] Dushan Dukić, *Hidrografkse karakteristike SAP Kosova,* Pokrajinski zavod sa urbanizam, Priština, 1971, 219.
[8] R. Çavolli, *vep. cit.*, 63.

Lugu i Baranit është i pasur me ujë, sepse përveç Bistricës dhe përrenjve, rrëzë kodrave (madje disa edhe në fushë) burojnë shumë „kajnaçe" — burime me ujë të pishem, (kroje, përrenj „ama") të cilët gjithashtu derdhen në Bistricë drejtëpërdrejt, ose me anë të përrenjve. Këto burime janë aqë të forta saqë disa nga këta kanë nga „nji vadë ujë". Të gjitha kajnaqet shfrytëzohen për ujitjen e fushave. Bistrica si lumë malor ka ujë gjatë gjithë vitit. Kuptohet se gjatë verës, kur në këto vise bie pak shi, niveli i ujit në shtratin e saj zbret. Uji pakësohet kështu edhe për arsye se fshatrat në anën perëndimore të Lugut të Baranit e kthejnë ujin me „nalloga" (presa, digë të vogla nga dheu) në vija e jaze për ujitjen e fushave të tyre. Kështu ndodhë që disa fshatra të Lugut të Baranit kanë fare pak ujë gjatë verës. Kjo gjendje do të ishte edhe më e keqe sikur mos të ishin kajnaçet, të cilat deri diku e plotësojnë mungesën e ujit në Bistricë.

Fshatrat furnizohen me ujë të pishem nga bunaret (puset), të cilat nuk janë shumë të thella. Varësisht nga terreni, ato shkojnë deri 6—7 m. Uji i tyre është i lehtë dhe i shishem për pije. Në disa fshatra dhe në disa kodra të pabanuara, ka edhe burime të ujit të pishem.

Përbërja e tokës. — Nga se kushtet natyrore të Rrafshit të Dukagjinit janë të ngjashme për të gjitha zonat e vogla gjeografike të kësaj treve, edhe përbërja e tokës në Lug të Baranit është e ngjashme me strukturën pedologjike të lugjeve të tjera (të Lugut të Drinit, të Lugut të Leshanit etj.). Ky është një konstatim i përgjithësuar, sepse ndodh që edhe brenda një zone të vogël, madje edhe brenda një fshati, pjesët e ndryshme të terrenit të saj të kenë përbërje të ndryshme pedologjike.



Pamje e fushës pjellore të Lugut të Baranit

Nga llojet e ndryshme të tokës, në fshatrat e Lugut të Baranit ka në sipërfaqe më të mëdha smonicë, podzol dhe toka aluviale (rënore). Toka të kuqe ka pak, ato zakonisht gjenden në zona kodrinore dhe janë më pak të përshtatshme për kultura bujqësore. Tokat aluviale, të cilat popullsia fshatare i quan „ronishta", ose „ranishta", shtrihen pranë Bistricës. Kjo është tokë pjellore plot lym dhe material të imët, të cilin e ka shtresuar lumi. Toka podzole ndodhet më tepër në pjesën kodrinore të kësaj zone, ku bimët bujqësore kultivohen fare pak nga se cilësia e këtij lloji të tokës nuk është aqë e mirë. Podzoli shtrihet në një hapësirë mjaft të gjerë në fushat e fshatrave të kësaj treve. Pjesa e saj e cila ujitet përbëhet kryesisht nga aluviumi, në përmasa më të vogla nga smonica.[9] Smonica është tokë e përshtatshme për shumë bimë bujqësore. Kjo në Lug të Baranit shtrihet kryesisht nga Kosuriqi deri në Kpuz.[10] Smonica, e cila shtrihet në lugina të lumenjve në Rrafsh të Dukagjinit, zakonisht ka ngjyrë të murrme dhe përmban shtresa të konsiderueshme hekuri. Në luginë një pjesë e sipërfaqeve bujqësore përmban material aluvial, ndërsa rrëzë kodrave material deluvial. Procesi i gërryerjes (erozioni) është mjaft i fortë, sepse terreni kodrinor është i përthyer dhe në shumë vende i zhveshur nga bota bimore.[11] Tarracat e poshtme të lumenjve e të përrenjve janë nga sedimentet e petëzuara aluviale. Shtresat e rërës e të zallit të trashë të palosura me shtresa të zhavorit, nuk janë të rralla në këtë zonë. Këto janë materiale zalli e zhavori të sjella nga përroi i Behocit.[12]

Pra, siç shihet nga këto të dhëna të ekspertëve që merren me studime pedologjike, fundi i luginave të lumenjve, përkatësisht zonat fushore, kanë kryesisht tokë pjellore, siç janë aluviumi dhe smonica. Në luginat e lumenjve shtrihet aluviumi, ndërsa në pjesën kodrinore ka më shumë „gajnjaçë" me podzol dhe hapësira më të vogla mbulohen nga smonica, podzoli, deluviumi etj.[13] Një pjesë e rërës, dhe disa lloje të tjera të tokës në këto vise, është shtresuar që nga periudha e tretësorit kur Rrafshi i Dukagjinit ishte i mbuluar nga liqeni. Kodrat janë formuar në periudhën e re të tretësorit. Përbërja e tyre pedologjike është e përshtatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit.[14]

Bota bimore e shtazore. — Pjesa kodrinore e Lugut të Baranit është e mbuluar me pyje të vogla — të degraduara, me shkurra, kaçuba, dëllinjë etj. dhe me bar. Pyjet kanë drunj të ndry-

[9] *Po aty*, 77; J. Marković, *vep. cit.*, 385; B. Bojović, *vep. cit.*, 30.

[10] A. Stebut, *Agropedologija, III*, Beograd 1953, 240—242.

[11] V. Najgebauer, *Prilog poznavanju pedologije Južne Srbije*, Spomenica dvadesetpetgodišnjice oslobođjenja Južne Srbije (1912—1937), Skoplje, 1937, 181—188.

[12] Đorđe Zloković, *Prilog poznavanju zemljišta Metohije*, Beograd, 1951, 76, 88.

[13] Mark Krasnići, *Savremene društveno-geografske promene na Kosovu i Metohiji*, Muzej Kosova i Metohije, Priština, 1963, 13.

[14] Anton Melik, *Jugoslavija*, Ljubljana, 1958, 386.

shëm, por më tepër ka bung e qarr, pastaj lajthi, shkozë, shkemëz, thanë etj. Gjatë sundimit të Jugosllavisë borgjeze pyjet e rritura janë dëmtuar shumë, sepse ato ua ka dhënë shteti kolonistëve malazezë, bashkë me tokat pjellore të fshatarëve shqiptarë, e këta shitnin dru me shumicë nga parcelat e tyre. Mbas Luftës së Dytë Botërore këto kodra janë zhveshur gati krejtësisht nga pyjet e kaçubat, janë lavruar dhe shëndërruar në tokë pjellore në kuadrin e Kombinatit bujqësor të Pejës. Meqenëse toka nuk është e cilësisë mirë, rendimentet ishin të vogla dhe kështu, pas disa vjetësh shfrytëzimi, një pjesë e madhe e tyre u la djerrë dhe sot janë lëndinë e kullota me pak bar. Kështu bota bimore është varfëruar shumë, sidomos pyjet. Por, nga ana tjetër, këto sipërfaqe shfrytëzohen për kullota, sidomos kur fushat në luginë janë të zëna me kultura bujqësore.

Bota bimore në pjesën kodrinore të Lugut të Baranit është e ngjashme me zonat e tjera kufitare, sepse në kodra ndërmjet Pejës e Gjakovës nuk ka pyje të vjetra me drunj të lartë, por pjesa më e madhe e kësaj zone është e mbuluar me kaçuba dushku, me bung e qarr, që është pak më i lartë se trupi i njeriut. Sipas disa autorëve, në fillim të shekullit XX rreth 3/4 të Rrafshit të Dukagjinit ishin të mbuluara me dushk e qarr.[15]

Në pjesën fushore, në luginë, bota bimore është e begatshme. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve bujqësore janë livadhe të blerta, të pasura me bar të njomë e të bukura si lulishte. Vendasit thonë se Lugu i Baranit ka marrë këtë emër mu për arsye se kjo zonë është plot bar verë e dimër. Midis pronave të vogla e të shumta të fshatrave, shtrihet rreshti i shelgjeve, i verrave, i plepave, lajthive, mollëve të egra dhe thanave. Këto janë mezhda me të cilat kufizohen këto prona. Përgjat brigjeve të Bistricës shtrihen lluga të mëdha me shelgje, plepa, verra e shelgjishtra (rakita). Të gjitha këto mezhda e lluga zënë sipërfaqe të konsiderueshme toke pjellore, e cila kështu mbetet e pashfrytëzuar. Shikuar nga kodrat e afërme, këto mezhda japin pamjen e një pylli të madh në rreshta të gjatë të formave të ndryshme, brenda të cilëve shtrihen livadhe e ara të vogla. Përgjat këtyre mezhdave ka shumë hithëra, llabushë e kokutë me fletë të gjera dhe bimë të tjera të padobishme, ndërsa përgjat përrenjve ka fier e shevar dhe bar të njomë të quajtur pungac, ose pugac.

Bota shtazore në Lug të Baranit tash është e varfër, sepse nuk ka pyje ku do të strehoheshin egërsirat. Ujku, që dikur paraqiste rrezik të madh për bagëtinë e këtyre fshatrave, tani gati është zhdukur fare. Dhelpra ende fshihet në disa shpella në kodrat e kësaj zone, por edhe ajo shihet rrallë. Derri i egër ka qenë shumë i përhapur para nja 30—50 vjetësh në pyjet e Lugut të Baranit, kështu që bënte shumë dëm në ara të misrit e në kopshte të patateve. Këtu ka pasur gjuetarë të mirë të derrave. Tani nuk mund të shihet kjo egërsirë në këto vise. Lepuri, vjedulla dhe iriqi shihen më shpesh në këto kodra të zhveshura, ose pjesërisht të mbuluara

[15] J. Cvijić, *vep. cit.*, 1138.

me pyje të ulta. Shpezët në këtë zonë janë ato të zakonshmet — si kudo në Rrafshin e Dukagjinit: vremçi, sorra, sorra e larme, korbi, turreci, mëllia, strica, guguçja ((„gugujsufi"), pastaj dallandyshja, lejleku, patat e egra, rrikat e egra etj. Në Bistricë rriten disa lloje peshku — trofta, mustaku („mrena"), krapi („sparani"), ngjala etj.

Marrë në përgjithësi, bota bimore e shtazore në terrenin e Lugut të Baranit sot është më e varfër se ç'ka qenë përpara një gjysmë shekulli. Me prerjen e drunjve në pjesën kodrinore të kësaj treve, janë zhdukur pyjet e rritura dhe kanë mbetur shkurra e kaçuba. Madje në një pjesë të madhe të kodrave edhe këto janë prerë, duke hapur kështu toka të reja për kultura bujqësore. Mirëpo, kështu i është hapur rruga gërryerjes, erozionit atmosferik, kështu që shpatet e pjerrta të përrenjve janë zhveshur fare, ndërsa në pjesët e tjera kodrinore edhe bari vyshket shpejt nga rrezet e forta të diellit. Bishat, që dikur jetonin në këto male në numër të konsiderueshëm, disa janë zhdukur fare, ndërsa disa të tjera janë duke ndjekur këtë rrugë, sepse kanë mbetur pa strehim, që ua ofronte më parë natyra. Por megjithatë, i gjithë Rrafshi i Dukagjinit është një zonë e mbuluar me blerim, qoftë ky bar, kaçuba, shelgje, dushk etj., apo kopshte pemesh të ndryshme. Është kjo një ndër trevat më të bukura në Ballkan, me begati të shumta natyrore dhe me bimë të ndryshme bujqësore, të mbjella e të kultivuara me shumë kujdes e dashuri nga dora e fshatarëve të vyer dukagjinas. Kështu edhe Lugu i Baranit, me botën e tij bimore e shtazore, është një pjesë e vogël përbërëse e mozaikut të peisazhit pitoresk të Rrafshit të Dukagjinit. Megjithëse kjo botë e krijuar nga natyra është dëmtuar mjaft gjatë kohës, për të plotësuar nevoja të ndryshme të popullsisë vendase, prapë ajo



Procesi i grryerjes në kodrina të Lugut të Baranit

nuk është zhdukur krejtësisht, dhe ajo që është zhdukur është zëvendësuar me bimë të tjera më të përparuara e më të dobishme.

Zona kodrinore e Lugut të Baranit, sidomos shpatet e „grrellat" — anët e pjerrta e të zhveshura të përrenjve, kanë mbetur si njolla në këtë ambient plot blerim. Gërryerja e tokës të pambrojtur nga vegjetacioni është një proces i natyrshëm dhe shumë i dëmshëm, ashtu siç është i dëmshëm edhe erozioni fluvial, që e shkakton Bistrica në fushat pjellore, të cilat shtrihen përgjatë saj. Prandaj shtrohet si nevojë e domosdoshme dhe urgjente mbrojtja e ambientit gjeografik, përkatësisht mbrojtja e sipërfaqeve të tokës pjellore dhe të atyre sipërfaqeve kodrinore, të cilat mund të shndërrohen në tokë buke. Mbrojtja më e mirë, e cila njëkohësisht nuk kushton shumë, është pyllzimi i këtyre terreneve. Kjo punë duhet të bëhet në mënyrë të organizuar dhe me ndihmë të ekspertëve bujqësorë. Nga ana tjetër, vegjetacioni i tepruar dhe i panevojshëm, që rritet pa kurrfarë kontrolli nëpër mezhdat e shumta të arave e livadheve, duhet të seleksionohet, të pakësohet, sepse ai zë vendin e kulturave bujqësore nga një anë, ndërsa nga ana tjetër drunjtë e mëdhenj të shelgjeve, plepave, verrave etj. i dëmtojnë këto kultura edhe me hijen e tyre, mu në atë kohë kur këtyre u nevojiten rrezet e diellit për t'u rritur dhe pjekur me kohë. Vërehet se në Lug të Baranit, si edhe në viset të tjera të këtyre anëve, bota bimore rritet e zhvillohet jashtë kontrollit dhe intervenimit të njeriut, megjithëse edhe kjo është pjesë përbërëse e ekonomisë bujqësore të fshatarit tonë.

KUSHTET SHOQËRORE

Zhvillimi historik. — Në terrenin e Lugut të Baranit nuk ka punuar deri tash sistematikisht ndonjë ekip arkeologësh, kështu që nuk kemi të dhëna të botuara të kësaj natyre për lashtësinë e popullsisë e të vendbanimeve të kësaj zone, për të cilën gjithashtu nuk ekziston ndonjë studim i botuar nga asnjë aspekt shkencor, që do të mund ta shfrytëzonim me këtë rast si mbështetje për të krahasuar shkallën e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve — domethënë të objektit që e kemi në shqyrtim. Por para pak vitesh, arkeologët kanë filluar rekognoscimin e terrenit në disa fshatra dhe me këtë rast ata kanë gjetur këtu disa vegla guri, sëpata, thika dhe materiale të tjera arkeologjike, të cilat dëshmojnë për ekzistimin e një lokaliteti nga prehistoria, përkatësisht nga periudha e neolitit të vjetër. Gërmimet që duhet të bëhën në këtë lokalitet do të hedhin dritë mbi të kaluarën e lashtë të Lugut të Baranit. Kjo zonë ndodhet në rrethet e Pejës, e cila është trevë me interes të madh arkeologjik, për arsye të begatisë së objekteve arkeologjike të zbuluara këtu deri më tash. Kështu p.sh., para pak vitesh (1978/79), në periferinë e Pejës (ku është ndërtuar fabrika e baterive automobilistike), janë zbuluar materiale të rëndësishme, të cilat dëshmojnë për kulturën materiale të fisit ilir — dardan në Rrafshin e Dukagjinit.[16] Përveç kësaj, kah gjysma e shekullit II, Peja figuron në „Gjeografinë" e njohur të Ptolomeut (në harta) me emër Siparantu, kurse Siparanti dardan (Peja), në kohën e sundimit të Bizantit në këto vise, quhej Pentza, Pech, Peka.[17] Kjo qendër e vjetër duhet ta ketë pasur edhe rrethinën e saj me vendbanime të lashta. Kërkimet arkeologjike do të zbulojnë vendbanime të tilla edhe në Lugun e Baranit.

Me sa dihet, dokumentet e para, të botuara, në të cilat përmenden disa fshatra të Lugut të Baranit, janë mjaft të vjetra, ato datojnë nga gjysma e parë e shekullit XIV. Këto dokumente quhen „krisobula", me të cilat sundimtarët e ndryshëm nga dinastia mesjetare e Nemanjiqëve u dhuronin manastireve fshatra, pasuri dhe privilegje të tjera mbi fshatarët e këtyre anëve. Kuptohet se në trevën e Lugut të Baranit duhet të ketë pasur banorë e

[16] Fejaz Drançolli, *Burime materiale me elemente autoktone*, Rilindja, Prishtinë, 20. XII. 1982.

[17] Muharem Cërabregu, *Kosova në hartat e vjetra*, Prishtinë, 1977, 28.

vendbanime edhe shumë shekuj para shekullit XIV, por në mungesë të dokumenteve përkatëse për ato periudha të lashta, ne do t'i shqyrtojmë ato materiale që disponojmë.

Dihet se në mesjetë kisha kishte privilegje të mëdha në këto vise dhe ndikim të fortë në pushtetin shtetëror, i cili mbështetej në përkrahje të fesë, përkatësisht të klerit. Sundimtarët nga dinastia e Nemanjiqëve mbanin lidhje shumë të ngushta me kishën ortodokse. Prandaj ata ndërtuan shumë kisha, manastire, kapela, kuvende për murgj etj. jo vetëm në Serbi, por kudo shtrihej pushteti i tyre. Siç dihet, Dushan Nemanjiqi përfshinte brenda kufijve të shtetit të tij edhe Shqipërinë, e një pjesë të madhe të Greqisë.[18] Në Greqi Nemanjiqët e përkrahnin shumë manastirin e njohur Hilandar, ndërsa në Kosovë atë të Deçanit, të Pejës, një manastir afër Prizrenit etj. Ata ia kishin dhuruar Hilandarit dhe manastirit të Deçanit edhe disa fshatra të Lugut të Baranit.

Stefan Urosh Nemanjiqi, brenda viteve 1292 e 1303, ia kishte dhuruar manastirit Hilandar në Greqi disa fshatra të rrethinës së Pejës, ndër të cilat figurojnë edhe „dy Vranikët". Si duket, këtu është fjala për Vranocin e Epërm dhe Vranocin e Poshtëm, sot fshati — Vranoc në Lug të Baranit.[19] Në një dokument të këtillë të mbretit Stefan Deçanski, të vitit 1327, përmenden fshatrat: Kosuriq, Çeskovë, Çellopek, Gllogjan e Nepole. Pak më vonë, më 1330, në krisobulën e Deçanit, përmenden Krysheci e Broliqi me rastin e përcaktimit të mezhdave midis Prapaqanit dhe këtyre fshatrave. Me këtë rast përmenden Isniqi, Strellci, Lëbusha dhe shumë fshatra të tjera. Kështu Krysheci kufizohet me „kronin e Dubovikut pertej rrugës", ndërsa Broliqi me „rrjedhën e ujit që derdhet në Bistricë" — siç thuhet në këtë krisobulë.[20] Duket se midis Hilandarit dhe manastirit të Deçanit kishte mosmarrëveshje rreth pronave të tyre në këtë zonë, gjë që shihet edhe nga krisobulat e ndryshme të shekullit XIV.

Nga këto dokumente shihet mjaft qartë gjendja shoqërore-ekonomike e fshatarëve, të cilët kishin detyrime të ndryshme ndaj shtetit dhe ndaj kishës. Kështu në krisobulën me të cilën mbreti Dushan ia falte qelisë së Sveti Savës në Kare (Greqi) Kosuriqin me disa fshatra të tjera të Lugut të Baranit thuhet shprehimisht se të gjitha ato detyrime që këto fshatra i kanë pasur ndaj shtetit, tash e tutje do t'i kenë ndaj manastirit në fjalë, të cilit i falen këto fshatra me gjithë pasurinë e tyre (kopshte, livadhe, kullota, — mullinj etj.). Pra, fshatari ishte pronë e thjeshtë e huaj, bujkrob i kishës e i shtetit. Megjithëse nuk kemi ndonjë të dhënë konkrete, mund ta marrim me mend se sa i madh e i rëndë ishte vetëm detyrimi i këtyre fshatrave për t'ia dorëzuar produktet bujqësore manastirit Hilendar në Greqi, kur komunikacioni në relacione të tilla shumë të gjata bëhej vetëm me karvanë kuajsh.

[18] Ivan Božić e tj., *Istorija Jugoslavije*, Beograd, 1972, 51, 74.

[19] Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, 232.

[20] Pavle Ivić — Milica Grković, *Dečanske hrisovulje*, Novi Sad, 1976, 157, 196, 197.

Siç dihet, detyrimet e fshatarit në mesjetë ndaj kishës e shtetit nuk ishin vetëm taksat e ndryshme dhe dorëzimi i produkteve bujqësore, por edhe puna fizike, kulluku, për hesap të kishës, sidomos kur kjo ndërtonte ndonjë objekt të ri. Pra, gjendja ekonomike e përgjithësisht shoqërore e popullsisë së Lugut të Baranit në atë kohë ishte e njëjtë si për popullsinë e këtyre viseve në përgjithësi — e kushtëzuar dhe e përcaktuar nga rendi feudal shtetëror-kishtar. Por këtu shtypja e shfrytëzimi i fshatarit ishte më i theksuar për arsye të afërsisë hapësinore me dy qendra të rëndësishme të shfrytëzimit të tillë — manastirit të Deçanit dhe patrikanës së Pejës. Këto fshatra mund të kenë pasur detyrime më të mëdha edhe për arsye se toka e kësaj zone është e cilësisë së mirë dhe kështu bujku ngarkohej me dorëzimin e sasive më të mëdha të produkteve bujqësore.

Të dhëna më të plota e më të rëndësishme për njohjen e kushteve shoqërore kah fundi i mesjetës në këtë trevë datojnë nga viti 1485, d.m.th. 155 vjet pas të dhënave që i përmendëm këtu më lart. Fjala është për defteret turke, në të cilat janë regjistruar të gjithë kryefamiljarët dhe detyrimet e tyre, të gjithë meshkujt të moshës madhore të pamartuar dhe gratë e veja.[21] Të gjithë këta ishin të ngarkuar me detyrime të ndryshme qoftë ndaj shtetit me të holla (ispenxhe), qoftë me produkte bujqësore (ushur), të cilat i mblidhte zakonisht spahiu, që e kishte këtë të drejtë nga shteti. Në defter, përveç emrit të fshatit e të fshatarëve, përcaktohet shuma e të hollave dhe lloji e sasia e produkteve bujqësore me të cilat ishte i ngarkuar fshati për t'i dorëzuar. Në këtë mënyrë defteri në fjalë jep një pasqyrë të qartë e të plotë mbi gjendjen ekonomike të fshatrave dhe mbi mënyrën e shfrytëzimit të tokës, përkatësisht nga këto të dhëna shihet struktura e mbjelljes dhe e prodhimit bujqësor në përgjithësi. Defteri nuk përfshin blegtorinë, sepse për detyrimet që kishte fshatari ndaj shtetit me produkte blegtorale ekzistonte defteri i posaçëm dhe këto detyrime i paguheshin shtetit drejtpërdrejtë, e jo me ndërmjetësimin e spahiut. Në këtë defter ka të dhëna të këtilla për një numër të madh të fshatrave të Sanxhakut të Shkodrës, ku përfshihej edhe Rrafshi i Dukagjinit. Aty figurojnë 9 fshatra të Lugut të Baranit: Krysheci, Buqani, Barani i Epërm, Barani i Poshtëm, Kotradiqi, Gllogjani, Nepolja, Kosuriqi dhe Çeskova. Pra, për dy të tretat e katundeve të sotme të kësaj zone kemi të dhëna të rëndësishme mbi gjendjen shoqërore e ekonomike të tyre para 500 vjetësh. Këto të dhëna do t'i shfrytëzojmë me rastin e shqyrtimit të problematikës së popullsisë dhe të vendbanimeve të cilave u përkasin këto, ndërsa këtu po nxjerrim nga këto vetëm disa përfundime lidhur me kushtet shoqërore për të cilat dëshmojnë këto të dhëna.

Nga defteri i vitit 1485 shihet se marrëdhëniet shoqërore feudale ishin gjithnjë në fuqi, si në kohën kur fshatrat e Lugut të

[21] Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1974, f XIX—XXIII.

Baranit ishin pronë e manastireve të ndryshëm mesjetarë, megjithëse kushtet politike kishin ndryshuar krejtësisht — me pushtimin e Ballkanit nga Perandoria Osmane. Ndryshimi midis këtyre dy periudhave, përsa i përket pozitës shoqërore-ekonomike të kësaj zone, ishte ndërrimi i pronarit, ndërsa detyrimet e fshatarit ndaj tij ndryshonin më shumë nga forma sesa nga pesha e tyre. Fshatrat që i shfrytëzonte manastiri i Deçanit më parë, tani i shfrytëzonte spahiu, sepse këto ishin „timar" i tij. Kështu për shembull, Krysheci ishte timar i njëfarë Musait, të birit të Perper Ahmetit, Barani e Gllogjani, timarë të Mustafait, të birit të Jahjasë, Kosuriqi ziamet i Hasan beut etj. Pra, ndërsa më parë këto fshatra ishin „metoh" mesjetarë, në kohën e sundimit të Bizantit e të Nemanjiqëve, ose „vakëf" në kohën e feudalizmit osman, më vonë, gjatë procesit të ndryshimeve pronësore, ato bëhën çifligje të bejlerëve të Pejës e të Gjakovës. Pra, edhe emri Metohi (që edhe sot përdoret në gjuhën serbokroate për treven e Dukagjinit) është fjalë greke, vjen nga fjala „metoh" (pronë e kishës, vakëf).

Periudha nga mbarimi i shekullit XV e deri në sh. XIX mbetet mjaft e padokumentuar, për sa i përket zhvillimit historik të Lugut të Baranit. Por dihet se gjatë kësaj periudhe kushtet shoqërore-politike ishin njësoj në mbarë Kosovën. Kjo periudhë mban vulën e përgjithshme të marrdhënieve feudale në fshat. Shfrytëzimi i fshatarit nga klasa sunduese feudale dhe pushteti osman ishte dukuri e përgjithshme, por pesha më e madhe binte mbi ato zona, të cilat ishin më pjellore dhe më afër qendrës administrative, siç ishte Lugu i Baranit dhe disa zona të tjera të ngjashme në Dukagjin. Mbetet pra, vend për kërkime të reja arkivore etj. për ta plotësuar eventualisht këtë boshllëk edhe për këtë trevë. Mirëpo, në saje të botimeve më të reja, qysh tash disponojmë disa të dhëna mbi gjendjen shoqërore-politike në Dukagjin në sh. XVI dhe XVII. Kështu, më 1560, për arsye të gjendjes së vështirë të tyre, fshatarët e rrethit të Pejës u ngritën kundër pushtetit turk. Në krye të fshatarëve ishte vënë Pjetër Bogdani (Plaku) nga fshati Dush, afër Pejës. Po në këto vise fshatarët çojnë krye edhe më 1580, 1788 etj. Madje, këta tani gëzonin përkrahjen edhe të disa pronarëve të tokave nga qyteti, të qehajëve etj., të pakënaqur me pushtetin turk. Në një raport dërguar portës së Lartë nga zyrtarët e këtyre viseve, më 1588, thuhet se edhe vojvoda i Sanxhakut të Dukagjinit, Idrisi, dhe personi i quajtur Ali Curri, „bëhen udhëheqës — prijatar të disa kryengritësve". Relatori Pjetër Budi në vitin 1620 iu drejtua me një raport kardinalit Kokadino në Romë në lidhje me organizimin e një kryengritje në Shqipëri dhe në viset e tjera të Ballkanit. Ai, përveç të tjerave, vë në pah se popullsia e rajonit të Dukagjinit, e cila pareshtur është në kryengritje kundër turqve, ka 6000 njerëz të aftë për luftë.[22]

Në luftën austro-turke më 1690, siç dihet, muarën pjesë në anën e ushtrisë austriake disa mijëra vullnetarë shqiptarë, në krye me arqipeshkvin e Shkupit Pjetër Bogdanin, bashkë me vullneta-

[22] S. Rizaj, *vep. cit.*, 481, 482, 492.

rët serbë, në krye me patrikun e Pejës Arsenije Crnojeviq. Numri i vullnetarëve shqiptarë ishte i madh, sidomos në rrethet e Pejës, siç dëshmon edhe një dokument i asaj kohe ku thuhet „3000 kryengritësit shqiptarë e muarën kasabën e Pejës.[23]

Në këtë kohë Peja pëson një katastrofë të përgjithshme nga epidemia e murtajës. Nga kjo kohë duhet të jenë „vorret e hasallakut" në disa fshatra në Lug të Baranit, si edhe në vise të tjera të Kosovës. Në një raport të misionarëve katolikë, dërguar papës në Romë më 1671 mbi gjendjen e kishës në dioçezin e Shkupit, përmendet edhe fshati Gllogjan me 8 katolikë (shtëpi?).[24] Nga ky raport nuk shihet se për cilin Gllogjan është fjala, sepse ka edhe disa fshatra në Kosovë po me këtë emër. Por, meqenëse bashkë me këtë përmendet edhe fshati Poçestë, i cili ndodhet afër Lugut të Baranit, mund të supozojmë se këto të dhëna i referohen Gllogjanit të kësaj zone, ku edhe sot të gjithë banorët janë të besimit katolik dhe ku ndodhet edhe kisha e tyre.

Siç dihet, marrëdhëniet feudale në këto vise nuk përfunduan me shkatërrimin e Perandorisë turke më 1912, sepse pronarë të tokës ishin feudalët shqiptarë vendës, të cilët nuk u larguan me ndryshimin e gjendjes politike në këto vise. Madje, ata disa vjet gëzuan përkrahjen e pushtetit të ri borgjez — përkatësisht të Jugosllavisë e cila u krijua pas Luftës Parë Botërore. Deri kah vitet '30 të këtij shekulli shumë fshatarë të Lugut të Baranit ishin çifçinj dhe ia jepnin beut të katërten e prodhimit të drithërave, kurse disa të tjerë i kishin blerë tokat nga feudali qysh më parë.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare gjatë shekullit XIX kishte jehonë të madhe edhe në popullsinë e Lugut të Baranit. Kjo për arsye se patrioti i njohur Haxhi Zeka, kishte pasur ndikim të madh në këtë zonë, para së gjithash në shtëpinë e Bajraktarit të Vranocit, që ishte i Krasniqës, një fis me Haxhi Zekën, si edhe në shumë fshatra të tjera të kësaj lugine, ku gati një e treta e popullsisë është e këtij fisi. Përveç kësaj, Lugu i Baranit nuk është larg Junikut — qerdhes së njohur të Lëvizjes Kombëtare, ndërsa Verrat e Llukës, ku bëheshin shumë mbledhje dhe ku lidhej besa e kryengritësve shqiptarë për luftë kundër pushtetit dhe ushtrisë turke, janë në kufi me këtë trevë. Më në fund, edhe nga aspekti i pozitës gjeografike Lugu i Baranit zë vend qendror në nahijen e Pejës e të Gjakovës, në një trevë pra, e cila gjithmonë është dalluar nga revolta dhe luftëra të shumta kundër shtypjes kombëtare dhe shfrytëzimit ekonomik.

Sipas traditës së vendit, popullsia e Lugut të Baranit mori pjesë aktive me armë në dorë në ushtrinë vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 1878—1881. Madje, Rexhë Bajraktari nga Vranoci ishte pjesëmarrës i dalluar në organet e Lidhjes, dhe ky, si bajraktar, e kishte gjithë popullsinë e bajrakut të Vranocit mbas veti në çdo rast. Më vonë, Ali Bajraktari ishte gjithashtu një ndër faktorët e dalluar në lidhjen e besës te Verrat e Lukës, përkatësisht të Besëlidhjes së Pejës, më 1897 e 1899, në krye me patriotin

[23] *Po aty*, 512.
[24] *Po aty*, 472.



Kulla e gurit në Vranoc

e njohur Haxhi Zekën, si edhe në tubimin te Verrat e Llukës, më 1909, ku gjithashtu u lidh besa për të kundërshtuar pushtetin shtypës e mashtrues të xhonturqve (turqve të rinj). Rexhë Bajraktari, pas shkatërrimit të Lidhjes së Prizrenit, u dënua nga pushteti turk me 6 vjet burg në Manastir, ndërsa kushëriri i tij Ali Bajraktari i vuajti 3 vjet burg në Shkup.

Por, fshatarët e Lugut të Baranit nuk luftuan kundër pushtetit turk vetëm larg trojeve të tyre. Ekspeditat ushtarake ua imponuan këtyre luftën e përgjakshme edhe në fushat e fshatrat e tyre, me ç'rast ata e kundërshtonin me trimëri, nga kullat e tyre të fortifikuara, armikun e armatosur me topa dhe armë të tjera moderne. Kështu ka hyrë edhe në histori lufta që u zhvillua në Lug të Baranit, më 11 korrik 1893, në krye me Haxhi Zekën, kundër ushtrisë turke, të komanduar nga Mustafa Çerkez pasha. Kah fundi i majit të vitit 1893 Haxhi Zeka kishte filluar të ftojë popullsinë e Pejës e të rretheve që të ngrihej në luftë kundër pushtetit turk. Ai donte të shfrytëzonte momentin e volitshëm kur edhe popullsia e Drenicës dhe e rretheve të Lipjanit luftonte kundër xhandarmërisë e ushtrisë turke, dhe kështu përpiqej që kryengritja të përhapej edhe në vise të tjera, dhe të çliroheshin nga sundimi turk. Një ushtri e madhe turke nga Peja, Mitrovica, Berana, Shkupi e Prizreni, në krye me komandantin Mustafa Çerkez pashën, u drejtua kundër Haxhi Zekës dhe kryengritësve të tij. Haxhi Zeka ishte tërhequr që me kohë në Lug të Leshanit, në kullën e tij të fortë tri-katëshe prej tullash në fshatin Leshan, nja 15 km në lindje të Pejës, fshat ky që ishte pronë e tij. Haxhi Zekës i erdhi në ndihmë një numër i madh vullnetarësh edhe nga nahija e Gjakovës; Bajram Curri me njerëz të vet dhe krerët shqiptare nga Kosova kishin vendosur t'i shkojnë në ndihmë. Përleshja filloi më 11 korrik dhe luftimet më të ashpra u zhvilluan në Lug të Baranit. Ushtria turke përbëhej më tepër nga kurdët e çerkezët. Një bateri topash, që vepronte pa ndërprerje, e kishte bërë hi e pluhur fshatin Vranoc dhe i kishte dëmtuar rëndë disa fshatra të tjera. Lufta mes kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë turke vazhdoi gjithë ditën pa ndërprerë, kështu që nga të dy palët pati shumë të vrarë e të plagosur. Duke parë se nuk mund të qëndronte me forca të veta dhe me pak armë, kundër gjithë asaj ushtrie të armatosur deri në dhëmbë, Haxhi Zeka u detyrua të pranonte ndërmjetësinë për marrëveshtje dhe lufta u ndërpre.[25] Vetë fakti se kjo përleshje e përgjakshme kundër ushtrisë turke u zhvillua mu në Lug të Baranit, tregon se këtu organizimi i rezistencës ishte më i fortë dhe forcat vullnetare nga nahija e Gjakovës me numër më të madh (sepse kjo zonë kufizohet me rethinat e Gjakovës). Përveç kësaj turqit e dinin se Haxhi Zeka mbështetej shumë në bajrakun e Vranocit, me rreth 40 fshatra, i cili edhe në të kaluarën kish treguar gatishmëri dhe aftësi për të kundërshtuar pushtetin turk. Prandaj topat e Mustafa Çerkez pashës iu drejtuan kullave të Vranocit. Por kjo nuk ishte as hera e parë as e fundit që muret e tyre të forta i bënin ballë zjarrit të armikut.

[25] Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës 1878-1912*, Prishtinë, 1969, 81-83.

Për këtë ngjarje historike dëshmon edhe tradita e gjallë, e cila përcillet brez pas brezi në Lugun e Baranit. Kjo i plotëson të dhënat e njohura të shkruara me disa detaje të rëndësishme. Kështu, pleqtë tregojnë se bashkë me ushtrinë turke kishin luftuar kundër forcave të Haxhi Zekës e të Bajram Currit shumë bashibuzukë shqiptarë, në krye me aganë e Botushës, Demali Deçanin etj. Çerkez pasha me 6 taborre u vendos në Kotradiq. Topat i kishte ngrehur mbi kodër të Kotradiqit, nga shihet shumë mirë Vranoci, të cilin e qëlloi me shumë gjyle. Lufta zgjati më 10 e 11 korrik 1893. Kryengritësit, pas qëndresës së fortë, detyrohen nga zjarri i artilerisë turke të tërhiqen. Ata nëpër pyje të cilat i mbulonin kodrat përreth, dalin në Rosujë, kalojnë Bistricën e Pejës dhe largohen në Lug të Leshanit.[26]

Gjatë Luftës Ballkanike Lugu i Baranit e ka hequr të zitë e ullirit nga ushtria e xhandarmëria e krajl Nikollës, që e pushtuan Rrafshin e Dukagjinit. Pushteti malazez i asaj kohe bënte kerdi në këto vise, duke vrarë me qindra shqiptarë të pafajshëm. Me terror të përgjakshëm ushtria malazeze, me ndihmën e kishës ortodokse, i detyronte shqiptarët që ta ndërronin fenë e kombësinë, të bëheshin ortodoksë e të sllavizoheshin. Këtë aksion e zbatonin me shkop e shpatë komandanti i xhandarmërisë malazeze Sava Llazareviq, vojvoda Pllamenac, vojvoda Lekiq etj. Sava Llazareviqi kishte pushkatuar qindra e qindra shqiptarë që s'pranonin të mohonin kombësinë e vet. Për vrasjet e panumërta që i bëri ky kriminel popullsia shqiptare e quante Savë Batarja. Ai vazhdoi të ishte kriminel gjatë gjithë jetës së tij, edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore — si çetnik i Drazha Mihajlloviqit, kur më në fund mori shpërblimin që e meritonte me kohë — plumbin partizan në kokë.[27] Terrori i vitit 1913 ishte i egër sidomos kundër popullsisë së Lugut të Baranit e të Rugovës e në Bellë mbi Deçan. Kështu xhandarmëria malazeze vrau Hazir Alinë me 13 vetë të tjerë në Baran. Në pranverën e hershme të vitit 1913 ushtria përmblodhi popullsinë e Lugut të Baranit — gra, burra, pleq e fëmijë, dhe i solli në Pejë për t'i pagëzuar me dhunë. Kështu arritën në qytet me bajraktarin e Vranocit në krye. Popat ortodoksë pritnin mbi urë, të veshur në rrobat e kishës, me enë plot ujë për t'i pagëzuar duke i lagur me „ujë të bekuar" popullsinë e torturuar e të frikësuar. Për çdo familje „të pagëzuar" ishte caktuar „kumbara" serb — nga Bellopoja, Gorazhdeci, Peja etj. Me këtë rast u vranë dhe u burgosën shumë vetë, por kjo qëndresë e popullsisë së Lugut të Baranit nuk mbeti pa jehonë dhe pa rezultate.[28]

Në terrorin që bëhej kundër shqiptarëve merrte pjesë me dorë të vet edhe komandanti Veshoviq, i cili vriste e plaçkiste, si ushtarët e tij. Ai e plaçkiti edhe kullën e Bajram Currit në Gjakovë. Në raportin e sekretarit të këtij gjenerali, nënkolonelit Mi-

[26] Kallëzim i Musli Krasniqit nga Vranoci.

[27] Radovan Zogović, *Došljaci*, Beograd, 1958, 38.

[28] Kallëzim i shumë pleqve nga Lugu i Baranit (Mustafë Mahmuti — Baran i Poshtëm, Daut Kolica, Musli Krasniqi etj.)

llovanoviq, thuhej: „Terror të tillë, siç e bën Veshoviqi ndaj shqiptarëve, ky popull kurrë nuk ka përjetuar".[29]

Gjatë sundimit të Jugosllavisë borgjeze populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e në Mal të Zi ishte i shtypur. Gjatë gjithë kohës së sundimit të saj, qeveria e atëhershme jugosllave merrte masa të ndryshme për t'i zhdukur shqiptarët nga trojet e tyre. Me këtë qëllim shqiptarët vriteshin nga xhandarmët ose nga vojvodët e „povereníkët" (njerëz të besuar) të qeverisë. Ata burgoseshin e torturoheshin pa kurrfarë faji, nuk kishin të drejtë shkollimi në gjuhën amtare, nuk kishin të drejtë të hynin në punë, ngarkoheshin me taksa të rënda dhe u merreshin tokat pjellore, të cilat u jepeshin kolonistëve të sjellë nga Mali i Zi, Serbia, Bosna e Hercegovina, Lika etj.

Pozita e fshatarsisë së varfër ishte shumë e rëndë për shkak të eksploatimit brutal të përhershëm të saj. Masat punonjëse shqiptare, të cilat e përbënin shumicën e popullsisë së kësaj treve, ishin në pozitë të rëndë — si në pikëpamje politike, ashtu edhe nacionale. Borgjezia serbe ndiqte politikë asimiluese ndaj shqiptarëve. Ata nuk kishin as të drejtat më elementare, nacionale dhe demokratike, të drejtën e përdorimit të gjuhës së vet në punët publike, të shkollimit në gjuhën amtare, të zhvillimit të kulturës nacionale, të individualitetit kombëtar etj.[30]

Reforma e ashtuquajtur agrare kishte për qëllim kryesor marrjen e tokës nga fshatarët shqiptarë dhe dëbimin e tyre për në Turqi. Këtë e thotë në librin e vet edhe nëpunësi i Zyrës Kryesore Agrare në Shkup Gj. Kërstiqi, i cili shton se, sipas programit të qeverisë, në viset kufitare me Shqipërinë duhet të kolonizohet një numër sa më i madh i kolonistëve serbë e malazezë, pastaj në viset e tjera me popullsi shqiptare të zvogëlohet e të shpartallohet kompaktësia e kësaj popullsie, duke infiltruar në mesin e saj elementin serb dhe, më në fund, t'u merret toka më pjellore fshatarëve shqiptarë, kështu që të detyrohen për t'u shpërngulur për në Turqi.[31] Më 1921 qeveria jugosllave proklamoi anulimin e marrëdhënieve feudale në të ashtuquajturën Serbi Jugore (Kosovë e Maqedoni), kurse kah fundi i vitit 1920 hyri në fuqi Dekreti mbi kolonizimin e „viseve jugore". Kështu filloi kolonizimi i viseve të Gjilanit (Morava), të Llapit dhe të Rrafshit të Dukagjinit, e pastaj vazhdoi në Drenicë e në pllajën e Kosovës. Deri në fund të vitit 1936 në mbarë Kosovën e në Maqedoni u sollen dhe u kolonizuan 15.594 familje dhe u ndërtuan 11.289 shtëpi për to. Kolonistët u sollën kryesisht nga Mali i Zi, Serbia, Lika, Hercegovina etj.[32] Shteti i mori shumë komplekse pyjore, kullotat e lendinat e fshatrave dhe ua dha kolonistëve. Përveç kësaj, çdo kolonist mori edhe nga 2 hektarë tokë pjellore (të cilën shteti ua konfiskoi fshatarëve shqiptarë). Shtëpitë e kolonistëve kryesisht ndërtoheshin përgjatë rrugëve kryesore (Mitrovicë-Prishtinë-Pejë-Gjakovë-Prizren-Ferizaj-Gjilan) dhe këto vendbanime të tyre shpeshherë mbanin emrin e vendit, ose të krahinës, nga kishin ardhur në Kosovë, si p.sh. Srbobran, Srbovac, Srbica, Shumadija etj.[33] Më 1926 qeveria jugosllave lidhi një marrëveshje me qeverinë turke për shpërnguljen e 400.000 shqiptarëve nga Jugosllavia për në Turqi. Për realizimin e plotë të kësaj marrëveshjeje, ajo me 1938 nënshkroi në Ankara konventën me qeverinë turke për shpërnguljen e shpejtë të 250.000 shqiptarëve dhe të vazhdojë shpërngulja e tyre për në Turqi gradualisht si vijon: në vitin 1939 — 4000 familje, më 1940 — 6000 familje, më 1941 — 7000 familje, 1943 — 8000 familje dhe më 1944 — 8000 familje. Për çdo familje shqiptare të shpërngulur, Jugosllavia i paguante Turqisë nga 500 lira turke. Kështu u muarën masa drastike për zhdukjen e shqiptarëve nga trojet e tyre, duke i dëbuar nga tokat e tyre pjellore, për t'i vendosur në vend të huaj, në shkretëtira të Anadollit, përgjat kufirit turko-irakian, në viset e kurdëve, të cilët luftonin kundër pushtetit turk dhe kërkonin autonominë e tyre.[34]

Për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova e Maqedonia angazhohej në mënyrë të posaçme Klubi Kulturor Serb, ku më 1937 e paraqiti projektin e vet të njohur prof. Vasa Çubrilloviq. Ai propozon aty masat më brutale për shpërnguljen e shqiptarëve me dhunë, terror, tortura dhe vrasje. Ky Klub e kishte devizën e tij — „Çdo gjë për kolonizim dhe për asimilim!" Për të arritur këtë qëllim, ai kishte në programin e tij këto 3 pika: a) çarmatimin e shqiptarëve, b) propagandën për shpërngulje, c) burgimet, përsekutimet, terrorin.[35] Qeveria borgjeze jugosllave përpiqej që „të përmirësohej" struktura kombëtare në Kosovë, ku 80—90% të popullsisë së gjithëmbarshme e përbënin shqiptarët, kështu që me shpërnguljen e tyre dhe me kolonizimin e këtyre viseve me 470.000 serbë e malazezë, 60% e popullsisë do të ishte sllave. Prej 1921—1931 popullsia e gjithëmbarshme e Kosovës ishte shtuar 18,5% kurse kolonistët 30%. Drejtori i Statistikës së Përgjithshme Shtetërore, Borivoje Panjevac, shkruante se rreziku më i madh për serbët ishte rritja natyrore e numrit të shqiptarëve, „pllesh-mëria e nënës shqiptare".[36]

Deri në fund të vitit 1939, vetëm në rrethin e Pejës, qeveria i kishte vendosur 7972 kolonistë, kështu që ata përbënin 14,3% të popullsisë së kësaj zone (shqiptarë kanë qenë 31.992, përkatësisht

[29] Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918—1928)*, Prishtinë, 1981, 18.

[30] Ali Hadri, *Lëvizja Nacional-çlirimtare në Kosovë 1941—1945*, Prishtinë, 1971, 24—27.

[31] Haki Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918—1941*, Prishtinë, 1981, 42—97, 159, 160; Djordje Krstić, *Kolonizacija Južne Srbije*, Sarajevo, 1928; Kosta Novaković, *Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*, „Liria Kombëtare", Vjenë, 15. IX 1931; Ali Hadri, *Marrëdhëniet agrare dhe lufta e PKJ në Kosovë-Metohi kundër reformës agrare të padrejtë të Jugosllavisë borgjeze*, Përparimi, nr. 9—10, Prishtinë, 1964.

[32] Atanasije Urošević, *Agrarna reforma i naseljavanje u Južnoj Srbiji*, Spomenica dvadesetpetgodišnjice oslobodjenja Južne Srbije, Skopje, 1937.

[33] Milisav Lutovac, *Današnje naseljavanje Metohije*, Glasnik Geografskog društva, XX, Beograd, 1934, 63, 68.

[34] H. Bajrami, *vep. cit.*, 159, 160.

[35] *Po aty*, 91, 161, 162.

[36] *Po aty*, 160—161.

54,4%, sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe.[37] Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë së Jugosllavisë, në rrethin e Llapit deri më 1918 nuk ka pasur asnjë familje sllave. Me kolonizimin e serbëve dhe të malazezve nga viset e ndryshme të Jugosllavisë në këtë zonë, popullsia sllave arriti në 12,5% të popullsisë së saj.[38]

Dendësia agrare në Kosovë ishte e theksuar qysh kah fundi i shekullit të kaluar, madje edhe më parë. Prona të mëdha kishin vetëm bejlerët dhe agallarët e vendit, kurse fshatari çifçi disponon-te vetëm ngastra të vogla në tokën e feudalit, mjete fare primitive, kështu që rendimentet ishin shumë të ulëta, madje edhe nga këto beu e merrte të katërtën. Me kolonizimin e këtyre viseve kjo gjendje u keqësua tepër. Më 1931 në Kosovë më se 37,5% të familjeve fshatare shqiptare kishin 2—5 ha, kurse 25,5% të familjeve koloniste kishin 5—10 ha tokë. Nga ana tjetër, familjet shqiptare kishin 10 deri 30 pjesëtarë, ndërsa familjet koloniste 5 deri 6 pjesëtarë.[39]

Kundër politikës të terorit dhe të shpërnguljes së dhunëshme të shqiptarëve nga trojet e tyre, luftonte Partia Komuniste, e cila atëherë edhe ajo vetë ishte e ndjekur dhe e persekutuar. Megjithatë, organi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë „Proleter" më 20. I. 1930 njoftonte opinionin e ndershëm botëror se fshatarëve shqiptarë në Jugosllavi pushteti antipopullor po u merrte tokat në tërësi, kështu që atyre në këtë situatë u mbetnin dy alternativa: ose të çoheshin kundër regjimit gjakatar, ose të shpërnguleshin. Sipas një statistike sekrete të policisë të Jugosllavisë borgjeze, në Kosovë ishin likuiduar, vetëm gjatë viteve 1919—1924, më se 2.600 patriotë shqiptarë, kurse deri në fund të vitit 1927 numri i viktimave kalonte 3000 vetë.[40]

Këto masa merreshin në mënyrë drastike me qëllim që shqiptarët të deklaroheshin turq dhe të shpërnguleshin për në Turqi e tokat e shtëpitë e tyre t'u mbesnin kolonistëve. Fshatari shqiptar edhe ashtu ishte në gjendje të mjerueshme ekonomike — me pak tokë e me shumë pjesëtarë të familjes, merrej vetëm me bujqësi, e cila jepte rendimente fare të vogla, kështu që disa qindra mijëra njerëz u detyruan të emigronin për në Turqi, e një numër i vogël për në Shqipëri.

Të këtilla ishin kushtet shoqërore në atë kohë edhe në Lug të Baranit. Madje, masat e qeverisë borgjeze jugosllave këtu zbatoheshin në mënyrën më brutale. Me qindra familje kolonistësh u kolonizuan në tokat pjellore dhe në kodrina të Lugut të Baranit, sipas vendimit të „agrarit" (organe të të ashtuquajturës reformë agrare, në bazë të së cilës u merrej toka fshatarëve shqiptarë), ndërsa një numër i madh xhandarësh ishte vendosur në staci-

[37] Miloven Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918—1941)*, Prishtina, 1981, 223.

[38] *Po aty*, 224.

[39] *Proizvodne snage NR Srbije*, Beograd, 1953, 55.

[40] „Proleter" — organ KPJ, 20. I. 1930, (sipas H. Bajrami, *vep. cit.*, 155).

nin e xhandarmërisë në Çellopek, ku torturoheshin fshatarët për „faje" të cilat i trillonin xhandarët vetë. Njëzet shtëpive në fshatin Baran, Vranoc etj. ua kishin vënë pllakatat e shtypura në derë të oborrit, me të cilat urdhëroheshin kryefamiljarët që brenda 10 ditësh të shpërnguleshin për në Turqi. Ky ishte urdhër i prerë i „naçallnikut" (prefektit) të Pejës. Mirëpo, masat brutale, që merreshin në këtë zonë nuk ia arritën qëllimit kryesor, sepse asnjë familje nga Lugu i Baranit nuk i lëshoi trojet e veta, nuk u shpërngul për në Turqi. Madje, në disa raste, fshatarët shprehen revoltë spontane dhe i dëbuan kolonistët nga arat e tyre, si ngjau p.sh. në fshatin Kryshec. Mirëpo, xhandarmëria, edhe me armë i dëboi fshatarët nga arat që ua kishte marrë „agrari". Kuptohet se revolta individuale kishte vazhdimisht, sepse edhe provokacionet nuk mungonin.

Se sa e vështirë ishte gjendja e popullsisë së Lugut të Baranit në atë kohë tregon edhe një rast drastik, nga i cili shihet se shqiptarët e kishin edhe jetën në rrezik nga xhandarmëria dhe „povereniket" e tyre, të cilët, nga pusia, vritnin njerëz të pafajshëm. Kështu iu kurdis pusia edhe bajraktarit të Vranocit — Haxhi Bajraktarit dhe Hajri beut, nipit të Haxhi Zekës, më 1928 ndërsa këta, bashkë me shokun e tyre Osman Xhemajlin nga Leshani, ktheheshin nga Peja me një karrocë. Xhandarët dhe njerëzit e tyre ishin së bashku në pritë. Mirëpo nga të shtënat e tyre u vranë Osman Xhemajli dhe karrocieri Rexhep Krasniqi (Ustah Xhema), ndërsa Haxhi Bajraktari e Hajri beu shpëtuan. Edhe ky ishte një aksion për ta demoralizuar popullsinë e kësaj ane, me qëllim që të shpërngulet për në Turqi. Madje, për këtë qëllim, pushteti i kishte blerë edhe disa hoxhallarë, të cilëve u jepte nga 100 dinarë në muaj, për të përhapur propagandë në xhematë se sa punë e mirë do të ishte sikur të shkonin për të jetuar në Turqi, ku do të gjenin „të gjitha të mirat" dhe do të jenë njerëz „të lirë e të kënaqur në shtetin e tyre mysliman". Kështu flitnin disa njerëz të shitur për shkretëtirat e Anadollit, ku fshatari shqiptar e fitonte kafshatën e bukës vetëm atëherë kur gjente rastin për t'u shitur si argat në tregun e qyteteve anadollake dhe ku ishte i shtypur e i përbuzur si „arnaut i egër". Por, as kjo veprimtari trathtare e një pjese të klerit mysliman nuk piu ujë te fshatarët e Lugut të Baranit.

Fshatarët e Lugut të Baranit kërkonin rrugë të ndryshme për të shpëtuar nga gjendja e mjerueshme në të cilen i kishte sjellë politika antipopullore e qeverisë borgjeze jugosllave. Gjendjen e tyre, si edhe të të gjitha fshatrave të tjera të Kosovës, e shfrytëzonin pa mëshirë avoketët, nëpunësit, kandidatët për deputetë dhe partitët borgjeze në parlament, të cilat kishin antagonizma mes veti, dhe u premtonin shqiptarëve përkrahje për të fituar votat e tyre, ndërsa në të vërtetë të gjithë ishin përkrahës të hapur ose të fshehur të politikës qeveritare antishqiptare. Kështu, p.sh. për t'i nxjerrë tokat që ua kishte marrë „agrari" më 1933 (për të cilat shqiptarët vazhdimisht paguanin tatim të rëndë dhe i punonin „për gjysë" — gjysmën e prodhimit ia jepnin kolonistit, të cilit ia kishte dhënë qeveria tokën) — fshatarëve të Ba-


ranit avokati i Pejës Luba Vuksanoviq u premtonte sukses të sigurt, nëse e angazhonin dhe e paguanin mirë për këtë punë. Ai në të vërtetë i nxori vetëm rreth 35 ha kodrina me kaçuba e drunj të ulët, tokë jopjellore. Mirëpo, për këtë „sukses" ai ua muar fshatarëve të varfër 30.000 dinarë, shumë kjo më e madhe sesa ishte vlera e këtyre kodrave të thata. Fshatarët edhe tash e përmendin këtë plaçkitje, dhe shumë të tjera, të avoketëve të asaj kohe, kur p.sh. çmimi i kaut ishte deri 500 dinarë, një dele kushtonte jo më shumë se 40 dinarë, 100 kg misër 40 dinarë, kurse nga 1 ha merrnin 1100 kg miser, ose 1000 kg grurë. Fshatari e linte veten dhe familjen e tij pa drithë në hambar e pa lopë në grazhd, për të paguar tatimin e tokës së vet, të cilën e shfrytëzonte tjetërkush, për honorarin astronomik avokatëve të paskrupula e pa ndërgjegje, për gënjeshtrat e tyre, për ryshfetin nëpunësve të korruptuar dhe gjobat e ndryshme për gabime që nuk i bënin, por i trillon nëpunësit e komunës në Baran dhe xhandarët në Çellopek.

Ngjarjet e vitit 1937 në Baran do të hyjë në historinë e kësaj treve si një dëshmi e pamohueshme dhe e hidhur për gjendjen e vështirë shoqëroro-politike të popullsisë së Lugut të Baranit, por edhe si argument i gjallë për shpirtin revolucionar dhe guximin burrëror të masave të shkelura popullore. Në këtë vit pra, bëheshin votimet për deputetë të parlamentit, në të cilin bënin pjesën më të madhe dy partitë kryesore — Partia Radikale, që e përkrahte krajlin e qeverinë, dhe Partia Demokratike, e cila ishte në opozitë. Në Pejë ishin dy kandidatë kundërshtarë — avokat Miro Protiqi (të cilin shqiptarët e quanin Mira i Protës) në listën e radikalëve, dhe drejtori i gjimnazit Velimir Jojiq, në listën e demokratve. Shqiptarët i mashtronin demokratët se gjoja ata do të luftojnë në parlament për tokat e tyre dhe për gjendjen e tyre të përgjithëshme. Ngase zgjidhej vetëm një kandidat, Lugu i Baranit votoi për listën e demokratëve. Mirëpo, organet e pushtetit, „naçallniku" Rakushiq (prefekti i Pejës) i anuluan votimet në Komunën e Baranit dhe urdhëruan që ato të bëheshin përsëri, me shpresë se fshatarët do të frikësoheshin nga kërcënimet e xhandarmërisë dhe do të votonin për listën e radikalëve. Por, kësaj here popullsia e Lugut të Baranit u tregua edhe më e vendosur. Megjithëse në zyrën e Komunës rrinte pranë kutijave të votimit kryesekretari i „naçallnikut" të Pejës, në uniformë solemne, me shpatë zvarrur e me kobure në brez, ndërsa në oborr të Komunës bridhnin poshtë e lartë 150 xhandarë të armatosur deri në dhëmbë dhe me bajoneta të ngritura në maje të pushkës, fshatarët nuk u trembën. Ata të gjithë i hodhën kokrrat e votimit në kuti të partisë opozitare, kështu që kutia e qeverisë mbeti boshe. Duke parë këtë situatë, kryesekretari i prefekturës, me xhandarë dhe nëpunës të tjerë, mbyllën dyer e dritare dhe filluan falsifikimin e votimeve. Fshatarët e hetuan këtë punë dhe menjëherë u ndez revolta. Ata thyen dyer e dritare dhe depërtuan në sallën e votimeve. Në kacafytje e sipër ata shkyen defterët e procesverbaleve dhe aktet e tjera të falsifikuara; madje as kryesekretari nuk shpëtoi pa marrë ndonjë grusht kokës. Xhandarët hapën zjarr, njëherë në ajër, e

mbasi kjo nuk i frikësoi votuesit, ata shtinë kundër tyre. Shqiptarët ishin duarthatë, asnjë nuk kishte kurrfarë arme. Nga plumbat e xhandarmërisë mbeten të vdekur 7 fshatarë e 30 të tjerë u plagosen. Ndër të plagosurit ishte edhe një kolonist malazez.

Me këtë rast votohej edhe kryetari i Komunës së Baranit, nga 2 kandidatët e paraqitur (Manojlo Manojloviq, nga fshati Gllaviçicë ishte në listën e Partisë Radikale qeveritare, ndërsa kandidat në listën e Partisë Demokratike opozitare ishte Haxhi Bajraktari nga shtëpia e Bajraktarëve të Vranocit. Kandidatin në listën e opozitës e përkrahte edhe Partia Komuniste, e cila atëherë ishte ilegale.

Në lidhje me këtë ngjarje të përgjakshme në Baran, e cila ndodhi më 21 shkurt 1937, për të cilën edhe sot (1980) ka shumë dëshmitarë të gjallë pjesëmarrës në të, organizata e Partisë Ko-



Ndërtesa e Zyrës së vendit në Baran sot, ku është zhvilluar ngjarja e shkurtit 1937

muniste në Pejë botoi e shpërndau ilegalisht një afishe, në të cilën, përveç të tjerave, thuhet: ....„Në këtë ditë u vranë 7 e u plagosen rreth 30 djem më të mirë të popullit.... Masat popullore u revoltuan, kështu që një grup votuesish depërtoi në sallë dhe i çjerri listat. Pastaj ky grup doli dhe bashkë me votuesët e tjerë u nisën për në shtëpitë e tyre. Në këtë moment gjakëpirësit e popullit — xhandarët hapën zjarr nga pushkët kundër zgjedhësve duarthatë e të pambrojtur. Këto viktima të pafajshme ndodheshin 100 deri 200 metra larg nga vendvotimi, të kthyer me shpinë nga ai.... Një fshatar i therur me bajonet ishte shtrirë përtokë gjysëmvdekur. Atij iu afrua shefi i rojës së qytetit... dhe me dy plumba të patllakes ia mori jetën... Një shqiptar tjetër u plagos rëndë atë ditë në tre mbas dite, por organet e pushtetit nuk leju-

an askend që t'i japë ndihmë, kështu që njeriu i gjorë mbeti i shtrirë përtokë deri të nesërmen në mëngjes... kur vdes nga plagët"....

Studentët përparimtarë të Kosovës e të Jugosllavisë në Beograd, me rastin e krimit që e bëri pushteti antipopullor në Baran, shtypën një proklamatë, në të cilën, përveç të tjerave, përshkruhej politika antipopullore që e zbatonin në Kosovë e Maqedoni qeveritë borgjeze që nga viti 1918. Në këtë afishe thuhej se „Qeveria, me qëllim që të pengojë luftën e shqiptarëve të robëruar e të malazezëve, i ka vendosur malazezët e varfër në toka të cilat ua ka rrëmbyer shqiptarëve të varfër.... Kështu ajo ia arriti të ngatërrohen fshatarët malazezë e shqiptarë ndër veti, për të sunduar më lehtë mbi ta".[41]

Në kushte të tilla tepër të vështira, kur shqiptarët pa kurrfarë faji likuidoheshin me numër të madh edhe fizikisht, dhe familjet e tyre mbeteshin rrugëve pa bukën e gojës, sepse tokën u merrte „agrari" (qeveria), shumë njerëz u detyruan të dalin kaçak në mal. Lëvizja kaçake në Kosovë kish marrë përmasa shumë të mëdha, sidomos prej 1918 e deri kah fundi i vitit 1928. Kjo ishte një lëvizje çlirimtare, sepse luftonte për të drejtat kombëtare e shoqërore kundër pushtetit antipopullor të Jugosllavisë borgjeze. Në krye të çetave kaçake ishte Azem Bejta, kurse strategë politikë të kësaj lëvizjeje ishin Hasan Prishtina, Bajram Curri etj.[42] Edhe nga Lugu i Baranit kishte pjesëmarrës direkt të Lëvizjes kaçake, e cila gëzonte përkrahjen e plotë në të gjitha fshatrat, në çdo pikëpamje, e sidomos si jatakë. Ata vepronin në kuadër të çetave të Dushkajës, në krye me Ramë Binakun e Dashinocit, Idriz Bekën nga Ratisha e Poshtme, Avdyl Selimin nga Strellci i Epërm, pastaj edhe në çetat e Prekorupës (Llapushës) të udhëhequra nga Sadik Rama i Gjurgjevikut etj. Kështu, në pranverën e vitit 1921 kaçakët luftuan kundër xhandarëve të „krajlit" në Komunën e Baranit dhe në Komunën e Gorazhdecit. Në këtë kohë në rrethet e Pejës vepronin më se 200 kaçakë — kryengritës kundër pushtetit antipopullor. Ata luftonin edhe kundër shërbëtorëve të organeve të pushtetit. Kështu, ata vrasin më 14 maj 1921 edhe disa shqiptarë, që ishin „poverenikë" (të besuar) të xhandarmërisë, ndër të cilët edhe kryetarin e Komunës së Gllaviçicës Mulla Xhelën (nga Peja) bashkë me policët e tij Dan Sejdiun dhe Millan Jociqin (nga fshati Cëravërh i Pejës).[43] Pushteti borgjez dhe xhandarmëria e tij, kishin përkrahje të madhe nga bashkëpunëtorët e tyre besnikë të këtyre fshatrave — vojvodë e kapitenë të njohur, siç ishin: Kosta Peçanac nga Gjurakoci, Miliq Kërsta nga Istogu, Spirë Kapetani (Dobrosavleviq) nga Dellovci, Arseni Qyrku (Qirkoviq) nga Gllaviçica, Gal Milenko Terziq (Gal Çorri) nga Letina (Pejë), pastaj Nikodim Grujiqi, Novë Giliqi nga Babiqi etj. Kësh-

[41] Momčilo Hajduković, *Četrdesetogodišnjica Prve Oblasne konferencije KPJ za Kosovo i Metohiju*, Letak protiv nasilja, „Politika", Beograd, 25. VI. 1977.

[42] L. Rushiti, *vep. cit.*, 1—278.

[43] *Po aty*, 172.

tu, më 1921 brenda ditës, Miliq Kërsta me xhandarmëri e bashibuzukë vrau 63 shqiptarë të pafajshëm në fshatin Jabllanicë (Dushkajë) afër Nepolës. Këta „vojvodë" vazhdonin terrorin e Savë Batarës kundër popullsisë shqiptare.

Më 8 e 9 korrik 1921, në terrenin e Lugut të Baranit, ndërmjet Nepolës e Rosujës, ushtria, xhandarmëria dhe bashibozukët serbë të mobilizuar nga xhandarmëria, e rrethojnë një çetë kaçake dhe zhvillohet luftë shumë e ashpër; me këtë rast vriten 20 luftëtarë të Lëvizjes kaçake, ndërsa nga ana e sulmuesve 3 ushtarë, kryetari i Komunës së Baranit, sekretari i Komunës së Isniqit (Strellcit?) dhe plagosen 5 vetë nga popullsia e mobilizuar.[44] Në kushte të tilla, në këto vise si edhe në mbarë Kosovën, popullsisë shqiptare iu kishte imponuar gjendja e kryengritjes, e cila kishte përpjesëtime të ndryshme në zona të ndryshme të kësaj treve. Kështu, vetëm në Zonën Neutrale (XII. 1921—II. 1923), në të cilën bënin pjesë fshatrat: Junik, Mulliq, Batushë, Brovinë, Ponoshec, Shishman, Babaj i Bokës, Popoc e Koshare, — në verën e vitit 1922 kishte 5000 kryengritës. Vetëm në qarkun e Dukagjinit, sipas një raporti zyrtar, kishin dalë në mal 15000 shqiptarë në vitin 1920, një numër i madh i tyre ishin nga fshatrat e Pejës, e sidomos nga Rugova, në krye me trimin e njohur Ker Sadrinë, Podguri i Pejës me Beqir Rexhën dhe Nak Berishën (nga Kërnina), nga nahija e Gjakovës me Bajram Currin, Ramë Binakun, Zefin e Vogël dhe Nimon Ferizin në krye etj.[45]

Popullsia e këtyre viseve nuk kishte kurrfarë ndihme nga asnjë anë, përveç ndihmës morale nga disa komunistë të dalluar (Kosta Novakoviq, Ilija Krasojeviq, Zef Lush Marku etj.), dhe nga qëndrimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë në përgjithësi, e cila edhe ajo vetë ishte në ilegalitet dhe e ndjekur nga pushteti borgjez. Nga ana tjetër, idetë komuniste nuk depërtonin në masat e gjera fshatare, sepse këto ishin krejtësisht analfabete dhe, përveç kësaj, kuadrot serbe e malazeze, të cilët përpiqeshin të përhapnin ideologjinë përparimtare, edhe ata vetë ishin kolonizuar në tokat, të cilat qeveria u kishte marrë shqiptarëve. Por përpjekjet nuk mungonin për demaskimin e regjimit antipopullor, për t'iu afruar masave të gjëra fshatare. Në këtë drejtim më 1937 u muarën masa konkrete dhe u formua celula e Partisë në fshatin Kryshec, e cila i përfshinte edhe disa fshatra të tjera përreth Lugut të Baranit (Dubovikun, Irzniqin etj.) Në fillim të korrikut 1937 u mbajt në Cëravërh (afër Pejës) Konferenca Themelore e Komitetit Krahinor të PKJ, në të cilën u dënua politika e qeverisë borgjeze ndaj shqiptarëve dhe ndaj popullsisë në përgjithësi. Mirëpo, as në këtë Konferencë nuk pati qëndrime të vendosura ndaj çështjes kombëtare dhe agrare.[46]

Terrori kundër shqiptarëve nuk pushoi gjatë gjithë kohës së sundimit të Jugosllavisë borgjeze (1918—1941). Njëri ndër ko-

[44] *Po aty*, 179.

[45] *Po aty*, 185, 189, 92.

[46] H. Bajrami, *vep. cit.*, 320—325.

munistët më konsekuentë serbë të asaj kohe — Kosta Novakoviq, shkruante se vetëm gjatë vitit 1921 më se 12.370 shqiptarë ishin likuiduar nga xhandarmëria e ushtria jugosllave, 22.110 vuanin nëpër burgje, 6.050 shtëpi të tyre ishin rrënuar dhe 10.525 familje ishin plaçkitur.[47]

Pra, si shihet nga sa u tha deri tash, kushtet shoqërore në Lug të Baranit ishin po ato që mbretëronin në gjithë Kosovën në periudha të cilat u përmenden këtu, por me disa veçori që rridhnin nga kushtet dhe situata konkrete në këtë trevë. Gjithsesi këto kushte këtu ishin shumë të vështira, si në kohën e sundimit osman, ashtu edhe gjatë Luftës Ballkanike dhe regjimit të Jugosllavisë borgjeze pas Luftës së Parë Botërore. Qëllimi i sundimit osman ishte shtypja nacionale, shkombëtarizimi dhe shfrytëzimi ekonomik i popullit shqiptar të këtyre trevave. Po këtë politikë e ndiqte edhe Jugosllavia borgjeze, në mënyrë drastike dhe brutale, duke u përpjekur që këta t'i zhdukë fare nga trojet e tyre. Por, fshatarësia e Lugut të Baranit gjatë të gjitha periudhave shprehte revoltë të hapur, madje edhe me armë në dorë, kundër shtypjve e shfrytëzuesve, siç u pa edhe nga disa shembuj konkretë, që i vumë në dukje me këtë rast.

Gjatë okupacionit italian dhe gjerman, si në shumë fshatra të Kosovës, edhe në ato të Lugut të Baranit, ku bejlerët i kishin tokat e tyre, fshatari detyrohej t'ia dorëzonte feudalit të dikurshëm të katërtën e prodhimit bujqësor, ndërsa të dhjetën organeve shtetërore (përkatësisht dhjetarit, i cili i blente nga shteti të dhjetat) kështu që u vështirësua jeta ekonomike. Pas çlirimit, kah fundi i vitit 1944, me qindra djem e burra të Lugut të Baranit hynë në brigadat partizane. Ndryshimet shoqërore-ekonomike, që janë bërë në Jugosllavinë socialiste, në Lug të Baranit janë të njëjta si në mbarë Kosovën.

Familja, fisi, bajraku e katundi. — Nga faktorët shoqërorë që kanë luajtur rol të posaçëm në jetën e fshatarit të Kosovës, si edhe të malësorëve në viset veriore të Shqipërisë, vend të posaçëm zë familja, fisi dhe bajraku. Këto institucione në Rrafshin e Dukagjinit nuk kanë shumë dallime në krahina të ndryshme të kësaj treve. Madje, për sa i përket organizimit të familjes mbretëron njëfarë skeme me shumë tipare të përbashkëta, jo vetëm kudo në Kosovë, por edhe në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Shqipëri.

Familja në Lug të Baranit edhe sot shpesh është patriarkale, megjithëse ka filluar procesi i shndërrimit të saj në familje bashkëkohore. Burri është kreu i familjes dhe ai pyetet dhe vendos për çdo gjë. Por, si thamë, kjo nuk është veçanti e kësaj treve, sepse e tillë është, ose e tillë ka qenë deri para pak vitesh, familja shqiptare kudo ndër ne në Kosovë, Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi në rrethet e Preshevës, të Bujanovcit e në Jabllanicë të Leskovcit. Prandaj nuk do të ndalemi këtu në shqyrtimin e

[47] *Po aty*, 317.


familjes sonë patriarkale nga aspekti i organizimit të saj, por do ta shikojmë këtë institucion nga aspekti i veçorive me të cilat ajo del në Lug të Baranit.

Para së gjithash bie në sy numri i madh i familjeve të mëdha, në të cilat jetojnë së bashku disa kurorë, vëllezër ose nipa të martuar dhe me fëmijë të tyre (në shumë raste edhe këta të martuar). Në çdo katund të kësaj zone, deri para pak vitesh ka pasur nga disa familje të tilla. Familja më e madhe në vitin 1971 ishte ajo e Tahir Smajlit të Nepoles, me 45 pjesëtarë. Mirëpo, për studimin e familjeve të mëdha nuk është aq i rëndësishëm numri i pjesëtarëve të saj, sa ka rëndësi numri i çifteve bashkëshortore. Ndryshe do të jenë marrdhëniet, atmosfera familjare, afiniteti dhe interesi personal p.sh. në një familje prej 15 pjesëtarësh, e cila përbëhet nga prindërit dhe 13 fëmijë të tyre të pamartuar, e ndryshe do të jetë situata në një familje tjetër që ka 12 pjesëtarë, ose më pak, e cila përbëhet nga tre vëllezër të martuar, e secili nga këta ka nga dy fëmijë. Kjo për arsye se afiniteti e kompaktësia e pjesëtarëve të familjës së parë bazohet në gjini gjaku, në dashurinë reciproke dhe në respektin ndaj prindërve, ndërsa familja e tipit të dytë është e kompozuar nga elemente të huaja, sepse kunatat janë element i ardhur dhe fëmijët e tyre, përkatësisht të vëllezërve, nuk janë në lidhje aq të ngushtë të gjinisë së gjakut, siç janë vëllezërit mes tyre. Kompaktësia e afiniteti në këtë familje bazohet më shumë në autoritetin e kryefamiljarit, sesa në dashurinë e afërsinë mes pjesëtarëve të familjes, ndërsa interesi ekonomik i familjeve të ngushta individuale nga të cilat përbëhet familja e madhe- vjen gjithnjë duke u individualizuar. Kështu, më në fund familja ndahet, shkëputen nga familja e madhe familjet e vogla individuale (prindërit me fëmijët e tyre). Në Lug të Baranit të gjitha familjet e mëdha përbëhen nga familjet individuale. Edhe që tani janë shumë të rralla familjet e mëdha me nga 40—50 pjesëtarë, ato me nga 2—3 kurorë nuk janë të rralla, madje, si e thamë, në të gjitha katundet ekziston një numër i madh i familjeve të tilla. Këtu për familje të tilla përdoret shpesh termi „familje shumë hisesh", ose për raste konkrete thuhet „familje 3 (ose më shumë) hisesh", që do të thotë se në rast se ndahet familja, toka e pasuria tjetër duhet të ndahet në aq pjesë sa ka kurorë, ose vëllezër, familja e madhe.

Një tip tjetër i familjes në këtë zonë është familja e ndarë, d.m.th. familja një pjesë e së cilës jeton në Lug të Baranit e pjesa tjetër në një zonë tjetër të largët. Kjo ngjan atëherë kur një familje blen tokë në një fshat të largët dhe atje shkon një pjesë e familjes së madhe, por kjo mbetet gjithnjë pjesë përbërëse e familjes amë.[48] Kur vjen koha për t'u ndarë familja e madhe e këtij tipi, zakonisht secila palë e saj mbetet në atë pjesë të pasurisë, të cilën e punonte edhe më parë. Kështu, në katundin Kosuriq jeton familja e madhe Panxha, e cila përbëhej nga dy pjesë: një pjesë jetonte në Voksh, e pjesa tjetër në Kosuriq. Në Voksh

[48] Mark Krasniqi, *Familja e madhe patriarkale në Kosovë*, Gjurmë e gjurmime, Prishtinë, 1979, 197.

ka qenë familja amë, dhe nga se atje janë shumuar pjesëtarët e saj e tokë buke Vokshi ka pak e të ligë, kanë blerë tokë në Kosuriq dhe këtu është vendosur një pjesë e saj. Me kohë, të dy pjesët e familjes janë rritur e janë bërë familje të mëdha. Kryefamiljari i të dy pjesëve të familjes rrinte herë në Voksh herë në Kosuriq. Ai i kishte dy gra — njërën në Kosuriq e tjetrën në Voksh. Para pak vitesh kjo familje është ndarë, kështu që secila pjesë e saj ka mbetur aty ku jetonte kur kishin një zot shtëpie të përbashkët. E tillë ishte edhe familja e Rrustem Alisë — jetonte në Baran e në Llukë. Në saje të familjeve të mëdha, edhe mesatarja e numrit të pjesëtarëve të familjës në këtë fshat, si edhe në fshatrat e tjera, në vitin 1950 ishte 9,8, në Llugaxhi 9 e kështu me radhë. Me ndarjen e familjeve të mëdha dhe me shpërnguljen e disa familjeve, ose pjesëve të tyre në qytet, edhe mesatarja e numrit të pjesëtarëve të tyre është zvogëluar, kështu që në disa fshatra kjo mesatare është 7 deri 8 pjesëtarë. Më 1971 çdo familje e Lugut të Baranit kishte mesatarisht 9,4 e më 1981 më se 10,2 pjesëtarë.



Në shtëpi të tilla jetojnë familjet e mëdha patriarkale

Një tip tjetër i familjës në Lug të Baranit është familja e përbërë nga dy fe të ndryshme — nga myslimanët dhe katolikët. Kjo dukuri dikur, para disa shekujsh, ishte e zakonshme jo vetëm këtu, por edhe në shumë vise të tjera. Kështu p.sh. arqipeshkvi e historiani i njohur Pjetër Mazreku shkruan në raportet e tij më 1621 mbi gjendjen e kishës katolike në Ballkan, se në Suharekë, si edhe në shumë katunde të tjera të këtyre viseve, meshkujt ishin të detyruar me forcë nga pushteti turk të kalonin në fenë islame.

Mirëpo gratë e fëmijët e tyre qëndronin edhe një kohë të gjatë në fenë katolike.[49] Pra, kështu një kohë të gjatë ka pasur ndër ne familje të përziera nga aspekti fetar. Në Karadak të Shkupit, në katundin Stubëll, Dunavë etj. deri vonë ka pasur familje të cilat jashtë shtpie, në kontakte me myslimanë, deklaroheshin si myslimanë, por brenda në shtëpi të gjithë pjesëtarët e familjes rrëfenin fenë katolike dhe i respektonin rregullat e saj. Kuptohet se në familje të tilla, të cilat populli i quan „laramanë", gratë gjithënjë ishin katolike, sepse ato nuk vinin në kontakt me njerëz të fesë tjetër dhe nuk kishin nevojë të kamufloheshin me mimikrinë fetare.

Në Lug të Baranit në të kaluarën mund të ketë pasur shumë familje dy fesh, por në ditët tona ishin vetëm dy familje të tilla, të cilat u ndanë para pak vitesh: familja e Smajl Keqanit në Baran të Epërm dhe familja e Adem Tahirit në Llugaxhi. Smajl Keqani vdiq si katolik më 1950, dhe pas tij nuk mbeti asnjë pjesëtar i familjes i këtij besimi. Familjen e Adem Tahirit e kam vizituar më 1957, atëherë kur kjo përbëhej nga katolikë e myslimanë — që ishin kushërinj të parë mes veti dhe jetonin në harmoni të plotë. Secila palë i respektonte zakonet e fesë së vet, myslimanët mbanin ramazanin dhe festonin Bajramin, katolikët mbanin krezhmet dhe festonin Pashkët e Kërshnellat dhe nuk kishte kurrfarë mosmarrëveshjesh, përkundrazi, të dy palët tregonin mirëkuptim dhe respekt ndaj palës tjetër në raste të tilla. Përkatësia fetare nuk qe shkak për ndarjen e kësaj familjeje, por, si te të gjitha të tjerat, arsyeja kryesore për ndarje ishte e natyrës ekonomike.

Familja patriarkale në Lug të Baranit, sidomos familja e madhe, kishte rol të posaçëm në zhvillimin ekonomik e shoqëror në të kaluarën, ishte një hallkë e fortë në zingjirin e institucioneve të tjera shoqërore, siç janë vëllazëria, fisi, bajraku etj. — për ruajtjen e sigurisë së pasurisë dhe të integritetit familjar, por gjithashtu edhe për mbrojtjen e dokeve e të zakoneve dhe të tipareve të tjera kombëtare, të cilat rrezikoheshin nga gjendja shoqërore-politike në periudha të ndryshme. Në përgjithësi familja shqiptare këtë rëndësi e këtë kuptim e kishte edhe në vise të tjera, por në Lug të Baranit kjo është manifestuar më fort e më shpesh, sepse këtë e impononinn disa faktorë të tjerë shoqërorë dhe disa elemente natyrore, të cilat i përmendëm me rastin e shqyrtimit të kushteve historike të kësaj zone. Lidhur me këtë po përmendim edhe një shëmbull, i cili tregon gjithashtu rolin e rëndësinë e familjes, sidomos të familjes së madhe me shumë meshkuj, në të kaluarën në këtë trevë. Kah fillimi i sh. XX, dhe më vonë, ndër familjet e mëdha të Lugut të Baranit përmendej edhe ajo e Kocit të Gllogjanit. Në atë kohë bejlerët e Pejës binin në kundërshtime të ndryshme njëri me tjetrin, qoftë për shkak të prestigjit, qoftë për zgjerimin e pronave të tyre dhe për çështje të tjera materiale. Në raste të tilla, ata mbështeteshin edhe në miqësinë me fshata-

[49] E. Fermendžin, *Isprave godine 1579—1671 tičuće se Crne Gore i stare Srbije*, Starine Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti, XXV, Zagreb, 1892, 173.

rët, e sidomos në çifçinjtë e tyre. Kështu, sipas traditës, njëri nga këta, me një rast të tillë, e furnizon Kocin me disa arka municion, sepse kjo familje kishte rreth 20 meshkuj të pushkës dhe ishte mbështetje e fortë e feudalit të Pejës. Kuptohet se gjendja ekonomike ishte një ndër shkaqet më të forta që mbante në bashkësi familjare një numër aq të madh njerëzish, të cilët jetonin vetem nga bujqësia në prona shumë të vogla në krahasim me numrin e njerëzve që ushqeheshin nga prodhimet e tyre. Në rast ndarjeje nga ky kolektiv i madh, pjesa që u takonte familjeve individuale, nga pasuria e përbashkët do të ishte fare e vogël dhe e pamjaftueshme për të mbajtur gjallë familjen e re, edhe në rast se kjo kishte vetem 5—6 pjesëtarë.

Ndarja e familjeve të mëdha në Lug të Baranit filloi pas Luftës Dytë Botërore, si në shumë vise të tjera të Kosovës, me ndryshimin e kushteve shoqërore-ekonomike. Ndarja e tyre në fillim bëhej vetëm formalisht, ndarje fiktive, me qëllim që të evitoheshin disa obligime materiale dhe kolektivizimi i tokës, të cilat ishin në rend të ditës në vitet e para mbas luftës. Mirëpo, shumë nga këto familje që u ndanë në këtë mënyrë mbetën të ndara përgjithmonë. Kur më vonë filluan edhe fshatarët të hyjnë në punë në ndërmarrje të ndryshme në qytet, të ndjekin shkollat e mesme e të larta e të hyjnë në punë përkatëse, e sidomos kur një numër i madh njerëzish nga kjo zonë filloi të shkonte në punë të përkohëshme në Gjermaninë Federale e vende të tjera të Evropës, ndarja e familjeve u bë një gjë e zakonshme, normale, ndërsa dikur kjo konsiderohej si një lloj fatkeqësie, madje turp dhe shkelje e traditës shekullore.

F i s i. — Në Rrafsh të Dukagjinit, dhe në Kosovë në përgjithësi, fisi në të kaluarën nuk e luante atë rol të cilin ky institucion e kishte në viset veriore të Shqipërisë. Kjo para së gjithash për arsye se fisit në Kosovë i mungon një nga faktorët kryesorë, me të cilin dallohet kjo bashkësi etnike e bazuar në — gjini gjaku e në territor të përbashkët. Në Kosovë pra, fisit i mungon territori i përbashkët, sepse pjesëtarët e një fisi ishin të shpërndarë nëpër fshatra e vise të ndryshme dhe të përzier me fise të tjera. Mungesa e territorit të përbashkët, e kompaktësisë hapësinore, bën të pamundshëm aplikimin e normave të njohura kanunore mbi të cilat bazohet organizimi i fisit. Mirëpo, në disa vise malore, p.sh. në Rugovë, në Shalë të Bajgorës etj., e gjithë zona etnografike përbëhet nga banorët e një fisi (i cili është i shpërndarë edhe në vise të tjera). Fisi në këto treva ka territorin e vet të përbashkët — bjeshkën e kullotat, disa rregulla fisnore sipas traditës, i përmbahet ekzogamisë etj. Por, megjithatë, këtu jeton vetëm një pjesë e fisit, një numër relativisht i vogël i familjeve që i takojnë fisit Shalë, përkatësisht fisit Kelmend. Raste të tilla, por në përmasa më të vogla, ka edhe në zonat fushore, ku një ose më shumë fshatra fqinj janë të një fisi (p.sh. Isniqi, një ndër fshatrat më të mëdha në Kosovë, është Shalë, Strellci Krasniqe, Gadimja, fshat i madh pranë Shpellës së Gadimës, shpellës së njohur të kristaltë, gjithashtu është Krasniqe, fshatrat e Vokshit janë Thaç, disa fsha-

PASQYRA ORIENTUESE E PËRKATËSISË FISNORE NË LUG TË BARANIT

	Fshati	Krasniqe	Berishë	Gash	Shtëpi: Shalë	Kelmend	Bytyç	Thaç	Morinë	Mirëditë	Kabash
											10
1	Kryshec		50	30	40		11				
2	Rashiq	2	35				4				
3	Turjakë	40		2				4			
4	Baran i Epërm	22	5								
5	Baran i Poshtëm	12	12	30	8	5		1			
6	Kotradiq	32	5	22							
7	Vranoc	60			5	12		5			
8	Çellopek	15	30	3	20	30		25			
9	Broliq			25	10						
10	Kosuriq	12	17	50							
11	Buqan	2	10	30							
12	Llugaxhi	5	22					13		9	
13	Gllogjan		20								
14	Nepole	42							15		
15	Çeskovë		15	3	2						
16	Kpuz	10	45								
	G j i t h s e j	254	266	195	85	47	15	48	15	9	Kabash 10

tra në Drenicë janë Berishë, ose të fiseve të tjera, e kështu me radhë). Mirëpo, në këto fshatra organizata fisnore pasqyrohet më pak se në viset malore, të cilat i përmendëm më sipër. Në kushte të reja ekonomike e shoqërore, fisi në Kosovë e ka humbur gati krejtësisht rolin e afinitetit midis pjesëtarëve të tij edhe në fshatra, ndërsa në qytet ka kohë që ky është zhdukur fare. Nga ky aspekt sot më shumë rëndësi ka përkatësia rajonale (vendi, krahina) sesa përkatësia fisnore.

Në Lug të Baranit edhe fisi ka disa veçanti më të theksuara sesa në disa zona të tjera të Dukagjinit. Në të vërtetë edhe këtu në shumicën e fshatrave fiset janë të përziera, madje në disa nga këto banorët u përkasin 4—5 fiseve të ndryshme. Mirëpo në disa fshatra të gjithë janë të një fisi, si p.sh. në Vranoc, në Nepole e në Turjakë — Krasniqe, në Llugagji — gati të gjithë Berishë, në Broliq — Shalë (nga Belleja) e Gash etj. Ajo që është me interes për shqyrtimin e fisit në këtë trevë, dhe që në jetën dhe marrëdhëniet shoqërore në të kaluarën ka pasur peshën e vet, është fakti se këtu disa fise u përkasin besimeve të ndryshme — përkatësisht fesë myslimane dhe fesë katolike. Këtu solidariteti fisnor në të kaluarën është manifestuar në raste të ndryshme dhe ka pasur përparësi në krahasim me solidaritetin në bazë fetare. Kështu p.sh. Krasniqja e Turjakës është e afërme me gjini gjaku me Krasniqen e Nepoles, megjithëse në Turjakë janë myslimanë e në Nepole të gjithë katolikë. Vranoci e Barani i Epërm gjithashtu janë të afërm nga ky aspekt me Turjakë e Nepole, sepse janë të një fisi. Berisha e Llugaxhisë, ku shumica janë myslimanë, janë të afërm me familjet katolike të këtij fshati, të cilat janë gjithashtu Berishë. Berisha e Gllogjanit, ku janë shumica katolikë, janë të afërm me Lugaxhi, Çellopek, Kryshec etj. Më në fund në drejtim të solidaritetit e të kompaktësisë të fiseve të ndryshme të Lugut të Baranit ka ndikuar edhe organizata e bajrakut të kësaj zone, me qëndër në Vranoc.

Përbërja fisnore e fshatrave të Lugut të Baranit (numri i familjeve të tyre) nuk mund të jepet me këtë rast krejtësisht e saktë për arsye se regjistrimet zyrtare të popullsisë nuk e shënojnë këtë element dhe kështu nuk mund të shihet nga regjistrat numri i familjeve të fiseve të ndryshme. Shënimet që i kam marrë nga popullsia në terren më 1951, 1972, 1979 dhe 1980 për të njëjtën çështje kanë dhënë rezultate të ndryshme për të gjitha këto vite, sidomos për sa i përket numrit të shtëpive dhe numrit të familjeve të fiseve të ndryshme nëpër fshatra. Kjo vjen edhe nga shkaku se ndarja e familjeve në kohët e fundit bëhet shumë shpesh dhe shpërngulja e disa familjeve të vogla në qytet nuk është definitive, sepse një pjesë e saj shkon, ndërsa pjesa tjetër mbetet në fshat, ndërsa disa familje të tjera vijnë herëpasherë në fshat e pas disa ditësh shkojnë përsëri në qytet, ose në punë të përkohshme në botën e jashtme. Prandaj tabela e përbërjes fisnore të kësaj zone është vetëm orientimore.

Bajraku. — Një nga faktorët shoqërorë që kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën publike të popullsisë së Lugut të Ba-

ranit ishte edhe organizata e bajrakut. Megjithëse fisi është institucion i bazuar para së gjithash në gjini gjaku, pra një tërësi e gjërë, të themi familjare, me kompaktësi dhe afinitet natyror midis pjesëtarëve të tij, prapë në Lugë të Baranit (dhe në Kosovë në përgjithësi), për arsyet që u cekën më parë, ai nuk e ka pasur fuqinë e kohezionit si në viset malore, para së gjithash në Malësi. Fisi ka pasur mundësi të jetojë gati krejtësisht i pavarur nga autoritetet shtetërore vetëm në zonat malore, të cilat dalloheshin me nivelin e ulët të jetës ekonomike, kështu që shteti, përkatësisht feudalët, nuk kishin levërdi të angazhoheshin tepër për vendosjen e pushtetit në ato zona. Nga ana tjetër, fisi ishte organizatë me kompaktësi shumë të madhe, me shpirt e tradita luftarake, i cili mbronte me vendosmëri dhe trimëri të rrallë lirinë dhe varfërinë e tij nga çdo sulm i jashtëm.

Turqit nuk ia arritën t'i pushtojnë fiset malësore me forcën e armve, prandaj ata gjatë shekullit XVII filluan të emrojnë bajraktarë e të krijojnë bajraqe në Malësi, me qëllim që ta dobësojnë autoritetin e krerëve të fisit dhe fuqinë e tij. Bajraktarëve turqit u jepnin dhurata, rrogë e dekorata të ndryshme dhe këta kishin për detyrë të mernin pjesë me njerëzit e bajrakut në luftëra të ndryshme që i bënin turqit në Ballkan ose më larg. Bajraku nuk përputhej gjithmonë me kufirin e fisit, kështu që mund të përfshinte një numër fshatrash të cilat bënin pjesë në disa fise kufitare. Funksioni i bajraktarit u bë i trashëgueshëm në familje.[50]

Në Kosovë turqit ua jepnin titullin e bajraktarit (flamurtarit) disa familjeve, zakonisht nëse ndokush nga meshkujt e saj është dalluar në luftë me trimëri kundër armikut. Familje të tilla, familje bajraktarësh, në Kosovë ka pasur me një numër të konsiderueshëm. Kjo ka mundësuar që, në rast nevoje, të mblidhet një numër sa më i madh i ushtarëve, sepse, si parashihej edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, secila familje e bajrakut (flamurit) detyrohej që, kur të thirret, do të dalë në kuvend të flamurit „burrë për shpi" dhe „do të dalë në ushtri të flamurit".[51]

Bajraku i Lugut të Baranit quhej Bajraku i Vranocit, sipas fshatit nga i cili ishte bajraktari. Familja e bajraktarit është e fisit Krasniqe, ndërsa kjo trevë, si e thamë, përbëhet nga fise të ndryshme, por shumica e familjeve janë Berishë e Krasniqe. Bajraku i Vranocit përfshinte të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit dhe shumë fshatra jashtë kësaj zone, përkatësisht të gjitha fshatrat ndërmjet Bistricës së Pejës e Bistricës së Deçanit (nga jugu e veriu), ndërsa nga lindja kufizohej me Drinin e Bardhë e në perëndim me fshatrat: Dubovik, Zllopek, Graboc e Gorozhdec, kështu që përfshinte rreth 40 fshatra. Bajraktar i fundit nga familja Bajraktaraj ishte Haxhi Bajraktari, i cili vdiq mbas Luftës Dytë Botërore. Këtë titull kjo familje e kishte fituar nga autoritetet

[50] *Historia e Popullit Shqiptar, I,* Prishtinë 1968, 371.

[51] Shtjefën Konst. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit,* Shkodër, 1932; shih edhe *Parathënien* e këtij *Kanuni* të Syrja Pupovcit botuar në Prishtinë më 1972, f. LXV, si edhe punimin e B. Palajt, *Mbi kanunin e maleve,* Studime e Tekste, Tiranë, 1944, 108.

turke qysh nga lufta e Moresë (1684), në të cilën, sipas traditës, kanë marrë pjesë 3 meshkuj të kësaj familje. Dy nga këta tre vllezër kanë qenë ushtarë, ndërsa i treti, i cili quhej Mehmet Dedë Mrripa, shkon për t'i vizituar vëllezërit. Atje ai paraqitet vullnetar për mejdan dhe del fitues në dyluftim. Pasha ia jep Mehmetit titullin bajraktar. Autoritetet turke, me anë të Begollëve të Pejës, ia falin Bajraktarit të Vranocit si feud fshatin Prapaqan (i cili kufizohet me Lug të Baranit), fshatin Brojë në Drenicë dhe Bjeshkën e Hajles në Rugovë, e cila atëherë ka qenë kullotë e malësorëve të Malësisë së Gjakovës. Nga fshatrat Prapaqan e Brojë familja e Bajraktarëve deri vonë e merrte të dhjetën e produkteve bujqësore.

Megjithëse turqit e kishin formuar institucionin e bajrakut si mështetje të tyre ushtarake, bajraku organizohej e vepronte në baza të traditës zakonore të vendit dhe shpesh luftonte kundër turqve. Në periudhën e Lidhjes shqiptare të Prizrenit ky qëndrim i bajrakut u manifestua në këtë pikëpamje më mirë se kurdoherë më parë. Por edhe më vonë bajraku luftoi për interesat kombëtare, kundër pushtuesve dhe agresorëve të huaj. Kështu edhe Bajraku i Vranocit ishte ferrë në sy për pushtetin turk, për pushtetin ushtarak gjatë Luftës Ballkanike dhe për pushtetin antipopullor të Jugosllavisë borgjeze, meqenëse mbante anën e opozitës, siç tregojnë bindshem edhe ngjarjet e përgjakshme, të cilat u përmendën më sipër.

Por roli i bajrakut nuk shfaqej vetëm në kohën e luftës dhe të betejave e përleshjeve të armatosura. Ai nuk ishte vetëm organizatë ushtarake, por edhe shoqërore. Rëndësia e tij më e madhe ishte mu në kohë të paqes. Bajraku kishte mision të posaçëm në rregullimin e marrëdhënieve midis fshatarëve, fshatrave dhe fiseve. Ndërhyrja e bajrakut, përkatësisht e bajraktarit, kërkohej kur shterreshin mundësitë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në instanca më të ulëta. Në këto treva fushore të Rrafshit të Dukagjinit, ku mungonte organizimi tradicional fisnor, këto instanca nuk ishin organe të caktuara, por në raste të nevojshme dihej njëfarë rendi: intervenonte vëllazëria, dajtë, kumbara, fqinjtë, miqtë, shokët e fisit, e dikur, nëse ngatërresa ishte më e madhe, kërkohej ndihma e bajrakut, i cili me pleqnarë të njohur i jepte fund problemit të hapur.

Bajraku i Vranocit luante rol të madh në qetësimin e gjendjes së acaruar, e cila shpeshherë vihej në rend të ditës lidhur me çështje pronësore, rend të ujit, kullota, pyje, pastaj në lidhje me çështje të delikteve të ndryshme (gjakmarrja, rrahje, fyerje etj), ose në lidhje me çështje të nderit, ikja e vajzave të fejuara etj. Rol të tillë luante ky bajrak sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur çdokush ishte i armatosur dhe organet e pushtetit shtetëror, në atë gjendje lufte, nuk kishin autoritet të duhur. Problemet dhe ngatërresat e ndryshme që ishin grumbulluar me dhjetra vjet më parë, tani kishin terren të përshtatshëm për t'u zgjidhur në mënyrë drastike në bazë të Kanunit mesjetar të Lekë Dukagjinit. Kjo kohë ishte e përshtatshme edhe për lindjen e problemeve e ngatërresave të reja. Komisioni i gjaqeve, ose „Islihati", i cili u

themelua për pajtimin e gjaqeve dhe të ngatërresave të tjera i cili veproi në atë kohë në mbarë Kosovën, kishte përkrahje të madhe nga bajraku i Vranocit.

Bajraku i Vranocit nuk përfshinte një popullsi heterogjene vetëm nga aspekti fisnor, por gjithashtu edhe nga ai fetar. Nga ky aspekt shumë bajraqe të viseve të tjera, p.sh. në Drenicë, Podgur, në pllajën e Kosovës etj. kanë qenë homogjene, jo të përziera. Por mu kjo përbërje heterogjne e Bajrakut të Vranocit i jep këtij disa tipare të rëndësishme, i jep një rol të posaçem në marrëdhëniet reciproke shoqërore në këtë zonë etnografike. Kjo shihet më mirë jo vetëm nga toleranca e plotë fetare midis myslimanëve e katolikëve, por nga fakti se kjo tolerancë ishte në atë shkallë, që mund të quhet unitet i plotë. Këtë e tregojnë më mirë e më bindshëm rastet e disa familjeve, të cilat i përmendem më sipër, në të cilat një pjesë e anëtarëve të tyre ishte myslimane e pjesa tjetër katolike. Këta ishin vëllezër dhe kushërinj, njerëz të një shtëpie e të një sofre. Kuptohet se për një unitet të tillë nuk ishte shkak vetëm bajraku i përbashkët, sepse ishin më të rëndësishem disa faktorë të tjerë shoqërorë, që kishin pasur ndikim vendimtar në unitetin e katolikëve e të myslimanëve në këtë trevë: ishte kjo para së gjithash, e mbi të gjitha, përkatësia kombëtare shqiptare e përbashkët — gjaku, gjuha, traditat, ndjenja dhe ndërgjegja kombëtare, e kaluara dhe e tanishmja e përbashkët me të gjitha të mirat e të këqijat. Në këtë drejtim ndikonte edhe pozita e tyre ekonomike e politike e vështirë njësoj për të gjithë — si në kohën e feudalizmit turk, ashtu edhe gjatë sundimit të qeverive antipopullore në Jugosllavinë borgjeze midis dy luftërave botërore.

Katundi. — Një nga temat më të rëndësishme dhe më interesante për studiuesit e jetës dhe të kulturës popullore, me siguri është fshati, si institucion ku zhvillohet jeta shoqërore dhe ekonomike e banorëve të tij në bazë të normave të caktuara, shumë nga të cilat i kanë rrënjët në të kaluarën e lashtë. Fshati si bashkësi ekonomike e shoqërore qysh moti determinohej me territorin e përbashkët, përkatësisht me kufijtë e këtij territori, me detyrimet materiale ndaj shtetit dhe me rregullimin e brendshëm. Në dokumentat e shekullit XIII e XIV, disa nga të cilat i përmendëm më parë (krisobulat), edhe fshatrat e Lugut të Baranit përcaktohen në këtë mënyrë. Fshati qysh atëherë kishte disa institucione të ngjashme me ato të ditëve tona. Madje, çdo katund e kishte kryeplakun, por organi i lartë i qeverisjes ishte kuvendi i katundit, i cili e kishte edhe kuptimin e fshatit.[52] Ndër shqiptarët fshati ishte një bashkësi ekonomike dhe shoqërore mjaft e fortë, gjë që dukej sidomos në lidhje me pronën e përbashkët të katundit (kullotat, pyjet etj.).[53]

---

[52] Stojan Novaković, *Selo*, Srpska njiževna zadruga, Novi Sad, 1943, 80.

[53] Surja Pupovci, *Građansko-pravni odnosi u zakoniku Leke Dukađinija*, Priština, 1968, 53.

Fshati i Lugut të Baranit, si institucion për rregullimin e marrëdhënieve reciproke të fshatarëve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në këtë bashkësi fshatare, nuk dallohet nga ky aspekt nga fshatrat e viseve të tjera. Por dihet se ky organizim ishte mjaft i thjeshtë dhe i reduktuar nga institucionet shtetërore, sidomos pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, plaku i katundit, ose disa pleq, të dalluar e të drejtë, konsultoheshin në raste të ndryshme, sidomos në çështjet kontestuese pronësore, në pajtimin e ngatërresave etj., ndërsa kryeplaku ishte organ shetëror për të zbatuar në fshat urdhërat e administratës shtetërore. Më i rëndësishëm ishte kuvendi ose mbledhja e katundit, në të cilin merrte pjesë nga një mashkull për shtëpi, zakonisht kryefamiljari. Aty vendosej për rendin e ujit, për zënien e livadheve, për ndonjë punë komunale etj. Disa nga këto funksione fshati i kryen edhe sot, por shumë të tjera bëhën në kuadër të zyrës së vendit, të organizatave shoqëroro-politike dhe të bashkësisë lokale.

Megjithse jeta moderne ka sjellë me veti ndryshime të mëdha edhe në fshat, sidomos me depërtimin gjithnjë më të madh të ekonomisë monetare edhe në këtë mjedis të ekonomisë naturale, bujqësore, prapë disa norma të moralit patriarkal ende gjallojnë edhe në fshatrat e Lugut të Baranit. Kështu, p.sh., mikpritja tradicionale shqiptare respektohet dhe praktikohet në çdo familje të kësaj treve. Upria, ndihma me punë vullnetare familjeve pa fuqi punëtore, gjithashtu është prezente në këto fshatra, megjithëse tash më pak se dikur. Vendimet e kuvendit të katundit respektohen edhe atëherë kur ndokujt nuk i shkojnë për shtat, sepse ato merren „katundisht". Më shumë respektohet fjala e kuvendit të katundit, se ajo e kryeplakut, ose e këshillit të fshatit. Në kuvend merr pjesë me të drejtë të barabartë çdo shtëpi, të cilën e përfaqëson një mashkull, pa marrë parasysh numrin e përgjithshëm të pjesëtarëve të familjes. Kështu veprohet edhe kur është puna e detyrimeve të ndryshme — „për tim" (për shtëpi). Kjo normë është shumë e lashtë, kështu që edhe në kohën romake e bizantine detyrimet e ndryshme, tatimet etj., mblidheshin „për tym", për shtëpi.[54] Lugu i Baranit, si edhe disa zona përreth, në të kaluarën binin sulle të ndryshme — në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme ndërmjerëzore qoftë brenda fshatit, qoftë me fshatra të tjera. Një sull të rëndësishem e kanë lidhur fshatarët e Lugut të Baranit më 1965 për të luftuar disa elemente prapanike në zakonet e martesës. Përveç tjerave, me këtë sull ndalohet fejesa e vajzave pa kryer shkollën tetëvjeçare, kurse për pajë („çeiz") nuk mund të kërkohen më tepër se 5 milion dinarë (të vjetër). Por, për atë kohë as kjo nuk ishte pak. Sullet i respekton çdo shtëpi, sepse të gjithë marrin pjesë në kuvendin e katundit kur vendoset për to, dhe, përveç kësaj, ai që e then sullin „hyn në hak të katundit", bie në kundërshtim me fshatin.

Individualiteti i njerëzve të ditëve tona po manifestohet gjithnjë e më tepër, si pasojë e ambicieve (jo gjithmonë të shëndo-

[54] St. Novaković, *vep. cit.*, 152.

sha) materiale e shpirtërore. Kjo në shumë raste dobëson moralin patriarkal e sidomos solidaritetin njerëzor, madje edhe në fshat. Këto norma të lashta kanë filluar të zbehen, por nuk janë zhdukur. Këtë e ilustron bukur edhe një rrëfim i sinqertë i disa fshatarëve nga rrethet e Pejës. Ata thonë se sikur t'i kishte qitur puna diku larg këtyre viseve, me shumë njerëz të tjerë nga viset e ndryshme dhe nga fshati i tyre, dhe sikur atje do t'ishte edhe dikush i afërm i tyre me gjini gjaku, por nga një fshat më i largët, — ata më shumë do të shoqëroheshin me një bashkëfshatar të tyre, qoftë ky edhe i kombësisë tjetër, se me një njeri të farefisit të tyre, me të cilin rrallherë takohen.[55] Pra, fshati si bashkësi shoqërore dhe ekonomike ndikon fuqimisht edhe në formimin e karakterit të njeriut dhe të ndërgjegjës së tij, sidomos atëherë kur ky jeton vetëm nga puna e tij bujqësore, me problemet e tij familjare e fshatare, të cilat janë të ngjashme e të përbashkëta me hallet e fqinjve dhe të mbarë katundit.

Institucioni i bajrakut, i fisit dhe e fshatit ka kohë që e kanë humbur fuqinë e tyre për të rregulluar dhe intervenuar në jetën shoqëroro-ekonomike sipas normave të Kanunit, sipas zakonit të vjetër, sepse kanë ndryshuar kushtet, koha, e cila ka sjellë ndryshime rrënjësore, norma të reja, të cilat ndryshojnë diametralisht me normat e traditës. Megjithatë, në shumë raste, populli i kësaj treve rregullonte marrëdhëniet reciproke sipas dispozitave ligjore në fuqi, mirëpo njëkohësisht edhe sipas traditës. Në të vërtetë, kjo e fundit kishte peshë më të madhe dhe marrëveshjet, vendimet që merreshin në bazë të normave zakonore (të traditës) zinin vend përgjithmonë, sidomos për sa i përket pajtimit të gjaqeve, ndërsa vendimet gjyqësore, ose të organeve të tjera shtetërore, nëse nuk ishin të kënaqura me to të dy palët, kishin fuqi të përkohshme dhe shpeshherë pala e pakënaqur e bënte të veten sipas normave të traditës, „sipas Lekës".

Nga të gjitha institucionet e tjera shoqërore që i përmendëm më sipër, familja kishte më pak ndryshime. Ndërsa fisi e bajraku nuk kanë fare ndikim në jetën bashkëkohore, e fshati ka pësuar transformim rrënjësor nga aspekti i organizimit të kësaj bashkësie themelore, ndërkaq familja ka mbetur në shumë raste patriarkale, edhe pse kjo ka pësuar gjithashtu ndryshime të mëdha në strukturën e saj. Familja në Lug të Baranit qëndron kryesisht në koncepsionet e traditës — me kryefamiljarin në ballë, me ndarjen e punës dhe me pozitën nënshtruese të gruas. Por në krahasim me ndjenjen e përkatësisë fisnore, e cila si e tillë është ende e fortë në Lug të Baranit, ndjenja e përkatësisë bajrakut është zbehur fare, madje kohezioni i tij dukej edhe në të kaluarën zakonisht vetëm atëherë kur jepej kushtrimi për të marrë armët në dorë.

Shkalla e ulët kulturore në të kaluarën ka ndikuar dukshëm në ruajtjen dhe konservimin e faktorëve të tjerë shoqërorë, që i kanë rrënjët thellë diku në mesjetë. Shkolla (dhe libri) në gjuhën shqipe kanë qenë të ndaluar rreptësisht si nën sundimin os-

[55] Kallëzim i Mehmet Deskut (Gllogjan), Daut Kolicës (Baran), Ndue Sadikut dhe Zef Gjokës (Gllaviçicë) etj.

man ashtu edhe në Jugosllavinë borgjeze. Në Lug të Baranit nga institucionet që duhej të quheshin „kulturore" ekzistonte vetëm një mejtep në Kosuriq, nja 3—4 xhami dhe kisha katolike në Gllogjan. Pra, këto ishin institucione fetare, të cilat nuk kishin kurrfarë rëndësie për zhvillimin e kulturës as në nivelin më të ulët. Përkundrazi, në mejtep e xhami mësoheshin vetëm „dovë" e norma fetare arabisht, e në kishë thuhej mesha dhe ceremoniali fetar vetëm latinisht, kështu që besimtarët nuk kuptonin asnjë fjalë. Në vend të shkollave e mësuesve, qeveritë antipopullore feudale turke e borgjeze jugosllave ndërtonin stacione policore nëpër fshatra, të cilat i mbushnin me zapti e xhandarmëri për ta shtypur e shfrytëzuar sa më tepër fshatarin e varfër. Nga ana tjetër përkrahnin deri diku kishën e xhaminë, përkatësisht klerin, sepse ata predikonin se populli duhet të jetë i dëgjueshëm dhe i përvuajtur ndaj çdo pushteti, se çdo pushtet „vjen nga perendia" dhe se njeriu duhet të vuaj në këtë jetë për të fituar parajsën, ose gjenetin „në atë jetë". Një politikë e këtillë dhe një bindje e tillë e masave të fshatarëve të thjeshtë e analfabetë, çonte ujë në mullirin e qeverive antipopullore.

Pozita e rëndë ekonomiko-shoqërore e fshatarit të Lugut të Baranit, por edhe të Kosovës në përgjithësi, vështirësohej edhe më tepër nga prapambeturia shekullore, nga niveli tepër i ulët i kulturës bashkëkohore dhe nga opiumi fetar që ia jepte klerit për ta vënë në gjumë sa më të rëndë.

Kushtet shoqërore ndryshuan rrënjësisht pas vitit 1945, në kuadrin e ndryshimeve që u bënë në përgjithësi në Kosovë dhe në mbarë vendin, në kushte të reja të rendit shoqëror socialist. Kjo është temë në vete, e cila duhet të studiohet nga disa aspekte, për të parë se si shkon dhe deri në ç'shkallë ka arritur procesi i ndryshimeve të gjendjes ekonomike. kulturore, të raporteve familjare, të strukturës sociale etj. në kuadrin e kushteve të reja shoqërore. Me këtë rast vetëm po i cekim shkurtimisht disa nga këto ndryshime.

Para së gjithash, edhe këtu si në vise të tjera, fshatarëve u është kthyer toka, të cilën ua kishte marrë „agrari" para lufte. Nga numri i madh i kolonistëve, kanë mbetur pak familje. Arsimit iu kushtua kujdesi i duhur qysh në ditët e para mbas lufte. Tani në Baran punon shkolla e mesme, si degë e gjimnazit të Pejës, ndërkaq në Gllogjan e në Kryshec ka shkolla fillore tetëvjeçare e në Nepole, Buqan e Rosuje shkolla katërvjeçare. Në Lug të Baranit para lufte nuk kishte shkelur këmba e mjekut. Tani në Baran është ndërtuar ambulanca moderne me mjek të përhershëm dhe me disa punëtorë të tjerë medicinalë. Një punë e mirë është bërë me ndërtimin e rrugës së asfaltuar, të gjatë rreth 15 km, nga fshati Gllogjan deri në Raushiq, ku lidhet me rrugën kryesore Pejë—Gjakovë. Kjo rrugë, megjithëse e ngushtë, ka lehtësuar lidhjen e të gjitha fshatrave të Lugut të Baranit me Pejën. Ajo ka rëndësi të posaçme për nxënësit e shkollave të mesme, të cilët

çdo ditë shkojnë në mësim në Pejë dhe kthehen në shtëpi të tyre me autobus, i cili qarkullon disa herë në ditë në këtë relacion. Para lufte nuk dinte shkrim as lexim në gjuhën amtare asnjë fshatar shqiptar nga kjo zonë. Tani nga fshatrat e Lugut të Baranit, përveç nxënësve të shkollave fillore e të mesme dhe të studentëve në fakultete të ndryshme, kanë dalë mjekë, inxhinierë, mësues, profesorë dhe ekspertë të tjerë me shkolla të larta e fakultete të kryera në gjuhën shqipe në qytete të ndryshme të Kosovës dhe në Universitetin e Kosovës në Prishtinë. Megjithëse këto janë rezultate të dukshme, prapë numri i atyre që kanë kryer shkolla të larta është i vogël, në krahasim me numrin e banorëve dhe me periudhën 35 vjeçare — nga mbarimi i luftës e deri më 1980. Gjithashtu edhe numri i atyre me shkollë të mesme nuk është aq i madh. Në lëmin e arsimit e të kulturës në Lug të Baranit janë bërë përpjekje serioze dhe rezultatet e deritashme janë relativisht të mira.

Po ky konstatim mund të nxirret edhe për sa i përket ndryshimit të strukturës sociale. Por, këtu rezultatet janë edhe më të vogla, sepse me punë jobujqësore merren vetëm disa persona që punojnë në nja 7—8 shitore nëpër fshatra, disa arsimtarë dhe ndonjë punëtor që ka gjetur punë në Pejë. Nëse këtu nuk e llogaritim një numër të konsiderueshëm punëtorësh që përkohësisht punojnë në botën e jashtme, e gjithë popullsia tjetër, domethënë të paktën 95%, merret vetëm me punë bujqësore. Përveç kësaj këtu dëndësia agrare është shumë e madhe — më pak se 25 ari tokë pjellore për banor. Shkaqet e një gjendjeje të këtillë janë dy llojesh: trashëgimi i mbrapambeturisë së madhe dhe të gjithanshme nga e kaluara dhe investimet e vogla pas lufte e deri tash në këtë zonë, për të dalë me hapa më të mëdhej nga kjo prapambetje. Nga ana tjetër, edhe qytetet e Kosovës janë mbrapa për sa i përket zhvillimit të industrisë dhe të ekonomisë në përgjithësi, kështu që ato nuk mund ta absorbojnë fuqinë punëtore që vjen nga fshati, sepse edhe në qytete mbretëron një papunësi e madhe.

Në kushte të tilla, një numër i madh punëtorësh nga mbarë vendi ka migruar përkohësisht në vende të Evropës Perëndimore, ku ka hyrë në punë. Kështu edhe nga Lugu i Baranit, nga çdo fshat i tij, ka marrë rrugën e gurbetit një numër i madh i njerëzve të rinj për të fituar larg shtëpisë dhe për të ndihmuar familjet e tyre në fshat. Numri i saktë i tyre nuk dihet, as nuk mund të konstatohet, sepse ata janë atje në punë vetëm përkohësisht, kështu që ndërsa disa shkojnë për herë të parë, disa të tjerë kthehen pasi të kenë qëndruar përjashtë disa vjet. Por, nga të dhënat zyrtare të vitit 1981 shihet se nga fshatrat e Lugut të Baranit 442 vetë punonin në botën e jashtme.[56] Nëse edhe këta merren në konsiderim në shqyrtimin e ndryshimit të strukturës sociale të këtyre fshatrave, atëherë mund të dalin rezultate të tjera, por as këto nuk mund të jenë të kënaqshme, sepse përqindja e popullsisë bujqësore në Lug të Baranit edhe në këtë rast duhet të jetë tepër e madhe. Kjo strukturë siç dihet, është indikator i bindshëm i prapambeturisë.

[56] Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin* nr. 14, Prishtinë, korrik 1981, 76.

POPULLSIA

Shënimet më të vjetra për popullsinë e Lugut të Baranit datojnë nga gjysma e parë e shekullit XIV, nga krisobula (dekreti) e manastirit të Deçanit. Siç e cekem edhe më sipër, me këtë dokument Stefan Nemanjiq Deçanski, me rastin e fillimit të punimeve për ndërtimin e këtij manastiri më 1330, ia dhuron këtij edhe disa fshatra në Lug të Baranit. Krysheci përmendet si fshat kufitar me Prapaqanin, ndërsa në Broliq emërtohen kryefamiljarët dhe meshkujt e rritur. Këtu përmenden rreth 55 emra sllavë, por ndër këta edhe vllehu Radosllav me djemtë: Millosh, Dragosh e Radosllav. Në një dokument të këtij mbreti të vitit 1327 përmenden fshatrat Kosuriq, Nepole, Gllogjan dhe Çeskovë. Fshatrat që përmenden në krisobulen e manastirit të Deçanit kanë shumë emra sllavë. Në bazë të onomastikës ose antroponimisë (emra njerëzish) shumë studjues sllavë në fusha historike, etnografike, linguistike etj. kanë nxjerrë dhe nxjerrin përfundime të gabuara për përkatësinë etnike të popullsisë mesjetare në këto vise, duke pohuar se ajo ishte vetëm sllave. Mirëpo këto janë konkluzione të njëanëshme, pa bazë shkencore. Pas Luftës së Dytë Botërore janë gjetur burime të reja historike në arkivat e Turqisë dhe të vendeve të tjera, në bazë të cilave sqarohet edhe çështja e përbërjes etnike të këtyre viseve, gjendja ekonomike e shoqërore e tyre në shekullin XV etj. Kështu të dhënat historike vërtetojnë se emrat sllavë në dokumentat mesjetare nuk tregojnë vetvetiu edhe përkatësinë etnike të personave përkatës, sepse emra sllavë kanë pasur edhe shumë shqiptarë, vllehë etj., siç shihet edhe nga krisobula e Stefan Deçanskit (vllehu Radosllav, djemtë e tij Millosh, Dragosh e Radosllav). Emrat sllavë ndër shqiptarë kanë qenë të përhapur jo vetëm gjatë mesjetës, por edhe më vonë, madje ata ekzistojnë në përmasa jo të vogla edhe sot. Kjo ka arsyet e veta.

Dihet se gati katër shekuj shqiptarët e sllavët janë në kontakt të përhershëm, madje edhe në bashkëjetesë nën sundimin e gjatë të sundimtarëve sllavë. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e popullsisë shqiptare ishte ortodokse, jo vetëm në jug, por edhe në veri edhe në Kosovë.[57] Përveç kësaj, kisha ortodokse serbe në Kosovë në kohën e sundimit turk kishte autorizime të mëdha nga sulta-

[57] Selami Pulaha, *Elementi shpiqtar sipas onomastikës së krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në vitet 1485—1582,* Studime Historike, nr. 1, Tiranë, 1972, 66, 80.

ni mbi të gjithë të krishterët, prandaj edhe mbi katolikët. Ajo në kohën e Nemanjiqëve kishte shumë fshatra si feude të vetat, ose si „metosh" — pasuri kishe, vakëf. (Nga kjo fjalë nën ndikimin e kishës, Rrafshi i Dukagjinit u quajt Metohi). Pasuri të tilla ajo ka pasur edhe në kohën e sundimit turk, por më pak se në mesjetë. Nga relacionet e klerit katolik, nga raportet që ata ia dërgonin papës në Romë, në shekullin XVII e më vonë, shihet se katolikët shqiptarë në Kosovë ishin të detyruar nga kisha serbe ortodokse që t'i nënshtrohen asaj, t'i paguajnë taksa të ndryshme dhe të bëjnë punë fizike për të. Patriku ortodoks i Pejës gëzonte përkrahje të pushtetit turk. Katolikët shqiptarë të këtyre viseve pësonin zullum edhe nga kisha, përkatësisht priftërinjtë ortodoksë. Kështu shumë katolikë shqiptar u detyruan të braktisin fenë e tyre e të kalojnë në atë ortodokse.[58] Kuptohet se këta njëkohësisht braktisnin edhe përkatësinë etnike të tyre dhe sllavizoheshin. Prandaj në dokumentet e krajlave të dinastisë së Nemanjiqëve në mesjetë, në krisobulat e Deçanit e të manastirëve të tjerë në këto vise, duhet të ketë shumë fshatarë shqiptarë që në këto dokumente figurojnë me emra sllavë. Më në fund dihet se edhe në familjen e njohur bujare shqiptare Kastriote ka pasur emra sllav, si p.sh. vëllezërit e heroit tonë kombëtar Skënderbeut të cilët quheshin Stanisha e Reposh. Prandaj nuk mund të merret gjithmonë si bazë e sigurtë antroponimia në dokumentet mesjetare serbe ose turke për përcaktimin e përkatësisë kombëtare — kur është fjala për shqiptarët, sepse këta në shumë raste paraqiten në ato dokumente me emra të huaj — sllavë. Kështu pra, as për popullsinë e fshatrave të Lugut të Baranit, që përmenden në krisobulat e manastirit të Deçanit të vitit 1327- 1330, 1348 etj., nuk mund të vërtetohet përkatësia etnike vetëm në bazë të antroponimisë së saj.

Meqenëse krisobulat (dokumentet kishtare mesjetare) e Deçanit kanë të bëjnë edhe me disa fshatra të Lugut të Baranit, e shohim të arsyeshme t'i themi dy-tri fjalë edhe për vlerën e këtyre dokumenteve burimore. Këto krisobula, si edhe disa të tjera, në historiografinë serbe merren si burime të dorës së parë, në bazë të cilave është shkruar dhe shkruhet shumë për historinë mesjetare të disa viseve, e sidomos të Kosovës. Mirëpo, krisobula e Deçanit nuk ekziston në origjinal, origjinalin e saj nuk e ka parë asnjë historian ose punonjës tjetër i shkencës. Kopja e krisobulës së Deçanit, e shkruar me dorë, është gjetur në shekullin e kaluar, pra mbas më se 600 vjetësh nga koha kur është shkruar origjinali. Madje janë gjetur katër versione të kopjes. Këto versione kanë ndryshime të mëdha mes tyre, jo vetëm gjuhësore, por edhe në përmbajtje, me shtojca e shkurtime që i kanë bërë kopjuesit e ndryshëm — priftërinjtë ortodoksë, ose „punëtorët nacionalë" të shekullit XIX, siç ka qenë arkimandriti i manastirit të Deçanit Gedeon Jurishiq, Millosh S. Millojeviq etj. Për këtë të

[58] Jovan Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI—XIX veka,* Srpska akademija nauka, Beograd, 1950, 340—343.

fundit edhe autorët e botimit më të ri të kësaj krisobule P. Iviq e M. Grkoviq thonë në parathënien e tyre (f. 20) se „nuk mund t'i besohet shumë".[59]

Një version të këtij dokumenti e ka dhënë edhe konsulli i Rusisë cariste në Dubrovnik e Sarajevë, propagandisti dhe ideologu fanatik i panslavizmit Aleksandar Hilferdingu etj. Autorët Iviq-Grkoviq shtojnë në parathënien e përmendur, në lidhje me versionet e kopjeve të gjetura, se — meqenëse origjinali i krisobulës së manastirit të Deçanit nuk ekziston, nga versionet e ndryshme të kopjes së tij shihet se shumë gjera janë shlyer, janë korrigjuar, janë hequr faqe të tëra dhe janë shtuar gjëra të reja (f. 23). Pra, nga kjo del se nuk mund të merret pa rezervë si e vërtetë përmbajtja e këtij dokumenti, të cilit i jepet aq shumë rëndësi në shkencën e historisë, etnografisë etj. Ajo që ka rëndësi të posaçme nga ky aspekt, është fakti se ky nuk është dokument origjinal, por janë kopje të shkruara me dorë nga kopjues të mëvonshëm e të gjetura dhe të botuara në shekullin XIX nga njerëz të tipit Millosh S. Millojeviq, Aleksander Hilferding, Gedeon Jurishiq etj. Të gjithë këta ishin të njohur si propagandistë të idesë panslaviste e të politikës serbomadhe. Prandaj nuk mund të përjashtohet mundësia e falsifikimeve të ndryshme në krisobulat mesjetare nga njerëz të tillë, të cilët përpiqeshin në çdo mënyrë që këtyre viseve t'u japin ngjyrën sllave edhe në dokumentet mesjetare, të shlyejnë e të shtojnë emra njerëzish e vendesh ashtu si shkonte në favor të koncepcioneve të tyre, e para së gjithash në dëm të popullsisë shqiptare të këtyre viseve.

Për popullsinë e Lugut të Baranit ka të dhëna interesante në një dokument, në një defter turk të vitit 1485, domethënë nja 150 vjet mbas krisobulës së manastirit të Deçanit. Ky është një defter ku janë shënuar emrat e fshatrave, emrat e të gjithë kryefamiljarëve dhe emrat e meshkujve të moshës madhore, por të pamartuar, si edhe emrat e grave të veja. Që të gjithë këta ngarkohen me detyrime të ndryshme ndaj shtetit. Përveç kësaj në këtë dokument shënohet struktura e detyrimeve, përkatësisht shuma e të hollave dhe sasia e produkteve bujqësore me të cilat ngarkohej fshati për t'ia dorëzuar spahiut. Detyrimet me të holla shënohen në defter me „ispenxhe" e ato me produkte bujqësore me „ushur". Defteri në fjalë ka rëndësi të madhe për njohjen e gjendjes ekonomike e shoqërore dhe për strukturën e popullsisë në këto fshatra e vise në shekullin XV, d.m.th. gjatë sundimit feudal turk në Ballkan. Defterin në fjalë e ka gjetur në Arkivin e Stambollit prof. Selami Pulaha. Ai këtë e ka përkthyer, redaktuar, studiuar, spjeguar e komentuar, dhe si të tillë e ka botuar Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë në Tiranë më 1974, njëkohësisht me origjinalin në gjuhën turke.[60]

Nga defteret turke të gjysmës së dytë të shekullit XV shihet se në nahijen e Pejës, përveç shumë emrave sllavë të popullsisë,

[59] P. Ivić — M. Grković, *Dečanske hrisovulje...*, 20.
[60] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 1—488.

në 15 fshatra të kësaj nahije popullsia ka pasur me një numër të madh emra shqiptarë, ndërsa pakica emra sllavë, kurse në 8 fshatra shumica mbante emra sllavë e pakica emra shqiptarë.[61] Në nahijen e Pejës, kuptohet, edhe atëherë bënte pjesë edhe Lugu i Baranit.

Nga defteri i vitit 1485 shihet se Lugu i Baranit ishte i banuar mjaft mirë, të paktën për sa i përket numrit të fshatrave, sepse aty figurojnë 10 vendbanime, që do të thotë 2/3 të numrit të fshatrave të sotme, dhe numrit të kryefamiljarëve, ose të shtëpive, siç tregon tabela e mëposhtme, e hartuar në bazë të të dhënave të këtij defteri.

NUMRI I KRYEFAMILJARËVE, I BEQARËVE E I GRAVE TË VEJA MË 1485

Fshati	Kryefamiljarë	Beqarë	Të veja
Kryshec	58	19	3
Kosuriq	50	12	2
Kotradiq	15	5	3
Baran i Epërm	21	2	3
Baran i Poshtëm	31	9	4
Gllogjan	33	3	2
Buqan i Epërm	20	9	1
Buqan i Poshtëm	13	9	1
Nepole	16	1	—
Çeskovë	10	1	1
Gjithsej	267	70	20

Nga tabela e sipërme shihet se nuk janë përfshirë të gjitha fshatrat e kësaj zone të cilat ekzistojnë sot, gjë që mbetet e pashpjegueshme, kur e dimë se në krisobulën e Deçanit, të cilën e përmendem më sipër, figurojnë fshati Broliq e Kryshec. Nga ana tjetër, Buqani në defter ndahet në dy fshatra të veçanta, ndërsa tani është vetëm një. Por kjo nuk ka rëndësi për problemin e popullsisë së kësaj treve të cilin e kemi temë trajtimi. Në krisobulat e Deçanit (ato janë 3) dhe në defterin turk të shekullit XV, nuk figuron numri i banorëve të fshatrave, sepse në këtë shënohen vetëm disa kategori të caktuara të popullsisë, të cilat ishin të ngarkuara me detyrime të ndryshme ndaj kishës, ose shtetit. Përveç kësaj, në dokumentat e parë (të sh. XIV) përmendet një numër më i vogël i fshatrave sesa në dokumentin turk të shekullit XV, kështu që nuk mund të bëjmë një krahasim statistikor të popullsisë midis këtyre dy periudhave. Por për një kohë që është larg nesh gati plot 500 vjet (1485—1981) edhe këto të dhëna nga ky defter, ashtu si janë, kanë rëndësi të madhe për ta njohur deri diku situatën popullative të asaj kohe në këtë trevë.

Struktura sociale e popullsisë nga këto dokumente del e qartë dhe e thjeshtë. Të gjitha familjet ngarkohen me detyrime bujqësore e monetare ndaj kishës dhe ndaj shtetit. Nga kjo shihet se e gjithë popullsia e kësaj zone merrej vetëm me bujqësi, me punimin e tokës e me mbajtjen e bagëtisë. Fshatarët ishin të varur

[61] Po ai, *Elementi shqiptar sipas onomastikës....*, 88.

plotësisht nga feudali — përkatësisht nga spahiu. Për fshatrat Kosuriq, Nepole, Çeskovë e Broliq shihet se vareshin nga manastiri i Deçanit në sh. XV. Prandaj produktet bujqësore, punën e krahut të fshatarëve etj. e shfrytëzonte kjo kishë, ose ndonjë kishë tjetër, të cilës sundimtarët e atëhershem ia falnin këto fshatra, gjë që për gjendjen sociale të fshatarëve nuk kishte ndonjë ndryshim. Nga defteri turk i vitit 1485 shihet se të gjitha familjet e fshatrave që përmenden në Lug të Baranit, vareshin nga spahiu. Atij i jepnin pjesën e caktuar të produkteve bujqësore e shtetit të hollat (ispenxhet). Atëherë përveç tregtisë e zejtarisë, nuk kishte ndonjë veprimtari tjetër ekonomike jobujqësore as në qytete, e as mos të flasim për fshatra. Në këto dokumente, përveç bujqësisë, nuk përmendet asnjë veprimtari tjetër në Lug të Baranit. Prandaj, mund të themi se edhe në atë kohë në këtë zonë jetonte një popullsi me strukturë sociale krejtësisht të unifikuar. Ishte kjo qind për qind popullsi bujqësore, e shfrytëzuar nga feudali dhe shteti feudal, sipas ligjeve të kohës.

Dokumentet në fjalë nuk përmbajnë të dhëna për strukturën kulturore të popullsisë, nuk përmendet asnjë shkollë, mejtep, mësues, ose „daskall" në këto fshatra. Por në kuadrin e gjendjes së përgjithshme kulturore të asaj kohe, mund të themi se niveli kulturor i popullsisë ishte shumë i ulët, jo vetëm në fshat, por edhe në qytet. Ishte kjo një popullsi krejtësisht analfabete, e shfrytëzuar dhe e shtypur nga feudali, administratorët shtetërorë dhe klerikët kishtarë, të cilët gjithashtu ishin në një shkallë të ulët kulturore.

Dokumentet mesjetare sllave e turke janë me interes të posaçëm në lidhje me studimin e strukturës kombëtare të banorëve të fshatrave të cilat figurojnë në to. Mirëpo këtu studiuesi has në vështirësi të mëdha, sepse, si thamë edhe më sipër, emrat e kryefamiljarëve në shumë raste janë sllavë, ndërsa personat përkatse shpeshherë kanë lidhje më të ngushtë të gjinisë së gjakut me njerëz të cilët mbajnë emra shqiptarë. Përveç kësaj, shqiptarët në mesjetë dhe më vonë janë emërtuar me emra sllavë, dhe kështu ndërlikohet problemi i përcaktimit të strukturës kombëtare. Pra, si thamë, në bazë të emrave të dokumenteve të tillë nuk mund të përcaktohet gjithmonë me siguri edhe përkatësia kombëtare kur është fjala për shqiptarët, sepse këta shumë shpesh mbajnë emra sllavë, Kështu p.sh. edhe autorët e botimit më të ri të krisobulave të Deçanit, por edhe disa autorë të tjerë, thonë në spjegime të tyre të këtij botimi se fshatrat Kushevë e Grevë (të cilat përmenden në këtë dokument), gjykuar sipas emrave të banorëve të tyre, kanë qenë fshatra shqiptare. Ndërkaq „shumica e banorëve të katundeve vllahe shpeshherë mbante emra sllavë... Njerëzit me emra sllavë e vllahë shpeshherë kanë qenë në gjini gjaku më të afërme (babë e djalë, vëllezër etj.).... Kjo tregon se kishte filluar procesi i asimilimit etnik i vllehëve, kjo ka qenë gjithashtu edhe shprehje e politikës që ushtronte kisha ortodokse serbe për dhënien e emrave".[62]

[62] P. Ivić — M. Grković, *Dečanske hrisovulje....*, 16.

Të dhëna të këtilla nga fusha e antroponimisë ka shumë në defterin turk të vitit 1485 edhe për popullsinë e Lugut të Baranit, ku dalin emra të përzier dhe shumë emra sllavë. Kështu p.sh. në fshatin Kryshec, përveç shumë emrave sllavë, disa kryefamiljarë dalin edhe me emra shqiptarë: Nenko, i biri Dimitrit, Gjergji, i biri i Dimitrit, Gjergji, i vëllai i Radiçit, Branko, i vëllai i tij, Branko, i vëllai i Gjonit, Gjorgji, i biri i Ajo Prendit, Dimitri, i biri i Spanit, Bozhidari, i biri i Nushës dhe Radosavi, i biri i tij, Nenko, i biri Gjures, mysliman Hamzai etj. Në këtë regjister (defter) dalin me emra shqiptarë 3 kryefamiljarë, 6 me emra shqiptaro-sllavë e 71 me emra sllavë.[63]

Në fshatin Kosuriq, sipas defterit të vitit 1485, kishte 47 kryefamiljarë të krishterë, 3 myslimanë, 12 beqarë e 2 të veja. Emrat e njerëzve edhe këtu janë sllavë, gjë që duhet të merret me rezervë për përcaktimin e strukturës etnike të popullsisë së fshatit, për arsye të cilat i cekëm më sipër. Ndër emrat familjarë janë edhe „mysliman Ismaili, mysliman Iskenderi dhe mysliman Jonusi", pastaj emrat, ose mbiemrat shqiptarë: Nika, Nikolla, i biri i Nikës, Kragui, i biri i Prenkut, Nikolla, i biri Gjushenit etj.[64] Në Baran të Poshtëm shënohen në defter 32 shtëpi, 9 beqarë e 4 gra të veja. Antroponimia e këtij katundi është gjithashtu interesante, sepse mes shumë emrave sllavë, ka edhe emra shqiptarë, si p. sh.: Plaku, i biri i Bozhidarit, Bogdani, i biri i Plakut, pastaj Lika, Miraçi, Fransoja, Gjurashi etj.[65] Në Baran të Epërm figuronin edhe emrat: Prebili, i biri i Gjures, një Prebil tjetër — i biri i Gjonit, Nikolla, i biri i Nenos, dhe shumë emra sllavë. Fshati kishte 21 kryefamiljarë, 2 beqarë e 3 të veja.[66] Në Gllogjan, përveç emrash të tjerë, figuronin edhe këta: Progoni, i biri i Grubaçit, Boçuli, i biri i Vukut, Spani, i biri i Vukut, Oliviri, i biri i Mirakut, Radivoi, i vëllai i tij, Prodani, i biri i Radovanit, Radiçi, i biri i Beles etj.[67] Këtu mund të ketë pasur edhe familje vllëhe. Fshati Raushiq quhet kështu, ndoshta, sipas Raushit (emër vllah).

Në defterin e shekullit XV figuron fshati Popole, i cili varej nga Peja. Ky fshat përmendet bashkë me Llukën e Epërme, fshat kufitar me Lug të Baranit. S'ka dyshim se Popola e defterit turk duhet të jetë Nepolja e sotme, e cila atëherë kishte 16 kryefamiljarë dhe 1 beqar. Në regjistrin e kryefamiljarëve të Nepoles përmenden edhe këta: Oliviri, Rajça, Radiçi, Nenko, i biri i tij, pop Bogdani, Marko Radashini, Dimitri- i biri i Stojanit etj.[68] Buqani në këtë defter paraqitet si dy vendbanime — Buqani i Epërm e Buqani i Poshtëm. Buqani i Epërm kishte 20 shtëpi, 9 beqarë e 1 të vejë, ndërsa Buqani i Poshtëm 13 shtëpi, 9 beqarë e 1 të vejë.[69]

[63] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 240, 241. Shih edhe punimin e tij *Të dhëna onomastike mbi elementin shqiptar të krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në fund të shekullit XV*. Studime Historike, nr. 4, Tiranë, 1972, 177, 180.

[64] Po ai, *Defteri i regjistrimit....*, 211, 212.

[65] *Po aty*, 281.

[66] *Po aty*, 276.

[67] *Po aty*, 290, 291.

[68] *Po aty*, 227.

[69] *Po aty*, 276, 277; 183, 184.

Emrat e banorëve të Buqanit tregojnë qartë se sa e përhapur ishte antroponomia sllave në popullsinë shqiptare në këtë zonë, por e njëjta situatë ishte edhe në krahina të tjera me popullsi shqiptare. Kështu në fshatin Buqan atëherë ishin edhe këta kryefamiljarë: Gjoni, i biri i Miomanit, Nenko, i biri i Lalës, Gropani, i biri i Lleshit, Gropani, i biri i Rajkos, Nikolla, i biri i Radiçit, Dimitri, i biri i Nikollës, Miomiri, i biri i Dobrashinit, Rajko, i biri i Radiçit etj.[70] Kotradiqi, sipas këtij defteri, në atë kohë ishte fshat i vogël me 16 shtëpi, 5 beqarë e 3 të veja.[71] Çeskova ishte edhe më e vogël, vetëm me 10 shtëpi, 1 beqar dhe 1 e vejë. Ndër emrat e banorëve përmenden edhe Nenko, Nikolla, Radiçi etj. Këta emra në disa fshatra të tjerë figurojnë pranë emrave shqiptarë në relacion të ngushtë të gjinisë së gjakut të personave që i mbanin këta emra. Përveç kësaj, nga defteri janë edhe disa të dhëna interesante për popullsinë e këtij fshati. Fjala është për migracionet e saj. Kështu, nga këta pak banorë një përqindje e madhe e tyre ishin të ardhur, të vendosur rishtas në këtë fshat. Kjo shihet nga fjala „prishliç" (i ardhur), e cila këtu është marrë si mbiemër: Rasha Prishliç, Radan Prishliç, Jovan Prishliç — të gjithë këta kryefamiljarë.[72] Ky mbiemër Prishliç mund të krahasohet me mbiemrin e sotem Muhaxhir, Muhaxheri, që do të thotë „i ardhur", i cili ka qenë i përhapur sidomos në pllajën e Kosovës në ato familje të cilat më 1877 e 1878 i dëboi qeveria borgjeze e Obrenoviqve nga Toplica, Prokupja, Kurshumlia, rrethinat e Leskocit etj. Këto familje shqiptare, me rreth 150.000—200.000 veta,[73] u vendosen nëpër fshatrat e qytetet e Kosovës dhe popullsia vendase i quante në fillim muhaxhirë. Shumë familje të tilla e morën këtë emër si llagap familjar. Gati në të gjitha qytetet e Kosovës edhe sot ekziston „mahalla e muhaxherve", e cila zakonisht ndodhet në një skaj të qytetit, atje ku qenë vendosur familjet shqiptare që shpëtuan nga masakri në Toplicë dhe vise të tjera, ku këto i kishin trojet e tyre, të cilat u bënë hi e pluhur.

Antroponimia mesjetare e Lugut të Baranit, nga dokumentat sllave e turke që i shfrytëzuam këtu, siç u pa, ka rëndësi të madhe për studimin edhe të disa problemeve të tjera popullative, e jo vetëm të përkatësisë kombëtare. Përveç të tjerave, antroponimia sllave në popullsinë shqiptare tregon edhe shkallën që kishte arritur procesi i sllavizimit të tyre. Këto të dhëna nga defteri turk i vitit 1485 janë publikuar para disa vjetësh, pra janë ende të panjohura sa duhet nga studiuesit e huaj, të cilët në bazë të antroponimisë sllave në dokumentat mesjetarë nxjerrim përfundime të gabuara mbi përkatësinë kombëtare të popullsisë, e cila figuron në ato dokumente, dhe kjo — në dëm të popullsisë shqiptare.

Defteri i shekullit XV tregon qartë, me shembuj konkretë, se shqiptarët mbanin edhe shumë emra sllavë. Në defterin e vitit

[70] *Po aty*, 276, 277.
[71] *Po aty*, 294.
[72] *Po aty*, 274.
[73] Sabit Uka, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Serbia Juglindore gjatë luftërave 1877—1878*, (Punim magjistrature), Prishtinë, 1979, 106—109.

1485 ka shumë shembuj bindës për të dokumentuar këtë të vërtetë edhe në fshatra të tjera, jo larg Lugut të Baranit. Kështu në Podgur të Pejës (ose të Istogut), në fshatin Uçë figuronin edhe këta kryefamiljarë: Gjura, i biri i Gjonit, Jaku, i biri i Bursatit, Ilia, i biri i Marinit, Gjoni i vëllai i Todorit. Në fshatin Dujakë, kufitar me Lug të Baranit: Nenko, i biri Kukës (Kokës), Nenko, i biri i Gjinit, Radiçi, i biri i Gjinit, Andrija, i biri i Gjonit, Gjini, i biri i Mekshes, Gjoni, i biri i Nikollës. Në qytetin e Gjakovës përmendet Bozhidari, i biri i Preniqit, Nikolla, i biri i Mires, Vuja, i biri i Domenikut, Dedaçi (Deda), i biri i Gjorgjit, Radiçi, i biri i Plakut. Në Deçan përmendet Radivoi, i biri i Gjonit, Bogdani, i biri i Gjeçit, Nikolla Kullari, Spala, i biri i Prekut. Në Shtupel: Vukota, i biri i Dedashit (Dedës) dhe Jovani, i vëllai i tij, Vuku, i biri i Dedashit dhe Marku, i vëllai i tij. Në Poterç të Poshtëm (Lugu i Leshanit), përveç tjerëve, thuhet qartë se me emrin Nenko quheshin shqiptarët. Në defter shkruan „Nenko shqiptari". Emri Nenko dhe emri Radiç paraqitet shumë shpesh gati në të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit dhe në shumë të tjera. Nga shumë shembuj të tjerë, disa nga të cilët i dhamë edhe këtu më sipër, shihet se Nenko ishte i biri i Gjinit, Radiçi gjithashtu ishte i biri i Gjinit, një Radiçi tjetër ishte i biri i Plakut, e kështu me radhë. Jo vetëm në defterin e shekullit XV, por edhe në atë të vitit 1591, antroponimia në disa vise të tjera përmban shumë shembuj të këtillë për strukturën e saj të përzier. Kështu në fshatin Dobrodolan në „nahijen e Hoçës" (Prizren) figurojnë kryefamiljarët: Gjon Milloshi e Jak Jovani, në fshatin Semetishtë: Dedja Jovani e Jak Daba, në Zojç: Dedë Marku, Duka Gika, Prend Gika, Bie Pejo, Prend Marku etj.[74]

Është me interes për sqarimin e disa problemeve të popullsisë së lashtë të Rrafshit të Dukagjinit, por edhe të pasardhsave të tyre, t'i shqyrtojmë edhe disa antroponime të kryefamiljarve në fshatin Junik, të shënuar në defterin e vitit 1485. Përveç emrave të tjerë, këtu figurojnë edhe këta: Damjani, i biri i Nikollës dhe i vëllai Progoni me djemtë e tij të quajtur Gjon e Nikollë; pastaj — Bozhidari, i biri i Gjonit, Gjoni, i biri i Lekës dhe Stepani, i biri i Lekës. Tash në Junik ekziston familja shqiptare me llagap Stepanët. Disa autorë sllavë, duke u bazuar në këtë emër, shkruajnë se kjo familje ka prejardhje serbe. Por nga dokumenti (defteri) i vitit 1485 shihet qartë se Stepani ka qenë i biri i Lekës, pra, gjithsesi shqiptar, ashtu siç ka qenë edhe Bozhidari i biri i Gjonit. Edhe në qoftë se kjo familje nuk rrjedh nga Stepani i shekullit XV, prapë nuk ka kurrfarë baze që prejardhja e saj kombëtare të cilësohet sllave në bazë të një emri, të cilin e kanë pasur edhe familjet shqiptare, madje mu në Junik, para shumë shekujsh. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për familjen Rajku në Dubovik dhe Stojku në Buqan në Lug të Baranit. Nëse merren përfundime të prera mbi strukturën etnike të asaj kohe vetëm në bazë të antroponimeve, atëherë si do të shpjegohej ky problem në fshatin Neprobishtë (Prizren), ku ekzistonin edhe këta kryefamil-

[74] S. Pulaha, *Elementi shqiptar sipas onomastikës....*, 175—227.

jarë: Drago Arbanasi dhe Miha, i biri i Arbanasit; ose në fshatin Truphoc (Istog) — Bogdan Shqiptari? Kështu, edhe emri Radiç tingllon si emër sllav, siç e cekem edhe më parë, por në shumë raste ai paraqitet bashkë me emra shqiptarë. Kështu vetëm në fshatin Bajë (Bana) të rrethit të Pejës në defter shënohet disa herë: Radiçi, i biri i Bogdanit, Radiçi, i biri i Boshkos, madje edhe Radiç Krasniqi, ndërsa në fshatin Leshan (Pejë) — Radiç Vuksani.[75]

Emrat që përmenden këtu, si p.sh. — Vuksan, Bozhidar, Bozhë, Gjurë, Nikë, Nikollë, Bogdan, Millosh etj. edhe sot mund të dëgjohen ndër shqiptarë katolikë në Rrafsh të Dukagjinit, ndërsa shqiptarët në Mal të Zi me një numër të madh kanë emra sllavë. Kjo dukuri shfaqet edhe në viset jugore të Maqedonisë. Nuk duhet harruar fakti se edhe në Kosovë një numër i shqiptarëve kanë qenë ortodoksë.

Për t'i përfunduar këto vrojtime që i bëmë këtu në lidhje me të dhënat nga dokumentat serbe e turke të mesjetës, mendojmë se do të jetë mënyra më e mirë t'u lëmë vend disa shembujve nga antroponomia e fshatit, i cili në defterin turk të vitit 1485 figuron me emrin Lepovaç, që duhet të jetë fshati Lipa përmbi Pejë, ose Lipoveci në Rekë (Gjakovë), gjë që me këtë rast nuk ka shumë rëndësi. Ky fshat ka qenë „timar i Lazar Shqiptarit" — thuhet në defter dhe ka pasur 45 kryefamiljarë, gati të gjithë me emra shqiptarë, ose shqiptaro-sllavë, si p.sh.: Gjoni, i biri i Andrijes, Pepa, i biri i tij, Nenko, i biri i tij, Gjoni, i biri i Stepanit, Gjini, i vëllai i Vukut, Tanushi, i vëllai i Vukut, Gjini, i biri i Bardos, Bardo (Bardh?) Stepani, Gega, i biri i Ivanit, Andrija Gega, Gega Govedari, Branko, i biri i Tanushit, mysliman Iskenderi, Vuk Gjeçi, Giga Todori, Gjeçi, i biri i Gjonit, Nenko, i biri i Gegës etj.[76] Këta shembuj vetë flasin shumë qartë në favor të shpjegimeve që i dhanë më sipër lidhur me antroponiminë dhe strukturën e popullsisë të Lugut të Baranit (dhe të viseve të tjera) në bazë të dokumentave mesjetare, të cilat i shfrytëzuam me këtë rast.

Të dhëna të shkruara për popullsinë e Lugut të Baranit për një periudhë të gjatë nuk kemi pasur rast të gjejmë — që nga regjistri i kryefamiljarëve në defterin turk të shekullit XV, e deri kah fillimi i shekullit XX. Materiale të tilla arkivore nga koha e sundimit turk duhet të ketë me siguri, por ende nuk janë botuar, as s'janë evidentuar në ndonjë botim. Kah fillimi i sh. XX ka mbledhur në terren materiale të ndryshme gjeografike e etnografike gati në të gjitha viset e Ballkanit gjeografi i njohur serb Jovan Cvijiq (1865—1927). Në Kosovë ka mbledhur materiale të tilla prej vitit 1900 deri më 1910. Ai ka organizuar një rrjetë të gjërë bashkëpunëtorësh në terren, sidomos mësues e priftërinj, të cilët mblidhnin dhe i dërgonin në Beograd shënime të ndryshme për popullsinë sipas udhëzimeve të tij. Kështu edhe për fshatrat e Lugut të Baranit Cvijiqi ka marrë të dhëna nga bashkëpunëtorët për numrin e familjeve dhe përbërjen kombëtare e fetare të

[75] P o a i, *Studime Historike* nr. 1/1972, 76.
[76] P o a i, *Defteri i regjistrimit....*, 255, 256.

tyre. Këto shënime janë të periudhës 1900—1905 dhe i ka botuar më 1911 në vëllimin e tretë të vepres së tij të njohur „Bazat gjeografike e gjeologjike të Maqedonisë e të Serbisë së vjetër." Ai jep shënime të tilla për 13 fshatra të Lugut të Baranit,[77] të cilat po i paraqesim në këtë tabelë.

NUMRI I SHTËPIVE DHE STRUKTURA KOMBËTARE MË 1900-1905

Fshati	Serbë	Shqiptarë		Jevgë		Gjithsej
		Myslimanë	„Latinë"	Myslimanë	Ortodoksë	
Broliq		12				12
Çeskovë		15				15
Gllogjan		7				7
Buqan		10				10
Baran		20				20
Kotradiq		15				15
Kryshec		10				10
Rashiq		10				10
Vranoc		14				14
Kosuriq		20				20
Kpuz		10				10
Turjakë		10				10
Nepole		25				25
Gjithsej		178				178

Nga të dhënat e sipërme mund të nxirren disa përfundime mbi gjendjen popullative të Lugut të Baranit kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i sh. XX. Para së gjithash bie në sy se mungojnë të dhënat për 2 fshatra të kësaj zone — për Çellopekun e Llugaxhinë, ndërsa fshati Baran është marrë si një vendbanim. Këto dy katunde nuk janë lagje të fshatrave të afërme, por figurojnë si tërësi në veti. Çellopeku ishte me kohë njëfarë qëndre strategjike, ku qëndronte xhandarmëria. Nëpër këtë fshat kalon rruga kryesore që lidh këtë zonë me Pejën. Llugaxhia është fare afër Kosuriqit, kështu që ata që kishin mbledhur shënime për këtë fshat duhet ta kishin vërejtur edhe Kosuriqin. Prandaj mbetet e pashpjegueshme mungesa e këtyre dy fshatrave në të dhënat e sipërme.

Nga tabela shihet vetëm numri i shtëpive, e jo edhe i banorëve. Por duket se edhe numri i shtëpive duhet të ketë qenë më i madh sesa është paraqitur këtu. Të 14 fshatrat e Lugut të Baranit kishin, sipas kësaj tabele, vetëm 178 shtëpi (familje). Tash vetëm Barani (i Epërm e i Poshtmi) kanë 133 shtëpi, ndërsa vetëm Krysheci, në vitin 1971, kishte më shumë se 140 shtëpi. Kjo mund të shpjegohet në dy mënyrë: ose më 1905 numri i shtëpive është shënuar shumë i zvogëluar, ose gjatë këtyre shtatë dekadave rritja e popullsisë në këtë trevë ishte shumë e madhe, meqenëse më 1971 kishte 1005 shtëpi.

Për sa i përket strukturës kombëtare të popullsisë, duhet pasur parasysh se gjeografi J. Cvijiq në veprat e tij i kushtonte

[77] J. C v i j i ć, *Osnove za geografiju i geologiju....*, 1189, 1190.

kujdes të posaçëm kësaj çështjeje. Mirëpo ai kujdesej në veçanti për popullsinë serbe, duke u përpjekur që mos të mbeste asnjë familje e kësaj kombësie pa u shënuar. Për më tepër, shpeshherë ai këto „i ka gjetur" edhe atje ku nuk kanë ekzistuar fare, kështu që në shumë raste popullsinë e kombësive të huaja e paraqet si popullsi serbe, ose me prejardhje të tillë. Kështu bën ai sidomos kur është fjala për popullsinë shqiptare. Edhe nxënësit e bashkëpunëtorët e Cvijiqit vepruan si mësuesi i tyre. Madje, edhe vetë Cvijiqi e konstaton këtë, kur këta ia teprojnë në këtë drejtim. Me gjithë tendencën e njohur të tyre, informatorët e Cvijiqit nga terreni për popullsinë e Lugut të Baranit nuk kishin pasur kurrëfarë mbështetjeje për të dhënë informata jo të sakta mbi përbërjen kombëtare të saj. Prandaj edhe nga të dhënat e tyre shihet se në fillim të sh. XX nuk ka pasur në Lug të Baranit asnjë familje të kombësisë tjetër përveç familjeve shqiptare. Të gjitha rubrikat e tjera të tabelës, përveç asaj ku është shënuar kombësia shqiptare, kanë mbetur zbrazët. Mirëpo, këtu është bërë një gabim lidhur me shënimet mbi strukturën fetare, sepse, sipas këtyre të dhënave del se e gjithë popullsia e Lugut të Baranit në atë kohë ishte myslimane. Mirëpo, siç e thamë edhe më parë, këtu nga ky aspekt gjithmonë jetonte një popullsi e përzier, madje, kishte edhe familje të përziera — myslimane e katolike. Fshati Gllogjan përbëhet gati i gjithë nga familje katolike, ndërsa Nepolja ka vetëm familje të kësaj feje. Janë edhe disa familje katolike në disa fshatra të tjera (p.sh. në Llugaxhi, Broliq etj.). Ortodoksë nuk ka pasur në këtë trevë para Luftës Parë Botërore, siç shihet edhe nga të dhënat nga tabela e Cvijiqit, por mund të ketë pasur ndonjë familje rome të cilat zakonisht flasin shqip e nuk dinë gjuhë tjetër, prandaj mund të jenë asimiluar me kohë.

Nga të dhënat e mësipërme shihet numri i shtëpive, e jo edhe i banorëve. Por, sikur të ishte i saktë numri i shtëpive, do të mund të llogaritej përafërsisht edhe numri i banorëve. Kah fillimi i sh. XX, por edhe më heret edhe më vonë, familjet e Rrafshit të Dukagjinit kishin shumë pjesëtarë, ishin familje të mëdha patriakale. Disa nga këto kishin edhe nga 100 njerëz nën një kulm. Familje me nga 20—30 pjesëtarë ka edhe sot në këtë zonë. Por, nëse e marrim se çdo shtëpi kishte mesatarisht 15 pjesëtarë, del se kah fundi i shekullit XIX Lugu i Baranit kishte rreth 2670 banorë. Madje, ky numër del duke marrë për bazë numrin e shtëpive, i cili na duket se është i zvogëluar dhe duke mos llogaritur këtu Çellopekun e Llugaxhinë, të cilat nuk janë përfshirë në të dhënat për të cilat është fjala. Nëse edhe për këto dy fshatra e marrim se mesatarisht kishin nga 10 shtëpi me nga 15 pjesëtarë të familjës, atëherë numri i përgjithëshem i banorëve të Lugut të Baranit del rreth 3000 vetë. Për një zonë relativisht pjellore, mund të themi se nuk ishte e banuar sa duhet për të shfrytëzuar këtë ambient gjeografik, me kushte të përshtatshme natyrore, aq sa duhet. Mirëpo, në atë kohë fshatarët i kushtonin kujdes më të madh blegtorisë sesa punimit të tokës, kështu që edhe sipërfaqja e shfrytëzuar për ara e kopshte ishte shumë më e vogël se ç'është tash.

Numri i saktë i popullsisë në këtë zonë, si kudo, është konstatuar me rastin e regjistrimit të popullsisë më 1948, 1953, 1961 dhe 1971. Përveç kësaj, edhe Këshilli Popullor i Vendit në Gllogjan dhe në Baran kishin bërë një regjistrim të popullsisë, për nevoja të tyre, më 1950. Edhe para Luftës së Parë Botërore janë bërë dy regjistrime të përgjithshme të popullsisë në Jugosllavinë borgjeze — më 1921 e më 1931. Mirëpo, nuk i kemi të dhënat e këtyre regjistrimeve, të cilat edhe ashtu nuk kanë qenë pasqyrë e gjendjes reale, sidomos për sa i përket numrit të përgjithshëm të shqiptarëve dhe përkatësisë tyre kombëtare. Pas çlirimit Lugu i Baranit nuk ishte një tërësi administrative, si është terësi etnografike dhe gjeografike. Një kohë fshatrat e kësaj zone përbënin dy Këshilla të vendit — Gllogjan e Baran. Gllogjani përfshinte: Kosuriqin, Llugaxhinë, Gllogjanin, Nepolen, Çeskovën e Kpuzin. Këto fshatra ndodhen në pjesën e poshtme, lindore, të Lugut të Baranit dhe përbëjnë deri diku një tërësi gjeografike më vete — me një pjesë fushore (Kosuriqi, Llugaxhia, Gllogjani e Nepolja) dhe me pjesën tjetër kodrinore (Kpuzi e Çeskova), e cila kufizohet kah lindja me Drinin e Bardhë. Këshilli i Vendit Baran përbëhej nga fshatrat: Kotradiq, Vranoc, Buqan, Çellopek, Turjakë dhe Baran. Përveç Turjakës, fshatrat e tjera ndodhen në zonën fushore të Lugut të Baranit dhe kështu përbëjnë një tërësi më vete nga aspekti gjeografik. Mirëpo, kjo ndarje ka qenë mjaft artificiale, e imponuar nga nevojat e kushtet e kohës, megjithëse nga aspekti gjeo-etnografik i gjithë Lugu i Barinit është një tërësi dhe një ndarje e tillë mund të arsyetohet vetëm me elemente të nevojshme momentale të administratës. Kjo ndarje nuk mund të ketë jetë të gjatë, madje ajo as nuk ka zgjatur shumë. Nga ana tjetër me ndarjen e tillë administrative kanë mbetur jashtë suazave të Këshillit të Vendit Baran tri fshatra — Broliqi, Rashiqi e Krysheci, të cilat janë pjesë të pandara të kësaj zone. E gjithë kjo krijon vështirësi për studimin e popullsisë në tërësi, sepse statistika zyrtare nuk i përfshin të gjitha vendbanimet, e përveç kësaj, metodologjia në regjistrimin e popullsisë ishte e ndryshme te këto dy këshilla të vendit. Kështu p.sh. Barani jep edhe strukturën gjinore të popullsisë, ndërsa në statistikën e Gllogjanit nuk ekziston kjo rubrikë. Nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 1948 kemi vetëm numrin e banorëve, e jo edhe strukturat e tjera demografike, të rëndësishme për studimin e popullsisë nga aspekte të ndryshme të shkencave shoqërore.

Më 1948 fshatrat Kpuz e Çeskovë nuk i takonin Këshillit Popullor të Vendit të Baranit, prandaj nuk ka të dhëna për këto dy vendbanime. Fshatrat e tjera kishin këtë numër banorësh: Nepolja 294, Gllogjani 441, Kosuriqi 733, Kotradiqi 480, Buqani 315, Barani 834, Krysheci 752, Vranoci 406, Rashiqi 440, Broliqi 607, Çellopeku 430, Llugaxhia 171 dhe Turjaka 288; gjithsej 6141.

Të dhëna të tjera statistikore, pas vitit 1948, ekzistojnë, si thamë, në regjistrat e këshillave popullore të vendit Baran e Gllogjan për vitin 1950. Me gjithë mungesat, për të cilat folem më sipër, ky regjistrim jep një pasqyrë të mirë të gjendjes numerike dhe strukturore të popullsisë së kësaj treve. Nga se na mungojnë të dhë-

POPULLSIA E LUGUT TË BARANIT MË 1950

Fshati	Numri i shtëpive			Numri i banorëve								
	Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Shqiptarë			Serbë		Malazezë		Gjithsej	
Kosuriq	63	1	28	617			3		147		767	
Llugaxhi	18	—	1	159			—		10		169	
Gllogjan	40	—	23	333			—		110		443	
Nepole	27	—	—	303			—		—		303	
Ceskovë	25	—	2	172			—		12		184	
Kpuz	36	3	13	266			16		60		342	
Kotradiq	51	1	18	416			4		72		492	
Vranoc	37	—	2	396			—		13		406	
Bugan	40	—	—	312			—		—		312	
Çellopek	48	—	7	412			—		22		434	
Turjakë	25	—	11	215			—		58		273	
Baran i Epërm	34	1	6	172			12		51		245	
Baran i Poshtëm	64	2	9	518			5		35		573	
Gjithsej	508	8	120	4350			40		565		4955	

nat nga regjistrimi i vitit 1948 për strukturat e popullsisë, mund të bëhët vetëm krahasimi i numrit të përgjithshëm të banorëve të kësaj zone me të dhënat e regjistrimit të vitit 1950, kur Lugu i Baranit kishte 5209 banorë, pa fshatrat Kryshec, Broliq e Rashiq. Këto 3 fshatra në regjistrimin e vitit 1953 kishin rreth 1750 banorë. Kështu, mund të thuhet se më 1950 Lugu i Baranit kishte rreth 6800 banorë.

Nga tabela e të dhënave statistikore të vitit 1950 (në fq. 64) shihet numri dhe struktura e popullsisë së Lugut të Baranit — përkatësisht vetëm struktura kombëtare, e cila mund të krahasohet me të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 1971.

Këtu, si thamë më parë, mungojnë fshatrat Kryshec, Broliq e Rashiq, të cilat perfshiheshin në atë kohë në kuadrin e një Këshilli të vendit jashtë Lugut të Baranit. Megjithatë, këto të dhëna japin një pasqyrë interesante demografike para më se 30 vjetësh. Këtu, para së gjithash, bie në sy numri fare i vogël i familjeve, përkatësisht i banorëve të kombësisë serbe dhe numri relativisht i madh i malazezve, Kjo vjen nga shkaku se, siç shkruan edhe gjeografi serb J. Cvijiq, në fillim të sh. XX në Lug të Baranit nuk kishte asnjë familje serbe, përkatësisht sllave, kështu që edhe ato pak familje serbe, që shënohen këtu sipri, janë të ardhura më vonë (pas Luftës Parë Botërore), si edhe kolonistët malazezë. Përveç kësaj, pas Luftës Dytë Botërore, shumë familje të kolonistëve malazezë, të cilat gjatë Luftës së Dytë Botërore u dëbuan nga okupatori dhe bashkëpunëtorët e tij dhe u kthyenë në Mal të Zi ose në Serbi, përsëri erdhen në këto fshatra.

Mirëpo, meqenëse toka pjellore, që u ka qenë marrë fshatarëve shqiptarë nga qeveria e Jugosllavisë borgjeze, iu kthye përsëri pronarëve të saj, shumë familje koloniste mbetën në toka jopjellore, në terrene kodrinore. Pas disa vitesh këto toka i bleu nga kolonistët sektori shoqëror bujqësor, kështu që shumë nga këta u shpërngulen në Pejë, por më shumë shkuan në Serbi e në Mal të Zi. Shumica e tyre hynë në punë të shtetit — në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme. Kjo dinamikë e popullsisë shihet nga statistika zyrtare më qartë pas vitit 1953 e 1961. Kështu pra, numri i familjeve malazeze në statistikën e Këshillave popullore të vendit Baran e Gllogjan në vitin 1950 vjen nga rritja mekanike e këtij numri, nga imigracioni, ndërsa të dhënat statistikore të vitit 1971 e tregojnë këtë proces me kahje të kundërt, me emigracionin e familjeve koloniste, si do të shihet në vazhdim.

Tabela e sipërme përmban të dhëna interesante për studimin e strukturës së familjes. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjes tregon se në këto fshatra njerëzit në ato vite jetonin në bashkësi të mëdha familjare. Kjo është më e theksuar te shqiptarët, se te serbët e malazeztë. Kështu familja shqiptare kishte mesatarisht 8,5 pjesëtarë, kurse familja serbe e malazeze 5,5 pjesëtarë. Në disa fshatra dallimi është më i madh në familjet e këtyre kombësive. Kështu në fshatin Kosuriq, ku numri i familjeve dhe i banorëve të kombësisë malazeze ishte më i madh se në çdo fshat tjetër, mesatarja e pjesëtarëve të familjeve malazeze ishte 5,1, ndërsa kjo mesatare në familjet shqiptare kapte 9,7. Kjo e vërte-

ton atë që u tha më parë për këtë fshat, në të cilin familja patriarkale paraqitet me disa veçanti, të cilat nuk janë aq të rendomta në vise të tjera. Fjala është për familjet e ndara. Por mu kjo veçanti na bën që në pamje të parë të mendojmë se numri i pjesëtarëve në njërën pjesë të familjes së ndarë nuk duhet të jetë aq i madh. Të dhënat e sipërme tregojnë të kundërtën, por gjithashtu dëshmojnë se në Kosuriq kishte në vitin 1950 më shumë familje të mëdha patriarkale, pa marrë parasysh tipin e tyre — a ishin të tipit të ndarë, apo e gjithë familja jetonte nën një kulm.

Një ndër faktorët kryesorë në problematikën e gjërë demografike është rritja vjetore e popullsisë. Kuptohet se kjo nuk është një shkallë e përhershme, e pandryshueshme, prandaj ajo vlen vetëm për një vit ose për një periudhë, nëse merret si mesatare. Por, dihet se Kosova zë vendin më të lartë në shkallën e rritjes së popullsisë në Evropë, dhe një ndër vendet e para në botë, sepse kjo shkallë është zakonisht prej 25 deri 32 promil. Nga të dhënat zyrtare të cilat mund t'i shfrytëzojmë me këtë rast shihet se në periudhën 1961—1968 rritja natyrore e popullsisë ishte rreth 28,7 për mijë në Komunën e Pejës (ku bën pjesë edhe Lugu i Baranit), e kjo është më shumë se mesatarja e Kosovës për këtë kohë. Por, shqyrtimet më të hollësishme demografike nuk përkojnë me natyrën e këtij studimi. Të dhënat kryesore të tilla mjaftojnë këtu për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të ecurive demografike, të veçantive eventuale, për të nxjerrë përfundime përkatëse. Në këtë drejtim ka rëndësi edhe struktura kombëtare bashkëkohore e ambientit gjeografik në shqyrtim, sepse edhe kjo strukturë mund të ndikojë në mënyrën e jetës, të punës, të or-

PËRBËRJA KOMBËTARE MË 1971

Fshati	Numri i shtëpive	Numri i banorëve				
		Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Të tjerë	Gjithsej
Baran	157	1069	18	81	1	1169
Broliq	59	500	—	55	18	573
Buqan	40	417	—	—	1	418
Çellopek	78	665	7		1	676
Çeskovë	32	290		4		292
Gllogjan	68	550	2	1		639
Kosuriq	109	919	7	87	2	1012
Kotradiq	75	593	1	84	2	646
Kpuz	48	449	8	20	32	505
Kryshec	142	896	2	46	1	1127
Vranoc	42	616	—	228	2	618
Llugaxhi	30	215	—	—	2	226
Nepole	37	526	—	11		526
Rashiq	68	684	10	—		696
Turjakë	40	337	—	6		343
Gjithsej	1005	8726	55	623	62	9466

ganizimit familjar, të krijimtarisë materiale e shpirtërore të popullsisë etj. Kjo gjendje në Lug të Baranit ishte më 1971, si në tabelën në faqen 66.[78]

Në vitin 1971, sipas regjistrimit të popullsisë, rezultatet e të cilit i paraqitem në tabelën e sipërme, 92,18% e popullsisë së fshatrave të Lugut të Baranit ishin të kombësisë shqiptare, ndërsa 7,83% të kombësive të tjera (malazeze, serbe etj.). Ndërkohë, gjatë dhjetë vjetëve nga regjistrimi i sipërm e këndej, edhe një numër i familjeve malazeze është shpërngulur nga kjo trevë e janë vendosur në qytet, ose në Mal të Zi e Serbi.

Në rubrikën „të tjerë" janë përfshirë 49 vetë, të cilët janë deklaruar si „myslimanë" me kombësi, 18 në Buqan e 31 në Kotradiq. Këta janë të ardhur këtu para pak vitesh nga Sanxhaku dhe rrethet e Plavës e të Rozhajës. Meqenëse flasin serbokroatisht dhe janë myslimanë me fe, ata janë deklaruar edhe me kombësi myslimane, si myslimanët në Bosnje. Populli këta i quan këtu „boshnjakë", megjithëse nuk janë nga Bosnja, as nuk kanë lidhje me prejardhjen „boshnjake". Po në këtë rubrikë, „të tjerët", janë regjistruar edhe 10 vetë të tjerë, për të cilët nuk dihet se për ç'kombësi janë deklaruar, apo nuk e kanë shprehur fare përkatësinë e tyre kombëtare. Përveç kësaj, bie në sy mungesa e romëve, megjithëse në botimet statistikore, ku janë edhe fshatrat e Lugut të Baranit, ekziston rubrika e posaçme për këtë kombësi.

REZULTATET E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË MË 1981

Fshati	Numri i banorëve	Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Myslim.	Të tjerë
1. Baran	1157	1116	8	32		1
2. Broliq	704	630	1	44	29	
3. Buqan	595	595				
4. Çellopek	872	867	5			
5. Çeskovë	401	400				1
6. Kodradiq	808	761	1	10	28	
7. Kosuriq	1162	1108	—	49	5	
8. Kryshec	1406	1213	7	179	7	
9. Kpuz	613	573	3	34	1	2
10. Gllogjan	722	664	—	51	5	2
11 .Llugaxhi	277	277				
12. Nepole	547	547				
13. Rashiq	894	888	—	6		
14. Turjakë	313	306	—	7		
15. Vranoc	753	753				
Gjithsej	11224	10702	25	413	75	5
Përqindja	100%	95,35%	0,22%	3,67%	0,66%	0,04%

[78] Enti Krahinor i Statistikës, *Popullsia sipas përbërjes kombëtare, sipas komunave e lokaliteteve më 1971, Buletin*, nr. 4, Prishtinë, 1975, 16, 17, 27—29.

Ndoshta ndonjë nga këta nuk është deklaruar fare për asnjë kombësi, prandaj mund të jetë ndonjë sish ndër ata 10 të panjohur. Por më parë duhet të jenë deklaruar, ato pak familje rome të kësaj zone, si shqiptarë, nëse janë myslimanë, ose si serbë e malazezë, nëse janë ortodoksë. Por numri i tyre është i vogël. Ndryshimet demografike që janë bërë në Lugun e Baranit gjatë dhjetëvjetëshit 1971—1981 shihen nga tabela në faqen 67.[79]

Të dhënat nga kjo tabelë tregojnë se brenda këtij dhjetëvjeshi (1971—1981) numri i përgjithshëm i popullsisë së Lugut të Baranit është rritur për 1758, ose 18,57%. Vetëm shqiptarët janë shtuar për 1976 njerëz, përkatësisht 22,64%. Të gjitha kombësitë e tjera përbëjnë 4,53% (518 vetë) nga numri i përgjithshëm i banorëve të kësaj zone. Numri i popullsisë është rritur në 13 fshatra, ndërsa në dy (Baran e Turjakë) shënohet një zbritje e vogël (për 42 banorë), gjë që rezulton nga migracionet fshat-qytet.

Migrimet e popullsisë. — Fshatarët migrojnë, dynden nga vendi i tyre më pak se kategoritë e tjera të popullsisë, të cilat merren me punë jobujqësore. Fshatarin e lidh toka, prona e tij e patundshme, të cilën nuk mund ta gjejë lehtë në vise të tjera. Mirëpo, në kohën e feudalizmit turk shumë fshatarë të Lugut të Baranit dhe të Rrafshit të Dukagjinit në përgjithësi, ishin çifçinj në tokë të bejlerëve e të agallarëve të Pejës, të Gjakovës e të Prizrenit. Në kushte të tilla edhe fshatarët migronin shpeshherë, por jo me vullnetin e tyre. Bejlerët e dëbonin fshatarin çifçi nga toka e tij sipas qejfit të tyre, madje edhe për një fjalë goje, e cila nuk i pëlqente feudalit. Një kohë të gjatë deri më 1912, disa beljerë nuk i lejonin çifçinjtë e tyre të ndërtonin shtëpi nga materiali i fortë, por vetëm kasolle, ose shtëpi përdhese nga qerpiçi. Madje, disa zotërinj (bejlerë) nuk e lejonin çifçiun të ngrinte në shtëpinë e tij të varfër oxhakun, as odën e miqve, sepse, sipas mendimit të tyre, oxhaku e oda e mysafirëve ishin shenjë i afirmimit të çifçiut dhe tendencë që toka e trualli, që i shfrytëzonte përkohësisht, të mbeteshin pronë e tij.[80] Shtëpia nga materiali i fortë, me odën e miqve dhe me „tym të vetin" (me oxhak) ishin shenjë e njeriut të lirë, shenjë se aty ka „zot shtëpie", dhe kështu autoriteti dhe e drejta e feudalit mund të binte në hije, të rrezipi kësisoji, beu nuk mund ta dëbonte aq lehtë kur t'i tekej atij.

Feudalët i ndërronin shpesh çifqinjtë edhe atëherë kur u pëlqenin atyre, kur këta ishin korrekt ndaj tyre, duke ua dorëzuar detyrimet nga produktet bujqësore etj. Këtë ata e bënën nga frishëm nëse, një kohë të gjatë, pa ndërprerje e punonin tokën e tyre. Në Podrime p.sh. nëse çifçiu e punonte një tokë 30 vjet pa ndërprerje, ai vetvetiu fitonte të drejtën e përhershme të çifçiut, kështu që feudali nuk mund ta dëbonte më nga ky çifllëk.[81]

[79] P o a i, *Buletin*, nr. 14, Prishtinë, korrik 1981, 39—41.
[80] Kallëzim i A v d y l B e k ë s nga Çeskova.
[81] S. P u l a h a, *Studime Historike*, nr. 1/72, 76.

Në një gjendje të tillë dyndjet e fshatarëve ishin të shpeshta nga fshati në fshat, nga një zonë në një zonë tjetër, duke kërkuar zotëri të ri për ta pranuar për çifçi. Këto migrime shkaktoheshin pra nga një trajtim i posaçëm i fshatarit nga ana e beut, i cili gëzonte përkrahjen e sistemit shoqëror feudal turk. Por, për hir të së vërtetës, nuk kishin të gjithë feudalët qëndrim të tillë ndaj çifçinjve të tyre. Përkundrazi, disa nga këta e përkrahnin fshatarin që të mëkëmbej ekonomikisht, të ndërtonte shtëpi të mirë e të blente bagëti, duke mos e rënduar me detyrime të ndryshme. I këtillë ishte Haxhi Zeka (1863—1902) dhe trashëgimtarët e tij, i cili edhe sot përmendet nga fshatarët e Lugut të Leshanit, Lugut të Baranit etj., si njeri bujar, i drejtë e zemërgjerë ndaj çifçinjve të tij të varfër, përveç meritave shumë të mëdha dhe historike në planin e interesave kombëtare.

Shumë fshatarë me kohë kanë blerë nga bejlerët, lëndina, kullota, ose tokë të mirë; të gjitha këto i kanë bërë tokë buke. Me rëndësi të posaçme është fakti se fshatari në këtë mënyrë bëhej pronar i përhershëm dhe i pavarur në tokën e tij. Kjo ishte pjesa më stabile e popullsisë bujqësore dhe familjet e tilla zakonisht janë më të vjetrat në fshatin e tyre. Gjatë punës kërkimore në terren kam vërejtur se pjesa më e madhe e familjeve fshatare nuk janë shumë të vjetra, sepse kanë ardhur në fshat të tyre para 200—300 vjetësh. Kuptohet se as kjo nuk është pak, përkundrazi, kjo është një periudhë mjaft e gjatë. Mirëpo, fshatari që ka tokë të mirë pjellore e të mjaftueshme, si është toka e Lugut të Baranit, nuk ka nevojë të lëvizë shekuj me radhë e të shkojë në vise të tjera (kuptohet, nëse nuk është i detyruar ta bëjë këtë i shtrënguar nga gjendja e vështirë e natyrës tjetër, joekonomike). Edhe ato familje, të cilat janë në Lug të Baranit një kohë më të gjatë kanë ardhur nga fshatrat e afërme, ose nga malet e afërme — Rugova, Malësia e Gjakovës, Drenica, Vokshi etj. S'ka dyshim se, para ardhjes së tyre, në këto fshatra do të kenë jetuar banorë të tjerë, fshatarë shqiptarë — çifçinj të bejlerëve, të cilët ishin të detyruar të migronin diku më larg nga shkaqet që i cekëm më lart.

Këto dyndje të popullsisë dhe vendosja e saj në tokë pjellore në Lug të Baranit, shkaktoheshin para së gjithash nga arsyet ekonomike. Ta marrim si shembull fshatin Bellë, i cili ndodhet lart në Bjeshkë të Nemuna në Grykën e Deçanit. Atje, të thuash, nuk ka asnjë pëllëmbë toke pjellore — vetëm pyje e shkëmbinj. Përveç patateve, bimët e tjera bujqësore nuk kanë pse të mbillen. Fshatarët mbajnë bagëti, kanë pak bylmet, por nuk kanë bukë. Ata shesin lopët e delet e tyre dhe blejnë mielli „në rrafsh". Shumë nga këta punonin në rrafsh tokën e huaj „për të tretën", e disa kanë blerë këtu tokë. Kështu, nga kushtet shumë të vështira në Belle (të cilën edhe e patën djegur e pjekur skuadristët italianë gjatë luftës së kaluar, si çerdhe antifashiste), e cila disa muaj gjatë dimrit është e shkëputur fare nga bota, banorët e saj gjithmonë e kanë pasur syrin në fushat pjellore të Rrafshit të Duka-

gjinit, i cili shtrihet rrëzë maleve të larta mbi të cilat qëndron Belleja me shumë halle të veta. Dyndja e fshatarëve nga këto lartësi ka filluar qysh me kohë. Shumë nga këta kanë ngulitur edhe në Lug të Baranit. Sot në Broliq banojnë më se 10 familje të ardhura nga Belleja, ku kanë blerë tokë dhe janë ambientuar krejtësisht si fqinjtë e tyre „rrafshjanë". Nga blegtorë të dikurshëm, tash këta malësorë janë shndërruar në bujq të zellshëm. Disa nga këto familje malësore të ardhura këtu më heret, për t'i pranuar bejlerët për çifçinj, kanë ndërruar edhe fenë dhe kanë kaluar në besimin islam. Këtë e kanë bërë më lehtë kur kanë gjetur këtu shumë familje myslimane të fisit të tyre.

Hakmarrja ka qenë gjithashtu një nga arsyet e dyndjeve të familjeve malësore, të rretheve të Gjakovës e të Plavës, të cilat janë vendosur në këtë zonë, si edhe në shumë fshatra të tjera të Rrafshit të Dukagjinit. Disa nga këta këtu e kanë ndërruar fenë, e disa edhe fisin, me qëllim që mos t'u binin në gjurmë ndjekësit eventualë. Por migrantët e tillë përpiqeshin të vendosen në ato fshatra ku nuk kishte familje të fisit me të cilin ato binin në gjak. Meqenëse në Lug të Baranit ka shumë fise, numri i familjeve të tilla është i vogël. Familje të tilla ka që kanë ardhur „nga boshnjakija" — nga Sanxhaku, Rozhaja etj.

Ngatërresat e ndryshme, sidomos grabitja e vajzave, e cila dikur nuk ishte dukuri e rrallë në disa vise malore, gjithashtu ishte shkak që disa familje ta braktisin vendin e tyre dhe të vendoseshin sa më larg — diku në rrafsh. Në këtë mënyrë jo vetëm që i iknin më larg hakmarrjes, por njëkohësisht e përmirësonin edhe gjendjen e tyre ekonomike, duke u vendosur në toka pjellore. Gjatë punës kërkimore në terren është mjaft vështirë të zbulohen shkaqet dhe arsyet e vërteta të dyndjes së familjeve nga zonat e largëta për t'u vendosur në zonë fushore. Kjo është e kuptueshme, sepse njerëzit nuk dëshirojnë t'i ngjallin as në kujtime plagët e vjetra eventuale. Prandaj bashkëbiseduesi kësaj pyetjeje më me qejf i përgjigjet se jeta e vështirë ekonomike ishte arsyeja për ardhjen e të parit të tyre të largët në këtë zonë nga viset malore. Megjithëse në disa raste përgjigjja e tillë nuk është e plotë, ajo është e arsyeshme dhe e vërtetë.

Disa familje janë vendosur në Lug të Baranit ardhur nga vise të largëta, ku ndiqeshin e persekutoheshin nga organet e pushtetit në të kaluarën, sidomos nga Toplica (muhaxhirët) më 1878, nga Mali i Zi më 1912 e 1913 dhe nga Bihori (Sanxhak) gjatë luftës së kaluar. Pra, edhe kushtet e vështira politike, shtypja nacionale e fetare, terrori e persekutimet nga ana e pushtetit antipopullor në fuqi, mund të ishin shkaqe për dyndje të popullsisë. Dihet se dyndje të tilla ka pasur edhe nga Kosova në drejtim të Malësisë së Gjakovës e Malësisë së Madhe në kohën e dyndjeve sllave në këto vise — herën e parë, dhe në kohën e invazionit turk, herën e dytë. Në të dy këto raste shumë familje shqiptare i kanë braktisur trojet e tyre në Rrafshin e Dukagjinit e përgjithësisht në Kosovë, dhe janë strehuar në shkrepat e Malësisë, ku ruhet tradita brez mbas brezi. Edhe tash pleqtë malësorë e dinë se të parët e

tyre të largët kanë ardhur në këto vise malore nga fushat e gjera të Kosovës.[82] Pra, migrimet, ose shtegtimet e popullsisë, janë një proces i përhershëm. Për arsye të ndryshme njerëzit shkojnë e vijnë, shpërnguljen e vendosen, gjithnjë janë në lëvizje për të gjetur vend e kushte më të mira për jetë nga ato që i kanë pasur në qerdhen e tyre të mëparshme. Asnjë krijesë në botë nuk është më mobile, më e lëvizshme se njeriu. Ai ka arritur të vendoset e të jetojë në të gjitha brezat klimatikë, ai i ka shkelur majet e maleve më të larta dhe është zhytur në thellësitë më të mëdha të detit.[83] Prandaj migrimi nga mali në vërri, ose, në raste më të rralla, në drejtim të kundërt, është një gjë shumë e zakonshme, e arsyeshme dhe e lehtë, sidomos në relacione të shkurtëra — disa orë rrugë, siç janë këto midis Lugut të Baranit e zonave malore përreth tij. Kuptohet se migrimet e popullsisë janë një nga indikatorët e prejardhjes së saj. Por ky indikator mund të jetë i ndërlikuar, për arsye se migrimet mund të bëhën në etapa të ndryshme, duke qëndruar një kohë të caktuar në një vend, dhe kështu me radhë përkohësisht në disa zona të tjera, deri sa të vendosen familjet migrante definitivisht në zonën ku ndodhen tash. Shumë nga familjet e tilla dinë vetëm për vendin e etapës së fundit nga kanë ardhur aty ku janë sot, kështu që prejardhja e tyre e largtë është harruar fare.

Prejardhja e familjeve të tashme nga Malësia në Rrafsh të Dukagjinit, në Kosovë, Maqedoni etj, është trajtuar në mënyrë joobjektive, është keqpërdorur nga shumë autorë borgjezë sllavë, madje dhe nga disa të tjerë pas luftes, duke u përpjekur në shkrimet e tyre që ta mohojnë autoktoninë e shqiptarëve në viset ku ata jetojnë sot. Ata përpiqen „të vërtetojnë" se shqiptarët kanë ardhur në këto vise vetëm gjatë shekullit XVII e XVIII, përkatësisht pas luftës austro-turke më 1690. Kjo e pavërtetë është shkruar, komentuar, botuar e ribotuar me qindra herë në versione të ndryshme, e sidomos në librin e gjeografit të njohur serb Jovan Cvijiqit „Balkansko Poluostrvo" dhe në edicionin e njohur të Akademisë serbe të shkencave „Naselja i poreklo stanovništva" (Vendbanimet dhe prejardhja e popullsisë).[84] Këtë edicion e filloi dhe e drejtoi Cvijiqi deri sa ishte gjallë, pastaj e vazhduan nxënësit e tij, kështu që deri tani janë botuar rreth 50 vëllime, nga të cilat në disa trajtohen viset me popullsi shqiptare nga aspekti antropogjeografik e etnografik. Mirëpo, përsa i përket autoktonisë, lashtësisë, së shqiptarëve faktet historike e arkeologjike e mohojnë krejtësisht tendencën e gabuar të këtyre autorëve. Mu Lugu i Baranit është një trevë e përshtatshme që me fuqinë e të dhënave historike të demantohen edhe me këtë rast pohimet pa bazë shkencore dhe tendencioze të autorëve të ndryshëm mbi autoktoninë

[82] Rrok Zojzi, *Ndamja krahinore e popullit shqiptar*, Etnografia Shqiptare, nr. 1, Tiranë, 1962, 35.

[83] Mark Krasnići, *Migracije stanovništva kao društveno-ekonomski fenomen*, Zbornik radova Pravno-ekonomskog fakulteta, II—III, Priština, 1965, 1—48.

[84] J. Cvijić, *Balkansko Poluostrvo — Južnoslovenske zemlje — Osnovi antropogeografije*, Beograd, 1966.

dhe prejardhjen e popullsisë të këtyre trevave. Meqenëse kjo është temë historike, këtu nuk është vendi që të merremi me të më gjerësisht. Prandaj vetëm do t'i përkujtojmë disa fakte të njohura, por edhe të injoruara nga këta autorë, të cilat janë shumë të qarta sa që ato flasin vetë dhe nuk ka nevojë të futemi në shqyrtime më të thella. Këtu do të ndalemi më gjerësisht në trajtimin e defterit turk të vitit 1485, kur do të flasim konkretisht për vendbanimet veç e veç, të cilat kanë lidhje direkte me këto të dhëna historike.

Shkenca ka vërtetuar, në bazë të të dhënave arkeologjike e historike, se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, dhe bashkë me grekët, janë populli më i vjetër në Ballkan. Ilirët kanë banuar në territorin e sotëm të Shqipërisë, në pjesën më të madhe të Jugosllavisë dhe në viset veriore të Greqisë e të Italisë. Me pushtimin e viseve ballkanike nga ana e romakëve, me përhapjen e Bizantit dhe me ardhjen e sllavëve në Ballkanë duke filluar nga shekulli VII, elementa ilir nuk u zhduk, megjithëse një pjesë u romanizua, ose u sllavizua, ndërsa një pjesë tjetër e tyre u strehua në vise malore rreth zonave fushore, siç tregon edhe tradita të cilën e përmendëm më sipër.

Në dokumentat mesjetare serbe, në krisobulat kishtare, të cilat i cekëm më parë, në shumë raste përmenden kryefamiljarë shqiptarë, madje edhe fshatra të tëra shqiptare në Podrime, në rrethet e Suharekës etj. Këto dokumente janë të shekullit XIV, përkatësisht shkruar 350 vjet më parë se të bëhej lufta austro-turke më 1690. Përveç serbëve e shqiptarëve, në atë kohë ka pasur në këto vise edhe popullsi vllahe.

Në dokumentat turke të shekullit XV (defteri i vitit 1485 etj.) është një numër i madh fshatrash në Lug të Baranit e në Rrafsh të Dukagjinit në përgjithësi, me popullsi shqiptare dhe shqiptaro-sllave. Ky dokument është shkruar 205 vjet para luftës austro-turke të vitit 1690.

Përveç kësaj, dihet mirë, në bazë të dokumenteve historike, se në luftën austro-turke të vitit 1689—1690 kanë marrë pjesë, si vullnetarë në anën e ushtrisë austriake, masivisht shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Sanxhakut të sotëm. Në krye të ushtrisë vullnetare shqiptare ka qenë arqipeshkvi i Shkupit, shkrimtari i njohur shqiptar, Pjetër Bogdani (1625—1689), i cili vdiq gjatë kësaj lufte në Prishtinë. Siç dihet, në këtë luftë kanë marrë pjesë në anën e austriakve edhe serbët e këtyre viseve në krye me patrikun e Pejës Arsenije Çarnojeviq.[85] Gjatë kësaj lufte u shfaq epidemia e kolerës, nga e cila vdiqën shumë njerëz, ndër të cilët edhe Pjetër Bogdani. Në Lug të Baranit edhe tash ekziston toponimi

[85] Mita Kostić, *Prilozi istoriji srpsko-arbanaskog ustanka 1689—1690 godine*, Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, knj. II (1924), Beograd, 1925, 11—21. Po ai, *Završni bilans polemike o srpsko-arbanskom ustanku protiv Turaka uz austrisku vojsku 1689—1690*, Beograd, 1962. Shih edhe S. Pulaha, *Qëndresa e armatosur e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga fundi i shekullit XVII — fillimi i shekullit XVIII, nën dritën e të dhënave të dokumenteve osmane*, Studime Historike, nr. 3, Tiranë, 1980, 131—157.

„Vorret e hasallakut", të vjetra „treqind vjet" — siç thotë tradita. Ky toponim ekziston edhe në vise të tjera të Kosovës dhe kudo e konsiderojnë si të lashtë. Ka mundësi që edhe nga kjo trevë të ketë pasur vullnetarë në këtë luftë kundër zgjedhës turke. Pas disfatës së austriakëve, të cilën e pësuan në Grykën e Kaçanikut, turqit u hakmuarën kunder shqiptarëve e serbëve, por shumë nga këta u shpërngulën dhe ikën bashkë me ushtrinë austriake dhe u vendosën në Srem, Sllavoni e në Vojvodinë. Në këtë kohë kanë migruar nga viset malore rreth Kosovës shumë familje shqiptare dhe janë vendosur në zona fushore të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Por këto familje kanë gjetur në këto vise bashkatdhetarët e tyre dhe e kanë rritur e përforcuar me ardhjen e tyre numerikisht popullsinë shqiptare në Kosovë e Maqedoni, e cila jetonte në këto vise pa ndërprerje shekuj me radhë më parë.[86] Kështu pra, shqiptarët kanë jetuar aty ku janë sot shumë shekuj para luftës austro-turke, në të cilën edhe ata kanë marrë pjesë. Prandaj nuk mund të jetë e vërtetë se ata paskan ardhur vetëm pas kësaj lufte në këto treva. Migrimet kanë qenë e janë proces i përhershëm, të cilat duhet të studiohen nga aspekti i metodës dialektike për ta nxjerrë të vërtetën në shesh. Por, si u tha edhe më parë, ky faktor i rëndësishëm në kuadrin e problematikës së gjerë të popullsisë, shpeshherë është trajtuar në mënyrë idealiste e tendencioze, për qëllime të cilat nuk kanë mbështetje në fakte historike dhe në të vërtetën shkencore.

Lugu i Baranit ka qenë trevë tërheqëse për imigrantë ekonomikë në të kaluarën, sepse këtu ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Mirëpo, nga rritja e popullsisë, qoftë në mënyrë natyrore, qoftë në mënyrë mekanike (imigracionet), është rritur edhe numri mesatar i njerëzve, dëndësia për 1 ha tokë, është shkaktuar kështu dëndësia agrare. Nga ana tjetër pronat edhe ashtu ishin të vogla, saqë më se gjysma e familjeve nuk kanë më shumë se nga 3 ha tokë pjellore, përkatësisht rreth 25 ari për banor. Sektori shoqëror ka 350 ha e ai privat 3000 ha tokë pjellore. Përveç kësaj, nga një pronë e tillë nuk mund të nxirren mjete financiare për të blerë maqina bujqësore dhe plehra kimike, kështu që toka punohet në mënyrë primitive dhe rendimentet janë të vogla. Megjithëse në vitet e fundit disa fshatarë kanë blerë traktorë, të cilët i shfrytëzojnë edhe fshatarë të tjerë, prapë toka nuk jep mjaft prodhime për t'i ushqyer dhe mbajtur familjet që jetojnë vetëm nga bujqësia, dhe të cilat rëndom përbëhën nga shumë pjesëtarë. Gjendja e këtillë ka shkaktuar migracione, dyndje të reja sidomos pas luftës, të cilat tani kanë drejtim të kundërt nga ai që e kishin më parë. Këto tash janë emigracione, sepse njerëzit shkojnë nga Lugu i Baranit me familjet e tyre, ose vetëm, për të gjetur punë në Pejë, në qytete të tjera të Kosovës, apo edhe më larg, madje edhe në botën e jashtme.

Migrimet fshat-qytet janë fenomen bashkëkohor, i shkaktuar nga varfëria në fshat dhe nga zhvillimi i industrisë në qytet.

[86] Grup autorësh, *Kosova dje dhe sot (monografi)*, botues Ekonomska politika, Beograd, 1973, 236.

Disa familje nga Lugu i Baranit, të shpërngulura më parë në qytete të ndryshme, kanë migruar për në Turqi pas Luftës së Dytë Botërore, siç vepruan me qindra familje të tjera nga Kosova e Maqedonia. Këto migrime janë shkaktuar jo vetëm nga gjendja e vështirë ekonomike, por edhe nga presioni dhe deformimet e njohura që janë bërë kundër popullsisë shqiptare nga disa organe të shërbimit të sigurimit. Këto shpërdorime dhe kjo gjendje u kritikuan rreptë më 1966 në Plenumin e Brioneve nga organet më të larta politiko-shoqërore të vendit.[87] Pra, nuk janë të vërteta pohimet e disa autorëve, të cilët thonë se popullsia e këtyre viseve është shpërngulur për Turqi vullnetarisht.[88] Akcioni famkeq i armëve në dimrin e vitit 1956 e ka intensifikuar, e ka nxitur, në përmasa shumë të mëdha, shpërnguljen e shqipëtarëve për në Turqi.[89]

Migrimet fshat-qytet në Lug të Baranit zakonisht zhvillohen në relacionin fshat-Pejë. Këto migrime janë të përhershme ose të përkohshme. Por edhe atëherë kur ndonjë familje shpërngulet në Pejë, ajo mban lidhje të vazhdueshme me farefisin që e ka në fshat. Migrimet e përkohshme përfshijnë vetëm një ose disa persona të familjes së fshatit, të cilët punojnë ose janë vendosur në qytet për të kryer ndonjë shkollë, zanat etj. Pas një kohe ata kthehen në shtëpitë e tyre në fshat dhe punojnë në shkolla, zyra ose shitore që gjenden në këtë zonë. Por më të rëndësishme dhe më të mëdha përkah numri janë migrimet ditore. Fjala është për nxënësit e shkollave të mesme që mësojnë në Pejë, dhe për një numër të vogël njerëzish që kanë gjetur punë në qytet. Këta të gjithë mbas mbarimit të mësimit, ose të punës, kthehen në fshat me autobus, i cili qarkullon disa herë në ditë në relacionin Gllogjan—Pejë e anasjelltas. Me hapjen e paraleleve të shkollës së mesme në Baran, numri i nxënësve, të cilët udhëtojnë për ditë në Pejë, është pakësuar.

Vala e migrimit ekonomik në botën e jashtme e ka përfshirë edhe Lugun e Baranit. Ky është një ndër llojet e ndryshme të migrimeve të popullsisë, i cili ka vështirësi të ndryshme dhe shumë anë negative, por, nga ana tjetër, ka lëvërdi ekonomike. Nuk ka fshat në Lug të Baranit që mos t'i ketë dhjetra veta në punë të përkohshme në botën e jashtme. Numri i punëtorëve të tillë nuk mund të konstatohet me saktësi, si e thamë edhe më parë, sepse nuk shkojnë të gjithë përmes institucionit përkatës zyrtar që merret me dërgimin e punëtorëve jashtë vendit, por shumë nga këta shkojnë krye më vete, rrinë atje sa t'ua merr mendja dhe kthehen përsëri në fshat. Me rastin e regjistrimit të popullsisë më 1971 dhe më 1981 është shënuar edhe numri i punëtorëve në punë të përkohëshme në botën e jashtme për çdo fshat.[90] Gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare janë bërë ndryshime, kështu që

[87] *Plenumi i VII i LKJ për Kosovë e Metohi, Zbatimi i vendimeve të Plenumit të IV të KQ të LKJ në Kosovë e Metohi*, Prishtinë, 1966, 39.

[88] B. Bojović, *vep. cit.*, 52.

[89] *Plenumi i VII i LKJ...*, 28, 29. Shih edhe N. Duraku, *Tko se iseljava sa Kosova*, botuar në Vjesnik u srijedu, Zagreb, 7. VII. 1971, 10.

[90] Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin*, nr. 14/1981, 65, 76, 77.

numri i tyre është rritur për 150 vetë. Disa katunde kanë pasur në këtë vit disa herë më shumë punëtorë të tillë se më 1971. Mund të këtë edhe punëtorë të tjerë të cilët nuk janë evidentuar nga statistika, sepse nuk kanë shkuar në mënyrë të organizuar, por përmes lidhjeve private, të cilat nuk mund të evidentohen lehtë.

NUMRI I PUNËTORËVE NË BOTËN E JASHTME DHE NUMRI I FAMILJEVE

Fshati	Numri i punëtorëve		Numri i familjeve	
	më 1971	më 1981	më 1971	më 1981
1. Baran	49	42	137	122
2. Broliq	16	15	59	65
3. Buqan	13	17	40	37
4. Çellopek	11	15	77	89
5. Çeskovë	13	18	32	33
6. Gllogjan	19	39	68	74
7. Kosuriq	38	82	109	119
8. Kotradiq	30	18	75	83
9. Kpuz	5	41	48	60
10. Kryshec	17	72	142	157
11. Llugaxhi	9	12	30	30
12. Nepole	25	30	39	53
13. Rashiq	25	25	68	82
14. Turjakë	9	7	41	29
15. Vranoc	13	9	42	66
Gjithsej	292	442	1007	1099

Nga tabela e sipërme shihet se në vitin 1971 çdo katund kishte rreth 20 punëtorë në botën e jashtme, ndërsa më 1981 rreth 30. Këto të dhëna u referohen vetëm punëtorëve, meshkujve, por një numër i tyre në kohën e fundit kanë marrë me vete edhe familjen e ngushtë, kurse disa janë martuar atje. Në këtë mënyrë migrimi i përkohëshëm mund të shëndrrohet në mërgim të përhershëm. Por në Lug të Baranit ka pak raste të tilla.

Migrimi bashkëkohor i popullsisë në Lug të Baranit dallohet nga migrimet e mëparshme me kuptimin e tyre klasor, sepse të gjithë ata fshatarë që dynden nga kjo trevë, shkojnë me qëllim që të merren me punë jobujqësore, qoftë në qytete të Kosovës e gjetiu, qoftë në botën e jashtme. Pra me këto migrime ndryshon struktura sociale e popullsisë, sepse tash askush nuk largohet nga toka pjellore e Lugut të Baranit për t'u vendosur në ndonjë zonë tjetër, ku do të merrej me bujqësi. Punëtorët nga Lugu i Baranit që gjenden në botën e jashtme merren më tepër me ndërtimtari dhe me industri, me shërbime komunale etj. Migrimet e mëparshme, gjatë sundimit turk e deri pas Luftës së Dytë Botërore, ishin migrime kryesisht bujqësore. Fshatari kudo që shkonte, ose kushdo që vinte në këtë trevë, kërkonte vetëm tokë buke, punë

në bujqësi, kështu që statusi i tij social mbetej i pandryshuar — ai mbetej gjithmonë e gjithkund vetëm bujk. I vetmi ndryshim është bërë rreth vitit 1930, kur u zhdukën definitivisht marrëdhëniet feudale në këto anë, por atëherë ishte një numër i vogël fshatarësh çifçinj, sidomos në Lug të Baranit, ngase tokën e kishin blerë shumica dërmuese e tyre qysh moti. Mirëpo, me kthimin e punëtorëve nga bota e jashtme, struktura sociale e tyre ndryshon, ata përsëri merren me bujqësi, nëse nuk kthehen përsëri mbas një kohe në vende të jashtme, ku kanë punuar në ndërmarrje të ndryshme industriale. Raste të tilla ka gjithnjë e më pak, sepse ai që ka punuar disa vjet përjashtë dhe është paguar mirë për punën e tij, vështirë pajtohet që të mbetet përgjithmonë në fshat, ku kthehet në familje për disa muaj (zakonisht gjatë dimrit), por përsëri shkon atje, ku puna e tij paguhet më mirë.

Në këtë mënyrë krijohet një kategori tjetër e migrimeve. Këto janë migrime stinore. Zakonisht njerëzit që përfshihen në këtë lloj dyndjeje punojnë në ndërmarrje të ndryshme të ndërtimit, të cilat dimrit kanë pak punë, ose nuk punojnë fare. Shumë punëtorë të tjerë, të cilët nuk kanë lënë në fshat njerëz të aftë për punë fizike në fushë, marrin leje të ndryshme dhe gjatë verës vijnë për të kryer punët bujqësore në fushat e tyre, e pastaj kthehen përsëri. Edhe këta në realitet janë punëtorë sezonalë, megjithëse kjo është një kategori më vete.


VENDBANIMET

Vendbanimet e Lugut të Baranit janë vetëm fshatra, të cilat dallohen mes tyre më shumë nga pozita gjeografike dhe numri i shtëpive, sesa nga pamja e tyre e përgjithshme, nga fizionomia e tyre, e cila vetëm në disa sosh ka ndonjë objekt, si shënjë të procesit të urbanizimit. Qëndra më e afërme, e urbanizuar deri në një shkallë, është Deçani. Mirëpo, meqenëse me Pejën lidhjet janë më të mira dhe diferenca e largësisë është e vogël, i gjithë Lugu i Baranit anon nga çdo aspekt kah Peja, e cila është qendra më e madhe e Rrafshit të Dukagjinit. Shumica e fshatrave ndodhen rrëzë kodre, e cila shtrihet që nga Krysheci e deri në Dri, ndërsa disa nga këto janë në këtë kodër e disa të tjera gjenden në pjesën fushore, më afër Bistricës së Deçanit.

Pjesa më e madhe e fshatrave janë të dendura, shtëpitë gjenden në afërsi njera me tjetrën. Në këtë mënyrë mbetet më shumë fushë e lirë për bujqësi, ndërsa vetë fshati i këtij tipi formon një tërësi më kompakte të banimit. Në pjesën kodrinore të kësaj zone fshatrat janë të tipit të shpërndarë, të përhapur, sepse shtëpitë janë larg njëra nga tjetra. Fshatra të tillë janë Turjaka, Çeskova e Kpuzi. Ky tip është përgjithësisht një veçanti e zonave malore, ku ka sipërfaqe të mëdha të tokës së lirë (këtu konkretisht kaçuba, drunj të vegjël, dëllinja etj.), njerëzit kanë hapur toka buke, të cilat nuk janë të kualitetit të mirë, prandaj duhet të shfrytëzohen sipërfaqe më të mëdha.

Si fshatrat e tipit të dëndur, ashtu edhe ato të tipit të shpërndarë, ndahen në mëhallë. Mëhallët janë pjesë të një fshati, është ky një numër shtëpish të grumbulluara në një vend dhe të quajtura me një emër, i cili mund të jetë emër fisi, vëllazërie, familje të njohur etj., ose emër gjeografik (mëhalla e Epër, m. e Poshtmë, m. e Kodrës, e Lugut etj.). Në shumë raste mëhallën e përbëjnë familje të një vëllazërie, të një fisi, të një „kabilje" etj., kjo do të thotë se fshati diferencohet sipas lidhjeve të gjinisë së gjakut të banorëve të tij. Në fshatrat e Lugut të Baranit ka shumë raste të tilla. Mëhalla që është pak më larg fshatit, me kohë mund të shkëputet fare nga ky e të formojë fshat më vete. Ndoshta kështu ka ngjarë edhe me fshatin Baran, i cili edhe tash në shumë raste merret si një tërësi, por në shumë raste të tjera veçohen dy fshatra: Barani i Epërm e Barani i Poshtëm. Kjo shihet edhe nga të dhënat statistikore të periudhave të ndryshme, ku paraqiten një

herë dy e herën tjetër një fshat. Kështu ka qenë rasti edhe me Buqanin, i cili tash është një fshat, por në dokumentet e shekullit XV figurojnë dy fshatra: Buqani i Epërm e Buqani i Poshtëm. Kështu këtu shihet një proces i zhvillimit të vendbanimeve, por që ka dy drejtime të kundërta. Në rastin e Baranit nga një tërësi krijohen dy, e në rastin e Buqanit ngjan e kundërta, nga dy Buqana krijohet me kohë vetëm një fshat. Para Luftës së dytë botërore, gjatë sundimit të Jugosllavisë borgjeze, si e cekëm edhe më parë, qeveria ka sjellë në Lug të Baranit shumë familje malazeze, të cilat i ka kolonizuar në këto fshatra në kodrina dhe në fushë pje-



Pamje e fshatit në shpat

llore. Shtëpitë e kolonistëve i ka ndërtuar shteti në shumicën e rasteve jashtë fshatit, në kodër ose në shpate. Ato kanë qenë të një tipi dhe kështu të grupuara kanë formuar lagje më vete. Fshatarët i quanin këto shtëpi sipas numrit të tyre „dhetë shpijat", „njizet shpijat" etj., ose „shpijat e naselenikve" (kolonistëve) dhe „shpijat e crnagorëve". Shumica e këtyre shtëpive janë prishur gjatë luftës; pas lufte disa u rindërtuan, por më vonë pronarët e tyre u shpërngulën dhe tash kanë mbetur vetëm disa sosh në Kryshec, ose në ndonjë fshat tjetër nga 2—3 shtëpi. Kështu, tipi i fshatrave ka mbetur përsëri ai i vjetri. Në asnjë rast në këtë zonë shtëpitë e kolonistve nuk kanë krijuar fshat më vete, por kanë qenë pjesë e re e fshatrave të vjetër. Kuptohet se kjo ka qenë bërë me paramendim për të futur grindje sa më të madhe ndërmjet shqiptarëve dhe kolonistëve.

Nga tabelat statistikore që i paraqitëm më sipër shihet se fshatrat e Lugut të Baranit janë relativisht të vogla. Nëse e marrim për bazë statistikën zyrtare të vitit 1971, del se vetëm 3 fshatra kishin atë vit më se 1000 banorë: Barani (1169), i cili këtu është marrë si një fshat, Kosuriqi (1012) dhe Krysheci (1127). Nëse e krahasojmë numrin e shtëpive në këto tri fshatra, shihet se Krysheci kishte 33 shtëpi më shumë se Kosuriqi, por vetëm 115 banorë më shumë. Ky disproporcion ndërmjet numrit të shtëpive e numrit të banorëve në Kryshec vjen nga fakti se në këtë fshat ka pasur në atë vit më shumë familje koloniste, të cilat zakonisht kanë më pak pjesëtarë. Përveç këtyre 3 fshatrave, edhe 8 fshatra të tjera kishin më shumë se 500 banorë: Buqani (676), Broliqi (573), Gllogjani (639), Kotradiqi (646), Vranoci (618), Rashiqi (696), Nepolja (526) dhe Kpuzi (505). Dy fshatra kishin 300—500 banorë: Buqani (418) e Turjaka (343) dhe 2 fshatra të tjerë më pak se 300 banorë: Çeskova (292) e Llugaxhia (226). Kuptohet se këto dy fshatra kanë pak shtëpi, nga 30, kështu që hyjnë në kategorinë e vendbanimeve fare të vogla, megjithse Çeskova, si fshat malor, shtrihet në një sipërfaqe mjaft të madhe.

Gjatë periudhës dhjetëvjeçare (1971—1981) nuk janë bërë ndryshime të mëdha në popullsinë e Lugut të Baranit, përkatësisht në vendbanimet e tij, e sidomos në strukturën sociale të banorëve. Megjithse kjo zonë më 1981 kishte 1756 banorë më tepër se para dhjetë vjetësh, prapë vetëm 3 katunde kishin më shumë se 1000 banorë (si më 1971). Madje, Barani e Turjaka diçka më pak. Nga ana tjetër, më 1981 në 9 fshatra numri i banorëve arrinte mbi 500, kurse më 1971 ishin vetëm 3 katunde të tilla. Numri i njerëzve në punë jashtë bujqësisë nuk ka ndikuar shumë në ndryshimin e strukturës sociale të Lugut të Baranit, kështu që këtu popullsia merret kryesisht me bujqësi, e cila është mjaft ekstensive. Kjo trevë, kryesisht bujqësore, ka dendësi të madhe agrare. sepse ka më pak se 0,25 ha tokë pjellore për banor. Ky është problem i madh i fshatit, i cili mund të zgjidhet vetëm me intensifikimin e prodhimit bujqësor dhe me inkuadrimin e popullsisë sa më shumë në punë jobujqësore në qytet ose në fshat.

Fshati është në njëfarë mënyre gurrë e pashterrshme e materialit të ndryshëm burimor, nga i cili shkenca mund të ndërtojë godina monumentale. Këtu deri tash i shqyrtuam problemet, dukuritë dhe faktorët e ndryshëm natyrorë, e para së gjithash shoqërorë në përgjithësi për tërë Lugun e Baranit, si tërësi etnogjeografike, duke i shfrytëzuar disa të dhëna, të cilat u referohen edhe vendbanimeve. Në vazhdim do ta shqyrtojmë çdo fshat veç e veç, dhe përveç me të dhënat historike, demografike dhe kushtet natyrore, do të merremi më shumë me shqyrtimin e toponimeve dhe antroponimeve të tyre, të cilat për shkencën etnografike, si edhe për shkenca shoqërore në përgjithësi, kanë interes e rëndësi të madhe. Përveç fakteve nga literatura, të dhënat e tjera janë marrë nga goja e popullit të vendit, nga kallximi i banorëve të këtyre fshatrave me rastin e punës kërkimore në terren në vitet 1951, 1972, 1979 e 1980. Të dhënat burimore mund të kenë edhe të meta eventuale, por në tërësi ato kanë forcën e dokumenteve.

Krysheci. — Krysheci ndodhet në fillim të Lugut të Baranit, është fshati i parë i kësaj zone me të cilin takohet njeriu duke shkuar rrugës së asfaltuar nga Raushiqi në drejtim të Gllogjanit, ku soset rruga e shtruar. Fshati shtrihet në një kodër të gjerë e të ulët dhe rrëzë saj. Nga kjo kodër fillon fusha pjellore e Lugut të Baranit. Ky është një vendbanim i vjetër, i cili përmendet edhe në dokumente mesjetare — në krisobulën kishtare dhe në defterin turk, si e thamë edhe më parë. Kështu, Krysheci si vendbanim përmendet në këtë vend para 650 vjetësh. Në krisobulen kishtare të vitit 1330 Krysheci përmendet si fshat kufitar me Prapaqanin, kështu që nuk ka të dhëna të tjera për të. Në defterin turk jepen të dhëna të hollësishme për të gjitha ato fshatra të cilat përfshihen në këtë dokument. Krysheci aty figuron si „Krusheviça" dhe varej nga Peja. Më 1485 ka pasur 58 shtëpi (kryefamiljarë). Ky numër tregon se Krysheci për atë kohë nuk ka qenë fshat i vogël. Përveç të tjerave, në defter thuhet se fshati ka pasur 19 beqarë e 3 të veja. Në regjistrin e kryefamiljarëve figurojnë 71 emra sllavë, 3 emra shqiptarë dhe 6 shqiptarë e sllavë.[91] Me këtë rast po e përsërisim edhe një herë atë që e thamë më parë, se në atë kohë, dhe më vonë, shumë shqiptarë kanë pasur emra sllavë e, përveç kësaj, një pjesë e madhe e shqiptarëve edhe në Kosovë duhet të ketë qenë ortodokse, nën jurisdikcionin e kishës serbe-ortodokse; si të tillë edhe këta shqiptarë kanë pasur emra sllavë. Por ndër këta emra në Kryshec, sipas këtij defteri, edhe para 500 vjetësh ka pasur disa kryefamiljarë me emra shqiptarë, si p.sh.: Gjergji, i biri i Dimitrit, Nenko, i biri i Radiçit, Branko, i vëllai i tij, Gjergji, i vëllai i Radiçit, Branko, i vëllai i Gjonit, Bozhidari, i biri i Nushës, Nenko, i biri i Gjurës, mysliman Hamza etj. Nëse Gjergji, Gjoni, Nusha etj. kanë qenë shqiptarë, atëherë kuptohet se edhe vëllezërit e tyre Branko, Radiçi, Bozhidari, Dimitri etj. kanë qenë shqiptarë. Mund të ketë pasur edhe familje etnikisht të përziera. Përveç kësaj, emra Bozhë (Bozhidar), Gjurë, Gjokë, Vuksan etj. edhe sot kanë shqiptarët katolikë në Pejë, në Lug të Leshanit, madje edhe në Lug të Baranit e në vise të tjera rreth tij. Për ta njohur strukturën e banorëve të Kryshecit të asaj kohe, ka rëndësi të posaçme emri i banorit Hamza, për të cilin në defter thuhet shprehimisht se është mysliman. Kjo do të thotë se qysh atëherë (më 1485) ka filluar procesi i islamizimit të popullsisë shqiptare në këto vise. Këtë e dëshmojnë edhe shembuj të tjerë të ngjashëm në fshatrat kufitare me Lugun e Baranit. Kështu p.sh. në këtë defter ekzistojnë edhe këta kryefamiljarë të fshatit Grabanicë të Lugut të Leshanit: mysliman Kasemi, mysliman Jusufi, mysliman Beqir Durmishi etj.[92]

Në defter janë përcaktuar detyrimet e fshatit ndaj spahiut, përkatësisht ndaj shtetit. Krysheci ishte i ngarkuar mjaft rëndë me detyrime materiale. Por nga kjo mund të shihet se fshati nuk qëndronte keq ekonomisht. Kështu ai ishte i detyruar të dorëzonte 26 barrë thekër, 25 barrë ujem, 15 barrë mel, një sasi liri e bathe dhe taksa për perime, fruta, bar, dru etj. Kështu, përveç

[91] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit...*, 240, 241.
[92] *Po aty*, 248.

produkteve bujqësore, fshati ishte i ngarkuar edhe me 1543 akçe (të holla) për produkte të tjera, që nuk dorëzoheshin në naturë. Nga kjo shumë Krysheci ishte i ngarkuar vetëm për barë me 290 e për dru me 116 akçe. Kjo tregon se fshatrat e Lugut të Baranit edhe atëherë, si sot, dispononin sipërfaqe relativisht të mëdha të livadheve e pyjeve. Pyjet sot nuk janë të atilla si mund të kenë qenë dikur, porse sipërfaqet e mbuluara me kaçuba e drunj jo të lartë, as tash nuk janë të vogla. Taksat për bagëti paguheshin sipas një defteri të posaçëm, prandaj në këtë defter ato nuk përfshihen, kështu që, nëse nuk e kemi këtë fakt parasysh, mund të nxirren përfundime të gabuara për ekonominë e përgjithshme bujqësore të asaj kohe.

Në fillim të shekullit XX, sipas shënimeve të gjeografit Jovan Cvijiq, të cilat i përmendëm edhe më parë, Krysheci kishte vetëm 10 shtëpi (familje), të gjitha shqiptare të fesë islame. Mirëpo, na duket se ky numër nuk e shpreh realitetin, sepse defteri turk dëshmon se ky fshat para 500 vjetësh kishte 58 familje, kështu që nuk ka ndonjë arsye të natyrës ekonomike, demografike e shoqëroro-historike për të zbritur numri i shtëpive, përkatësisht i banorëve, në këtë shkallë, kur zakonisht procesi i zhvillimit të vendbanimeve në përgjithësi në këto vise shkon drejt rritjes shumë të shpejtë.

Krysheci është fshati më i madh i Lugut të Baranit, më 157 shtëpi e 1406 banorë, sipas statistikës zyrtare të vitit 1981, kështu që vetëm edhe dy fshatra të tjera (Kosuriqi e Barani) kanë mbi 1000 banorë. Më 1971 Krysheci kishte 1127 banorë. Përbërja kombëtare në këtë vit ishte më e përzier se në çdo fshat tjetër, sepse aty ndodheshin përveç 896 shqiptarëve, edhe 228 banorë malazezë, 2 serbë dhe 1 i panjohur.[93] Ndërkohë disa familje malazeze emigruan në Serbi, ose në qytete të Kosovës, kështu që u zvogëlua numri i tyre. Jugosllavia borgjeze këtu ka sjellë numrin më të madh të kolonistëve në gjithë Lugun e Baranit me 104 familje, kryesisht nga Mali i Zi. Përbërja kombëtare e fshatit më 1981 ka qenë: 1213 shqiptarë, 179 malazezë, 7 serbë dhe 7 myslimanë.

Përbërja fisnore e Kryshecit gjithashtu është heterogjene, e përzier, por fisi më i madh është këtu Berisha (rreth 50 shtëpi) e Gashi (30). Gashi ndahet në vëllazëritë: Malaj, Binak e Alibajramaj (nga 10 shtëpi) dhe Dezdar (3). Malaj, Binakët e Alibajramajt janë të ardhur nga fshati i afërm Lumbardh, i cili shtrihet në bregun e djathtë të Bistricës së Deçanit, kurse Dezdarët kanë ardhur nga Malësia e Gjakovës. Gashët kanë shokë të fisit në fshatin Luzhë (Malësi). Berisha ndahet në këto barqe: Gërvallë (20), Alshiqe (15), Tarakaj (5), këta janë Mertur — Larinë. Fise më të vogla janë: Bytyçi (15) dhe disa edhe më të vogla. Çerretët janë Bytyç, me prejardhje nga Çerreti. Këta janë rreth 11 familje. Sipas traditës, në këtë fshat më të vjetër janë Gërvallat.

Kolonizimi këtu ka qenë më drastik se në çdo fshat tjetër të kësaj zone, me qëllim që me thyerjen e fshatit më të madh puna të shkojë më lehtë në fshatrat e tjera. Përveç kësaj, edhe

[93] Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin*, nr. 4/1971, 28.

kolonistët kanë lakmuar të vendosen këtu, sepse fshati është afër qytetit dhe toka është pjellore. Shumë nga këta nuk janë kthyer pas lufte, ose janë shpërngulur në qytet më vonë, por kanë mbetur edhe rreth 30 familje me nga pak pjesëtarë, sepse pjesëtarët e tjerë janë shkolluar e shpërngulur në qytet, ose kanë hyrë në punë në Pejë. Në vitin 1980 në Krysheс kanë qenë këto familje të kolonistëve malazias: Mileviq, Tomoviq, Vujoviq, Mijoviq, Vullanoviq, Gojkoviq, Gjuriçanin, Izgaroviq, Radosheviq, — të gjithë nga 1 shtëpi: pastaj Stankoviq, Zhivanoviq, Saveliq, Markoviq, Shqepanoviq, Vllahoviq, Boshkoviq, Veshoviq dhe Bozhoviq. Këto 2 të fundit janë 3, e ato të tjerat familje nga 2 shtëpi. Shtëpitë e kolonistëve janë në kodër, më larg nga pjesa e vjetër e katundit, ku jetojnë vetëm familjet shqiptare.

Krysheci përbëhët nga mëhallat: Gash, Çerret, Gërvallë e Larin. Pra, mëhallët e katundit janë formuar sipas përkatësisë etnike, përkatësisht në bazë të gjnisë së gjakut dhe të kombësisë, meqenëse kolonistët janë të grumbulluar në „mëhallën e crnagorëve" (malazezëve). Fshati ka shkollën tetëvjeçare, shitoren dhe xhaminë në qendër. Sipas traditës që e mbajnë në mend njerëzit e vjetër të Kryshecit, të parët e tyre kanë kaluar në fenë islame mjaft vonë, aty para 200 vjetëve, ose edhe më vonë. Kjo vërtetohet edhe me antroponimet e brezave të kaluar. Kështu p.sh. tregon Rrustem Arifi gjenealogjinë e familjes së tij: Uka (i biri) — Rrustemi — Arifi — Musliu — Dema — Ndou — Perçeta — Kola — Biba — Leka — Pogi — Muri — Dedi — Jata — Jatagani. Në terren nuk kam takuar ndonjë plak tjetër që dinte të numronte brezat e familjës së tij deri në 15 faqe, siç është ky rast në Kryshec. Për përkatësinë fetare të parëve të popullsisë së tanishme dëshmojnë edhe disa toponime (emra në fushë, etj.), siç janë: Lisi i Kishës, Lugu i Vojimit etj.

Toponimet në terrenin e Kryshecit janë më tepër të natyrës gjeografike, si p.sh. Arat e Epra, Lugu i Gllogocit, Lugu i Kanikut, Lugu i Vojimit, Lugu i Fellë, Përroni i Duboçakut, pastaj Fusha Gomur, (pyje), Zabeli i Kadisë, Lisi i Kishës, Galigjat, Suhajat, Sejishtat, Kroni i Toplluhës, Guri i Sylë Nezirit, Kroni i Sarushave, Lugu i Ostrigave, Kroni i Lëbushës etj. Pleqt tregojnë se kanë dëgjuar nga pleqtë e dikurshëm të fshatit se në Lug të Baranit dikur moti, para 300 e 350 vjetësh, „ka bá kërdi hasallëku në kohën e nji lufte midis Nemcës e turkut"[94]. Kjo mund të jetë murtaja e luftës austro-turke të vitit 1689-1690, të cilën e përmendëm më sipër. Popullsia e Kryshecit merret me bujqësi, mirëpo, në vitin 1980 rreth 80 fshatarë ishin në punë të përkohëshme në botën e jashtme. Kjo do të thotë se nga çdo e dyta shtëpi një pjesëtar i saj është marrë me punë jobujqësore jashtë vendit. Kuptohet se kjo ka ndikuar në jetën ekonomike të këtij fshati, i cili në përgjithësi është i varfër, sepse fshatarët kanë pakë tok e shumë pjesëtarë të familjes. Përveç kësaj, toka nuk ujitet sa duhet sepse përrgin e Gu-

[94] Kallëzim i Rrustem Arfit, Bajram Tarakut etj. nga Krysheci.

shavcit, të cilin e shfrytëzojnë për këtë qëllim, e shfrytëzon gjithashtu edhe Isniqi, një katund shumë i madh nëpër fushën e të cilit kalon ky përrua, pa mbërritur në terrenin e Kryshecit. Në saje të punës dhe ndihmës së punëtorëve nga bota e jashtme, fshati ka 10 traktorë, kështu toka punohet më mirë e më lehtë se para disa vjetësh, kur përdorej vetëm pllugu, e në disa raste edhe parmenda.

Fshatarët e Kryshecit janë njerëz punëtorë dhe dinamikë, kështu që përpiqen të ecin me hapin e kohës, megjithëse mundësitë e tyre ekonomike nuk janë të shkallës së tillë. Dëshira e tyre për të ecur në rrugën e përparimit shihet edhe nga shkollimi i fëmijëve, sidomos i vajzave, të cilat ndjekin edhe shkollat e mesme në Pejë. Kur dola për të parën herë në këtë terren për të mbledhur material burimor nga jeta, përvoja dhe gjendja e popullit të kësaj zone, në vitin 1951, rastësisht asistova në zyrën e Këshillit të vendit ku zhvillohej një skenë e rëndomtë dhe jo shumë e rëndësishme për atë kohë. Shikuar tash, pas një çerek shekulli, nga aspekti i procesit të zhvillimit të përgjithëshëm të këtyre fshatrave, ajo ngjarje që atëherë më dukej fare e vogël, e parëndësishme, tash më paraqitet në dimensione të tjera. Fjala ishte për marrjen në përgjegjësi të një fshatari nga ana e nëpunësit të Këshillit të vendit për arsye se ky paska dalë në rrugë me gruan e tij „me havale", e cila në atë kohë u ndalua me ligj. Tash të rejat e Kryshecit, vajza të rritura e të shëndetshme, shkojnë për ditë me autobus në Pejë bashkë me shokët e tyre e shumë udhëtarë të tjerë. Autobusi buçet nga kënga e gazi rinor i tyre, dhe të gjithë kënaqen, edhe pleqët, me sjelljet e lira, por të matura, të vajzave e mbesave të tyre, të cilat ndjekin me gëzim rrugën e përparimit.

Mirëpo, me gjithë sukseset e arritura në fushën e arsimit e të kulturës, rezultatet janë relativisht të vogla, sepse që nga mbarimi i luftës e deri më 1980, nga Krysheci kanë kryer shkollën e lartë vetëm 6 vetë (në çdo 6 vjet vetëm 1 i diplomuar). Në këtë vit fshati kishte 10-12 studentë. Edhe kjo tregon shkallën e ulët ekonomike të familjeve, të cilat nuk kanë mundësi për t'i shkolluar fëmijët e tyre. Numri i traktorëve (10) dhe i televizorëve (rreth 50) nuk tregon gjithmonë shkallën e përparimit të përgjithshëm, në qoftë se krahas me numrin e mjeteve teknike nuk rritet edhe numri i njerëzve të shkolluar. Ajo që në rrethana të tilla ka rëndësi të posaçme është vullneti dhe mirëkuptimi i brezit të vjetër për shkollimin e brezit të ri. Mirëpo, vullneti i mirë duhet ta ketë edhe bazën e mirë materiale, e cila, për fat të keq, u mungon gati të gjithë fshatarëve të Kryshecit dhe të Lugut të Baranit në përgjithësi. Kur flasim për shkollimin e brezit të ri, kemi parasysh familjet shqiptare, sepse ato malazeze kanë jetuar në kushte më të volitshme para luftes, kështu që i kanë shkolluar fëmijët e tyre atëherë kur nuk lejohej asnjë shkollë shqipe, kur edhe abetarja shqipe ishte argument i mjaftueshëm për burg.

Krysheci është rreth 10 km larg Pejës. Rruga e asfaltuar kalon nëpër fshat. Kjo ka bërë të mundshme lidhjen e tij më të shpeshtë e më të lehtë me këtë qytet, që ka rëndësi të posaçme për shkollimin e fëmijëve në radhë të parë, por edhe për ekono-

minë e këtij fshati, para së gjithash për shitjen e produkteve bujqësore në treg. Nga se fshatarët janë të varfër dhe nuk janë në gjendje ta rrisin prodhimin bujqësor e blegtoral në shkallë të duhur, në shkallë tregu, do të ishte një përkrahje e madhe kësaj popullsie sikur të ngrihej këtu një fermë e madhe e kafshëve, e lopëve qumshtore, nga e cila do të furnizohej qyteti me mish e qumësht dhe me të cilën do të kooperonin ekonomitë individuale të këtij fshati, ku kushtet për blegtori janë mjaft të mira.

Rashiqi. — Ky fshat shtrihet në fushë të gjerë të lugut të Bistricës. Në anën veriore të tij ngrihet një kodër, rrëzë së cilës shtrihet fshati. Rashiqi është nja 25 metra nën nivelin e lartësisë mbidetare të Kryshecit. Nga jugu i fshatit rrjedh Bistrica e Deçanit. Ndërmjet Rashiqit e Bistricës shtrihet fusha pjellore — ara e livadhe. Rashiqi ndahet në dy mëhallë: mëhalla e Epërme e mëhalla e Poshtme. Në Mëhallën e Poshtme (e cila quhet edhe Rashiqi i Poshtëm) familjet janë kryesisht të fisit Berishë, ndërkaq në Mëhallën e Epërme (Rashiqi i Epërm) fiset janë të përziera. Fshati është i pasur me ujë, kështu që çdo shtëpi ka bunarin në oborr (pusin), i cili nuk shkon më thellë se 6 metra. Përveç kësaj në fshat ka 4 kroje e 2 burime. Në jug të fshatit ndodhet burimi i madh i quajtur Gërma, të cilin e mbulon me zhavor e tokë përroi Behoc. Por fshatarët e zbulojnë përsëri kur e mbulon Behoci dhe e përdorin për ujitje të fushave të kësaj pjesë të terrenit të fshatit. Ky burim i fortë ka ujë nga janari deri kah mesi i gushtit. Por një pjesë e madhe e fushës nuk ka mjaft ujë për ujitje. Kanali ujitës i betonuar vjen nga Peja deri afër Rashiqit, por atë e shfrytëzojnë fshatrat e tjera Llozhani, Turjaka, Duboviku etj. Për ujitje shfrytëzohen edhe disa burime e përrenj të tjerë të vegjël, të cilët populli i quan „kajnaqe". Ato burojnë rrëzë kodrës, por edhe midis fushës. Nga se nuk ka mjaft ujë, shumë fshatarë janë pajisur me pompa motorike për ujitje. Kur retë e zeza mblidhen në perëndim e në veri, fshatarët thonë se do të bjerë shi. Kjo vlen vetëm për muajt e verës, ndërsa gjatë stinëve të tjera shiun e presin nga jugu.

Rashiqi nuk përmendet në dokumente të vjetra, as në defterin turk të vitit 1485, ku ka të dhëna për fshatra të tjera të kësaj treve. Por kjo nuk do të thotë se ky vendbanim nuk ka ekzistuar fare në atë kohë. Ai mund të jetë marrë ndoshta si mëhallë e largët e ndonjë fshati tjetër, por mund të jetë formuar edhe më vonë si vendbanim i pavarur. Nga të dhënat e shkruara kemi vetëm shënimet për numrin e familjeve në fillim të shekullit XX. Sipas këtyre shënimeve, të vitit 1905, Rashiqi ishte katund i vogël me gjithsej 10 shtëpi shqiptare. Me rastin e regjistrimit të popullsisë më 1948 këtu janë evidentuar 57, e më 1971 68 shtëpi. Atë vit Rashiqi kishte 696 banorë, nga të cilët 684 shqiptarë, 10 malazezë e 2 të tjerë. Kjo do të thotë se çdo shtëpi kishte nga 10,2 pjesëtarë. Nëse këtë mesatare e marrim edhe për banorët të kombësisë malazeze, atëherë del se këtu ka qenë vetëm një familje e kësaj kombësie. Më 1981 Rashiqi ka pasur 894 banorë (888 shqiptarë e 6 malazezë) me 82 familje.

Edhe në Rashiq popullsia u takon disa fiseve. Pjesa më e madhe është e fisit Shalë (rreth 40 shtëpi), pastaj Berishë (30), e cila ndahet në këto barqe: Bezerë, Bricorë e Gjocë. Gjocajt janë rreth 20 shtëpi. Disa familje janë Bytyç (Kryezi). Një familje e fisit Krasniqe është e ardhur nga Strellci i Epërm (ky fshat i madh i Pejës përbëhet vetëm nga ky fis). Bytyçi janë të ardhur nga Suhareka, Shala nga Malësia në Isniq (fshat i madh afër Deçanit, të gjitha familjet janë Shalë) e pastaj janë vendosur këtu. Gjocajt kanë prejardhje nga fshati Gjocaj afër Junikut, Bezerët nga Krysheci. Familjet të kolonistëve malazezë janë 2: Shqekiq e Peroviq. Para lufte këtu kanë qenë kolonizuar 18 familje malazeze.

Fshatarët nuk mbajnë mend se e kujt ka qenë toka e këtij fshati në kohën e sundimit turk. Duket se të parët e tyre e kanë blerë para shumë kohe dhe janë bërë pronarë të pavarur nga feudalët. Nga se kanë pak tokë, as bagëti nuk mbajnë shumë, sepse nuk kanë mjaft ushqim për kafshë për dimër, kurse kullotat e dikurshme në kodra janë lavruar e janë bërë ara. Prandaj verës bagëtinë e çojnë në bjeshkë në drejtime të ndryshme, sipas të drejtës tradicionale: Shala në Bjeshkë të Zhlepit mbi Pejë, Berisha në bjeshkë të quajtur Zalli i Rupës përmbi Gjakovë, disa shtëpi të tjera, po të këtyre fiseve, e shfrytëzojnë malin e Ishtedimit (afër Pejës). Rashiqi është vend i përshtatshëm për kultivimin e misrit, sepse toka përmban mjaft lagështi dhe ujitet. Kultivohen perimet (speca e lakra), e nga frutat — kumbullat e mollët, si në shumicën e fshatrave të kësaj treve.

Tradita tregon se fushën e tanishme të Rashiqit kanë filluar ta punojnë më parë 2 shtëpi Shaljane të ardhur nga Isniqi. Këta banorë të parë kanë hapur toka të reja, duke çelur pyje e kaçuba. Por megjithëse këtë punë e kanë vazhduar edhe gjeneratat e reja, sot fshati ka pak tokë pjellore në krahasim me numrin e familjeve, kështu që gati çdo vit janë të detyruar të blejnë bukën. Fshati ka shumë kulla të gurit, të ndërtuara para 80-100 vjetësh, në kushte të vështira shoqërore, të cilat e kanë imponuar ndërtimin e kështjellave të tilla, nga të cilat fshatarët kanë luftuar për të drejtat e veta. Këto kulla të lashta lënë përshtypjen e një fshati të fortë nga çdo aspekt. Edhe sot brenda mureve të tyre të trasha e frengjive të ngushta, ruhet mikpritja tradicionale e fshatarit tonë bujar. Por e gjithë kjo është e mbështjellë me velin e skamjes dhe me shumë halle. Kjo gjendje ka qenë shumë më e keqe para luftës së kaluar, kur edhe nga këta fshatarë të varfër „agrari" ka marrë një pjesë të madhe të tokës, e cila nuk mjaftonte as për ta, dhe këtu ka sjellë rreth 20 familje koloniste.

Toponimet në terrenin e Rashiqit janë mjaft të varfëra, gjë që mund të jetë njëfarë treguesi për lashtësinë e tij jo aq të largtë. Disa toponime këtu janë të përbashkëta me ato të Kryshecit, sepse këto janë dy fshatra fqinj, si p.sh. Lugu i Vojimit, Germa (burim i madh), Seishta etj. Toponime karakteristike janë: Lisi i Rashiqit, ku ishte pika e takimit e bajrakut të Vranocit, Vorri i Shehitit, pastaj Behoci, Behaxha („kajnak", burim), Kroni i Therrës, Bigovica (fushë), Frutka e Deli Ukës, Ara e Gatë, Pllugishta, Ronishte, Llozhiq (ara e livadhe), Livadhet e Thata etj.

Rashiqi ka relativisht pak njerëz me shkollim të lartë. Gjatë këtyre 35 vjetve 4 vetë kanë kryer shkolla të larta (fshati ka rreth 70 familje). Në fakultete ka rreth 10 studentë, shkollën fillore e kanë në Kryshec. Rreth 20 vetë janë në punë të përkohëshme jashtë vendit. Mjetet teknike janë të rralla në familjet e Rashiqit, sepse shkalla ekonomike e këtyre është mjaft e ulët.

Broliqi. — Broliqi ndodhet pranë Bistricës së Deçanit, në anën e majtë të saj, afër Lumbardhit, i cili gjendët në anën e kundërt të Bistricës. Fshati shtrihet rrëzë një kodre dhe në shpatet e saj, e cila është e lartë 527 metra, përafërsisht ka nivelin e kodrës së Kryshecit dhe është më e lartë për 21 m se kodra e Rashiqit, me të cilin kufizohet ky fshat. Bistrica gërryen vazhdimisht brigjet e majta të shtratit të saj, ku ndodhet Broliqi, dhe fushat e shumë fshatrave të këtij lugu, kështu që shkakton dëme të mëdha. Broliqi është i pasur me ujë, sepse nëpër fshat kalon jazi me ujë të Bistricës, i cili shfrytëzohet për ujitjen e fushave. Çdo shtëpi ka në oborr bunarin (pusin) me ujë të pishëm, të cilët në pjesën fushore të fshatit janë të cekët (rreth 6 m), ndërsa në kodër thellësia e tyre është rreth 12-15 metra. Fshati ndahet në 4 mëhallë: Lekaj, Pergjeqaj, Ukaj e Istrefaj.

Ky fshat, sot i vogël, përmendet në krisobulen (dokumentin) e manastirit të Deçanit para 650 vjetësh si fshat kufitar me katundin Prapaqan, si e cekëm edhe më parë. Mirëpo, në defterin turk të vitit 1485 nuk figuron emri i tij. Ndoshta në atë kohë është konsideruar si lagje e ndonjë fshati tjetër, siç janë trajtuar disa vendbanime të tjera të kësaj zone, p.sh. si lagje të Kosuriqit. Në fillim të shekullit XX Broliqi përmendet në literaturë si fshat i vogël me 12 shtëpi dhe me popullsi shqiptare. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1971 Broliqi kishte 59 shtëpi (familje) me 573 banorë, nga të cilët 500 shqiptarë, 55 malazezë dhe 18 myslimanë (me kombësi), kurse më 1981 gjithsej 704 (shqiptarë 630, malazezë 44, myslimanë 29 dhe 1 serb) — me 65 familje.

Shumica e familjeve të sotme në Broliq janë Gash (rreth 25 shtëpi) e Shalë (20). Familjet e tjera përbëhen nga fise të ndryshme. Përveç familjeve shqiptare, këtu janë edhe disa familje malazeze, të vendosura këtu para luftës së fundit, dhe disa familje të tjera „boshnjake", të cilat janë deklaruar me rastin e regjistrimit si myslimanë me kombësi. Këto familje janë vendosur këtu para disa vjetësh. Ato kanë blerë tokën e malazezëve të cilët janë shpërngulur. Populli i quan „boshnjakë" megjithëse nuk janë nga Bosnja, por nga Sanxhaku, ose rrethinat e Rozhajës e të Plavës, janë myslimanë me fe dhe flasin serbisht. Sipas traditës, Shala këtu është fisi më i vjetër. Shaljanët nga prejardhja janë nga fshati Bellê, nga malet e larta mbi Grykë të Deçanit. Ata e kanë blerë tokën nga agallarët Misin Ramosi e Haxhi Mani nga Gjakova. Para tyre këtu kanë qenë disa shtëpi çifçinj të këtyre feudalëve, të cilët ua kanë ofruar për t'ua shitur tokën. Meqenëse këta nuk kanë dashur ta blejnë, atë e blenë Shaljanët e Bellesë e çifçinjtë e mëparshëm u shpërngulën. Tash në Bellê janë rreth 15 familje Shaljanë, shokë të afërmë të Shaljanëve të vendosur në Broliq para nja 200 vjetësh, sipas traditës. Plaku Buc Rama, i lindur rreth vitit 1885, i cili kishte (më 1951) djemë e nipa të rritur, tregonte se këtu ka ardhur nga Belleja katragjyshi i tij, që do të thotë brezi i gjashtë nga nipi i Bucit. Nëse merren 3 breza si periudhë njëqindvjeçare, atëherë del se Shaljanët e Bellêsë banojnë në Broliq tash më se 200 vjet. Meqenëse gjenealogjia e Buc Ramës tregon jo vetëm lashtësinë e Shaljanëve në Broliq, por edhe procesin e islamizimit të tyre, është me interes që ta shënojmë këtu: Buci (1885) — Rama — Zeneli — Çeka — Marashi — Gila — Kola — Martini. Kjo tregon se Çeku është bërë mysliman, kurse baba i tij Marashi ka qenë katolik. Fenë duhet ta kenë ndërruar pra, me rastin e blerjes së tokës në rrafsh, nga zotërinjtë myslimanë, duke u vendosur në një ambient gjeografik, banuar gjithashtu nga shqiptarët myslimanë.

Edhe Gashi i Broliqit ka ardhur nga viset e afërme të Lugut të Baranit. Madje, Gashjanët nuk kanë bërë rrugë të gjatë për t'u vendosur në Broliq, sepse ata janë me prejardhje nga Lumbardhi, fshati më i afërm i Broliqit, ndërmjet të cilëve është vetëm Bistrica e Deçanit. Këtu kanë ardhur 4 vëllezër: Istrefi, Uka, Pergjeqi e Leka. Sot në Broliq janë katër mëhallë me emra të këtyre vëllezërve. Nga këta i pari ka ardhur Istrefi, dhe, si shihet nga emri, ai ka kaluar në fenë islame, ndërsa këta duhet ta kenë bërë edhe pasardhësit e vëllezërve të tjerë. Nga shembulli i kësaj familjeje, si edhe nga shumë shembuj të tjerë, shihet jo vetëm procesi i islamizimit, por edhe toleranca e madhe fetare mes katolikëve e myslimanëve, të cilët në shumë raste kanë qenë vëllezër dhe kushërinj të parë, madje edhe pjesëtarë të familjeve të përbashkëta. Përveç kësaj, kjo tregon se shqiptari nuk i ka kushtuar rëndësi të madhe fesë, por përkatësia kombëtare ka qenë gjithmonë në plan të parë.

Prejardhja më e largët e Gashit të Broliqit është nga fshati Pauçinë, në rrethet e Rozhajës. Gashi e shfrytëzon për kullotë bjeshkën e Lumbardhit, sepse edhe pse janë shpërngulur kahmot nga ky fshat, prapë e kanë mbajtur deri tash të drejtën që e kanë pasur dikur si banorë të Lumbardhit dhe pjesëtarë të fisit Gash. Për të njëjten arsye edhe Shala e shfrytëzon bjeshkën e Bellêsë. Para lufte këtu kanë qenë kolonizuar 17 familje malazeze.

Toponomastika e Broliqit është shumë e varfër. Kjo vjen ndoshta për arsye se terreni i këtij fshati është i vogël, fshatarët kanë fare pak tokë, kështu që dëndësia agrare është e madhe, e përveç kësaj, këtu relievi është mjaft uniform, i thjeshtë — kryesisht fushë e rrafshtë që shtrihet gjatë bregut të Bistricës, dhe një kodër e vogël, ku ndodhet një pjesë e katundit. Shumë fshatra të tjera, përveç fushës në rrafsh, kanë edhe malin (pyllin) në kodër të gjerë, e cila shtrihet gjatë gjithë Lugut të Baranit kah veriu, dhe ku ka forma të ndryshme të relievit (lugje, gryka, përrenj, shpate, gropa etj.), të cilat i kanë emrat e tyre të posaçme. Broliqi është larg kësaj zone kodrinore. Toponimet më të rëndomta në terrenin e Broliqit janë: Arat e Gata, Rosuja, Bigovica, Firaja, Kodrat etj. Rrëzë Kodrës janë varrezat katolike të të parëve të popullsisë së sotme, e pranë tyre varrezat myslimane.

Fushat e Broliqit kanë mjaft lagështi dhe mundësi për ujitje artificiale. Ato mbillen me shumë perime, sidomos me speca e lakra, pastaj me bostan (shalqin) etj. Një pjesë e fushës së Broliqit shtrihet në anën e djathtë të Bistricës së Deçanit.

Turjaka. — Turjaka ndodhet në pllajën e kodrës që shtrihet në anën e veriut të Lugut të Baranit, që nga Krysheci në perëndim e deri në Dri të Bardhë në lindje. Kjo pllajë ka nivelin mbidetar rreth 500 metra dhe është e përthyer me përrenj të vegjël, të cilët e kanë thelluar shtratin e tyre në të. Ky është fshat i tipit të shpërndarë, sepse shtëpitë janë larg njëra nga tjetra dhe formojnë disa grupe. Disa ndodhen në luginën e ngushtë të përroit Makve, i cili buron në terrenin e këtij fshati dhe rrjedh në drejtim të lindjes, nëpër fshatin Rosujë, ku derdhet në Bistricë të Pejës. Disa shtëpi të tjera janë në kodër dhe nëpër shpate. Megjithatë, Turjaka ka vetëm 2 mëhallë — Turjaka e Epërme e Turjaka e Poshtme, megjithëse disa shtëpi janë rreth 1 km larg njëra nga tjetra. Fshati nuk ka ujë të mjaftueshëm, madje edhe uji i pishëm gjendët vetëm në puse të thella më se 15 metra. Është edhe një burim i vogël i cili gjithashtu shfrytëzohet për pije. Fusha e Turjakës vuan për ujë. Për ujitje shfrytëzohet përroi Makve, por ai ka pak ujë dhe kështu pjesa më e madhe e tokës mbetet pa ujitur. Kanali ujitës i betonuar më 1968 vjen nga Peja deri afër Turjakës, por ajo nuk mund ta shfrytëzojë. Toka e kualitetit të dobët — mellë (argjil) e kuqe, smonicë, siç thonë banorët e këtushëm. Kuptohet se rendimentet janë fare të vogla. Nuk janë të rralla vjeshtat kur fshatari, i cili punon tokën e tij me kujdes, por me mjete primitive, merr vetëm farën që e ka mbjellë në pranverë. Turjaka është fshat shumë i varfër, sepse fshatarët gjejnë drith vetëm për 2-3 muaj, kështu që zakonisht për 10 muaj e blejnë bukën.

Turjaka ka më shumë pyll e kullota se fshatrat e tjera. Nga drurët këtu ka më shumë qarr e bung. Mbajnë më shumë bagëti, sidomos gjedhe, dhe kafshët i shesin për të blerë bukën. Dikur shitnin edhe dru, sepse kishte pyje të rritura. Pyjet e Turjakës e të Duboçakës kanë qenë të përmendura edhe në zonat e tjera jashtë Lugut të Baranit. Aty strehoheshin edhe komitet në kohën e sundimit turk dhe të Jugosllavisë borgjeze.

Popullsia e Turjakës përbëhet vetëm nga fisi Krasniqe dhe 1 familje Gash. Krasniqja ndahet në dy pjesë: Gegëhysenë e Planë. Shumica janë Planë. Paraardhësit e familjeve të tashme kanë banuar më parë në Vranoc, më vonë janë vendosur këtu. Por më të afërm e kanë Nepolen, e cila përbëhet vetëm nga fisi Krasniqe dhe të gjithë janë katolikë, se bashkëfistarët e tyre në Vranoc, ku kanë jetuar më parë. Brenda fisit ekziston ekzogamia apsolute. Në Turjakë ka ende disa familje të mëdha patriarkale me nga 20-25 pjesëtarë. Qëndrimi i familjeve të tilla me një numër më të madh në Turjakë është kushtëzuar nga varfëria e tyre. Këtu, si thamë, toka është e ligë dhe kushtet e tjera gjithashtu jo të mira për të siguruar jetë sadopak normale ekonomike. Por në familje të mëdha ka më shumë punëtorë, më shumë meshkuj, dhe kështu disi kalohet. Sikur të ndaheshin në disa pjesë, do të vështirësohej

gjendja edhe ashtu e keqe e tyre, dhe kështu janë të shtrënguar të jetojnë në bashkësi, e cila në kushtet tona në përgjithësi është duke u zhdukur shpejt në shumë fshatra e zona të tjera. Përveç kësaj, popullsia e Turjakës merret vetëm me bujqësi, sepse nuk ka njerëz të shkolluar, as të atillë që merren me punë të tjera jobujqësore. Jugosllavia borgjeze ka pasë kolonizuar këtu 20 familje malazeze.

Turjaka nuk përmendet në dokumentat e shekullit XV, të cilët i kemi përmendur disa herë më sipër lidhur me të dhënat për fshatrat e tjera të kësaj treve. Më 1905 kishte 10 shtëpi; ndërkaq më 1971 këtu janë regjistruar 40 shtëpi (familje) me 337 banorë, nga të cilët 331 shqiptarë e 6 kolonistë malazezë, kurse më 1981 313 banorë (306 shqiptarë e 7 malazezë) me 29 familje.

Megjithëse kushtet ekonomike në Turjakë janë të këqia, nga ky fshat vetëm 3 vetë gjenden në botën e jashtme në punë të përkohshme. Edhe kjo është në lidhje të ngushtë me shkallën e ulët ekonomike të tyre, sepse për të shkuar jashtë shtetit në vende të largta nevojitet një shumë jo e vogël e të hollave, e kjo në Turjakë nuk mund të sigurohet. Nga ana tjetër, as në qytete të Kosovës, ose në vise të tjera nuk ka njerëz në punë nga Turjaka, përveç një agronomi dhe një nëpunësi në Pejë. Të gjitha këto e ngadalësojnë shumë procesin e përparimit.

Turjaka nuk ka shkollë. Nga se shtëpitë janë larg njëra — tjetrës në disa raste edhe më se 1 km, edhe sikur të kishte këtu një shkollë fillore, nuk do të ishte aq lehtë që dimrit nxënësit e këtij fshati të shkonin në të. Por kjo do të ishte prapë një lehtësi shumë e madhe për vocërrakët e Turjakës, të cilët tani duhet të bëjnë rrugë për ditë, verë e dimër, nëpër pyje e kodra, duke kaluar përrenj e gërrella, për të ardhur në mësim në Baran, nja 3 km, oso më tepër larg shtëpive të tyre, e për t'u kthyer dimrit edhe në mbrëmje vonë, nëpër borë e shi. Kuptohet se në kushte të tilla nuk mund të shkollohet, as nuk mund të përparojë brezi i ri. Kjo shihet nga fakti se deri tash, për më se 35 vjet pas lufte, vetëm një i ri nga ky fshat ka kryer fakultetin dhe vetëm 5 të tjerë i ndjekin mësimet në shkolla të larta (më 1980), megjithëse, si e cekëm më parë, Turjaka ka më se 40 familje me 337 banorë, ndër të cilët shumica janë të rinj. Përveç kësaj Turjaka është e izoluar nga Peja, të cilën nuk e ka larg në vijën ajrore, por fshati nuk ka lidhje të mirë me rrugën e shtruar Pejë — Gllogjan. Rruga e fshatit është shumë e dobët, sidomos dimrit e pas shirave, kështu që edhe ky fakt e vështirson shumë shkollimin e brezit të ri dhe përparimin e fshatit. Toka nuk ujitet, sepse nuk ka ujë, i cili mund të sillet me ndërtimin e kanalit anësor që do të lidhej me kanalin i cili ka arritur mjaft afër. Kështu do të rriteshin rendimentet bujqësore, të cilat janë tepër të vogla. Një përpjekje për kooperim midis sektorit shoqëror e atij individual në bujqësi, sidomos në blegtori, do të ishte një hap i mirë përpara në rrugën e përparimit.

Shkalla e ulët ekonomike e fshatit shihet edhe nga fakti se këtu kanë gjithsej 2 traktorë, ndërkaq makinat e tjera, bujqëso-

re mungojnë fare. Rryma elektrike është element i rëndësishëm i jetës moderne që ka depërtuar në Turjakë gjatë këtyre 35 vjetëve.

Toponime në terrenin e Turjakës nuk ka shumë. Duket se fshati është mjaft i ri, meqenëse kushtet për jetesë, si e thamë, këtu nuk janë aq të volitshme. Në të kaluarën ato kanë qenë edhe më të pavolitshme, sepse kjo trevë ka qenë e mbuluar me pyje të mëdha. Njerëzit i kanë prerë pyjet për të fituar tokë bukë. Deri vonë nuk ka pasur nevojë për një punë të tillë të vështirë, sepse ka pasur tokë të lirë e shumë më të mirë në zonën fushore të Lugut të Baranit. Këtu kualiteti më i mirë i tokës është në lugje të përrenjve të vegjël, sidomos rreth përroit Tmavë. Një pjesë e fshatit, që gjendet në lug, quhet po me këtë emër — Lugu. Në toponiminë e Turjakës termi „lug" përdoret në disa raste: Lugu i Laknave, Lugu i Mullinit, Lugu i Hujve, Lugu i Trumajes; pastaj fusha ka edhe këta emra: Gurra e Shapotit, Arat te Vorret, Benocat e Moçme (livadhe), Kroni i Demë Danit etj.

Këto lugje, kodra, shpate, e sidomos pyjet e mëdha, në të kaluarën kanë qenë edhe pika strategjike për qëndresë kundër zaptive të turkut e xhandarëve të krajlit. Nga ky aspekt terreni i Turjakës është shumë i ngjashëm me kodrat, lugjet e pyjet e Dushkajës, e cila shtrihet në anën e djathtë të Bistricës së Deçanit, nga Ratishi e Suka e Zabelit në perëndim, e deri në Dri në lindje. Në këtë trevë mblidheshin dhe luftonin jo vetëm komitët, por edhe bajraku i Vranocit e bajraqet e tjera të kësaj ane kundër ushtrisë turke, të prirë nga pashallarët e ndryshëm për të shuar lëvizjen çlirimtare kombëtare të periudhës së Lidhjes së Prizrenit e të Beslidhjes së Pejës më 1897 etj. Kështu ka ndodhur më vonë edhe më Vesel pashën, i cili pësoi disfatë në përleshje me bajraqet e kësaj ane, të cilat me qëllim strategjik e qendrese kanë ndërtuar edhe një kullë trikatshme në Turjakë, që është edhe sot. Këto ngjarje, ende të gjalla në traditën e popullit të këtyre fshatrave, i ka thurë në vargje në këngë trimërie edhe rapsodi popullore, ku Turjaka paraqitet si vend strategjik, sepse të tillë e bëjnë jo vetëm elementet natyrorë që i përmendëm, por edhe pozita gjeografike, e sidomos trimëria e banorëve të saj, si edhe e mbarë popullsisë të këtyre viseve.

Barani i Eprëm. — Barani konsiderohet zakonisht si një vendbanim, megjithëse janë dy mëhallë të ndara e të veçuara, kështu që mund të merren edhe si dy fshatra, siç i gjejmë në dokumentet e vjetra mesjetare. Tash administrata e statistika Baranin e konsideron vetëm si një vendbanim. Nga se materialet e vjetra kanë të dhëna për dy vendbanime të veçuara, edhe ne me këtë rast do t'i trajtojmë si të tilla.

Barani i Epërm ndodhet rrëzë Kodrës së Baranit. Fshati ndahet në mëhallën Fushaxhi dhe Katund. Afër fshatit është një burim i fortë, i cili „sjellë dy gurë mullini". Verës ky ka mjaft ujë, ndërsa dimrit shterret. Pjesa perëndimore e fushës nuk ka ujë, ndërkaq ajo nga lindja ujitet. Çdo shtëpi ka bunarin (pusin) me një thellësi jo më tepër se 6 metra.

Në defterin turk të vitit 1485 thuhet se Barani i Epërm varet nga Peja. Ai ishte në kompetencën e njëfarë Mustafait, të birit të Jahjas, i cili këtë e kishte si shtesë të timarit të tij. Barani i Epërm në atë kohë kishte 21 shtëpi, d.m.th. kryefamiljarë, pastaj 2 beqarë e 3 gra të veja. Detyrimet e fshatit ndaj spahiut, përkatësisht ndaj shtetit, bashkë me „ispenxhen" (tatim i paguar me të holla), ishin 1013 (akçe). Fshatarët e Baranit të Epërmë mbillnin e korrnin në fshatra të tjera. Prandaj në defter nuk janë të shënuara detyrimet sipas llojeve të produkteve bujqësore veçmas, por përmbledhtas në një shumë të caktuar (1013 ispenxhe), si bëhej edhe në disa raste të tjera.[95]

Për popullsinë e Baranit të Epërm ky defter jep shënime të ngjashme si për fshatrat e tjera të Lugut të Baranit. Kryefamiljarët kanë emra sllavë në shumicën e rasteve, vetëm 3 kryefamiljarë dalin me emra të përzier shqiptarë e sllavë. Mirëpo, si e thamë edhe më parë, në shumë raste shqiptarët paraqiten me emra sllavë, dhe këtu nuk ka nevojë t'i paraqesim e t'i shpjegojmë përsëri rrethanat e arsyet për një dukuri të tillë. Këtu po paraqesim vetëm 2-3 raste të tilla, që të dokumentohet edhe më konkretisht se në bazë të antroponimeve (emrave të njerëzve) nuk mund të vërtetohet gjithmonë përkatësia kombëtare e tyre, kur është fjala për popullsinë shqiptare, sepse shqiptarët mbajnë emra sllavë në shumë raste në dokumente të ndryshme, jo vetëm në mesjetë e më vonë, por në disa vise madje edhe sot e kësaj dite. Kështu në defterin e Baranit të Epërm figurojnë edhe kryefamiljarët: Prebili, i biri i Gjurës, Radiçi, i vëllai i Markut, Nikolla, i biri i Nenos, pastaj Prebili, i biri i Gjonit etj. Emri Radiç, i cili përmendet në regjistrin e Baranit në defterin e vitit 1485, përmendet edhe në fshatra të tjera shumëherë, dhe nga relacioni i gjinisë së gjakut me njerëz që mbajnë emër të banorit shqiptar, shihet se edhe Radiçi duhet të ketë qenë po i kësaj përkatsie etnike. Kështu në regjistrin e „fshatit Dubovë" (Dubova është afër Ilixhës së Pejës, por ndoshta me këtë emër quhej Duboviku i sotëm, i cili kufizohet me Lug të Baranit), përveç të tjerëve, ekzistojnë edhe këta kryefamiljarë: Hamza, i biri i Abdullahut, Jaku, i biri i Mehmetit, Haxhi Jusufi, Radiçi, i vëllai i tij. Pra, nëse ka qenë shqiptar mysliman Haxhi Jusufi, gjë që nuk mund të vihet në dyshim, atëherë duhet të ketë qenë i tillë edhe vëllai i tij Radiçi. Edhe një shembull nga Isniqi, fshat kufitar me Lugun e Baranit. Në Isniq 4 kryefamiljarë kanë pasur emrin Radiç: Radiçi i biri i Bozhidarit, Radiç Vllatkoviqi, Todor i vëllai i tij, Petko i biri i Radiçit, Bozhidar Radiçi.[96]

Në të dhënat e gjeografit J. Cvijiq të vitit 1905 Barani figuron si dy vendbanime, por numri i shtëpive këtu jepet përmbledhtas, së bashku për Baranin e Epërm e Baranin e Poshtëm, të cilët kanë pasur, sipas këtyre të dhënave, vetëm 20 shtëpi. Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë më 1971 gjithashtu janë të përbashkëta për të dy fshatrat, të cilat në këtë mënyrë konside-

[95] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 276.
[96] *Po aty*, 280—283.

rohen si një vendbanim me 2 mëhallë. Barani kishte atë vit gjithsej 157 shtëpi (familje) me 1169 banorë nga të cilët 1069 shqiptarë, 18 serbë, 81 malazezë e 1 të tjerë. Brenda këtyre 65 vjetëve (1905-1980) në Baran nuk ka pasur emigracione të mëdha, sepse kah mesi i shekullit të kaluar edhe në këto vise fshatrat janë stabilizuar me banorë të vjetër e të përherëshëm, kështu që migrimet kanë qenë të vogla e sporadike. Prandaj numri i shtëpive në Baran nuk është rritur në mënyrë mekanike (me imigrim, por në mënyrë natyrore (me ndarjen e familjeve të mëdha patriarkale të fshatit). Kështu pra, numri i shtëpive në vitin 1905 duhet të ketë qenë shumë më i madh se 20, gjë që mund të thuhet edhe për disa fshatra të tjerë, për të cilët duket se është dhënë i zvogëluar numri i shtëpive. Më 1981 Barani i Epërm dhe Barani i Poshtëm kanë pasur së bashku 1157 banorë (1116 shqiptarë, 33 malazezë, 8 serbë) me 122 shtëpi.

Shumica e familjeve të sotme në Baran të Epërm janë Krasniqe (më se 20); ndahen në Kapit e Murataj. Thaçi (3) është këtu më i vjetër nga familjet e fiseve të tjera. Berishë janë nja 6 familje, ndahen në Alshiqe (që quhen edhe Kolgjonaj) e në Tarakaj të Aprripës (Thaçi janë të përzier — myslimanë e katolikë). Dy familje Berishë janë të ardhura nga fshati i afërm Llukë (në anën e djathtë të Bistricës) dhe quhen Gecaj. Këtu jetojnë edhe 5 familje malazeze, të ardhura si kolonistë nga Mali i Zi më 1932 -1936: Camniq (3), Strikoviq(1), Brajeviq (1) dhe 1 familje serbe e ardhur gjithashtu më 1936 nga Serbia. Në Baran të Epërm e të Poshtëm kanë qenë kolonizuar 30 familje malazeze.

Toka ka qenë e bejlerëve të Pejës, kështu që deri vonë fshatarët kanë qenë çifçinj të tyre. Fushat e kodrat kanë shumë toponime, që do të thotë se Barani është vendbanim i vjetër. Nga numri i madh i toponimeve më të njohura janë këto: Firinat (tokë buke), Livadhi i Mullinit, Fusha e Epërme, Batalleku (tani fushë pjellore), Rrahishta, Fushaxhija, Ara e Mikelit, Behaxha, Gliadishat, Shamahet e Halil Hamzës, Kodra e Sokolçunve, Shavarinat, Qerhanet, Vorret e Shehitve (varret e 14 viktimave të pushkatuara më 1913 nga ushtria malazeze, sepse refuzuan të ndërronin fenë e kombësinë e tyre), Podet (pyjet) Livadhi i Mllakit etj. Disa toponime janë të përbashkëta me ato të terrenit të Çellopekut e të Turjakës, përkatësisht për pjesën kodrinore të këtij terreni (fjala është për disa forma të relievit — lugje, shpate, kodra etj.), si edhe për ndonjë toponim tjetër në fushë, e cila kufizohet me fushën e Baranit të Poshtëm, me të cilin është i përzier nga shumë aspekte, si lagje e tij.

Barani i Poshtëm. — Barani i Poshtëm, si edhe Barani i Epërm, shtrihet rrëzë Kodrës së Baranit, por pak më larg saj në drejtim të fushës, kështu që ky është pak më poshtë se Barani i Epërm. Nëpër fshat kalon rruga e asfaltuar Pejë—Gllogjan. Në Baran janë dy mëhallë — Mahalla e Epërme dhe Mahalla e Poshtme. Ky fshat zë vend qendror në Lug të Baranit, sipas emrit të tij quhet e gjithë kjo zonë, ndoshta mu për arsye të pozitës së tij gjeografike. Por përveç kësaj, Barani ka qenë edhe qendër administrative e shoqërore, e në njëfarë dore — edhe qendër kulturore, megjithëse bajraku e ka pasur qendrën në Vranoc, i cili gjithashtu ka luajtur rol të rëndësishëm në ngjarjet dhe procesin e zhvillimit të jetës shoqërore të kësaj zone.

Për Baranin e Poshtëm ka të dhëna të rëndësishme në defterin turk të vitit 1485. Ky fshat në atë kohë ishte timar i Kasem Çelebiut, të birit të Malhoçit, dhe ishte i varur nga Peja. Kasem Çelebiu e kishte timar të vetin edhe Isniqin, i cili sipas defterit, atëherë kishte vetëm 18 shtëpi, ndërsa sot është njëri ndër katundet më të mëdha të Kosovës (me rreth 300 shtëpi e 3000 banorë). Barani i Poshtëm atëherë kishte 32 shtëpi (kryefamiljarë), 9 beqarë e 3 të veja. Pra, edhe para 500 vjetësh ky fshat ishte relativisht i madh. Defteri përmban material interesante për historinë ekonomike të këtyre fshatrave. Barani nga ky aspekt është shumë karakteristik. Kjo jo aq për sasinë e taksave e të mallrave bujqësore, sa për strukturën e prodhimeve dhe të pasurisë së përgjithëshme. Kështu ky fshat detyrohej të paguante (më 1485) 50 barrë grurë, 50 barrë thekër, elb, tagji etj., pastaj 13 barrë mel, musht 34 subur, taksa bari 16, taksa të druve 64, taksa të lirit 300, taksa të perimeve 56, taksa për 4 mullinj 160 etj. Barani kishte edhe prona shtetërore (has), nga të cilat dorëzoheshin për shtetin 10 barrë grurë dhe 150 aspra për barë nga livadhet e hasit. Shteti kishte këtu një mulli. Barani mbante edhe bletë dhe për to paguante taksë të posaçme prej 10 akçesh.

Nga këto të dhëna shihet se Barani ngarkohej me detyrime mjaft të rënda, por kjo mund të tregojë edhe se gjendja ekonomike e tij ndoshta nuk ishte aq e dobët. Bie në sy struktura e produkteve bujqësore, e cila gjithashtu dëshmon për aktivitet më të gjallë në ekonominë bujqësore. Gjithashtu tërheq vëmendjen fakti se nga drithërat kishte grurë, thekër etj., ndërsa sot bima kryesore në arat e kësaj zone është misri. Ky ndryshim vjen nga fakti se misri atëherë nuk njihej në këto anë, e përgjithësisht në Evropë, si drithë buke. Vreshtaria gjithashtu duhet të ketë qenë e zhvilluar, sepse fshati ngarkohej me sasi të caktuara mushti. Tash në Lug të Baranit nuk ka, të themi, asnjë rrënjë hardhie. Paguhej atëherë edhe taksa për li, mel etj., kultura këto që tash nuk mbillen. Bletaria gjithashtu duhet të ketë qenë e zhvilluar, sepse edhe kjo degë ekonomike ngarkohej me tatim të caktuar. Nuk përmenden bimë industriale, të cilat sot kultivohen në këtë zonë (duhani, luledielli, panxharsheqeri, sepse atëherë këto nuk ekzistonin në këto vise. Nuk dihet se çka prodhohej nga perimet, meqenëse defteri i përfshin të gjitha këto bimë me një fjalë „perime". Sot gati të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit, kuptohet vetëm ato në rrafsh, kultivojnë sasi të mëdha perimesh (lakra, speca, domate etj.), madje një pjesë të madhe edhe për treg. Gjithashtu në defter nuk përmenden pemët, përveç vreshtave. Tash në këtë zonë ka me mijëra trupa kumbullash, por ka edhe mollë, dardha etj.

Popullsia e Baranit paraqitet në defter para 500 vjetësh e përzier përkah struktura e emrave — sllavë e shqiptarë. Nga 32

familjarë të regjistruar në këtë dokument, 6 kanë emra të përzier, 1 emër shqiptar e të tjerët kanë emra sllavë. Por, si e thamë edhe më parë, shumë shqiptarë kanë pasur emra sllavë, dhe në bazë të antroponimisë nuk mund të vërtetohet gjithmonë kombësia kur është fjala për shqiptarë. Ndër emra të tjerë, këtu përdoret Plaku, i biri i Bozhidarit, Bogdani, i biri i Plakut, Radiçi, i biri i Bogdanit, Liku, i biri i Nikollës etj.[97]

Në shënimet e vitit 1905, si u cek më lart, dy Baranat kishin gjithsej 20 shtëpi. Me rastin e regjistrimit të vitit 1971 Barani gjithashtu është paraqitur si një vendbanim i vetëm në botimet e ndryshme statistikore. Rezultatet statistikore të këtij regjistrimi po i përsëritim edhe këtu, nga se numri më i madh i familjeve dhe i banorëve i takon Baranit të Poshtëm, i cili bashkë me Baranin e Epërm kishte: 157 shtëpi dhe 1169 banorë (1069 shqiptarë, 18 serbë e 81 malazezë). Nga aspekti i përbërjes kombëtare Barani i Poshtëm dallohet nga Barani i Epërm, sepse këtu ka vetëm 1 familje malazeze e 1 serbe, të gjitha familjet e tjera janë shqiptare. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjes (në dy Baranat)) arrinte 7,4 për çdo familje. Barani i Poshtëm ka rreth 90 shtëpi. Këtu është me interes të shqyrtojmë të dhënat statistikore të Këshillit të vendit Baran për vitin 1950, sepse ato janë dhënë veçmas për Baranin e Poshtëm, e veçmas për Baranin e Epërm. Atëherë Barani i Epërm kishte 75 shtëpi (familje) nga të cilat 64 shqiptare, 9 malazeze e 2 serbe, me gjithsej 573 banorë, nga të cilët 510 shqiptarë, 35 malazezë e 5 serbë. Sipas gjinisë — 289 meshkuj e 284 femra. Më 1980 në Baran të Poshtëm ishin vetëm 2 shtëpi malazeze. Mesatarja e pjesëtarëve të familjes shqiptare ishte 7,8 e asaj serbe e malazeze 3,6, sipas të dhënave nga viti 1950. Nga kjo shihet se familja e madhe patriarkale në Baran është ende e fortë, megjitëse edhe këtu ka filluar procesi i shkuarjes së saj.

Fshati përbëhet nga disa fise. Numri më i madh i familjeve janë Gash (më se 30 shtëpi), pastaj vjen Berisha (15), Krasniqja (10), Shala (8), Kelmendi (5), Kastrati (1), Thaçi (1), pastaj këtu janë 2 familje serbe dhe malazeze: Kastratoviq (serbe) dhe Vushoviq (malazeze). Familjet rriten e ndahen, si kudo ndër ne, por për familjen Thaç fshatarët thonë se kurrë nuk është bërë dy shtëpi. Gashjanët, të cilët e përbëjnë gati gjysmën e fshatit, kanë ardhur nga Raushiqi (Pejë), njëherë në Carrabreg, e „para shtatë faqesh" (shtatë breza) janë shpërngulur nga Carrabregu (Deçan) e janë vendosur në Baran. Këta breza i numrojnë kështu: Bajrami (i lindur më 1958) — Mustafa (baba i tij, i lindur më 1910) — Muhameti — Avdyli — Brahimi — Dema — Osmani — Mula — Kola. Këtu ka ardhur Osmani nga Carrabregu. Gashjanët siç thonë ata, ndahen në këto barqe (vëllazëri): Kolicaj (sipas Kolës nga brezat që i numruam), Memaj, Neziraj (këta quhen edhe Demukaj) dhe Balaj. Kolicajt e Balajt banojnë në

[97] P o a i, *Studime Historike*, nr. 4/72, 198.

Mëhallë të Poshtme. Fshatarët e përmendin Daut Kolicën si njeri të mençur, kuventar e pleqnar. Ka vdekur në moshën 100-vjeçare, më 1967 në Baran.

Barani ka qenë në shënjestër të të gjitha qeverive antipopullore deri në çlirim, bashkë me Vranocin. Në këtë situatë ishin të gjitha fshatrat e kësaj zone, por për realizimin e politikës shtypëse, organet e qeverisë fillonin më parë nga këto dy fshatra, ose nga Krysheci, që ishin më të forta. Përveç kësaj, Barani ishte qendër, ekspoziturë e politikës së tillë në këtë zonë, sepse këtu ishte komuna e Baranit, e afër komunës, në fshatin Çellopek, xhandarmëria e krajlit. Në kohen e terrorit më 1913 për ndërrimin e fesë, përkatësisht të kombësisë, Barani ka vuajtur tepër. Përveç torturave e burgosjeve të shumta, ushtria e xhandarmëria malazeze këtu i ka pushkatuar 14 fshatarë të pafajshëm, si u tha edhe më parë. Drama e njohur e vitit 1937 me rastin e votimeve, kur mbetën të vrarë e të plagosur 32 fshatarë të kësaj zone nga plumbat e xhandarëve, gjithashtu është zhvilluar në Baran.[98] Baranit „agrari" ia ka marrë tokën pjellore „deri në prag të derës së shtëpisë" dhe prefekti i Pejës u ka vënë në derë të oborrit pllakatat e shtypura me të cilat fshatarët urdhëroheshin të shpërnguleshin për në Turqi brenda 10 ditësh. Për të gjitha këto folëm më gjatë me rastin e shqyrtimit të kushteve shoqërore-historike. Barani, bashkë me fshatrat e tjera të kësaj zone, ka luftuar kundër ushtrisë e zaptive turq që vinin për t'i ndëshkuar fshatarët dhe i kërkonin të drejtat e tyre kombëtare. Komandanti i ushtrisë Vesel pasha dhe më vonë komandanti i xhandarmërisë së Pejës Xhafer Tajari, kthehen të turpëruar nga rezistenca e fshatarëve. Ata u qëndrojnë edhe topave të Savë Batares, përkatësisht terrorit të njohur të ushtrisë së krajl Nikollës më 1912-1913. Më vonë ata vuajtën e duruan edhe për kafshatën e gojës pranë arave të tyre plot grurë e misër, të cilat ua rrëmbeu „agrari". Qëndruan në troje të stërgjyshërve të tyre edhe atëherë kur në dyer të tyre xhandarët vunë pllakata të mëdhenj, në të cilët ishte urdhëri i prerë i „naçallnikut" të Pejës, që brenda afatit të caktuar t'i zbrazin shtëpitë e tyre e të shpërnguleshin për në shkretira të Anadollit. Kështu qëndroi Barani, Vranoci, Krysheci e të gjitha fshatrat e tjera të Lugut të Baranit.

Fusha e Baranit të Poshtëm ka shumë toponime, sepse ajo është mjaft e gjerë, kështu që terreni i fshatit shtrihet edhe në zonën kodrinore edhe në lug, në rrafshinë; përveç kësaj, si u pa nga faktet të cilat i shqyrtuam më sipër, Barani është fshat i vjetër, dhe kështu toponimet janë trashëguar e janë shtuar brez pas brezi. Këtu po i shënojmë disa nga numri i madh i toponimeve të terrenit të këtij fshati: Arat e Epra, Arat e Gata, Arat e Hysenit, Arat e Memës, Livadhet e Buta, Kroni i Etheve (aty i „lidhnin ethet"), Lugu i Hafizit, Kroni i Kallugjerit, Rrahije, Arat e Pavada, Prroni i Behocit, Letika, Pinik (kodër), Lugu i Thive, Lugu i Mullinit, Lugu i Trumhajes, Kroni i Ahit, Gurra e Shapitit, Mllakishte, Kroni i Keqes, Shpati, Kroni i Baranit etj.

[98] Kallëzim i M u s t a f ë M a h m u t i t nga Barani.

Barani edhe tash (1980) është qendër administrative, arsimore e shëndetësore për të gjitha fshatrat e kësaj zone, sepse aty është Zyra e vendit, shkolla tetëvjeçare, dy klasë të para të shkollës së mesme, ambulanca e re, disa shitore etj. Si e thamë edhe më sipër, pozita gjeografike e Baranit ka ndikuar, përveç elementeve të tjera, që ky fshat të ketë rolin e qendrës administrative etj., sepse ndodhet në pjesën qendrore të Lugut të Baranit, gati në gjysmën e rrugës Kryshec — Gllogjan, ndërsa Kpuzi e Çeskova anojnë më tepër kah Lugu i Leshanit e Klina, e cila gjithashtu është qendër, madje e përparuar dhe relativisht e madhe, dhe më afër këtyre fshatrave se Baranit.

Kotradiqi. — Kotradiqi, ose Kodradiqi, shtrihet pranë bregut të majtë të Bistricës, rrëzë një kodre, e cila është e lartë rreth 500 metra, kurse një pjesë e fushës përtej këtij lumi. Fshati ndahet në 3 mëhallë, të cilat quhen sipas morfologjisë së terrenit ku gjenden: Kodra, Rrafshi, Ornica. Para lufte, gjatë sundimit të Jugosllavisë borgjeze, këtu ua kanë marrë tokat fshatarëve dhe kanë sjellë një numër kolonistësh malazezë. Shtëpitë e kolonistëve kanë qenë në kodër dhe formonin një mëhallë në vete, të cilën e quanin Kotradiqi i Ri. Gjatë okupacionit kolonistët e kanë braktisur fshatin. Megjithëse fshati ndodhet gati buzë lumit, një pjesë e tij — Mahalla e Kodrës, nuk ka mjaft as ujë të pishëm. Aty ujët del vetëm në një thellësi prej 13 deri 15 metrash, kështu që puset (bunarët) janë mjaft të rralla. Në pjesën fushore të fshatit, në rrafsh, puset nuk shkojnë më thellë se 6 metra. Në anën lindore të fshatit është një burim me ujë të pishëm, të cilin fshatarët e quajnë Kroni i Mark Gatës. Fushat i ujitin me një kanal që ndahet nga Bistrica përmbi Broliq, dhe shkon rrëzë Kodrës së Broliqit para se të arrijë në fushë të Kotradiqit. Ky kanal (jaz) ka rënien prej 12 metrash, kështu që mund të zgjerohet e të shfrytëzohet për qëllime hidroenergjetike. Tani këtu ka vetëm mullinj, por rëndësia e këtij jazi është e madhe për ujitjen e fushave të kopshteve të fshatit.

Kotradiqi figuron në defterin turk të vitit 1485 si fshat i vogël me 16 kryefamiljarë, kur shënohen edhe 5 beqarë e 3 gra të veja. Fshati varej nga Peja, siç thuhet në defterin në fjalë, dhe kishte këto detyrime vjetore ndaj spahiut (shtetit): 543 ispenxhe (taksa që paguheshin me të holla — akçe), 7 barrë grurë, 6 barrë mel, musht 15 muhur, taksa e govatës 40 ispenxhe, taksa e bletëve 15, e perimeve 32, e barit 80, taksa e spinaqit dhe e qepëve 10, druve 32, e derrave 20 etj. Fshatarët ngarkoheshin me detyrime të rënda, të cilat kapnin shumën e përgjithshme prej 2806 akçesh.

Ndër emrat e kryefamiljarëve, të cilët janë sllavë, figuron edhe emri Radiç, për të cilin folem në lidhje me antroponimet e këtilla në fshatin Baran të Epërm, ku Radiçi figuron në defter si vëlla i Haxhi Jusufit. Në Kotradiq përmenden dy kryefamiljarë me këtë emër: Nikolla, i vëllai i Radiçit, Radovani, i biri i tij, dhe një tjetër Radiç, i biri i Stajkos.[99] Gati të gjitha antroponimet në defterin e vitit 1485, të cilat u referohen banorëve të viseve të Rrafshit të Dukagjinit, mbarojnë me trajtën e shquar shqip, përkatësisht me **i**, me **u**, **it**, **ut** (p.sh. Stepani, Jovani, Vuku, Stojku, Bozhidarit, Rajkut etj.). Kjo ka rëndësi të posaçme kur dihet se regjistrimin e popullsisë (kryefamiljarëve) nuk e ka bërë shqiptari, por ndonjë nëpunës turk, serb ose vllah i islamizuar. Prandaj ai i ka shënuar emrat ashtu si ia kanë thënë fshatarët vetë, ashtu si i kanë shqiptuar personat, të cilët i mbajnë këta emra. Problemi i antroponimisë të asaj kohe përsëritet në çdo fshat që është i shënuar në defter, prandaj edhe shpjegimi është njësoj me atë që e thamë më parë, kështu që nuk ka nevojë të përsëritet.

Të dhënat e defterit për historinë ekonomike të këtyre fshatrave gjithashtu janë pak a shumë të ngjashme, struktura e produkteve bujqësore është njësoj kudo, por ndryshon sasia e shuma e detyrimeve ndaj shtetit, varësisht nga gjendja ekonomike e fshatit. Në shumë fshatra, përveç taksave të tjera, fshatarët ngarkoheshin edhe me „bidatin e derrave", që duhet të jetë edhe një lloj takse. Kjo tregon se popullsia ka qenë e krishterë — ortodokse e katolike, në disa raste edhe e përzier me myslimanë. Por, feja nuk e tregon në këtë rast edhe përkatësinë kombëtare, sepse në atë kohë ka pasur edhe në këto vise shumë shqiptarë të besimit ortodoks, kurse katolikët kanë qenë shqiptarë. Gjatë kohës nga ndikimi i madh i kishës ortodokse, një pjesë e ortodoksve shqiptarë kanë humbur gradualisht tiparet e tyre kombëtare dhe janë sllavizuar, ashtu si janë turqizuar edhe disa familje të besimit mysliman në Prizren, në Prishtinë e në Gjilan. Mirëpo, ka pasur edhe raste të kundërta.

Më 1905 Kotradiqi kishte 15 shtëpi (të gjitha shqiptare), sipas shënimeve të Cvijiqit, të cilat i përmendëm disa herë më parë. Më 1971 këtu janë regjistruar 75 shtëpi (familje) me 646 banorë, të cilët kishin këtë strukturë kombëtare: 593 shqiptarë, 31 myslimanë (me kombësi myslimane), 20 malazezë, 1 serb dhe 1 „të tjerë". Më 1981 fshati kishte 808 banorë (761 shqiptarë, 28 myslimanë, 10 malazezë dhe 1 serb). Edhe Kotradiqi para lufte ishte qendër e kolonizimit, sepse qeveria këtu ka pasë vendosur 35 familje malazeze. Mirëpo, pas lufte shumë nga këta e kanë shitur tokën dhe kanë shkuar në Serbi, në Mal të Zi, ose në qytete të Kosovës. Disa prona të tyre i kanë blerë myslimanët nga rrethet e Novi Pazarit, Tutinit, Bihorit, Plavës dhe Rozhajës. Numrin e atyre që me rastin e regjistrimit të popullsisë janë deklaruar si myslimanë me kombësi, duhet kërkuar vetëm në radhët e këtyre ardhecakëve.

Kotradiqi ka rreth 80 familje, të fiseve të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre janë Gash (rreth 25 shtëpi) e Krasniqe (30), pastaj Berishë (5), kurse „myslimanë", të cilët populli i quan „boshnjakë", janë rreth 10 shtëpi, serbe është familja Janiqijeviq dhe 3 familje janë malazeze — Markoviq, Radovanoviq dhe Peroviq. Këtu janë edhe 2-3 familje romë (jevgj), por ato mbahen me fisin e Krasniqes. Nga banorët e tashëm këtu më të vjetër janë Krasniqja. I pari i tyre ka jetuar më parë në Strellc të E-

[99] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 294.

Bayerische Staatsbibliothek München

përm. (Banorët e këtij fshati janë të gjithë Krasniqe). Këtu ka ardhur si një familje (1 shtëpi) dhe nga kjo tash janë rreth 30. Krasniqja e këtij fshati quhen Malgataj. Kanë shokë të fisit (më të afërm) në fshatin Blakaj, në Pejë e në Sarajevë. Gashjanët kanë ardhur nga Deçani në Dashinoc, e pastaj në Kotradiq. Nga Dashinoci janë shpërngulur për shkaqe ekonomike, sepse në Dushkajë (ku ndodhet Dashinoci) toka është e ligë dhe pa ujë. Këtu kanë ardhur 2 familje Gash, nga të cilat tash janë rreth 25. Vëllazëri kanë në Pejë (5 familje) dhe në Australi (1).

Nga Kotradiqi punojnë përkohësisht rreth 25 vetë në botën e jashtme.

Toka ka qenë e Rizvanollëve të Gjakovës, nga të cilët e kanë blerë fshatarët. Ata kanë pjesë edhe në Bjeshkën e Lumbardhit, ku verës dalin me bagëti. Merren me kultivimin e misrit e të perimeve, më pak mjellin grurë. Deri më 1950 fshatarët kishin edhe vreshta, por janë prishur nga sëmundja dhe nuk i kanë përtëritur më.

Toponimet (emrat e terrenit etj.) janë mjaft interesante, sepse janë kuptimorë, duke filluar që nga emri i fshatit e deri te lisat e objektet e tjera të ndryshme. S'ka dyshim se Kotradiqi ka marrë emrin nga kodra, rrëzë të cilës ndodhet. Madje, shumkush nuk e shqipton Kotradiq, po Kodradiq. Me qëllim që të zhduket çdo gjë që është shqiptare dhe që e vërteton autoktoninë (lashtësinë) e shqiptarëve në Kosovë, qeveria antipopullore e Jugosllasë borgjeze ka ndryshuar me të madhe toponimet në hartat gjeografike, në administratë etj., madje edhe emrat e mbiemrat e popullsisë shqiptare dhe të vendbanimeve të tyre, ndërsa kolonistët i kanë vendosur në fshatra të reja gjatë rrugëve kryesore, të cilave iu kanë dhënë vetëm emra sllavë, si p. sh. Zagrmle, Serbica, Shumadija, Milloshevo, Llazarevo, Devet Jugoviqa, Babin Most etj. Kështu ia kanë ndryshuar emrin edhe Kotradiqit dhe zyrtarisht e kanë quajtur Markoviq, sipas një familjeje të kolonizuar aty. Mirëpo, as ndër kolonistë nuk depërtoi ky emër dhe Kotradiqi mbeti Kotradiq — me emrin e tij të vërtetë, me të cilin përmendet dhe figuron edhe në defterin turk të vitit 1485, d.m.th. para më se 500 vjetësh. Toponimet e tjera janë- Lisi i Gjaqe (ve) (këtu i kanë pajtuar gjaqet, sipas traditës), Firaja, Livadhet e Buta, Zallina, Kërkisha (ke, te kisha), këtu, sipas traditës ka qenë kisha katolike, dhe tash në atë kodër ka rrasa guri; Arat e Sarajt, Arat e Pavada, Lisat e Hasallekut (kolera e vitit 1690), Butaja, Rrahishta (pyll ku çdo familje ka pjesën e vet). Kolonistët, megjithëse para lufte ishin shumë, nuk kanë lënë gjurmë në toponomastikën e fshatit, por as në fshatra të tjera, ku ishin kolonizuar, edhe pse gjatë punës kërkimore në terren jemi përpjekur të gjejmë gjurmë të tilla.

Vranoci. — Vranoci ndodhet në pjesën qendrore të Lugut të Baranit, buzë Bistricës e rrëzë Kodres së Vranocit, e cila është e lartë 465 metra. Në terrenin e këtij fshati Bistrica bën një kthesë (meander) duke u larguar kështu nga kodra në anën e djathtë të saj, rrëzë së cilës rrjedh gjatë gjithë terrenit të Lu-

gut të Baranit. Një kthesë të tillë ajo e bën edhe në fushën e fshatit Llugaxhi. Vranoci shtrihet në fushë të gjerë, si shumica e vendbanimeve të kësaj zone. Në anën e djathtë të Bistricës janë disa shtëpi, të cilat formojnë një mëhallë në vete — Vranocin e Vogël, që konsiderohet si fshat i pavarur nga Vranoci. Në të vërtetë ky fshat nuk përfshihet në Lug të Baranit, i cili në këtë anë e ka Bistricën kufi natyror, kështu që Vranoci i Vogël bën pjesë në Dushkajë, e cila është tërësi tjetër etnike e gjeografike. Edhe administrativisht Vranoci i Vogël i takon një njësie tjetër — komunës së Deçanit. Madje edhe në të kaluarën ai ka qenë në nahije të Gjakovës, ndërsa Vranoci në nahije të Pejës, e tash në komunë të Pejës. Vranoci ka mjaft ujë, sepse puset nuk shkojnë më thellë se 5-6 metra. Fusha ujitet nga Bistrica, por një pjesë e madhe e saj edhe nga „kajnaqet" (burimet) që burojnë në anën perëndimore të fshatit.

Në dokumentet mesjetare, të cilët i kemi shfrytëzuar për disa fshatra të kësaj zone deri tash, nuk e kemi parë emrin e Vranocit. Por kjo tokë pjellore dhe pozita e volitshme gjeografike buzë lumit, me kushte të mira nga çdo aspekt për të zhvilluar ekonominë bujqësore, vështirë që të ketë qenë pa banorë kur përmendet p.sh. Krysheci e Çeskova, të cilat janë pjesë e kësaj zone, por me kushte natyrore shumë më të pavolitshme se këto që i ka Vranoci. Nga ana tjetër, tradita tregon se populsia e këtij fshati ka një histori mjaft të gjatë dhe duhet të ketë qenë këtu para disa shekujsh.

Si e cekëm edhe më parë, Vranoci ka qenë qendër e një bajraku të njohur e të përmendur në Rrafsh të Dukagjinit, me kufij mjaft të gjerë që nga Drini në lindje deri në Logjë, Zllopek e Prapaqan në perëndim, kurse nga veriu mbërrinte deri në Bistricë të Pejës, e nga jugu në Bistricë të Deçanit. Shtëpia e bajraktarëve ishte gjithmonë në thumb të qeverive të ndryshme në të kaluarën. Megjithëse, siç dihet, turqit i formonin vetë bajraqet dhe individëve ua jepnin këtë titull, si e cekem më parë, në Lëvizjen Kombëtare të Lidhjes së Prizrenit dhe më vonë, bajraku ishte organizatë e fortë që mobilizonte masat e gjera popullore për luftë të armatosur kundër ushtrisë e xhandarmërisë turke. Regjimi i Jugosllavisë borgjeze gjithashtu e kishte në thumb shtëpinë e bajraktarëve, sepse e dinte që rreth saj mblidhen e lidhen masat e gjera të fshatarësisë, të cilat ai i shtypte, ua merrte tokën dhe bënte çmos për t'i zhdukur nga këto troje. Ngjarjet e vitit 1913, ato të vitit 1937 etj. e tregojnë qartë këtë. Prandaj kulla e bajraktarit të Vranocit është rrahur me topa të Mustafë pashë Çerkezit, të Vesel pashës, të Savë Batares e me plumba të xhandarmërisë se krajlit, si shumë kulla të tjera në këtë lug. Këtu zhvillonin aktivitetin patriotik ideologët e shquar të Lëvizjes Kombëtare Haxhi Zeka, Bajram Curri, Isa Boletini etj. Këtu mblidheshin komitët e njohur, të cilët me armë në dorë kalonin jetën nëpër male e prita, duke luftuar kundër terrorit të xhandarmërisë së krajlave — Azem Galica, Qel Shabani, Ker Sadrija, Ramë Binaku i Dashinocit, Bafti Ndou i Rakocit, Zhuj Selmani, Zhuj Avdyli

etj. Në Kodër të Vranocit, dhe në kodra e lugje të tjera të kësaj zone, edhe sot janë Vorret e çerkezve, Vorret e shehitve dhe shumë varre të tjera, që dëshmojnë për një të kaluar të idhët e të përgjakshme të Lugut të Baranit. Vranoci ka qenë qendër e kushtrimit, por bajraku mblidhej në Kryshec, ose në Graboc — te Dardha e Grabocit, për shkaqe strategjike — sepse këto fshatra janë më afër Pejës, nga vinte gjithmonë rreziku, dhe afër rrugës kryesore Gjakovë — Pejë — Istok — Rugovë, kah vinin bajraqet e tjera për t'u bashkuar në luftë të përbashkët.

Pra, megjithëse nuk kemi dokumente të vjetra për Vranocin, tradita dhe historia e shkruar janë plot fakte për gjendjen shoqërore të Vranocit, përkatësisht të Lugut të Baranit, për shekullin e kaluar e për ngjarjet e shekullit XX, si dhe për formimin e bajrakut të Vranocit në luftën e Moresë më 1684. Një pasqyrë të shkurtër të këtyre ngjarjeve e dhamë më parë, prandaj këtu nuk po e përsërisim, por do të ishte me interes për shkencën historike sikur ato të studioheshin e të analizoheshin më hollësisht, për të nxjerrë në dritë fakte e përfundime të reja në bazë të traditës, e cila po zhduket, e në bazë të dokumenteve arkivore, të cilat duhen gjetur.

Sipas shënimeve të vitit 1905 Vranoci kishte asokohe vetëm 14 shtëpi, të gjitha shqiptare. Në vitin 1971 janë regjistruar në këtë fshat 42 shtëpi më 618 banorë, nga të cilët 616 shqiptarë e 2 „të tjerë". Sipas këtyre të dhënave del se numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve ishte jashtëzakonisht i madh — 14,5. Kjo tregon se familjet e Vranocit ishin të mëdha, familje patriarkale, ndër të cilat kishte edhe asosh me 20 e 30 pjesëtarë. Që nga viti 1950 e deri më 1971 mesatarja e pjesëtarëve të familjes është rritur shumë. Më 1950, sipas statistikës së Këshillit të vendit Baran, Vranoci kishte 39 shtëpi, nga të cilat 37 shqiptare e 2 malazeze. Atëherë mesatarja e pjesëtarëve të familjes arrinte gati 11 për çdo familje (përkatësisht 10,7). Para lufte në Vranoc kishte më shumë familje të mëdha („shpi të mëdha"), ndër të cilat dallohej ajo e Adem Bajraktarit, me 50 pjesëtarë. Tash (1980) familje të tilla nuk ka më, por nuk janë të rralla ato me 15 e 20 pjesëtarë. Kështu Mon Ademi ka 20 pjesëtarë, Daut Hasani 35 etj. Më 1981 Vranoci ka pasur 753 banorë (të gjithë shqiptarë) me 66 familje. Para lufte kanë qenë këtu 2 familje koloniste.

Të gjitha familjet e fshatit janë të fisit Krasniqe, dhe ndahen në këto mëhallë: Bajraktaraj (15 shtëpi), Baiqaj (30) e Sylregjaj (5). Nga mëhalla Sylregjaj janë edhe 3 shtëpi në Turjakë, nga Bajraktarajt është në Pejë 1 shtëpi, 1 në Prishtinë, 1 në Danillovgrad, 1 në Ivangrad e 1 në Njujork. Krasniqja e Vranocit ka prejardhjen nga Krasniqja e vendit, nga Geghyseni. Nga andej kanë ardhur, sipas traditës, para 300 vjetësh 3 kushëri: Mehmeti, Selimi e Demushi. Kjo mund të jetë e saktë, nëse e marrim edhe gjenealogjinë e familjeve të tashme si mbështetje për vërtetim të traditës, e cila në këtë zonë ende ruhet mirë. Kështu e tregon Mon Ademi gjenealogjinë (brezat) e familjes së tij: (i lindur më 1917) — Ademi — Rexha — Moni — Rrustemi — Bajrami — Rrustemi — Ibra — Mehmeti (ky ka ardhur nga Malësia) — Deda — Mrripa. Moni ka djem, nipa e mbesa. Pra, me Monin bëhen 3 breza, pas tij edhe 7 breza të tjerë. Nëse e marrim se 1 brez i përgjigjet periudhës 33 vjeçare, siç merret zakonisht në shkencë, deri te Mehmeti bëhën rreth 300 vjet. Tre kushërinjtë, të ardhur para 300 vjetësh, këtu kanë gjetur vetëm pyje e lluga, të cilat i kanë blerë nga agallarët e Pejës, dhe kanë filluar t'i hapin brez pas brezi për tokë buke.

Toponimet në terrenin e Vranocit më tepër kanë kuptim gjeografik: Lugu i Butajës, Lugu i Isufit, Lugu i Qelës, Lugu i Shabanit, Lugu i Dembelive, Lugu i Thive, Shpati i Rezës, Shpati i Hijes, Qafa e Llugave, Lluga e Madhe, Lluga e Bërzhenisë, Lluga e Malgatës, Kroni i Ahave, Kroni i Lejthisë, Rrihna (shpat), Birat e Dhelpnave, Shpijat e Reja (Shpijat e Naselenikve — kolonistëve), Kroni i Letikave (kënetave), Letikat (kënetat), Fusha e Thatë, Livadhet e Shabanit, Gllavica, Arat mbi Katund, Arat e Fetah agës, Zallinat, Rrahishtat, Ereniqet (ara), Arat e Zajmit, Kroni i Zajmit, Prroni i Xhamisë (xhaminë në Vranoc e kanë ndërtuar Bajraktarajt), Ufullaqe (livadhe), Kroni i Fushës së Thatë, Gurinat, Megjat, Ornicat, Qerpiqt (livadhe), Qerhanet, Qylnat, Kroni i Shekës, Kroni i Zajmit, Kroni i Knetave, Kroni i Bogoshevcit, Bunari i Gurinës, Lisi i Kajushës, Lisi i Bajrakut, Vorret e Janiçerëve, Ura e Sykës, Blinat (në kodër ku mblidhej katundi) etj.

Gjykuar sipas numrit të toponimeve, Vranoci duhet të jetë fshat relativisht i moçëm, sepse ky numër i madh toponimesh duhet të jetë shtresuar nga shumë breza. Disa nga këto tregojnë diçka edhe nga ngjarjet historike në këtë fshat, përkatësisht në këtë lug. I tillë është toponimi Vorret e Janiçerëve. Gjithashtu disa nga këta emra tregojnë se edhe ndonjë aga ka pasur aty pronë të tij, p.sh. toponimi Arat e Zajmit, Kroni i Zajmit etj.

Çellopeku. — Pozita gjeografike e Çellopekut dallohet nga ajo e Vranocit, sepse ky është një katund me shtëpi të larguara njëra nga tjetra, të cilat janë vendosur pjesërisht në rrafsh, e pjesërisht në shpat të kodrës. Në pjesën fushore të fshatit popullsia furnizohet me ujë nga puset, të cilat janë mjaft të cekta, 3-4 metra, kurse shtëpitë që janë në kodër furnizohen me ujë nga disa burime, të cilat shfrytëzohen edhe për ujitje, ose nga puset e thella.

Çellopeku përmendet në dokumentet mesjetare, më 1348, si pronë e qelisë Kare (Greqi).[100] Në shënimet e vitit 1905, ku ka të dhëna për vendbanimet e tjera të kësaj zone, nuk figuron ky katund. Statistika e Këshillit të vendit Baran për vitin 1950 shënon 55 shtëpi (familje) në Çellopek, nga të cilat 48 shqiptare e 7 malazeze. Sipas gjinisë popullsia kishte këtë strukturë: 234 meshkuj e 206 femra. Nga këto të dhëna shihet se familjet shqiptare kanë pasur mesatarisht nga 8,6 pjesëtarë, kurse familjet malazeze 3,1. Më 1971, në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë, Çellopeku

[100] Stojan Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjeg veka*, Beograd, 1912, 470.

kishte 78 shtëpi me 676 banorë (665 shqiptarë, 7 serbë e 4 malazezë). Nga kjo shihet se, në krahasim me vitin 1950, numri i serbëve e malazezëve është përgjysmuar deri në vitin 1971, sepse kanë migruar në Serbi, ose në qytet, meqenëse kodrat ku e kanë pasur ata tokën si kolonistë, i ka blerë Kombinati bujqësor i Pejës. Nga këto të dhëna shihet se mesatarja e pjesëtarëve të familjeve është rritur në krahasim me atë që ka qenë para 20 vjetësh Në familjet shqiptare, në vitin 1971, mesatarja kapte 9 pjesëtarë, kurse në familjet serbe e malazeze 3,6. Kjo është rezultat i rritjes së përgjithshme të popullsisë për 242 vetë, përkatësisht për rreth 50%, si edhe për arsye të emigrimit të familjeve malazeze, të cilat zakonisht kanë pak pjesëtarë. Më 1981 Çellopeku kishte 89 familje me 872 banorë (867 shqiptarë e 5 serbë).

Shumica e familjeve në Çellopek janë të fisit Berishë (rreth 30 shtëpi), pastaj Krasniqe (15), Kelmend (12), Thaç (5), Gash (3), Shalë (5) etj. Sipas traditës, këtu janë më të vjetër Kelmendët. Ata kanë prejardhjen nga Rozhaja. Kelmendët më parë kanë jetuar në Rugovë, në Rekë të Allagës dhe prej këndej janë shpërngulur në Rozhajë. Ata duhet të kenë ardhur nga Rozhaja në Çellopek, sipas traditës, para nja 200 vjetësh. Kjo përputhet edhe me brezat që i numërojnë këtu pleqtë. Kështu, gjenealogjia e Hasan Zeqës (1915) e çon këtë kohë në brezin e tetë të të parëve të tij: Rushja (mbesa e Hasanit, 9 vjeçe) — Kameri (djali i tij i lindur më 1951) — Hasani — Zeqa — Brahimi — Murseli — Uka — Memija. Dyndja e tyre për në Çellopek lidhet me emrin e Memijës. Krasniqja ndahet në Dervishahmetaj e Radunë, të cilët kanë ardhur nga Drenica. I pari i tyre ka jetuar atje në fshatin Sanoc të Drenicës, ku, sipas traditës, është martuar me një grua të quajtur Radunë. Një kohë fshati e ka quajtur këtë familje Radunë. Dervishahmetaj kanë ardhur nga Irzniqi. Krasniqja më parë ka jetuar në Nepole, shkokët e fisit i kanë në Sanoc e në Mrasor në Podrime. Berisha ndahet në Kuq dhe Aliçkaj. Kuqët janë të ardhur nga Broja e Drenicës, kurse Aliçkajt nga Deçani. Broja në Drenicë, si e thamë më parë, ka qenë e Bajraktarëve të Vranocit. Ndoshta migrimi i Kuqve ka lidhje me këtë fakt. Tradita thotë se disa familje të Berishës janë këtu gjithashtu të vjetra, (p.sh. Manollajtë). Nga ky fis janë disa familje Alshiqe, të ardhura nga Prekorupa (Llapusha), pastaj disa të tjera janë Bricor, i pari i tyre ka ardhur nga fshati Bricor i Malësisë, më parë në Baran e pastaj në Çellopek, në mëhallën Kamenicë. Gashjanët kanë ardhur nga Lumbardhi në Çellopek, ku janë ndarë pas një kohe dhe një pjesë e tyre është vendosur në Kosuriq. Gashi ndahet në Tredhakë e Grabocaj. Këta të fundit janë të ardhur nga fshati Graboc. Thaçi e ka prejardhjen nga Gërgoci i Dushkajës. Shala janë të ardhur nga fshatra të ndryshme të rrethinave. Përveç 3 familjeve serbe e malazeze (Çejoviq, Lumoviq, Jovanoviq), janë edhe 2—3 familje jevge, por ato flasin shqip dhe deklarohen si Shaljanë. Këto familje nuk janë shumë stabile, sepse migrojnë herëpasherë, zakonisht në qytet, ose në ndonjë fshat më afër, ku gjejnë mundësi më të mira për jetesë.

Çellopeku ndahet në 3 mëhallë: Mahalla e Poshtme, Aliçkaj dhe Kamenicë. Në mëhallën Aliçkaj jetojnë nja 20 shtëpi Berishë, në mehallën Kamenicë jetojnë Berishë e Krasniqe, kurse në Mahallën e Poshtme familjet u takojnë fiseve të ndryshme, të cilat i përmendëm më sipër. Tani, me ndarjen e familjeve, ndërtohen shtëpi të reja ndërmjet mëhallave, kështu që ndarja hapësinore e tyre vjen duke u zvogëluar.

Një pjesë e madhe e terrenit të Çellopekut është e mbuluar me pyje të vogla, ku dikur ka pasur drunj të rritur dhe kullota të mira. Rreth tyre Çellopeku e Barani kanë pasur në të kaluarën shumë kohë ngatërresa të mëdha, madje edhe përleshje të përgjakshme. Me një rast të tillë Baranit i ka ardhur në ndihmë fisi Gash nga disa fshatra të tjera, ndërsa Çellopekut Berisha e Lugut të Baranit e Kelmendi nga Rugova. Tri javë ditë kanë luftuar nga kullat. Për Çellopekun pylli ka qenë burim i rëndësishëm i jetës ekonomike. Fshatarët kanë shitur dru dhe kanë mbajtur shumë bagëti, se kushtet për kullotje të saj kanë qenë shumë të mira. Tani rëndësia e dikurshme e këtyre pyjeve gati ka humbur fare. Një pjesë është bërë tokë pjellore, kurse pjesa tjetër është me drunj të vegjël, me kaçuba etj., kështu që fshati është orientuar krejtësisht në bujqësi.


Toponimet e terrenit të Çellopekut më shumë i referohen zonës kodrinore, pyjore, ku ka, si zakonisht kudo, shumë lugje, kodra etj., si p.sh. — Lugu i Ahit, Lugu i Zaberdanit, Lugu i Kallabjakut, Lugu i Vneshtit, Zabeli i Hajratit, Kroni i Makreshit. Të gjitha këto toponime tregojnë vende e objekte në kodrat e pyjet e fshatit, kurse në zonën fushore të tij, në anën kah perëndimi, janë këto toponime: Behaxha (livadhe e ara), Fusha e Madhe, Ledinat, Arat e Mëdha, Petusha, Rrahije, Gajnoce etj.

Tokën e shfrytëzojnë fshatarët për prodhimin e drithit, si të gjithë fshatarët e tjerë të kësaj zone. Mirëpo në Çellopek i kushtojnë kujdes të posaçëm kultivimit të perimeve, sidomos të specave e patateve, të cilët i prodhojnë edhe për treg me shumicë.

Toka në kohën e sundimit turk ka qenë e agallarëve të Pejës. Një pjesë të saj e ka pasur njëfarë Nezir aga nga Peja, të cilën ua ka shitur fshatarëve. Duket se pjesa jopjellore e këtij terreni, kodrat me pyje, nuk kanë qenë pronë e bejlerëve, sepse nga ato nuk kanë pasur ndonjë lëvërdi ekonomike, kështu që ato i kanë ndarë fshatarët mes tyre qysh me kohë. Në kohën e Jugosllavisë borgjeze, Çellopekut iu muar toka nga qeveria („agrari") dhe u sollën aty shumë familje kolonistësh. Më 1933 rreth 30 familje të tilla qeveria i vendos në shtëpi të reja, të cilat i pat ndërtuar ajo në kodër e shpate, pranë Çellopekut. Kolonistët ishin nga Mali i Zi. Tash nuk ka në terrenin e Çellopekut asnjë familje të tillë, sepse shumica e tyre nuk janë kthyer fare pas lufte, kurse edhe ato familje që u kthyen, pas një kohe e shitën tokën dhe Kombinati bujqësor i Pejës ka mbjellë aty grurë, thekër etj., kurse një pjesë e këtyre sipërfaqeve është shtetëzuar për nevoja të ekonomisë shoqërore.

Fshatarët në përgjithësi kanë pak tokë buke. Nga se familjet e tyre janë mjaft të mëdha e të gjithë jetojnë vetëm nga bujqësia,

gjendja e përgjithshme ekonomike e Çellopekut është mjaft e dobët. Kjo gjendje është vështirësuar nga fakti se fshatari nuk ka as bagëti sa duhet, e cila, si e thamë, dikur ka qenë degë kryesore ekonomike e tyre. Të shtrënguar nga gjendja e tillë shumë fshatarë kanë marrë rrugën e mërgimit të përkohëshëm në botën e jeshtme, nga u dërgojnë familjeve të tyre ndihmë, pa të cilën shkalla ekonomike e tyre do të ishte edhe më e ulët se ç'është tash.



Arat e grurit në pronat shoqërore

Nga produktet bujqësore vetëm me speca mund të fitojnë fshati pak të holla, se prodhimet e tjera nuk mjaftojnë shpeshherë as për plotësimin e nevojave familjare. Madje, shumë familje janë të shtrënguara ta blejnë edhe bukën, sidomos nëse verës kushtet klimatike nuk janë të favorshme për bimët bujqësore.

Kosuriqi. — Pas Kryshecit Kosuriqi është fshati më i madh në Lug të Baranit. Shtëpitë e fshatit janë rrëzë kodrës dhe në fushë. Përveç disa shtëpive të jevgjve që janë të veçuara, të tjerat janë të grumbulluara, kështu që formojnë një vendbanim të tipit të dendur. Kosuriqi është i pasur me ujë. Në fushë ka shumë „kajnaqe" (burime) e nëpër fshat kalon jazi, i cili vjen nga Bistrica. Çdo shtëpi e ka pusin në oborr, i cili zakonisht shkon deri në 4 metra thellësi. Përroi i Behocit, kur vërshon, bën dëme të mëdha në fushë, sepse sjell shumë zhavor e gurë në ara e livadhe dhe përveç kësaj, i mbush burimet të cilat shfrytëzohen për ujitje.

Kosuriqi përmendet në dokumentat e shekullit XIV. Mbreti Stefan Deçanski më 1327 me një dokument merr vendimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet igumanit të Hilandarit (Greqi) dhe fshatit Kosuriq në lidhje me mezhdat e pronave të Hilandarit në këto anë. Për të vërtetuar kufijt ndërmjet këtij fsha-

ti e pronave të manastirit Hilandar, janë caktuar pleqtë të cilët, „të ngarkuar me betim të madh", e caktojnë kufirin e vërtetë. Më vonë, mbreti Dushan Nemanjiq, me rastin e vizitës së tij në Malin e Shenjtë (Greqi), ia fal qelisë së Karesë, ndër të tjerat edhe „fshatin Kosuriq me mëhallët Nepole, Dolan (Gilogjan) Çeskovë, Çellopek", me tokë e vreshta, me mullinj e kopshte, me livadhe, kullota, llaze e bjeshkë dhe me të gjitha të drejtat e atij fshati. Në këtë dokument thuhet pastaj se të gjitha detyrimet të cilat këto katunde i kishin ndaj shtetit, tani e tutje duhet t'ia japin qelisë së Sveti Savës në Kare.[101]

Pra, si shihet nga ky dokument, fshatrat e Lugut të Baranit në këtë kohë nuk kanë qenë pronë e manastirit të Deçanit, por të manastirit Hilandar në Greqi, të paktën për një kohë, kur kanë pasur qelinë e tyre, pirgun, ose kapelën, edhe disa sundimtarë të tjerë mesjetarë. Madje, edhe Skenderbeu e ka pasur një pirg (kullë) të tillë në këtë manastir, i cili ka qenë i njohur në botë si vlerë e madhe kulturore e asaj kohe.

Kosuriqi duhet të ketë qenë fshat me rëndësi, vendbanim qendror në këtë zonë, sepse Nepolja, Gllogjani, Çellopeku e Çeskova përmenden në dokumentin mesjetar vetëm si pjesë të tij, si mëhallë, megjithëse këto vendbanime nuk janë aq afër tij për t'i konsideruar si të tilla. Në terrenin e Kosuriqit nuk është zbuluar, ose nuk është kërkuar, ndonjë objekt arkeologjik, i cili do ta vërtetonte lashtësinë e tij si vendbanim. Por s'ka dyshim se ai duhet të ketë ekzistuar edhe shumë kohë para shekullit XIV, kur përmendet si vendbanim i rëndësishëm.

Më vonë, në defterin turk të vitit 1485, për Kosuriqin ka të dhëna më të plota. Ai atëherë ishte „ziamet" i Deçanit që varej nga Peja, nën zotërimin e Hasan beut, i cili e kryente shërbimin ushtarak në Shkodër. Në defter Kosuriq figuron si vendbanim jo i vogël për kushtet e asaj kohe, sepse kishte 47 shtëpi (kryefamiljarë). Defteri në fjalë i shënon këtu edhe 12 beqarë e 2 të veja. Popullsia e fshatit paraqitet me emra sllavë dhe me emra të përzier sllavë e shqiptarë. Kështu p.sh. Kragui është i biri i Prenkut, Nikolla e Dimitri janë të bijtë e Gjushenit etj. Në bazë të antroponimeve të shënuara në defter mund të konkludohet se popullsia e Kosuriqit ishte e krishterë — sllave e shqiptare. Raporti numerik mes tyre vështirë mund të vërtetohet në bazë të emrave vetiakë të njerëzve, për arsyet të cilat i kemi shqyrtuar më parë në këtë punim. Por me interes të posaçëm është fakti se qysh atëherë (1485) në Kosuriq ka pasur edhe popullsi myslimane, sepse, përveç kryefamiljarëve kristianë, defteri konstaton edhe 3 kryefamiljarë myslimanë: Ismailin, Iskenderin dhe Jonuzin. Gjykuar sipas procesit të islamizimit të popullsisë në Kosovë, mund të themi se dhe këto familje myslimane ishin shqiptare, por ka pasë raste të islamizimit edhe të familjeve serbe e vllehe.

Gjendja ekonomike e Kosuriqit, sipas detyrimeve që i kishte ndaj shtetit, duket se nuk duhet të ketë qenë e keqe. Fshati ngarkohej për të dorëzuar 39 barrë grurë, 19 barrë thekër, 7 barrë

[101] *Po aty*, 397, 470, 471.

tagji, 10 barrë mel dhe me taksa të ndryshme për perime, barë, bletë, dru etj. Kështu p.sh., taksa e barit ishte 210 ispenxhe, e druve 84, e bletëve 25, musht 44 subur, taksa e govatës 70, e perimeve 80, vreshta 15 subur, taksa e derrave 26 (ispenxhe) etj.[102]

Sipas shënimeve të gjeografit J. Cvijiq, Kosuriq kishte në fillim të shekullit XX vetëm 20 shtëpi. Duket se numri i familjeve me këtë rast është dhënë pa u përpjekur që të shënohen aq sa janë, por ashtu me hamendje. Mund të jetë që kjo është bërë me qëllim, sepse dihen koncepcionet dhe qëndrimet e Cvijiqit ndaj shqiptarëve. Meqenëse më 1905 edhe ai vetë shënon se të gjitha familjet e Lugut të Baranit janë shqiptare, gjë që, pa dyshim, s'do t'i ketë pëlqyer aspak, Cvijiqi përpiqet ta zvogëlojë numrin e tyre, të paktën në botimet e veta. Nja 420 vjet para shënimeve të Cvijiqit, (më 1485) Kosuriqi kishte 47 shtëpi, kështu që duket e pabesueshme të ketë pasur gati dy herë e gjysmë më pak pas një periudhe kaq të gjatë, kur zakonisht numri i shtëpive, përkatësisht i banorëve, shumëfishohet, megjithëse mund të ngjajë edhe e kundërta.

Me rastin e regjistrimit të popullsisë, më 1971, në Kosuriq ishte konstatuar kjo gjendje: 109 shtëpi dhe 1012 banorë, nga të cilët 919 shqiptarë, 84 malazezë, 7 serbë e 2 „të tjerë". Sipas të dhënave zyrtare të këshillit të vendit Gllogjan, Kosuriqi kishte më 1950 gjithsejt 92 shtëpi (63 shqiptare, 28 malazeze e 1 serbe) dhe 767 banorë, nga të cilët 617 shqiptarë, 3 serbë 81 malazezë këta kanë qenë kolonistë të paraluftës). Sipas të dhënave të mbledhura në terren (në 1980), Kosuriqi duhet të ketë rreth 150 shtëpi. Në këtë fshat ka pasur shumë familje të mëdha patriarkale, të cilat pas lufte kanë filluar të ndahen, dhe kështu numri i shtëpive (familjeve) rritet shpejt. Të dhënat statistikore, të cilat i shënuam më sipër, na mundësojnë të nxjerrim mesataren e pjesëtarëve të familjeve. Kështu, mesatarja e përgjithshme arrinte 8,3 për çdo familje. Mirëpo, nëse e shqyrtojmë këtë gjendje veçmas për çdo kombësi, konstatojmë se çdo familje shqiptare ka pasur mesatarisht 9,8 pjesëtarë, kurse kjo mesatare në familjet serbe e malazeze ishte vetëm 2,8 pjesëtarë. Ndër familjet e mëdha përmendej qysh para lufte „shpija e madhe" Panxhaj, një pjesë e të cilës jetonte në Voksh të Madh, si e thamë më parë. Kosuriqi më 1981 kishte 120 familje me 1162 banorë (1108 shqiptarë, 49 malazezë dhe 5 myslimanë.

Kosuriqi ndahet në mëhallën e Epërme e në mëhallën e Poshtme. Në katund janë këto fise: Kelmend (rreth 30 familje), Gash (50), Thaç (25), Berishë (15), Krasniqe (10), Shalë (10) dhe 5—6 familje jevgj. Gashi ndahet në vëllazëri: Mąznikollë, të ardhur nga Mazniku i Gjakovës, Shllak, nga Sllaku i Shkodrës, Aliçkaj, të ardhur nga Irzniqi (afër Deçanit), Dezdarë, të ardhur nga Lumbardhi, Tredhakë, të ardhur nga fshati Pauçinë i rretheve të Rozhajës. Këtë mbiemër, e kanë marrë sipas mjeshtërisë që e bënin si blegtorë. Në Sanxhak ekziston fshati Pauçinë, banorët e të cilit

[102] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 211, 212.

ende flasin shqip. Shumë familje nga Pauçina janë vendosur në Lumbardh, e nga këndej janë shpërndarë nëpër fshatra të tjera. Kelmendi këtu ndahet në: Hoxhaj (të ardhur nga fshati Drelaj në Rugovë), Sylaj, nga Nokshiqi i Plavës, Shkrel, nga fshati Shkrel (Rugovë), Rugova, nga Pepiqi i Rugovës, Bekhalilaj, nga Dugajeva e Rugovës, Tiganët, nga Rozhaja, Pashiqët, nga Bisheva e rretheve të Ivangradit (Beranë). Këta janë vëllazëri me Pashiqët e Rastokës, buzë Drinit të Bardhë. Thaçi ndahet në: Gërgoc, të ardhur nga Gërgoci i Dushkajës, Panxhaj, me prejardhje më të largët janë nga Vokshi, prej nga kanë ardhur më parë në Rashiq, pastaj në Çellopek e më në fund janë vendosur në Kosuriq. Berisha ndahet në: Stanojë, me prejardhje të largët nga Kuqi i Malit të Zi (këta i kanë shokët e afërm në Grabanicë të Lugut të Leshanit), Deskaj, të ardhur nga Joshanica e Klinës, i kanë shokët në Gllogjan, Dodaj, të ardhur nga Kralani, Danaj, me prejardhje nga Jabllanica e Dushkajës. Krasniqja ndahet në: Nikaj, të ardhur nga Llozhani, Gugjaj, nuk u dihet prejardhja sepse janë të vjetër këtu në Kosuriq. Shalë janë Tekajt, të ardhur nga Irzniqi. Jevgjit e Kosuriqit janë Morinë e Krasniqe.

Fiset e Kosuriqit e shfrytëzojnë verës bjeshkën e krahinës nga kanë prejardhjen (bjeshkën e Lumbardhit, të Vokshit e të Rugovës). Rugovasit para se të vendoseshin në Kosuriq vinin dimrit për të dimëruar këtu me grigjet e veta, sepse në bjeshkë nuk kishin mjaft ushqim për to. Ata blejnë ngapak tokë dhe dikur zbresin si banorë të përhershëm në Kosuriq.

Kosuriqi, si thamë më parë, duhet të ketë qenë njëfarë qendre më e rëndësishme se fshatrat e tjera perreth tij, disa nga të cilat kanë qenë një lloj lagjeje të këtij vendbanimi, si shihet nga dokumenti i vitit 1327, të cilin e përmendëm këtu më lart. Edhe para Luftës së Dytë Botërore Kosuriqi kishte mejtep, një lloj shkolle fetare, pastaj shitore, mbathtar dhe disa fshatarë merreshin me mjeshtëri të ndryshme në fshat, sidomos pas sezonit të punëve bujqësore. Pas luftës këtu kishte shkollë fillore, më parë në ndërtesën e vogël të mejtepit të dikurshëm, e më vonë në një lokal tjetër, por jo shumë më të mirë.

Toponimet e fushës së Kosuriqit u ngjajnë atyre të disa fshatrave të tjera. Kështu, edhe këtu janë: Arat e Epërme, Livadhet e Poshtme, Seishtat (ose Sojishtat), Rrahijet, pastaj — Dallama (ara), Tulezhe (ara e livadhe), Grykat (ara), Gurinat, Tëthorat (ara), Lugu i Bungave, Letikat, Lugu i Currit (tradita e lidhë këtë me Bajram Currin), Lugu i Gashit, Lugu i Vorreve, Lugu i Thanave, Lugu i Gjonit, Lugu i Çellopekut, Lugu i Tamnikut (i Tomë Nikut?), Lugu i Smajlit, Lugu i Saricave, Rruga e Porogonëve (ara), Lenishta, Prokoshnica, Otava, Shavarina, Guri i Alisë, Arat e Kronit, Kodra e Tupanit, Drezgat etj. Qeveria e Jugosllavisë borgjeze ia pat vënë emrin Kosuriqit Aleksandrovac, por nuk ia doli.

Toka e Kosuriqit ka mjaft lagështi, prandaj nëpër ara del shumë barë dhe e pengon kultivimin, përkatësisht rritjen e grurit e të panxharsheqerit. Prandaj fshatarët, përveç misrit, mbjellin shumë perime, sidomos lakra e speca. Toka ka qenë e Begollëve të Pejës. Fshatarët një kohë ishin çifçinj, por më vonë shumica e

blenë tokën nga pronarët feudalë. Edhe fshatarëve të Kosuriqit gjatë kohës së Jugosllavisë borgjeze „agrari" ua kishte marrë tokën (në emër të ashtuquajturës reformë agrare, qeveria ua merrte tokën fshatarëve të varfër shqiptarë dhe ua jepëte „naselenikëve" d.m.th. kolonistëve).

Fshatarët në përgjithësi këtu kanë pak tokë. Madje, Kosuriqi as pyll nuk ka, se kodrat janë bërë ara të Kombinatit bujqësor të Pejës. Ky fshat i madh ka pak njerëz të shkolluar, kështu që struktura sociale e popullsisë është gati thjeshtë bujqësore.

Buqani. — Ky fshat gjendet buzë Bistricës, e cila këtu rrjedh rrëzë kodrës që shtrihet në anën e djathtë të saj. Buqani është fshat fushor nga aspekti i pozitës së tij gjeografike, i tipit të dendur, sepse shtëpitë janë të grumbulluara në një vend, në një hapësirë të vogël. Buqani ka mjaft ujë për fusha, meqenëse ndodhet pranë lumit, kurse për pije shfrytëzohen puset, të cilat janë mjaft të cekta, rreth 5 metra mesatarisht. Përveç ujit të Bistricës, fshatarët i shfrytëzojnë për ujitje edhe 5—6 burime, të cilat ndodhen në terren të katundit. Në anën e djathtë të Bistricës së Deçanit shtrihet një pyll (bungishtë) i cili është pronë e Buqanit.

Në defterin turk të vitit 1485 figurojnë dy vendbanime me emrin Buqan — Buqani i Epërm e Buqani i Poshtëm. Të dyjat vareshin nga Peja.[103] Sipas këtij defteri, Buqani i Epërm në atë kohë kishte 20 kryefamiljarë (shtëpi), 9 beqarë e 1 të vejë. Emrat vetiakë të banorëve të këtij fshati janë sllavë, pastaj disa të përzier — sllavë e shqiptarë e disa të tjerë emra shqiptarë. Kjo tregon se banorët e Buqanit të Epërm ishin të përzier nga aspekti i përkatësisë kombëtare — sllavë e shqiptarë. Mirëpo, këtu figuron një numër relativisht i madh i kryefamiljarëve me emra shqiptarë: Gjonji, i biri i Miomanit (që do të thotë se edhe Miomani ka pasur një perkatësi etnike me Gjonin), Nenko, i biri i Lalës (ky emër Nenko përmendet në disa raste në defter në lidhje direkte gjinie gjaku me njerëz që mbajnë emër thjesht shqiptar), Gropani, i biri i Lleshit, Gropani, i biri i Rajkos (d.m.th. nëse Gropani është emër shqiptar me të cilin emërtohet personi i kësaj kombësie, gjë që nuk mund të vihet në dyshim, sepse është emër kuptimor, e përveç kësaj Gropani është i biri i Lleshit, —, atëherë edhe Rajko duhet të jetë njeri i kësaj kombësie, sepse ai është prind i Gropanit), pastaj — Nikolla, i biri i Radiçit, Radiçi, i biri i Bogosavit (në Buqan të Poshtëm), Petri, i biri i Prebilit etj. Për emrin Radiç folëm më sipër, gjithashtu edhe për Prebilin, i cili edhe në Baran paraqitet disa herë, madje edhe si i biri i Gjonit. Edhe në regjistrin e kryefamiljarëve të Buqanit emrat mbarojnë me **i, u, it ut, os** etj., si edhe në të gjitha fshatrat e tjera, jo vetëm në Lug të Baranit, por në mbarë Sanxhakun e Shkodrës, territori i të cilit përfshihet në defterin turk të shekullit XV.

Buqani i Poshtëm, sipas defterit në fjalë, ka qenë më i vogël se Buqani i Epërm, sepse ky numronte vetëm 13 kryefamiljarë

[103] *Po aty*, 183, 184, 276, 277.

(shtëpi), 9 beqarë e 1 grua e vejë. Pra, nëse e marrim si një vendbanim, Buqani kishte gjithsej 33 familje para pesëqind vjetësh.

Defteri turk tregon edhe detyrimet materiale të Buqanit ndaj shtetit, siç i tregon edhe për fshatrat e tjera. Buqani i Epërm ishte i detyruar të dorëzonte: 18 barrë grurë, 8 barrë thekër, 6 barrë tagji e 1 barrë mel, pastaj 15 barrë kumbulla, 1 barrë arra, 14 barrë gështenja, musht 22 subur dhe taksa me të holla për perime 34 ispenxhe, për barë 200, për spinaq 4, për dru 40, për derra 40, për lin 30, ispenxhe 481. Buqani i Poshtëm ishte më pak i ngarkuar me këto detyrime, madje më pak se gjysmën e sasisë së disa prodhimeve kishte për të dorëzuar, përkatësisht për të paguar vlerën e tyre. Ky fshat, ose lagje, ngarkohej me 6 barrë grurë, 3 barrë thekër, 8 barrë tagji, 2 barrë mel, 5 barrë gështenja, taksa e govatës 50, e perimeve 20, e dhjeta e barit 26, taksa e spinaqit 6, taksa e bletëve 15, e dhjeta e lirit 14, kumbulla 15 deng, taksa e derrave 9, ispenxhe 556. Këtu bie në sy një detyrim i Buqanit, të cilin nuk e kishin fshatrat e tjera të kësaj zone, d.m.th. dorëzimi i gështenjave (Buqani i Epërm 14 e Buqani i Poshtëm 5 barrë). Në lug të Baranit nuk ka gështenja. Pyjet e gështenjave të buta shtrihen rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, që nga Strellci e deri në Junik. Ndoshta para 500 vjetësh ka pasur edhe në Lug të Baranit ndonjë pyll gështenjash, por në atë rast do të ngarkoheshin me dorëzimin e gështenjave edhe fshatrat e tjera. Mund të jetë që Buqani të ketë pasur pjesën e tij në pyjet e gështenjave rrëzë bjeshkëve, ku e kanë shumë fshatra të tjera. Gjethsesi kjo çështje mbetet enigmatike.

Kah fillimi i shekullit XX Buqani (i cili vetëm në defterin turk figuron si dy vendbanime) kishte vetëm 10 shtëpi, nëse mund t'u besohet të dhënave të J. Cvijiqit, të cilat disa herë i vumë në dyshim. Sipas të dhënave të Këshillit të vendit Gllogjan të vitit 1950, Buqani kishte 40 shtëpi me 312 banorë, të gjithë të kombësisë shqiptare. Mesatarja e pjesëtarëve të familjes arrinte 7,8. Në vitin 1971 ky fshat kishte gjithashtu 40 shtëpi (familje), por 418 banorë, të gjithë shqiptarë. Pra, brenda 20 vjetëve numri absolut i banorëve është shtuar për 106 vetë, d.m.th. për 33 promil, ose për një të tretën. Mesatarja e pjesëtarëve të familjes brenda kësaj periudhe gjithashtu është rritur shumë, sepse më 1971 çdo familje kishte mesatarisht nga 10,4 pjesëtarë. Me 1981 Buqani kishte 37 familje 595 banorë (të gjithë shqiptarë), pra, mesatarisht çdo familje nga 16 pjesëtarë.

Popullsia e Buqanit përbëhet nga disa fise, por numri më i madh i familjeve janë Gash (rreth 30 shtëpi), pastaj Berishë (7), Krasniqe (2). Gashi ndahet në dy barqe: në Stojk dhe në Boshtrak. Boshtrakët kanë ardhur në Buqan nga Deçani, kurse Stojkët nga Kralani (dy fshatra afër Buqanit). Stojkët e kanë prejardhjen nga fshati Pauçina, ndërmjet Rozhajës e Bellopojës në Mal të Zi. Të parët e tyre kanë ardhur vetëm si një shtëpi (1 familje), e tash janë rreth 25. Berisha e Krasniqja kanë ardhur këtu nga fshatrat e rretheve, nga nahija e Pejës dhe e Gjakovës. Për prejardhjen e Stojkëve ka tregime e supozime të ndryshme. Për këtë folëm edhe

më parë në këtë punim. Sipas një versioni, i pari i Stojkëve duhet të ketë qenë sllav. Ata që mendojnë kështu nuk kanë kurrfarë faktesh, përveç emrit të kësaj familjeje. Por, për emrat sllavë thamë dhe e shpjeguam disa herë se në bazë të tyre në dokumentet e ndryshme të mesjetës e më vonë, nuk mund të vërtetohet edhe përkatësia etnike, sepse shqiptarët në shumë e shumë raste kanë pasur emra sllavë, madje emra të tillë kanë edhe sot e kësaj dite shqiptarët ortodoksë e katolikë. Në qoftë se për vërtetimin e përkatësisë kombëtare bazohemi sot vetëm në emra të njerëzve, atëherë edhe për shqiptarët e sotëm mund të themi se janë të kombësisë arabe, greke sllave, italiane, franceze etj., sepse të gjithë myslimanët shqiptarë (përveç brezit të ri) kanë emra arabë, shqiptarët ortodoksë — grekë e sllavë, kurse shqiptarët katolikë — italianë, francezë etj. — e jo emra shqiptarë (siç janë p.sh. Agim, Afrim, Gazmend, Bujar, Shpresë, Dritë, Krenare, Mirushe etj.). Pra, nuk mund të thuhet me siguri se Stojku, Rajku Raduni, Stepani etj., të cilët përmenden para 500 vjetësh në këtë trevë, nuk kanë qenë shqiptarë, ashtu si nuk mund të themi këtë sot për shqiptarin që e ka emrin Adem, Ajvaz, Abaz, Musli, Mark, Martin, Kristë, Kristaq, Vuksan, Gjurë, Ksenofon etj. Emri jo vetëm që s'e bën njeriun njeri, por ai ndër shqiptarë as nuk e tregon përkatësinë e tyre kombëtare (prapë po themi — përveç brezit të ri, i cili tash vonë ka filluar të quhet ashtu si duhet — me emra kombëtarë kuptimorë).[104] Kushtet historike ua kanë imponuar shqiptarëve fenë e emrat e huaj dhe bashkë me ta edhe zgjedhën e robërisë. Edhe sikur Stojku të kishte qenë sllav, ai ka qenë një njeri, një familje — para disa shekujsh, kështu që edhe në këtë rast ajo ka humbur para sa e sa shekujsh, është asimiluar, kështu që Stojkët e Buqanit nuk mund të kenë as lidhjen me të vogël etnike me të. Këtë e theksuam këtu edhe një herë, sepse edhe sot ka autorë që bëjnë spekulime të ndryshme me onomastikën e dokumenteve mesjetare, për të „vërtetuar" prejardhjen e kësaj ose asaj familje, madje edhe përkatësinë e tyre kombëtare. Shumë më i madh dhe shumë më i qartë është procesi i kundërt, sllavizimi i popullsisë shqiptare gjatë mesjetës dhe më vonë në disa vise edhe jashtë Kosovës (Mali i Zi, Sanxhaku, Maqedonia perëndimore etj.), ose turqizimi i disa familjeve në disa qytete.

Në terrenin e Buqanit nuk ka shumë toponime. Ndoshta për shkak se gati i gjithë fshati përbëhët nga një fis, pra, ai është kompakt dhe familjet janë të afërta me gjini gjaku, kështu që edhe fusha e fshatit (llugat, kullotat etj.) janë të përbashkëta dhe nuk ka pasur nevojë të përcaktohen pjesët e ndryshme të saj me emra të huaj. Nga ana tjetër fshati nuk ka pyje, kodra e lugje por vetëm fushën pranë Bistricës, me reliev uniform, të thjeshtë. Më shpesh këtu dëgjohen këto toponime: Gurinat, Ranishtat, Shavarinat, Arat e Gata, Maqare, Rrezinë (mal i Buqanit pertej Bistricës), Përbatina e Zeqë Ferizit etj.

[104] Mark Krasniqi, *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike*, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, 377—414.

Llugaxhia. — Llugaxhia përbëhët nga dy mëhallë: Llugaxhi e Ledinaxhi, të cilat tash janë dy fshatra të veçanta, sepse i ndan Bistrica e Deçanit dhe kështu u takojnë dy zonave të ndryshme etnografike — Llugaxhia e Lugut të Baranit e Ledinaxhia e Dushkajës. Por ndër gjenerata të vjetra emri Ledinaxhi shpeshherë përdoret për të dy fshatrat. Meqenëse këtu kemi në shqyrtim vendbanimet e Lugut të Baranit, duhet t'u përmbahemi kufijve të tij etno-gjeografikë dhe mos ta kalojmë Bistricën e Deçanit, se aty fillon Dushkaja.

Fshati shtrihet buzë Bistricës, e cila rrjedh rrëzë kodrës së Ledinaxhive. Shtëpitë e fshatit janë në fushë, e cila është e pasur me ujë. Në anën perëndimore të fshatit gjendet një burim i madh i quajtur Leskovik, kurse dy burime të tjera janë në fshat brenda. Nëpër Llugaxhi rrjedh përroi Kalinoc. Puse ka çdo shtëpi dhe ato janë të cekta, rreth 5 — metra.

Toka ka mjaft lagështi dhe cilësia e saj është e mirë. Më e përshtatshme është për livadhe e misër. Pjesa më e madhe e fushës përbëhet nga „ranishtat", kurse një pjesë është smonicë. Kultivohen perime e pemë, si në fshatrat e tjera fqinj. Toka ka qenë e bejlerëve. Fshatarët tregojnë se ata kanë qenë shumë të ashpër ndaj çifçinjve. Mjaftontë të ulej çifçiu në praninë e beut, për ta dëbuar ky nga toka.[105]

Duket se Llugaxhia është fshat i ri. Në dokumenta të cilët i kemi shfrytëzuar këtu nuk përmendet, madje as në shënimet e vitit 1905. Vetë emri i fshatit tregon se këtu duhet të kenë qenë lluga e një pjesë lëndina. Edhe tash fshati dhe mezhdat e fushave janë plot verra, shelqe, shelgjishtra (rakita) e drunj të tjerë.

Llugaxhia është fshat i vogël. Më 1950 kishte 19 shtëpi (18 shqiptare e 1 malazeze) me vetëm 169 banorë (166 shqiptarë e 3 malazezë). Mesatarja e pjesëtarëve të familjes ishte mjaft e madhe, 9 vetë për çdo shtëpi. Kjo mesatare del e zvogëluar në vitin 1971, kur çdo familje kishte mesatarisht nga 7 pjesëtarë. Kjo tregon se gjatë kësaj kohe, gjatë një periudhe 20 vjeçare, familja patriarkale ka filluar të ndahet dhe të formohen familje të vogla individuale. Më 1971 Llugaxhia kishte 226 banorë (215 shqiptarë e 11 malazezë), më 1981 — 272 banorë (të gjithë shqiptarë).

Popullsia e këtij fshati është homogjene nga aspekti i përkatësisë fisnore. Të gjitha familjet janë të fisit Berishë. Fisi ndahet këtu në 3 mëhallë: Rracaj (7 shtëpi), Vishaj (8) dhe Tetaj (5). Megjithëse të gjitha familjet, sidomos ato të një mëhalle, janë të një fisi dhe të afërme, ato nga aspekti fetar ndahen në myslimanë e katolikë. Rracajt janë myslimanë, Vishajt myslimanë e katolikë, Tetajt vetëm katolikë. Deri para pak vitesh këtu ka pasur edhe familje të përziera — myslimanë e katolikë, siç e thamë edhe më parë. Kështu, familja e Adem Tahirit përbëhej nga pjesëtarët e të dy besimeve. Tani vonë janë ndarë, por jo për shkaqe fetare. Kjo tregon tolerancën fetare, rolin që ka pasur fisi dhe ndikimin e vogël të kishës, përkatësisht të xhamisë në ndërgjegjen e fshatarit,

[105] Kallëzim i Sylë Sejdiut nga Llugaxhia.

megjithëse në disa fshatra të Lugut të Baranit ka hoxhë e xhami, e në Gllogjan prift e kishë. Afiniteti e solidariteti fisnor ka qenë shumë më i fortë se ai në bazë fetare, siç vërtetohet, jo vetëm nga rasti në fshatin Llugaxhi, por edhe me shumë raste të tjera në Lug të Baranit dhe në përgjithësi në viset e ndryshme ku është popullsia e përzier, ku jetojnë bashkë myslimanë e katolikë.

Sipas traditës, Rracajt prejardhjen e kanë nga rrethet e Pukës. Këtu ka ardhur i pari i tyre vetëm — një familje, para nja 300 vjetësh. Kjo kohë përputhet me brezat që i numërojnë të vjetrit nga Rracajt. Mëhalla Rracaj quhet edhe Mahalla e Epërme. Vishnjat e kanë prejardhjen nga fshati Dobërdol i Prekorupës (Llapushë). Tetajt kanë jetuar në Broliq, nga janë shpërngulur e janë vendosur në Potërç (Lugu i Leshanit) dhe më në fund kanë ardhur e janë stabilizuar në Llugaxhi. Në këtë fshat janë edhe 2—3 shtëpi Krasniqe dhe 1 familje malazeze (Vasojeviq) e cila ka ardhur këtu më 1932 dhe ka blerë tokë. Në anën e djathtë të Bistricës, në Ledinaxhi, janë 3—4 shtëpi Vishaj dhe 4—5 shtëpi romë. Në botën e jashtme ndodhen (më 1980) 15 vetë në punë të përkohshme. Fëmijët shkojnë në shkollë në Gllogjan. Deri tani (1980) shkollimin e lartë e kanë kryer për këto 35 vjet të pasluftës 3 vetë nga Llugaxhia.

Sipërfaqja e tokës së punueshme në Llugaxhi është e vogël, gjethsej 124 ha, nga të cilët 2/3 ara e 1/3 livadhe. Përveç kësaj, fshati ka në anën e djathtë të Bistricës „malin" (pyllin) në kodren Çokza. Çdo familje ka aty nga 2 ha pyll, por ky është i vogël — dushkajë (qarr e bung).

Megjithëse, me gjasë Llugaxhia nuk është shumë e vjetër, të paktën në krahasim me Kosuriqin e Nepolen që i ka afër, prapë në fushën e saj ka shumë toponime, madje të gjitha janë emra kuptimorë dhe i përgjigjen natyrës ose funksionit të objektit, i cili e mban toponimin përkatës. Ndër të tjerë janë edhe këto toponime: Llugat, Ronishta, Arat e Bistricës, Ara e Qershisë, Ara e Dardhës, Ara e Frashnit, Dallama (ara), Ara e Stanit, Nalloga (diga, presa) e Qershisë, Gurinat, Bostanishta, Nalloga e Gurinave, Kalinoci (përrua), Nalloga e Trokaçes (trokaçe — kambanë bagëtish), Ara e Adem Sadikut, Idhaqe (livadhe me barë të idhtë), Ara e Begit, Livadhi i Deli Ndout, Livadhet e Gata, Nalloga e Tulezhit. Në kodër përtej Bistricës gjendet Kodra e Vorreve, atje i kanë varret katolikët, myslimanët i kanë varret në fshat — në Ledinë të Tahir Begut, kurse Rracjat në Buqan). Në këtë kodër janë edhe toponimet Çokza, si e thamë, dhe Bajraki. Fjala „nallogë" është ndoshta sllave, por në Dukagjin përdoret shumë në lidhje me ujitjen e fushave dhe ka kuptimin e digës së vogël, presës, kthesës së ujit.

Sipas traditës, fshatarët nuk e kanë blerë shtrenjtë tokën nga bejlerët, megjithëse ajo është e cilësisë së mirë, sepse atëherë pjesa më e madhe ishte e mbuluar me pyje, kishte shumë lluga, si e tregon edhe toponomastika e stome. Nga kjo shihet gjithashtu se ujët e Bistricës shfrytëzohet në mënyrë intensive për ujitjen e fushave, sepse në toponiminë e këtij terreni janë edhe 3—4 „nalloga", që do të thotë diga të vogla, të cilat fshatarët i

ndërtojnë „katundisht" (të gjithë së bashku) me gardhe të ulëta, gurë, dhe, copa dërrasash etj. për ta kthyer Bistricën në jaz (kanal) të katundit, me të cilin ujiten fushat. Llugaxhia shtrihet mjaft larg rrugës së asfaltuar, kështu që dimrit dhe kur laget toka, e cila edhe ashtu ka shumë lagështi, lidhja me fshatrat e tjera vështirësohet.

Gllogjani. — Gllogjani ndodhet në shpat të kodres, e cila shtrihet përgjat anës së majtë të Lugut të Baranit. Një pjesë e fshatit është rrëzë kësaj kodre. Sipas pozitës gjeografike të tij, fshati ndahet në dy mëhallë: Mahalla e Epërme (në shpat) dhe Mahalla e Poshtme — në rrafsh. Mëhalla e Epërme ka pak ujë, përkatësisht furnizohet më vështirë me ujë të pishëm, sepse ai gjendët thellë, kështu që puset këtu shkojnë deri 18—20 metra. Në kodër është një burim, edhe në rrafsh një tjetër. As fusha nuk ka mjaft ujë, sepse një pjesë e saj shtrihet shumë mbi nivelin e Bistricës. Kështu një pjesë e tokës është pa vadë.

Gllogjani përmendet qysh në shekullin XV, bashkë me Kosuriqin, si „mëhallë" e tij, si vendbanim i vogël i veçuar në dekretin e car Dushanit me të cilin ai ia falë kishës së Karesë (Greqi), qelisë së Sveti Savës, siç e thamë më parë.[106] Në këtë dokument Gllogjani figuron si „Dollani", por meqenëse ai përmendet bashkë me Nepolen e Kosuriqin, duhet të jetë fjala vetëm për Gllogjanin, i cili në atë kohë mund të quhej Dolani, ose mund të jetë shënuar gabim në dokumentin në fjalë.

Këtë fshat e gjejmë më vonë edhe në defterin turk të vitit 1485. Por edhe në këtë dokument emri i Gllogjanit ndryshon pak nga ky i sotmi, sepse aty figuron si Gllogjan i Epërm. Megjithatë, nuk ka kurrfarë dyshimi se dokumenti turk bën fjalë mu për Gllogjanin, për një vendbanim që ekziston edhe sot aty ku ka qenë para 500 vjetësh, dhe më parë. Gllogjani varej nga Peja dhe ishte timar i Mustafait, të birit të Jahjasë.[107] Sipas defterit në fjalë, Gllogjani kishte 33 shtëpi, 3 beqarë 2 të veja dhe paguante 962 ispenxhe, 20 barrë grurë, 20 barrë thekër, 30 barrë elb, 10 barrë mel, musht 20 suburë dhe taksa të ndryshme — taksë perimesh 62, taksë të bletëve 20, taksë për li 120, për barë 165, për dru 66, për derra 31, për spinaq 15 — të gjitha këto ispenxhe. Ndër emra të kryefamiljarëve, të cilët shumica dërmuese janë sllavë, janë edhe disa emra shqiptarë, disa familjarë kanë emra të përzier — shqiptarë e sllavë. Kështu p.sh. aty figuron kryefamiljari Nikashi (Nokë, (Nikë), pastaj Spani, Boçuli, Mali, Miraku, Prodani, si edhe disa emra të tjerë të cilët i cekëm më parë, si emra që i kishin kryefamiljarët shqiptarë, siç del qartë nga relacioni i tyre i gjinisë së gjakut me njerëz që kishin emër thjesht shqiptar (p.sh.. Nenko shqiptari, Radiçi, i biri i Gjonit, Bogdani, vëllai i tij, Vuku, i biri i Gjinit etj.). Nga ana tjetër, si e thamë edhe më

[106] St. Novaković, *Zakonski spomenici....*, 470, 656.

[107] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit....*, 290, 291; dhe në *Studime Historike*, nr. 2/1976, 190.

parë, shqiptarët ortodoksë të këtyre viseve mbanin emra sllavë në shumë raste dhe ishin nën administrimin e kishës serbe ortodokse, gjë që manifestohej edhe në antroponiminë e tyre. Kuptohet se në kushte të tilla edhe martesat ndërmjet shqiptarëve e sllavëve ishin të shpeshta. Madje, kjo ka ndodhur edhe në ditët tona mu në Gllogjan. Kështu, me rastin e punës kërkimore në këtë terren më 1951 fshatarët më treguan se njëfarë Pjetër Maçi, nga ky fshat, ishte martuar me një malazeze, në mëhallën Drezgë në kodër, mbi katund, ku kanë qenë rreth 20 shtëpi kolonistë malazezë.

Kah fillimi i shekullit XX, sipas shënimeve të J. Cvijiqit, Gllogjani kishte 7 shtëpi (familje) shqiptare myslimane. Por, si edhe në shumë raste të tjera, edhe këto shënime të tij janë të gabuara për dy shkaqe: numri i familjeve duhet të ketë qenë më i madh se 7 sepse edhe familja „më e re" është vendosur këtu të paktën para 80—100 vjetësh; përveç kësaj, në Gllogjan popullsia është katolike, dhe nuk mbahet mend të ketë qenë e ndonjë besimi tjetër as më parë. Në shënimet e Cvijiqit nuk përmenden fare katolikët në asnjë fshat të Lugut të Baranit. Sipas të dhënave zyrtare të Këshillit Popullor të vendit Gllogjan, ky fshat kishte me 1950 gjithsej 63 shtëpi, nga të cilat 40 shqiptare e 23 malazeze, me 435 banorë (333 shqiptarë e 105 serbë e malazezë). Mesatarja e pjesëtarëve të familjes ndër shqiptarë arrinte 8,3 vetë për çdo familje, ndër serbë e malazezë 4,5 pjesëtarë. Me regjistrimin e popullsisë të vitit 1971 është konstatuar në Gllogjan kjo gjendje demografike: gjithsej 640 banorë, nga të cilët 550 shqiptarë, 2 serbë e 87 malazezë dhe gjithsej 68 shtëpi (familje). Mesatarja e pjesëtarëve të familjës brenda periudhës 1950—1971 është rritur për më se 1 pjesëtar për çdo familje, ndërkaq numri i përgjithshëm i banorëve për 105. Numri i banorëve të kombësisë serbe e malazeze është zvogëluar për 16, sepse disa familje janë shpërngulur pasi e kanë shitur tokën. Me 1981 fshati kishte 74 familje me 722 banorë (664 shqiptarë, 51 malazezë e 5 myslimanë). Çdo familje kishte 9,75 pjesëtarë mesatarisht.

Popullsia e Gllogjanit përbëhet nga disa fise, por shumica janë Berishë (20 familje). Berisha ndahet në Deskaj, Tetaj e Rrac (si në Llugaxhi, ku i kanë shokët e afërm). — Rreth 13 familje janë Thaç (ndahen në Koc e Velë), pastaj Kabash (10) e Mirditë 9 shtëpi. Berisha kanë ardhur në Gllogjan nga fshati Broliq, Thaçi — disa familje nga Nepolja, e disa të tjera nga Malësia. Mirdita kanë ardhur nga fshati i afërm Llozhan. Kabashi e kanë prejardhjen nga Gjurakoci (Istog), por para së të vendoseshin në Gllogjan, janë shpërngulur në disa fshatra të tjera: nga Gjurakoci në Muzhovinë (Lugu i Drinit), nga Muzhovina në Dugajevë (Lugu i Leshanit) e pastaj këtu në Gllogjan. Ata bredhnin në këtë mënyrë ngase ishin çifçinj dhe bejlerët nuk i mbanin gjatë në tokat e tyre, kështu detyroheshin të kërkonin zotëri tjetër. Sipas traditës, i pari i Kabashëve ka ardhur këndej si një njeri i vetëm nga Dardha e Shkodrës, këtu është martuar (në Dukagjin) dhe, me kohë familja e tij është rritur.

Në Gllogjan para lufte pushteti ka kolonizuar 44 familje malazeze (nga fiset Piper, Vasojeviq etj. nga rrethet e Kolashinit të Malit të Zi).[108] Pas lufte disa nga këto janë kthyer e disa jo, sepse toka që u ka qenë marrë fshatarëve shqiptarë iu kthye pronarëve të vjetër pas lufte. Një numër tjetër familjesh, të kthyera pas pak vitesh, u shpërngul, pak më vonë u shpërngulen edhe familjet e tjera, sepse Kombinati bujqësor i Pejës hapi toka buke në kodra ku i kishin parcelat këto familje, të cilat për pronat e tyre muarën dëmshpërblimin përkatës.

Në lidhje me strukturën e popullsisë, por më tepër në lidhje me tolerancën fetare, edhe në Gllogjan ka shembuj interesantë, të cilët dëshmojnë për solidaritetin e zemërgjerësinë e fshatarëve të kësaj zone të besimeve të ndryshme. Kështu në familjen e njohur të Ndue Delisë (i cili ka vdekur rreth vitit 1935) kishte pjesëtarë myslimanë e katolikë. Me kohë meshkujt myslimanë vdesin, mirëpo edhe tash i kanë bijat e tyre myslimane të martuara për myslimanë në Rakoc (Dushkajë), të cilat rregullisht vijnë „në të pamë" te axhallarët e kushërinjtë e tyre në këtë familje nga e cila kanë dalë, ku tani (1980) është zot shtëpie Ndrecë Zeqa.

Toka e Gllogjanit ka qenë e njëfarë Tahir beg Kastratit (të paktën një pjesë e saj). Të gjithë fshatarët e kanë blerë tokën nga feudalët, kështu që sistemi i çiflëkut këtu është zhdukur me kohë.

Toponimet e terrenit të Gllogjanit janë më të shumta në pjesën kodrinore të tij: Lugu i Madh, Lugu i Thanave, Lugu i Drezgës, Lugu i Vogël, Gryka e Hajnave, Guri i Alisë (vend vrasje), Lugu i Gjeriqit, Lugu i Vorreve, Lugu i Gjonit, Lugu i Gjupajës, Lugu i Shakut, Rrahije etj. Në rrafsh, në pjesën fushore të terrenit, gjenden këto toponime: Arat e Epërme, Arat e Poshtme, Begllaku, Lisi i Kocit, Kroni i Zhavarit, Kroni i Madh etj.

Gllogjani ka qenë një kohë qendër administrative e Këshillit të vendit për fshatrat: Kosuriq, Llugaxhi, Gllogjan, Nepole, Çeskovë e Kpuz, të cilat ishin, më 1950, më se 1900 banorë (1852 shqiptarë e 52 serbë e malazezë). Edhe tash (1980) ky fshat është një lloj qendre për këto fshatra, sepse, para së gjithash, këtu fillon rruga e asfaltuar e cila shkon për në Pejë, në Gllogjan është shkolla tetëvjeçare „Migjeni" ku shkollohen fëmijtë e këtyre katundeve, këtu janë edhe 2—3 shitore, nga të cilat furnizohen disa fshatra. Për besimtarët katolikë të kësaj zone këtu është edhe qendra fetare, kisha e cila është ndërtuar pas Luftës së Parë Botërore, kurse, sipas traditës një kishë e vjetër katolike duhet të ketë qenë në shpat ndërmjet Gllogjanit e Nepoles.[109] Gllojgani ka pak njerëz të shkolluar, ka vetëm 4—5 mësues, 2 të tjerë me fakultet e 2—3 studentë. Në botën e jashtme gjenden rreth 40 vetë në punë të përkohshme (më 1981).

[108] M. Obradović, *Agrarna reforma...*, 278.
[109] Kallëzim i Mehmet Deskut nga Gllogjani etj.

Nepolja. — Edhe Nepolja ka pozitë të ngjashme gjeografike me Gllogjanin e me disa fshatra të tjera, që ndodhen rrëzë kodrës. Kushtet hidrografike gjithashtu janë të njëjta, përkatësisht pjesa e sipërme e fushës rrëzë kodres nuk ka mjaft ujë, kurse ajo më afër Bistricës ujitet pa vështirësi.

Nepolja përmendet bashkë me Kosuriqin e Gllogjanin, më 1348, me emrin Dnepolje. Kah fundi i shekullit, XIV më 1390, në një dokument tjetër figuron si dhuratë e manastirit të Deçanit.[110] Në të dy këto dokumente (i car Dushanit, përkatësisht i murgeshës Evgenija) Nepolja quhet Dnepole. Por s'ka dyshim se fshati me emrin Dnepole është Nepolja e sotme, sepse përmendet në kontekst me fshatra të tjera përreth saj. Nga këto dokumente shihet se car Dushani ia dhuron Nepolen kishës së Karesë në Greqi, e pas 40 vjetësh murgesha Evgenije ia dhuron kishës së Deçanit. Nuk shihet qartë se sa kohë ka qenë pronë e njërës e sa e tjetres kishë, por për statusin ekonomik e social të fshatit kjo nuk ka rëndësi, sepse ai, në thelb, nuk ka ndryshuar por ka mbetur feud, vakëf, ose „metoh" i kishës, i shfrytëzuar si nga njëra ashtu nga tjetra. Më vonë, më 1485, Neploja përmendet në defterin turk, ku ka të dhëna të rëndësishme për të, ashtu si edhe për fshatrat e tjera të kësaj zone. Në këtë defter Nepolja figuron si Popole, në një ziamet me Llukën e Epërme. Si e thamë edhe më parë, në këto anë nuk ekziston ndonjë fshat me këtë emër, ose me emër që i përgjan këtij më shumë se Nepolja. Prandaj identitetin e Popoles me Nepolen po e marrim si të sigurt.

Nga të dhënat e defterit të shekullit XV shihet se Nepolja ishte fshat i vogël me gjithsej 16 shtëpi, përkatësisht familje.[111] Por këto të dhëna tregojnë gjendjen para 500 vjetësh, kur, ndoshta fshati me 16 shtëpi nuk ishte aq i vogël sa na duket neve sot. Në krahasim me Gllogjanin e Kosuriqin, as detyrimet e Nepoles nuk ishin aq të rënda. Nepolja jepte 435 ispenxhe, 5 barrë grurë, 10 barrë thekër, 6 barrë elb, 11 b. tagji e oker, 2 b. mel, musht 11 mushur, pastaj taksa për li 30 ispenxhe, për perime 22, për bletë 45, për derra 18, taksa e govatës 45 etj. Nga regjistri i detyrimeve shihet se struktura e ekonomisë bujqësore të Nepoles ishte e ngjashme me atë të fshatrave të tjera, ndryshime ka vetëm në vëllimin e tyre. Në shënimet e vitit 1905, të cilat i kemi përmendur disa herë deri tash, Nepolja figuron si fshat relativisht i madh, me 25 shtëpi. Edhe për Nepolen Cvijiqi shënon në këto të dhëna se popullsia është shqiptare myslimane. Por gjendja edhe këtu, nga ky aspekt, është si në Gllogjan, megjithëse kjo s'ka ndonjë rëndësi të posaçme, në krahasim me strukturat e tjera të popullsisë. Nga këto të dhëna del se Nepolja ishte në atë kohë fshati më i madh i Lugut të Baranit, gati sa Kosuriqi e Krysheci së bashku (sipas regjistrit që e jep Cvijiqi).

Në regjistrimin e vitit 1950, sipas të dhënave të Këshillit të vendit Gllogjan, janë evidentuar në Nepole 27 shtëpi me 305 banorë, të gjithë shqiptarë. Në vitin 1950 mesatarja e pjesëtarëve të

[110] St. Novaković...., *Zakonski spomenici*...., 470, 656.
[111] S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit*...., 227.

familjes ishte më e madhe, 11,3. Më 1971, me rastin e regjistrimit të përgjithëshem të popullsisë, ky fshat kishte 526 banorë (të gjithë shqiptarë) me 39 shtëpi (pra, vetëm 23 më shumë se para 500 vjetësh, ose 15 më shumë se para nja 80 vjetësh). Mesatarja e pjesëtarëve të familjes më 1971 ishte shumë e madhe, 13,5 për çdo familje. Kjo tregon se familja e madhe patriarkale ende ishte e fortë, të paktën për sa i përket numrit të tyre. Vetëm Buqani kishte mesatare më të madhe kësisoji në Lug të Baranit. Më 1981 Nepolja kishte 547 banorë (të gjithë shqiptarë) me 53 familje, mesatarisht nga 10,3 pjesëtarë për çdo familje.

Sipas të dhënave të banorëve të Nepoles, gjatë punës kërkimore në terren më 1979, të gjithë banorët e këtij fshati janë të fisit Krasniqe (Nikaj e Curraj). Banorët e tanishëm këtu kanë ardhur vonë, para nja 100 vjetësh. Kjo vërtetohet edhe me breza që i numërojnë në fshat, si p.sh. në familjen e Mark Noshit: Vera (mesa e tij 2 vjeçe) — Vuksani (i lindur më 1937) — Marku (1918) Noshi — Deda — Nika — Vuksani. Këtu ka ardhur Noshi, si djalë i ri, i cili ka vdekur në moshën 102 vjeçare. Kur ka ardhur Krasniqja në Nepole, këtu i kanë gjetur Gashjanët si banorë të përhershëm. Të parët e Krasniqes së Nepoles janë nga „Krasniqja e vendit" (Malësia e Gjakovës). Fshati ka qenë pronë e njëfarë Osman agës nga Peja. Me intervenimin e Haxhi Zekës, Osman aga i largon Gashjanët nga Nepolja dhe aty vendoset Krasniqja, d.m.th. një populisi e një fisi me Haxhi Zekën. Nuk dihen hollësitë se si e pse ishte bërë ky ndërrim i çifçinjve. Por dihet se patrioti i shquar Haxhi Zeka ka qenë kundërshtar i papajtueshëm i sundimit turk në Kosovë. Në luftën e tij të vendosur me fjalë e me pushkë, ai mbështetej në masat më të gjera popullore, në fshatarësinë. Arsyeja e përkrahjes së Krasniqes së Nepoles që të vendoset aty mund të ishte qellimi që të forcohet ky fis në Lug të Baranit edhe më tepër, ku edhe shtëpia e bajraktarit ishte e këtij fisi, në të cilin Haxhi Zeka mbështetej në çdo rast. Krasniqja e Nepoles është e tëra e besimit katolik. Prandaj përkrahja e Haxhi Zekës edhe me këtë rast tregon koncepcionet e tij të gjera kombëtare. Madje, ngjarjet e përgjakshme me ushtrinë e zaptinjtë turq, të cilat i përmendem në këtë punim më parë, nuk janë zhvilluar rastësisht në Lug të Baranit. Haxhi Zeka nuk ishte vetëm politikan mendjehollë, por edhe strateg i shkathët.

Megjithëse popullsia e sotme e Nepoles është këtu relativisht e re, toponimia e këtij terreni prapëseprapë nuk është e varfër. Madje, ajo tregon diçka edhe për historikun e këtij fshati. Kështu p.sh. ndër toponimet e tjera ekzistojnë edhe këto: Vau i Gashit, Nalloga e Lumës, pastaj Mrizet, Vizhma (ara), Fertova (livadhe), Llugat, Podijet, Mrizet, Kerdhokllat, Sojishtat e Ukhajdarëve. Në kodër mbi fshat: Lugu i Xhupanjes, Lugu i Camës, Kodra e Ali Gegës, Lugu i Tanës, Rrahije, Lugu i Thive etj.

Nga Nepolja janë 30 punëtorë në botën e jashtme (1981). Në fshat është shkolla fillore katërvjeçare. Numri i njerëzve me shkollë të mesme dhe në studime në shkolla të larta është fare i vogël. Përveç dritës elektrike e të shkollës katërvjeçare, e cila punon në një lokal aspak të përshtatshëm, fshati ka arritur pak sukse-

se të tjera në rrugën e përparimit në planin shoqëror pas luftës e kendej. Ka mbetur pa u lidhur me Gllogjanin, deri ku ka arritur rruga e asfaltuar. Afër fshatit, në grykë të Bistricës, nxjerrin rrasa të mira të gurit, shumë të përshtatshme për ndërtimtari. Por kjo punë bëhët në mënyrë stihike dhe me mjete primitive. Sikur të themelohej këtu një ndërmarrje e vogël e industrisë ndërtimore, do të bëhej një punë shumë e mirë dhe e arsyeshme nga aspekti i lëvërdisë ekonomike dhe i përpjekjeve për zhvillimin e fshatrave, për përmirësimin e standardit të tyre, i cili sot është mjaft i ulët.

Çeskova. — Ky fshat ndodhet në zonën kodrinore të Lugut të Baranit, në pjesën lindore të kodrës, e cila shtrihet në anën veriore të lugut, që nga Turjaka në perëndim, e deri në Dri në lindje. Shtëpitë e fshatit janë të shpërndara në disa grupe nëpër shpate të kodrave, të cilat e rrethojnë një luginë të ngushtë të formuar nga përrenjtë. Kështu fshati ka tip mëhalle, sepse grupet e shtëpive janë të vendosura nga të gjitha anët e kësaj lugine. Mëhalla që ndodhet në anën veriore të saj quhet Balë,- e ajo nga jugu Morinë, sipas familjeve të cilat quhen me këtë „llagap" (mbiemër). Kushtet natyrore në Çeskovë nuk janë të përshtatshme për jetesë, sepse toka është e cilësisë së dobët dhe ujë nuk ka për ujitjen e fushave. Ujin e marrin nga puset, të cilat janë shumë të thella dhe nga dy burime që janë në katund.

Çeskova është njëri ndër fshatrat më të vjetra të kësaj zone. Ajo përmendet në dokumentet e Stefan Deçanit më 1327, në lidhje me mosmarrëveshjet rreth megjave ndërmjet Kosuriqit dhe pronave të manastirit Hilandar (Greqi), i cili duhet t'i ketë pasur këtu si dhuratë të sundimtarëve nga dinastia e Nemanjiqëve. Me këtë rast përmendet kufiri i pronës së Hilendarit në Çeskovë — „nga Kurilljaku gjatë rrugës". Më vonë, më 1348, car Dushan Nemanjiqi ia dhuron qelisë së Karesë në Mal të Shenjtë (Greqi) fshatin Kosuriq, me vendbanime të vogla (lagje), ndër të cilat edhe Çeskovën. Çeskova figuron në dokumente të tilla me të cilat sundimtarët e ndryshëm ua dhuronin manastirëve fshatrat e malet për t'i shfrytëzuar si prona (metoh, vakëf) të tyre. Kështu, më 1389, „murgesha Evgenija", ia kthen manastirit të Deçanit fshatrat të cilat ia kishin marrë më parë, dhe i fal fshatra të tjera. Në këtë dokument përmenden si dhurata kishës së Deçanit edhe fshatrat Batushë, Nepole, Çeskovë „me të gjitha mezhdat e tyre".[112] Duket se manastiri Hilandar (Greqi) dhe manastiri i Deçanit ishin në rivalitet rreth pasurive, pronave të dhuruara nga sundimtarët e ndryshëm në këto anë. Duket se edhe Çeskova ishte e tillë, sepse një herë i takonte Hilendarit e pastaj më vonë i kthehet Deçanit si „fshat i rrëmbyer", që do të thotë se më parë ishte i Deçanit. (Murgesha Evgenija më parë ishte sundimtare, por në atë kohë sundimtarët e fisnikët e ndryshëm, duke marrë shembull nga Bizanti, para vdekjes shkonin në manastire dhe bëheshin murgj

[112] St. Novaković, *Zakonski spomenici....*, 397, 470, 656.

e murgesha, duke marrë edhe emër tjetër nga ai që e kishin më parë.[113] Duket se Çeskova në atë kohë kishte një rëndësi të posaçme, kuptohet relative, për kultivimin e vreshtave dhe të bletëve. Këto dy degë ekonomike çmoheshin në atë kohë në qarqet kishtare, sepse produktet e tyre konsumoheshin në këto rrethe me të madhe. Edhe sot ekziston në terrenin e Çeskovës toponimi „Prroni i Vneshtave", megjithëse ka kohë që këtu nuk mbahet mend kultivimi i tyre.

Çeskova përmendet në defterin turk të vitit 1485, bashkë me fshatin Lutogllavë, si shtesa të spahiut Ali Bazhdari. Çeskova varej nga Peja, Lutogllava është afër Pejës, por mjaft larg Çeskovës, por s'ka dyshim se këtu është fjala për këtë fshat, sepse edhe në dokumente të shekullit XIV përmendet me fshatra të Lugut të Baranit. Defteri turk shënon vetëm 10 kryefamiljarë (shtëpi) në Çeskovë. Ndaj shtetit ka pasur këto detyrime: 306 ispenxhe, 15 barrë grurë, 8 b. thekër, 20 b. elb, 12 b. tagji e okër, 4 b. mel, musht 44 subur, taksa e govatës 30 ispenxhe, taksa e bletëve 35, e frutave 10, e barit 50, e druve 20, taksa e derrave 23 etj.

Në defterin e shekullit XV emrat e kryefamiljarëve të Çeskovës janë sllavë, por ndër këta emra gjenden edhe Radiçi, i biri i Milloshit, Nenko, i biri i Novakut etj. Në raste të tjera, që i shqyrtuam këtu më sipër, treguam se këta emra, dhe shumë të tjerë, paraqiten bashkë me emra shqiptarë që i mbanin njerëzit me të cilët Radiçi, Nenko etj. figurojnë në lidhje më të ngushtë gjinie gjaku (babë e djalë, vëllezër etj.). Kështu, Radiçi në fshatin „Bana" (Bajë) që varej nga Peja, ishte „i biri i Gjonit", pastaj një kryefamiljar quhej „Radiç Krasniqi", si e cekëm edhe më parë, kurse Gjurashi, Vuçiqi e Stepani ishin bijtë e Gjonit etj. Disa nga këta emra figurojnë edhe në regjistrin e kryefamiljarëve të Çeskovës, sipas defterit në fjalë.[114]

Në të dhënat e vitit 1905, Çeskova figuron si fshat i vogël me 15 shtëpi shqiptare.[115] Emri i fshatit është shënuar Çesko, por ky i referohet vetëm Çeskovës së sotme. Sipas regjistrit të Këshillit të vendit Gllogjan më 1950, Çeskova kishte 27 familje (25 shqiptare e 2 malazeze) me 184 banorë (172 shqiptarë e 12 malazezë). Më 1971 kishte 32 familje dhe 292 banorë (290 shqiptarë e 2 „të tjerë"). Atë vit familjet e Çeskovës kishin mesatarisht nga 9,1 pjesëtarë. Më 1950 kjo mesatare ishte 6,8 pjesëtarë për familje. Nga kjo shihet se gjatë kësaj periudhe 20 vjeçare procesi i zhvillimit të familjës në këtë fshat shkonte drejt përforcimit të familjes patriarkale me shumë anëtarë, megjithëse kushtet e reja ekonomike e shoqërore ndikojnë në drejtim të kundërt. Mirëpo, Çeskova është fshat i varfër, me fare pak tokë buke. Sikur të ndaheshin familjet e mëdha do të varfëroheshin edhe më tepër, sepse pronat e tyre të vogla do të copëtoheshin në parcela shumë të vogla, të cilat do të angazhonin fuqinë punëtore dhe kështu nuk do të kish-

[113] Konstantin Jeriček, *Istorija Srba, II*, Beograd, 1952, 316.
[114] S. Pulaha. *Defteri i regjistrimit...* 274, 272; Stud. Hist. 2/76, 190.
[115] J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju....*, 1189, 1190.

te mundësi askush të merret me punë të tjera jobujqësore, p.sh. me gurbet në shtete të huaja. Çeskova më 1981 kishte 400 banorë (të gjithë shqiptarë) me 33 familje. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve arrinte 12,1. Para lufte këtu kanë qenë kolonizuar 10 familje malazeze.

Popullsia e Çeskovës, përkatësisht struktura e saj, gjatë shekujve ka ndryshuar disa herë, siç ndryshon kudo. Pleqtë e tashëm të Çeskovës tregojnë se kanë dëgjuar nga brezat e mëparshëm se popullsia e këtij fshati ka qenë e besimit katolik. Kjo shihet edhe nga disa toponime në terrenin e fshatit. Kështu një pjese të kodrës i thonë Shpati i Nikës dhe Shpati i Arave të Nikës. Po në këtë shpat kanë qenë Vorret e Katalikve, ku më vonë janë varrosur edhe disa komitë. Toponimi Rrahi i Fandës gjithashtu ka lidhje me banorë shqiptarë të besimit katolik. (Fandë ka në Lug të Drinit, janë me prejardhje nga pellgu i lumit Fan në Mirditë). Nërkohë, si kudo ndër ne, sundimi turk dhe sistemi feudal u ka imponuar fshatarëve shqiptarë besimin mysliman.

Nga të dhënat e mbledhura në terren, gjatë punës kërkimore më 1956, del se historiku i popullsisë së këtij fshati është me interes të madh për studime etno-gjeografike të Lugut të Baranit, sidomos për sa i përket prejardhjes dhe migrimeve të saj në të kaluarën. Këtu janë nja 15 familje Berishë, të cilat quhen Kuq, me prejardhje nga Kuqi në Mal të Zi. Për fisin e Kuqit ka shumë studime, dhe dihet se një pjesë e tij ka qenë e kombësisë shqiptare, por nga se kanë pasur kontakt të përhershëm me fiset malazeze, pjesa më e madhe e Kuqit është sllavizuar.[116] Tradita që e tregon prejardhjen e tyre shqiptare edhe tash mbahet në mend mirë në familjet kuqjane, në të cilat deri vonë flitej edhe shqipja. Kuqët e Çeskovës kanë ardhur në Rrafsh të Dukagjinit gjatë sundimit turk dhe kështu kanë shpëtuar nga shkombëtarizimi. Të parët e tyre një kohë të gjatë kanë bredhur nga fshati në fshat, derisa ngulitën këtu ku janë. Sipas traditës, Kuqët më parë kanë jetuar në Loxhë (Pejë). Më vonë janë shpërngulur në Kralan, pastaj në Kpuz dhe më në fund në Çeskovë. Përveç Kuqëve, këtu ka edhe rreth 15 shtëpi Morinë. Edhe të parët e tyre kanë ardhur këtu pasi kanë qëndruar një kohë në fshatra të ndryshme të Dukagjinit. Në Çeskovë kanë ardhur nga Dollova (fshat i afërm). Sipas traditës, Morina e ka prejardhjen nga Rrzhanica (Plavë). I pari i tyre, Ahmet Bala ka ardhur në Dollovë para 300—350 vjetësh, ai vetëm me gruan e tij. Tash në fshat ekziston sipas këtij emri, mëhalla Balë. Më 1956 këtu kanë qenë edhe 2 familje malazeze — Llakçeviq e Pajoviq, të ardhura këtu para luftës nga Bjellopavliqi (Palabardhi). Këta tregonin se janë me origjinë nga Gruda. Të parët e popullsisë së tashme të Çeskovës, në disa raste, kanë ikur nga viset malore dhe janë vendosur në Dukagjin për t'iu larguar hakmarrjes, sepse në vendin prej nga kanë ardhur kishin rënë në

[116] Stevan Dučić, *Život i običaji plemena Kuča,* Srpski etnografski zbornik, knj. XVIII, Beograd, 1931, 3, 4; Marko Miljanov, *Pleme Kuči u narodnoj priči i pjesmi,* Beograd, 1904; Marko Rašović, *Pleme Kuči — etnografsko-istorijski pregled,* Beograd, 1963.

gjak. Tradita tregon se ndër të gjithë banorët e fshatit, Morina janë këtu më të vjetrit. Në Çeskovë jetojnë edhe 3 familje Gash e 2 Shalë. Tokën, përkatësisht pyllin, e kanë blerë të gjithë nga bejlerët e pastaj e kanë hapur për tokë buke. Nga feudalët këtu e përmendin njëfarë Pederoll beun.

Toka e Çeskovës është e varfër, kështu që fshatarët janë të detyruar të blejnë bukën. Mbjellin pak misër e grurë, perimet nuk kultivohen se nuk ka ujë për t'i ujitur. Pemë gjithashtu ka fare pak. Më parë fshatarët merreshin me blegtori dhe me shitjen e druve, për të blerë drithë. Megjithëse toka është e cilësisë shumë të dobët, prapë edhe këtu „agrari" ua ka marrë para luftes 70 ha ku i kanë vendosur disa familje koloniste, të cilat nuk janë kthyer pas lufte, përveç atyre dy familjeve që i përmendem më parë.

Terreni i Çeskovës ka këto toponime: Prroni i Katundit, Prroni i Kanjushës, Prroni i Vneshtave, Prroni i Kalabës, pastaj — shpati i Arave të Nikës, Livadhi i Gusisë, Rrahi i Fandës, Pollosajke, Kaprica, Rrahije, Megjara (livadhe), Ara e Jonuzit, Ornica, Lugu i Livadheve, Livadhi i Muratit, Kodra e Nezës, Livadhi i Odes, Ara e Dushit, Livadhi i Hysehasës, Lisi i Ulicës, Vorret e Mira, ose Vorret e Hasallakut etj. Ky toponim edhe këtu ka po atë kuptim si në fshatra të tjera ku paraqitet.

Megjithëse fshati është i varfër, banorët e tij e kanë ruajtur mikpritjen tradicionale shqiptare. Këtu para lufte janë strehuar shpeshherë komitet dhe njerëz të tjerë, të cilët i ndiqte qeveria e atëhershme antipopullore. Edhe në fshatra të tjera të këtyre anëve flitet për shtëpinë bujare të Ali Ramës, e cila natë e ditë i kishte dyert e hapura për mysafirë të njohur e të panjohur. Madje, disa njerëz të vobekt kanë gjetur aty strehim me muaj e me vite.[117]

Tash (1980) nga Çeskova punojnë në botën e jashtme përkohësisht relativisht më shumë njerëz se nga çdo fshat tjetër, gati nga çdo shtëpi nga një mashkull. Kjo është e kuptueshme, sepse ndryshe nuk mund ta sigurojnë bukën nga varfëria e këtyre kodrave në të cilat jetojnë. Në saje të punës së tyre, në fshat janë ndërtuar disa shtëpi moderne, pastaj këtu ka nja 6 traktorë e disa aparate elektrike për amvisni. Mirëpo, fshati është i shkëputur nga bota, sidomos dimrit, pa rrugë, pa shkollë, pa shitore etj.


Kpuzi. — Për nga pozita gjeografike, Kpuzi është fshati i fundit i Lugut të Baranit. Ai ndodhet në kodër, e cila ngrihet përmbi bregun e djathtë të Drinit të Bardhë, që është e lartë 457 m mbi nivelin e detit. Fshati është i tipit mëhallë, meqenëse përveç grupit të shtëpive të vendosura në kodër, një numër i vogël shtëpish ndodhet pranë bregut të Drinit, larg nga fshati i vjetër. Kjo mëhallë quhet Rastokë dhe shpeshherë merret si fshat më vete, e jo si mëhallë e Kpuzit, sepse, përveç që është mjaft larg nga katundi, edhe pozita gjeografike e saj e fshatit fushor bën që të jetë fare e veçuar. Edhe brenda në Kpuz janë disa mëhallë, që emërtohen

[117] Kallëzim i Avdyl Zekës nga Çeskova.

sipas fisit ose kombësisë së banorëve të saj. Këtu kanë qenë rreth 40 shtëpi të kolonistëve të ardhur nga Mali i Zi, Serbia dhe Bosna e Hercegovina.[118]

Megjithëse Kpuzi ndodhet në terren kodrinor, prapë gati çdo shtëpi ka pusin në oborr, që nuk është shumë i thellë, mesatarisht rreth 10 m. Mes fshatit është një krua me ujë të shijshëm. Fusha është pa vadë — nuk ujitet, përveç një pjese të vogël, që ndodhet përgjat Drinit e Bistricës.

Kpuzi nuk përmendet në dokumentat të cilat e kemi shfrytëzuar me këtë rast për vendbanimet e tjera të Lugut të Baranit. Kështu ky fshat mund të konsiderohet si vendbanim i ri. Por meqenëse është fare afër Çeskovës, dhe me tipare të njëjta gjeografike, mund të supozohet se dikur mund të këtë qenë mëhallë e Çeskovës, ose pjesë përbërëse e saj. Por për këtë nuk kemi të dhëna, madje as nga tradita.



Tip i ri i shtëpisë fshatare

Nga të dhënat e vitit 1905 shihet se fshati kishte 10 shtëpi shqiptare myslimane. Në lidhje me këto të dhëna folëm disa herë deri tash, para së gjithash për sa i përket numrit të shtëpive, i cili edhe me rastin e Kpuzit na duket se është i zvogëluar, megjithëse ky vend malor edhe tash është fshat i vogël, pra mund të këtë qenë edhe më i vogël para 80 vjetësh, kur janë shënuar këto të dhëna. Më 1950, sipas të dhënave të Këshillit Popullor të Vendit Gllogjan, Kpuzi kishte 52 shtëpi (familje), nga të cilat 36 shqiptare, 13 malazeze e 3 serbe. Atëherë fshati kishte 342 banorë (266

[118] M. Obradović, *Agrarna reforma...*, 281.

shqiptarë, 60 malazezë e 16 serbë). Në familjet shqiptare mesatarja e pjesëtarëve të familjës arrinte 7,6, kurse në familjet serbe e malazeze 4,7. Pas 20 vjetësh d.m.th. më 1971, Kpuzi kishte 48 shtëpi e 505 banorë, nga të cilët 449 shqiptarë, 46 malazezë e 8 serbë. Kjo do të thotë se ndërkohë një numër i familjeve koloniste është shpërngulur nga fshati. Atë vit mesatarja e pjesëtarëve të familjes (duke i marrë së bashku të gjitha familjet pa dallim kombësie) ishte 10,5. Brenda kësaj periudhe 20 vjeçare rritja e popullsisë ishte 50% më e madhe, megjithëse ndërkohë ka emigruar gati gjysma e banorëve serbë e malazezë. Gjatë kësaj periudhe familja patriarkale është përforcuar edhe më tepër, sepse çdo shtëpi ka pasur mesatarisht 3 pjesëtarë më tepër se para 20 vjetësh. Shkaqet duhet të jenë po ato të cilat i shqyrtuam me rastin e trajtimit të këtij problemi në fshatin e afërm Çeskovë, ku kushtet natyrore e ekonomike janë krejtësisht identike me këto në Kpuz. Por raportet e reja ekonomike të cilat vijnë nga ndryshimi i strukturës sociale, qoftë kjo edhe me inkuadrimin e përkohshëm të fshatarëve në botën e jashtme, duhet të sjellin ndryshime edhe në raportet familjare, sidomos në familjet patriarkale, të bazuara në pronën e përbashkët dhe në autoritetin e kryefamiljarit, në ato themele, pra mbi të cilat nuk mund të ngrihet, as nuk mund të qëndrojë familja bashkëkohore.

Kpuzi më 1981 kishte 613 banorë (573 shqiptarë, 34 malazezë, 3 serbë, 3 të tjerë) me 60 familje, të cilat u përkasin fiseve Berishë (rreth 45 shtëpi) dhe Krasniqe (10), përveç 4—5 shtëpive të kolonistave malazezë, përkatësisht serbë. Berisha janë me origjinë nga Rrzhanica, si ata të Çeskovës (Kuq). Ky fis këtu ka këto mëhallë (llagape): Kollonë, Sylsmajlë e Brahoviq. Ky i fundit daton që nga koha kur kanë ardhur nga Rzhanica. Një familje e Berishës quhej dikur Stojanët. Sipas traditës, ajo është e afërme me gjini gjaku me Gariqët (serbë) në Dollovë dhe me Stepanët (shqiptarë) në Junik. I pari i Stojanëve ka ardhur, si një njeri i vetëm, nga Kuqi i Malit të Zi. Përkatësia e tij kombëtare mund të shpjegohet në kuadrin e këtij problemi për pjesën më të madhe të fisit Kuq përgjithësisht, si u tha edhe për Kuqët e Çeskovës më parë. Krasniqja e Kpuzit ka prejadhje të largët nga Luma. Në Rastokë jetojnë nja 6 familje: Gash (2), të ardhura nga Sferka e Gashit, Karavesh (2) dhe 3 famlije „boshnjakë" — Begoviq të ardhur këtu nga Bihori i Sanxhakut.

Toka e Kpuzit ka po atë cilësi si edhe ajo e Çeskovës, përveç fushës pranë Drinit e Bistricës. Fshatarët mbjellin misër e grurë, por nuk mjafton prodhimi për ushqimin e familjeve të tyre. Nga pemët këtu rriten vetëm manat. Toponimet e terrenit të Kpuzit janë mjaft specifike. Kështu disa livadhe quhen Fundishtat e Kpuzit, e një burim Kroni i Kpuzit. Ky është rast i rrallë kur ndonjë objekt ose pjesë e fushës në terrenin e fshatit quhet me emrin e vetë fshatit. Kështu i quajnë këto zakonisht fshatrat e tjera, për të treguar kujt i takojnë ato. Arat përgjatë Drinit quhen Fongishta, pastaj Fongje (ara e livadhe), Guri i Zi, Delanca (fushë pranë Drinit), Guri i Madh (në breg të Drinit), Kroni i Vorreve, Vnezhdë, ose Lugu i Vnezhëve (vresht i dikurshëm).

Megjithëse Kpuzi ka shkollën tetëvjeçare, prapë në rrugën e përparimit të përgjithshëm ekonomik e kulturor ka bërë hapa të vegjël gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të pas luftës. Kjo shihet nga fakti se përveç 1 mësuesi e 1 studenti, ky fshat, me rreth 60 shtëpi, nuk ka njerëz të tjerë të shkolluar. Fshati është gati i izoluar gjatë dimrit, për shkak se nuk ka rrugë të mirë as nga ana e Drinit për t'u lidhur me rrugën e asfaltuar në Klinë, as nga ana e kundërt deri në Gllogjan, ku fillon rruga e asfaltuar për në Pejë. Fshati është elektrifikuar bashkë me fshatrat e tjera të Lugut të Baranit.

Edhe në Kpuz, si në Çeskovë, gjendja ekonomike e vështirë është kapërcyer deri diku me shkuarje në kurbet në botën e jashtme, ku gjendet një numër i konsiderueshëm i djemve të këtij fshati. Në saje të ndihmës së tyre, të cilën ua dërgojnë familjeve, Kpuzi ka 7—8 traktorë, disa televizorë dhe aparate të tjera elektrike për amvisni. Kështu, edhe këtu, varfëria e ambientit gjeografik gërshetohet me disa elemente të industrisë bashkëkohore dhe paralajmëron një ritëm më të shpejtë të zhvillimit të këtyre kodrave të prapambetura në çdo pikëpamje.

PROCESI I URBANIZIMIT TË POPULLSISË DHE VENDBANIMEVE

Megjithëse Lugu i Baranit është zonë fushore dhe gjendet afër qytetit të Pejës, prapë ai ka kaluar shekuj me radhë në njëfarë izolimi, gati si fshatrat malore larg nga qyteti. Kjo ka ndodhur nga se forcat prodhuese në qytet nuk kanë qenë të zhvilluara, ndërsa sistemi feudal osman, dhe ai kapitalist i Jugosllavisë borgjeze, vetëm e kanë shfrytëzuar fshatarin në forma të ndryshme kështu që nuk është arritur ndonjë hap në përparimin e tij material e kulturor. Pa shkolla, pa institucione shëndetësore, pa rrugë e pa elektrifikim, Lugu i Baranit e kaloi epokën e feudalizmit, dhe të kapitalizmit — në një prapambetje të përgjithshme. Jeta patriarkale, e ngakuar me shumë elemente negative, në kushte të tilla i kishte thelluar rrënjët e saj si në rethin familjar, ashtu edhe në fshat e në shoqëri më të gjerë. Deri pas çlirimit shekuj me radhë lidhja ndërmjet fshatit e qytetit bazohej vetëm në shkëmbimin e mallrave, përkatësishët me shitjen e produkteve bujqësore në tregun e Pejës dhe në blerjen e disa produkteve industriale. Vëllimi i kësaj tregtie ishte shumë i kufizuar. Fshatari e shiste misrin, fasulen e lopën, eventualisht ndonjë qerre dru e barë (sanë). Këto ishin produktet e punës së tij në fushë, të cilat ai shpeshherë detyrohej t'i shiste, për të paguar tatimin e rëndë, ndërsa veten e linte keq dhe detyrohej të blente pas disa muajsh misër me çmim më të lartë për ta ushqyer familjen. Atëherë nuk kultivoheshin bimët industriale — panxharsheqeri, luledielli dhe duhani, as perimet, përveç specave, kështu që misri ishte artikulli kryesor i tregut, të cilin e shiste shumë lirë në vjeshtë dhe e blente shtrenjtë në pranverë, kur mbetej pa të. Nga artikujt industialë, me të cilët furnizohej fshati në tregun e Pejës, më të zakonshmit ishin — kripa, vajguri dhe penjtë e pambukut. Të gjitha nevojat e tjera materiale fshatari i plotësonte në fshat nga produktet bujqësore dhe nga puna e dorës.

Pra, lidhja me qytetin ishte shumë e dobët, e kufizuar vetëm në shkëmbimin e disa artikujve. Kjo tregon jo vetëm shkallën e ulët ekonomike të fshatit, por edhe të qytetit. Shkëmbimi i vlerave kulturore ndërmjet tyre nuk bëhej, sepse në fshat, përveç kulturës tradicionale, ato nuk ekzistonin fare, kurse edhe qyteti ishte shumë i varfër në këtë aspekt. Mjafton të përmendim se jo vetëm fshatarët, por edhe qytetarët, ishin analfabetë me një përqindje shumë të madhe.


Nga kjo shihet se lidhja fshat-qytet ishte fare e dobët, kështu që ndikimi i qytetit në këtë zonë bujqësore as që ndihej fare. Për-

veç kushteve që i përmendëm, të cilat ndikonin negativisht në raportet e tilla, duhen pasur parasysh edhe mjetet e komunikacionit të paraluftës (qerrja e qeve, ose kali) dhe rruga shumë e keqe, e cila mund të kalohej vetëm kur ishte kohë e thatë. Në kushte të tilla, një pjesë e madhe e banorëve të Lugut të Baranit, si edhe e viseve të tjera përreth tij, as që kishin qenë ndonjëherë në qytet, sepse, si tham, për mundësitë e nevojat e atëherëshme, që të mbahet ndonjë kontakt me qytetin, mjaftonte të kryente këto punë vetëm kreyfamiljari. Madje, edhe ai shpeshherë shkonte e kthehej duarthatë, sepse fuqia blerëse e fshatarit ishte në një shkallë tepër të ulët, ngase produktet bujqësore ishin të vogla, çmimi i tyre në tregun e Pejës gjithashtu shumë i ulët. Në ndikimin e dobët të qytetit në procesin e urbanizimit të fshatrave të rretheve luante rol edhe fakti se as vetë qyteti i Pejës (dhe gati të gjitha qytetet e tjera të Kosovës) para lufte nuk ishin krejtësisht të urbanizuara, sepse një pjesë e mirë e banorëve të saj merrej me bujqësi, kurse gati çdo familje mbante të pakten një lopë për qumësht. Çdo mëngjes lopari i mëhallës trokiste derë më derë për ta nxjerrë lopën përjashta, kështu që në këtë kohë të gjitha rrugët e lagjeve mbusheshin me lopë e dhi, të cilat lopari i çonte në kullotë në fushë të Pejës. Shumë qytetarë punonin tokën e kopshtet e tyre dhe kjo ishte puna kryesore e tyre, nga frytet e të cilës ushqeheshin me qindra familje në qytet. Furrat e qytetit mbusheshin me bukë misri në tepsi, të cilat i sillnin gratë për t'i pjekur. Në shumë shtëpi shiheshin gratë në kostumin kombëtar, në veshjen e grave fshatare të Rrafshit të Dukagjinit — me pshtjellakë e këmishë të tires, me terlik e havli, me lidhcë e mahramë, kurse burrat me tirq, herkë e plis të bardhë. Në përgjithësi mund të themi se shumë më i madh ishte ndikimi i fshatit në mënyrën e jetesës në qytet, sesa e kundërta. Përkatësisht, mund të themi se para luftës procesi i urbanizimit të fshatit ka stagnuar, ndërsa procesi i ruralizimit të qytetit ka qenë shumë aktiv.

Mbas çlirimit krijohen kushte të reja shoqërore-ekonomike të cilat hapin rrugën e progresit të gjithanshëm edhe në treven e Lugut të Baranit, si kudo në Kosovë. Ndër këto kushte, të cilat ishin bazë për ndërtimin e jetës së re, rol vendimtar luajti barazia kombëtare dhe barazia e gruas me burrin, garantimi i të drejtave qytetare të barabarta për të gjithë etj. Këto të drejta, qysh në fillim, u sanksionuan me kushtetutën e re federative dhe me ligjet e organeve shtetërore të të gjitha shkallëve. Nga kjo arrihen shumë ndryshime në jetën e fshatarit edhe në Lug të Baranit. Atyre, para së gjithash, iu kthye toka të cilën ua kishte marrë Jugosllavia borgjeze, u hapën shkollat e para në gjuhën amtare, u formuan organet e pushtetit popullor, të cilat përbëheshin nga përfaqësuesit e popullsisë së vendit etj. Kjo ishte kthesë e madhe dhe një mundësi e re për të ecur me hapa më të sigurtë rrugës së emancipimit të gjithanshëm edhe këto fshatra të lëna pasdore shekuj me radhë.

Këtu nuk do t'i shqyrtojmë ata faktorë dhe ato dukuri, masat e akcione të ndryshme që u morën pas lufte në përgjithësi në Kosovë dhe në viset e tjera për të ecur më shpejt në rrugën e urbani-

zimit dhe të përparimit të gjithanshem, por vetëm disa nga këto që janë të lidhura me zonën e Lugut të Baranit dhe që deri diku janë manifestuar e zbatuar këtu në mënyrë të veçantë. Kështu, emancipimi i femrës dhe kolektivizimi në vitet e para pas luftës pat hasur në vështirësi të mëdha kudo ndër ne, kurse në Lug të Baranit kishte edhe raste drastike të kundërshtimit të aksioneve të tilla në fillim, sepse tradita ishte rrënjosur shumë thellë në jetën dhe psikologjinë e fshatarësisë kësaj treve. Në të kaluarën ajo e kishte kultivuar e mbrojtur këtë psikologji me xhelozi e vendosmeri. Mirëpo, koha e bëri të veten, kështu që tani në Lug të Baranit ka mësuese, infermiere, aktiviste në jetën shoqërore etj. dhe



Shkolla tetëvjeçare „Migjeni" e Gllogjanit

kjo nuk i duket askujt gjë e jashtëzakonshme, kurse çdo ditë shkojnë në shkolla të mesme të Pejë me dhjetra vajza nga shumë fshatra të këtij Lugu.

Hapja e shkollave në gjuhën shqipe është një rrugë e re dhe e sigurtë edhe në Lug të Baranit e cila çon drejt emancipimit dhe urbanizimit të popullsisë së këtyre fshatrave. Rëndësi të posaçme kanë paralelet e shkollës së mesme në Baran, ku mbajnë mësim arsimtarët e vendit dhe disa të tjerë, që vijnë përditë nga Peja. Një numër nxënësish ndjekin studimet e larta në Pejë, në Prishtinë e në Gjakovë. Megjithëse ky numër është i vogël, prapë ka rëndësinë e vet, sepse vjen gjithënjë duke u rritur. Rëndësi të posaçme nga aspekti i kulturës e arsimit ka fakti se fshatari i këtushëm e ka kuptuar nevojën e shkollimit të fëmijëve të tij dhe se familja e tij nuk mund të jetojë vetëm nga ara e vogël, nga e cila duhet të ushqehet një numër gjithnjë e më i madh i pjesëtarëve të familjes së tij. Deri vonë ai kishte pikëpamje e qëndrime negative ndaj shkollimit sidomos ndaj shkollimit të vajzave fshatare.

Për zhvillimin e Lugut të Baranit, për procesin e urbanizimit të kësaj zone, rëndësi të posaçme ka rruga e asfaltuar Gllogjan — Pejë dhe vendosja e lidhjes së përditshme me autobus midis fshatrave të kësaj treve e qytetit. Kjo, si e thamë edhe më parë, ka rëndësi të posaçme për shkollimin e fëmijëve të cilët ndjekin ndonjë shkollë të mesme në Pejë. Krahas me rëndësinë e kësaj rruge, nga aspekti i procesit të urbanizimit është edhe elektrifikimi që është shtrirë në të gjitha fshatrat. Madje, siç dihet, rëndësia e elektrifikimit të vendbanimeve dhe familjeve në përgjithësi kudo ka pasur e ka rëndësi të posaçme për zhvillimin e gjithanshëm kulturor e ekonomik në çdo vend e në çdo kohë.



Shitorja e fshatit Baran

Këtu duhet të përmendim edhe hapjen e disa shitoreve në shumë fshatra të Lugut të Baranit, madje në disa nga këto janë edhe nga dy e tri sosh. Megjithëse këto janë vetëm objekte tregtare, prapë ato njëkohësisht janë edhe elemente të qytetit, të urbanizmit, ku shiten artikuj të ndryshem industrialë. Nga ky aspekt ka rëndësi edhe shitorja e gazetave, e cila është hapur në Baran. Një qendër e vogël shëndetësore po në këtë fshat, e hapur në vitet e fundit, me mjek e infermierë, gjithashtu është një element i urbanizimit, por para së gjithash, ndihmë e madhe për ruajtjen e shëndetit dhe për kulturën higjenike të popullsisë fshatare, e cila para lufte as që kishte parë ndonjëherë mjekun në mjedisin e saj.

Një faktor tjetër që ndikon në procesin e urbanizimit të këtyre fshatrave është ndërrimi i strukturës sociale të banorëve të tyre. Këtë e përmendëm edhe më parë, por këtu po e theksojmë se në këtë drejtim ka ndikuar më tepër migrimi i përkohshëm ekonomik në botën e jashtme. Kështu një numër i madh familjesh

i ka përmirësuar kushtet materiale nga ndihma e meshkujve të tyre që punojnë përjashta, dhe kësisoj është krijuar njëfarë baze për ndryshimin e mënyrës së jetesës, përkatësisht të gjendjes materiale në përgjithësi. Kjo shihet sidomos nga ndërtimi i shtëpive të reja, nga blerja e veglave e makinave bujqësore, shkollimi i fëmijëve dhe blerja e aparateve të ndryshme elektrike. Të gjitha këto kanë në Lug të Baranit përmasa të vogla, por megjithatë janë një sukses drejt urbanizimit, të cilit kështu i hapet rruga për të ecur me ritëm më të shpejtë në të ardhmen. Por ky migracion në botën e jashtme ka edhe anët negative, sidomos në lidhje me stabilitetin e familjes, edukimin e fëmijëve etj.

Ndikimi i qytetit në jetën kulturore, përveç arsimit, në fshatrat e kësaj zone gati nuk ndihet. Nuk ka ndonjë aksion ose plan pune të organizuar në këtë drejtim. Këtu nuk vjen asnjë ekip për të dhënë ndonjë program zbavitës e kulturor, nuk shfaqet asnjë film, nuk jepet asnjë koncert. Madje, as në shkollat e kësaj treve nuk ekziston ndonjë grup, shoqatë, ose ekip folklori, ose ndonjë lloji tjetër të aktivitetit kulturor. Nga ky aspekt vetëm radioaparati e televizori kryejnë një mision kulturor, përkatësisht ndikojnë në zgjerimin e horizontit dhe në procesin e urbanizimit në përgjithësi.

Vendbanimet janë ai element i hapësirës gjeografike, i cili qysh në vështrim të parë japin një pasqyrë mjaft të qartë të shkallës së zhvillimit dhe të gjendjes së përgjithshme ekonomike e shoqërore të popullsisë së tyre. Kështu edhe fshatrat e Lugut të Baranit me pamjen e tyre të jashtme, me tipin dhe kompozicionin e tyre, e sidomos me tipat e shtëpive, tregojnë shumë, jo vetëm për gjendjen e tashme, por edhe për të kaluarën e kësaj treve. Por këtu kemi në shqyrtim ndryshimet bashkëkohore, procesin e urbanizimit të vendbanimeve, megjithëse ato janë një dokument i llojit të posaçem i kohëve të kaluara dhe një temë me interes për kërkime e shqyrtime shkencore nga shumë aspekte të shkencave shoqërore.

Procesi i urbanizimit është më i dukshëm dhe ka arritur shkallë më të lartë në ndryshimin pozitiv të vendbanimeve sesa të popullsisë. Por ky është një proces i njohur në evolucionin e shoqërisë — më lehtë e më shpejt ndryshon jeta ekonomike, ana materiale në një mjedis, sesa ndryshon psikologjia e njeriut dhe njeriu në përgjithësi. Kështu ka ndryshuar shtëpia fshatare, e cila në shumë raste ka stilin e shtëpisë bashkëkohore të qytetit. Ajo ndërtohet tani nga materiali i fortë, zakonisht nga tullat e pjekura në vend, ose nga tullat („blloqet") e mëdha të fabrikës. Fshatari tash për ndërtimin e shtëpisë përdor hekur e çimento dhe tjegulla „të Selanikut", në vend të baltës e qerpiçit dhe të rrasave të gurit me të cilat e mbulonte kulmin. Shtëpia e tij tash ka dritare të gjera, të mëdha, madje më të mëdha se ç'ishte dera kryesore në shtëpinë e tipit të vjetër. Dimensionet e shtëpisë re në Lug të Baranit tash janë më të vogla në shumë raste se më parë. Kjo për arsye se shtëpinë e re e ndërtojnë para së gjithash ata njerëz që kanë hyrë në punë diku në qytet, ose në shtete të jashtme, të

cilët janë ndarë nga gjiu i familjes së madhe, kështu që nuk kanë nevojë për ndërtesë të madhe ku strehoheshin 20 e më shumë pjesëtarë të familjes.

Me ndërtime të reja po ndryshon edhe tipi i fshatit, sepse zakonisht këto ndërtime bëhen diku në skaj të fshatit ose më larg tij në fushë. Në këtë mënyrë po zvogëlohen sipërfaqet e tokës së bukës, kështu që nga aspekti ekonomik ky lloj i urbanizimit shkon në dëm të ekonomisë bujqësore.

Kontakti me qytetin është i përditshëm, i pandërprerë, qoftë nëpërmes të mjeteve të telekomunikacionit dhe gazetave, qoftë me anë të komunikacionit automobilistik. Kuptohet se kjo e bën të vetën, kështu që disa elemente të jetës qytetare depërtojnë në këto fshatra, megjithëse jo në atë masë si do të depërtonin sikur të ekzistonte baza e mjaftueshme materiale, puna e organizuar dhe e përhershme në këtë drejtim.

Praktika ka treguar se në procesin e urbanizimit të popullsisë dhe të vendbanimeve industria ndikon më shumë se çdo gjë tjetër. Dihet mirë se mënyra e prodhimit ndikon fuqimisht në formimin e koshiencës dhe të botëkuptimit të njeriut. Lugu i Baranit, si e thamë edhe më parë, është trevë krejtësisht bujqësore, sepse në ata pak njerëz që janë në punë jobujqësore dhe ata punëtorë në punë të përkohshme në vendet e jashtme, përbëjnë një përqindje fare të vogël në krahasim me popullsinë e këtyre fshatrave që merret vetëm me bujqësi. Prandaj, për t'iu hapur rruga procesit të urbanizimit më të shpejtë, duhet të merren masa përkatëse për ndryshimin e strukturës sociale të kësaj popullsie. Kjo mund të bëhet me inkuadrimin e një numri sa më të madh të njerëzve në ndërmarrje të ndryshme në Pejë dhe në qytete të tjera dhe me hapjen e ndonjë ndërmarrjeje industriale në këtë zonë, përkatësisht me hapjen e ndonjë objekti industrial të organizatave të punës së bashkuar në ekonomi të qytetit. Kështu p.sh. do të mund të vepronte Kombinati i lëkurëve dhe i këpucëve nga Peja, ose ndonjë fabrikë tjetër qoftë nga Peja qoftë nga ndonjë qytet tjetër i Kosovës, ose edhe jashtë saj. Në Sllloveni ekziston një mori ndërmarrjesh, përkatësisht repartesh të kombinateve të mëdha, nëpër shumë fshatra. Kosova nuk ka industri të zhvilluar, e cila do të mund t'i angazhonte të gjithë ata që janë pa punë as në qytete, kështu që fuqia punëtore nga fshati as që vjen në konsiderim për t'u angazhuar në industrinë e qytetit. Prandaj e vetmja rrugë mbetet hapja e reparteve të vogla industriale në fshat, nëse dëshirojmë ta nxjerrim nga prapambeturia kulturore dhe varfëria ekonomike. Zhvillimi i zejtarisë do t'ishte gjithashtu faktor i rëndësishëm në këtë drejtim. Tashmë kuadrot nuk mungojnë sepse nga Universiteti i Kosovës çdo vit dalin ekspertë të rinj për degë të ndryshme ekonomike dhe kulturore.

TRADITA POPULLORE DHE NDRYSHIMI I SAJ BASHKËKOHOR

Tradita popullore (doket, zakonet, kultura materiale e shpirtërore e popullit) zakonisht studiohet brenda një zone të caktuar etnografike ku ajo ka tipare të veçanta, me të cilat dallohet nga zonat e tjera. Ajo mund të studiohet edhe sipas temës ose problemit të veçantë, i cili hulumtohet e studiohet në zona të ndryshme etnografike, ose edhe në suaza ndërkombëtare e botërore. Por, për këtë lloj studimi duhet të ekzistojnë më parë studime e të dhëna zonale, krahinore, në bazë të cilave mund të bëhen krahasime e përgjithësime etnografikë.

Lugu i Baranit është një zonë e vogël etnografike, pjesë përbërëse e një zone më të madhe etnografike — e Rrafshit të Dukagjinit. Nga aspekti etnografik Rrafshi i Dukagjinit është homogjen, si është homogjen edhe nga aspekti gjeografik. Ky homogjenitet shihet edhe nga të dhënat statistikore të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 1981, sipas të cilave në 8 komuna të Rrafshit të Dukagjinit (Pejë, Istog, Gjakovë, Deçan, Klinë, Rahovec, Prizren e Suharekë) ditën e regjistrimit kishte 493.433 shqiptarë, që do të thotë 84,21% nga popullsia e përgjithëshme e këtyre komunave kurse pjesa tjetër e popullsisë janë serbë, turq, myslimanë, malazezë e romë.[119] Nuancat etnografike ndërmjet zonave më të vogla brenda Rrafshit të Dukagjinit janë fare të vogla, si në të folur (gjuha), në doke e zakone, ashtu edhe në veshje, në elemente të tjera të kulturës materiale. Por, kuptohet, ka disa dallime të vogla, si kudo, të cilat janë pak më të theksuara në viset malore, që shtrihen rretherrotull zonës fushore të Rrafshit të Dukagjinit (Rugova, Hasi, Opoja etj.).

Duke marrë parasysh se nga aspekti etnografik Lugu i Baranit indentifikohet dhe shkrihet me Rrafshin e Dukagjinit, duke u dalluar me disa nuanca fare të vogla, nuk e shohim të arsyeshme që me këtë rast të merremi me shqyrtime të hollësishme të traditës popullore të kësaj zone, sepse sikur të vepronim kështu kjo do të ishte shqyrtim i traditës popullore të Rrafshit të Dukagjinit në përgjithësi, por i cunguar, sepse nuk do të përfshiheshin këtu veçoritë etnografike zonale, të cilat, sado të vogla që të jenë, e përbëjnë dhe e kompletojnë mozaikun etnografik të një tërësie më të gjerë, siç është Rrafshi i Dukagjinit. Për këtë shkak këtu do

[119] Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin*, nr. 14, Prishtinë, 1981, 10.

ta shqyrtojmë traditën popullore të Lugut të Baranit vetëm në vija më të shkurtra, duke lënë vend kështu për studime më të hollësishme të këtij lloji në mbarë Rrafshin e Dukagjinit, me ç'rast ndoshta mund t'u hyjë në punë studiuesve të ardhshëm edhe kjo që po shënojmë këtu për Lugun e Baranit.

Kultura shpirtërore e popullit. — Nga aspekti etnografik kultura shpirtërore popullore zakonisht përfshin doket e zakonet, kurse muzika, vallet, letërsia gojore etj., që janë gjithashtu manifestime të kulturës shpirtërore popullore, tash studiohen në kuadrin e etnomuzikologjisë, të folkloristikës dhe të letërsisë, madje folklori — edhe nga aspekti i gjuhësisë dhe i historisë. Pra, spektri i kulturës shpirtërore popullore është mjaft i gjerë e disiplinat shkencore të cilat merren me studimin e saj janë të ndryshme.

Fejesa në Lug të Baranit bëhej, si në viset e tjera, me shkuesi. Shkues ishte ndonjë mik i afërm i prindërve të vajzës, i cili e njihte mirë edhe familjen që kërkonte vajzën. Preferohej për shkues daja i vajzës, sepse në raste të tilla suksesi ishte më i sigurt. Shkuesit zakonisht nuk ia jepnin fjalën për të parën herë, por i thoshin se ishin mirënjohës për qëllim të mirë e për nderimin që i bëhet familjes së tyre, të cilën duan ta bëjnë mike, por „tash njëherë është heret për fejesë, sepse vajza është e re, ose në shkollë, ose e sëmurë etj.", gjendeshin arsye edhe të paqena, për ta shtyrë punën për një tjetër herë. Kjo bëhej për shumë arsye, por zakonisht për të fituar kohë që të merrnin njoftime sa më të hollësishme për djalin dhe familjen e tij, por edhe që mos të mendojë miku eventualisht se ata mezi presin ta heqin vajzën nga shtëpia. Zakonet rreth fejesës janë pak a shumë njësoj në zonat e ndryshme të Rrafshit të Dukagjinit, prandaj, si thamë më parë, nuk do të ndalemi në përshkrimin e tyre të hollësishëm, por vetëm në veçoritë kryesore dhe në ndryshimet bashkëkohore.

Deri vonë për fejesë vendoste zakonisht kryefamiljari në marrëveshje me prindërit e djalit, ose me meshkujt e shtëpisë. Por fjala e tij ishte vendimtare. Djalin as vajzën nuk e pyeste kush për këtë punë. Nuk ishin të rralla rastet kur fejesa bëhej edhe sa ishin fëmijët në djep. Madje, kishte raste kur familjet miqësoheshin edhe pa lindur fëmijët, derisa nëna ishte shtatzënë. Kjo bëhej sepse miqtë pëlqeheshin mes veti, por edhe për të zënë mik ndonjë shtëpi të fortë, e cila në kushte të vështira në të kaluarën kishte rëndësi të madhe, sepse miku i fortë ishte ndihmë e madhe për mbrojtjen e familjes e të pasurisë nga sulmet e njerëzve të cilët mirreshin me punë të prapta. Pra, fejesa gjithsesi bëhej shumë heret. Për këtë kishte edhe një arsye tjetër që na duket mjaft e rëndësishme. Siç dihet, më parë miku për vajzën jepte mjaft të holla. Këto ai i paguante herëpasherë gjatë disa vjetësh. Pra, ai kishte nevojë për afat sa më të gjatë, sepse nuk ishte në gjendje ta siguronte gjithë shumën e të hollave për pajën e vajzës (dhe eventualisht për shkues) vetëm për disa vjet. Përveç kësaj, këtu kishte njëfarë peshe edhe ana psikologjike e ambientit, e mjedisit, i cili gjithmonë ka shpjegime e komentime të vetat. Kë-

shtu, nëse mbetej djali, ose vajza e rritur pa u fejuar, dilnin fjalë të ndryshme, por më shpesh thuhej se „shtëpia e filanit nuk është për mik" — prandaj as s'i jep, as s'i merr kush. Të gjitha këto bënin që në këtë punë të nxitohej. Nuk ishte pa fjalë të tilla as Lugu i Baranit, ku tradita ruhej me shumë kujdes dhe ku burrëria çmohej mbi të gjitha, sepse ky, si e pamë në shqyrtimet e mëparshme, konsiderohej si trevë e burrave.

Tash fejesa ka dalë nga binarët e traditës. Vajzat e djemtë janë të detyruar ta kryejnë shkollën tetëvjeçare. Në Lug të Baranit janë disa tetëvjeçare, kështu që të gjitha vajzat e djemtë deri në moshën 14—15 vjeçare janë në shkollë, kur askush nuk i fejon fëmijët. Por në familje kanë ndryshuar raportet. Familjet e mëdha janë duke u ndarë dita ditës dhe autoriteti i kryefamiljarit është luhatur. Në moshën 14—15 vjeçare djemtë e vajzat e thonë fjalën e tyre, kështu që prindërit nuk mund t'ua imponojnë aq lehtë fejesën pa dëshirën e tyre. Më në fund, edhe prindërit ngurrojnë ta fejojnë vajzën në atë moshë kur ajo mund ta ndërrojë mendjen më vonë dhe të gjejë një djalë tetër në vend të të fejuarit të parë. Kështu ngatërrohen punët. Raste të tilla ka sidomos nëse vajza ose djali vazhdon mësimet në shkollë të mesme ose të lartë. Të tilla raste ka pasur, e do të ketë edhe në të ardhmen, në Lug të Baranit dhe në vise të tjera. Dikur ikja e vajzës dhe prishja e fejesës kishte pasoja tragjike, tani këto janë shumë më të lehta, por gjithësesi jo të mira, madje shpeshherë edhe të ndërlikuara. Në raste të tilla, në të kaluarën, kryefamiljari i shtëpisë së vajzës së ikur „ia kishte borxh benë me pleq" mikut se në këtë punë nuk kishte gisht shtëpia e tij, nuk kishte „hak as hile". Pasi sqarohej kështu puna, i vinte radha shtëpisë ku kishte vajtur vajza e ikur, sipas asaj nga Kanuni i Lekës „ku shkon pshtjellaku — shkon gjaku".

Fejesa nuk ka pasur as më parë ndonjë ceremonial të madh ose zakone të posaçme: zakonisht msitit, ose shkuesit, i jepej një dhuratë simbolike, dhe kur i jepet fjala, familja e vajzës caktonte ditën kur mund të vinte kryefamiljari i shtëpisë së vajzës për t'ia bërë „për hajr" vajzën, me ç'rast zakonisht „ndërroheshin shejat", jipej ndonjë dhuratë simbolike (mahramë, shami, unazë etj.). Shtëpia e të fejuarit bënte „zjafet", zakonisht një darkë, ose një drekë për shokë e fqinj, ku ishte prezent msiti dhe me këtë rast ai vihej në krye të vendit. Këtë festim e quajnë „fjalë nusje". Fjala „fejesë" në këto anë është përdorë shumë rrallë; në vend të saj saj thuhej „me zanë çikë", ose „m'e folë çikën".

Detyrimet materiale për përgatitjen e pajës së vajzës kanë qenë të mëdha edhe në Lug të Baranit, madje deri vonë përveç „pareve hupse" që eventualisht mund t'i kërkonte miku për veti, shkonin edhe rreth 5—8 milionë dinarë të vjetër për pajën e nuses, të cilën e përgatiste vajza. Me këto të holla bleheshin rreth 100 kg lesh, penj të pambuktë 500 kutë pëlhurë dhe „teshat e nuses" e „teshat e shtratit". Meqenëse çmimet e këtyre produkteve në treg rriten shumë shpejt, rritet edhe shuma e të hollave me

të cilat duhet të blehen këto. Lugu i Baranit „ka lidh sull" më 1965 që mos të fejohen vajzat pa kryer shkollën tetëvjeçare e për pajë të jepen deri 5.000.000 din.

Pas çlirimit në shumë zona ose fshatra popullsia ka marrë vendim, „ka bâ sull", me të cilat janë përcaktuar kufijtë deri ku mund të shkojnë shpenzimet e ndryshme për martesë. Në të gjitha këto „sulle" ndalohet „msiti" — dhënia e „pareve hupse" mikut për vajzën e fejuar, ose caktohet një shumë modeste, zakonisht sa për t'i mbuluar shpenzimet e përcjelljes së vajzës. Por edhe më parë, edhe tash, në Lug të Baranit kanë qenë të rrallë ata që merrnin msit.

Tash edhe shpenzimet për pajën e nusës nuk janë aq të mëdha si dikur. Kjo për arsye se tash ka filluar të ndryshojë veshja popullore me shpejtësi, kështu që nuset kërkojnë veshje „allafranga" e jo „veshje katundi". Veshja allafranga është më e lirë se ajo që vite me radhë e përgatiste vajza për ta marrë me veti ditën e dasmës. Tash paja blehet në qytet. Përveç të tjerave, për nusen blehen rreth 5 palë rroba të gatshme dhe 1—3 palë „tesha katundi".

Ceremoniali i fejesës dhe përgatitja e nuses, si shihet, kanë pësuar ndryshime cilësore. Por ndryshimi më i madh dhe më pozitiv është fakti se tash gjithnjë e më tepër të rinjtë vendosin vetë për fatin e tyre, ose të paktën edhe këta konsultohen nga ana e prindërve dhe pa pëlqimin e tyre, nëse kanë moshën mbi 15 vjeçare. Koha ndërmjet fejesës e dasmës tash është shkurtuar shumë. Nëse të rinjtë merren vesh vetë, kur këta janë në moshë të pjekur, ky interval mund të jetë disa vitesh, ose disa muajsh. Më parë e fejuara fshehej edhe nga të afërmit e të fejuarit. Kjo praktikohet edhe tash nëse i fejojnë fëmijët e vegjël, por nëse janë të rritur dhe njihen qysh më parë, ata shihen edhe pas fejesës. Gjithsesi këto raporte janë liberalizuar në kohët e fundit, por jo aq shumë dhe jo në çdo familje.

Dasma zhvillohet sipas traditës dhe tiparet kryesore i ka të ngjashme, ose të përbashkëta, me shumë zona etnografike të Kosovës e të Malësisë së Gjakovës.[120] Në shtëpinë e nuses kësaj i paraprin „nata e kanagjeqit", me këngë shpotitëse të shoqeve dhe me lot të saj, kurse në shtëpinë e dhëndrit mblidhen dasmorët në mengjes ditën e dasmës. Deri para disa vjetësh nusja merrej të enjten. Nëse dhëndri ishte vejan, dasma bëhej të hënën. Tash zakonisht dasma behet vetëm të dielën. Më parë fqinjtë ia sillnin familjes së dhëndrit drutë një javë para dasmës. Të enjten ndahej puna mes grave. Po këtë ditë përgatitej brumi dhe qeshkeku.

[120] Myftar Memia, *Dasma e Malësisë së Gjakovës*, Etnografia Shqiptare, I, Tiranë, 1962, 276—306; Abaz Dojaka, *Ceremoniali i dasmës shqiptare*, Etnografia Shqiptare, IX, Tiranë, 1978, 115—150; Agron Fico, *Tradita dhe e reja në ceremonialin e dasmës*, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike, Tiranë, 1976, 199—207; Llambrini Mitrushi, *Dasma në lalet e Myzeqesë*, Entnografia Shqiptare, II, Tiranë, 1963, 175—217; Kolë Shtjefni, *Doke Mirditore*, Etnografia Shqiptare, II, ..., 275—309.



Sipas „sullit të katundit", tash vajzat shkojnë nuse në moshë më të pjekur

Gjellën (kazanin e mishit) e përgatitnin njerëzit e sprovuar në këtë mjeshtri, ndërsa gjellët në tepsi i bënin gati gratë. Për të marrë nusen shkonin e ktheheshin para dite — sa është dita mbarë, në të rritur. Në qerre për të marrë nusen shkojnë 3—4 gra dhe me to një çun i vogël, që është zakonisht „djalë hasreti". Këto gra në Lug të Baranit i quajnë „gra të kerrit", kurse në disa vise të tjera iu thonë edhe „bulla të kerrit". Ato në shtëpi të nusës i gostitin mirë, por edhe i rëndojnë me këngë fyese, që i këndojnë shoqet e nuses. Duket se ky zakon nuk praktikohet në disa vise të Kosovës, si p.sh. në Podgur të Istogut. Tash „grave të kerrit" nuk u kthejnë bukë, prandaj mund të vijnë më shumë. Dasmorët nuk qëndrojnë shumë në shtëpinë e nuses, sidomos nëse kanë rrugë të largët. Kur çohen për t'u kthyer, secili dasmor lë në tabak të kafes pak të holla. Kryefamiljari ia dorëzon nusen babait ose të vëllait të dhëndërit, duke i thënë „Ia pafsh hajrin e ua gëzoftë konakun". Ka qenë zakon që dikush nga dasmorët më të rinj të „vjedhë" një filxhan pasi të pinin kafen, „për t'i marrë soin fisit tjetër". Kështu bëjnë edhe në Malësi të Gjakovës. Nusja pa u nisur qan me zë dhe kur vjen koha për t'u nisur, ajo, duke qarë kështu, kundërshton të hyjë në qerre. Vëllezërit e marrin për krahë dhe e fusin në qerre, duke e qetësuar që të mos qajë. Kjo dikur ishte një skenë dramatike në ceremonialin e dasmës, e cila përcillet fillim e mbarim me këngë e hare. Në shtëpinë e dhëndërit zhvillohet ceremoniali i njohur kur të arrijë nusja: kumbara hedh të holla metalike, të cilat i mbledhin fëmijët, hidhet grurë e sheqer etj. — që të sjellë nusja bereqet e jetë të ëmbël në shtëpi. Kur të hyjë brenda, e ulin në karrigë dhe ia vënë në prehër një djalë të vogël, i cili duhet t'i ketë gjallë të dy prindërit. Nusja pastaj „bën divan" e pranë saj rri motra ose kunata e dhëndërit, dhe kështu ngjallet kënga e shtohet gazmendi.

Ky ceremonial, të cilin këtu e cekëm vetëm shkurtimisht, sepse ai është i njohur dhe gati i përgjithshëm ndër ne, tani ka pësuar ndryshime të mëdha në Lug të Baranit dhe kudo. Nusja tash nuk vjen në veshjen kombëtare, por „alafranga" dhe e mbuluar me vel të bardhë. Paja e nuses nuk është e qëndisur me grep e gjilpërë, si përpara, sepse kjo është blerë e gatshme në qytet. Nusja nuk merret me kalë, ose me qerre kuajsh si dikur, por me veturë, ose me traktor. Dasma më parë zgjaste 2—3 ditë dhe ftoheshin edhe më se 100 dasmorë. Tani ajo është shkurtuar fare, kështu që kryhet brenda ditës — dasmorët vijnë në mengjes, shkojnë për të marrë nusen e kthehen para dreke, hanë drekë dhe në mbrëmje shpërndahen. Mirëpo, megjithatë shpenzimet e dasmes janë të mëdha. Madje, në disa raste, edhe tash dasma zgjat deri të nesërmen.

Nuk ka ndryshuar tradita që gazmendi i dasmes të bëhet veç e veç për gra e burra. Bile, zakonisht burrat me këtë rast priten në shtëpinë e fqinjit, që e ka odën e mysafirëve të madhe, kurse gratë rrinë në odën e mysafirëve në shtëpinë e dhëndrit. Në vitet e fundit ka filluar të përdoret në disa raste edhe alkooli, i cili deri vonë nuk përmendej fare. Mirëpo, këto janë raste të rralla dhe zakonisht përdoret vetëm për një kategori njerëzish (nëpunës, ar-

simtarë, mysafirë nga qyteti etj.), të cilët me këtë rast vendosen në një sofër, ose dhomë të posaçme. Nga instrumentat, më parë në dasmë dëgjohej vetëm tupani, defi, zurla e çiftelia. Tani tupanin e zurlen po e zëvendëson gjithnjë e më tepër violina, e nganjëherë edhe fizarmonika. Por tani gati s'ka dasmë ku nuk dëgjohen këngë e muzikë nga shiriti i manjetofonit. Ka qenë zakon që, para së të shpërndaheshin, dasmorët shkonin për ta parë e për ta dhuruar nusen, por tani edhe kjo pikë e ceremonialit të martesës është hequr nga rendi i ditës në shumë raste.

Lindja e fëmijëve është qëllimi kryesor i martesës ndër fshatarët tanë. Rritja e familjes në të kaluarën kishte interes më të gjerë, sepse kështu rritej e përforcohej vëllazëria dhe fisi. Madje për këtë qëllim ata që kishin gjendje më të mirë ekonomike, dikur i merrnin 2 dhe 3 gra, por nëse nuk kishin fëmijë me gruan e parë, edhe ata që ishin „të të hollë nga takati", me gjendje më të dobët ekonomike, martoheshin përsëri, duke e mbajtur edhe gruan e parë. Edhe në Lug të Baranit ka pasur, e ka edhe tash, burra me dy gra. Por këta janë fare pak dhe janë njerëz të moshuar, kështu që në gjeneratat e reja nuk ka raste të tilla. Të ninjtë, nëse nuk kanë fëmijë me gruan e parë mund të ndahen nga kjo e të martohen me një tjetër, dhe nuk jetojnë në bigami.

Gruaja shtatzanë respektohet në familje dhe ndaj saj kanë kujdes, kështu që nuk e ngarkojnë me punë të rëndë (e lirojnë nga „rendi i magjes", nuk shkurton dru, nuk shkon për ujë, as nuk bën ndonjë punë tjetër në fushë). Atë e ruajnë gratë e tjera, sidomos vjehrra, edhe nga „syni i keq", nga shtrigat dhe „mëgjitë" e ndryshme. Prandaj përpiqen që ajo mos të dalë në rrugë e në fshat, mos të shihet nga shumëkush, dhe natën mos të mbesë vetëm, sidomos në muajtë e fundit, kur burri fle në dhomë të burrave.

Kuptohet se edhe në këtë trevë, si kudo ndër ne, të gjithë dëshirojnë që të lindë djalë, të rritet e të përforcohet familja edhe me një mashkull, me një punëtor e, dikur, — edhe me një pushkë. Lindja e djalit lajmërohej me të shtëna nga pushka dhe bëhej gosti" për miq e kojshi", sidomos nëse ky ishte djali i parë i prindërve. Gruaja e cila kujdesej për nusen me rastin e lindjes, i lajmëronte e para burrat për lindjen e djalit dhe me këtë rast kryefamiljarit i thoshte: „Myzhde, se na u shtue nji mashkull!"

Lindja e vajzës shkaktonte një atmosferë krejt të kundërt në familje, sepse, sipas traditës, „vajza asht kafshata e huej" dhe „prej saj s'ka hajr shpija, sepse asht mall i huej." Madje, kur vijnë fqinjtë për të uruar djalin zgjedhin fjalë më të mira për jetën e gjatë e të lumtur të tij e të prindërve, kurse për vajzën thonë: „A ju idhnoi kjo çikë? Ishalla tash e mbas ju gëzon zoti me djalë." Ose thonë fjalë ngushëllimi, si p.sh.: „Mos merziteni, se edhe çika asht rob i zotit. Mos me le çika, s'kishin me le as djem. Me çikë nxan njeri mik të mirë." etj. Urime, ose ngushëllime të tilla të rastit ka edhe në Malësi të Gjakovës.[121] Foshnjen e ruajnë që mos

[121] M. Memia, *Lindja dhe kumbaria në Malësinë e Gjakovës*, Etnografia Shqiptare, II, Tiranë, 1963, 266.

ta shohë kushdo, sepse mund t'i ngjajë ndonjë gjë e keqe nëse e sheh „syri i keq". Për ta mbrojtur nga rreziku eventual i tillë, në dhomë ku rri foshnja vënë thelba hudre, gërhanë, lëkurë iriqi etj. — gjëra që mbrojnë më tepër nga shtrigat. Po me këtë qëllim, tërë natën e mbajnë llamben ose bishtukun ndezur. Tash këto zakone i mbajnë vetëm plakat.

Kumbaria zë vend të rëndësishëm në tradifën tonë popullore. Kumbara e ndrikulla konsiderohen si njerëz shumë të afërm të familjes. Kumbaria është disa llojesh: kumbara i fëmijës, përkatësisht ndrikulla, e cila ia pret kërthizën, kurse te katolikët ekziston edhe kumbara i pagëzimit (i cili e mban fëmijën në kishë me rastin e pagëzimit dhe dhënies së emirt), pastaj kumbara i kurorës, i cili është dëshmitar para organit përkatës shtetëror ose fetar me rastin e regjistrimit të kurorës, dhe kumbara i flokëve, d.m.th. kumbara i cili ia pret flokët famullit për të parën herë. Kumbaria është një institucion i njohur kudo ndër ne, madje edhe ndër popuj të tjerë të Ballkanit,[122] dhe kudo i ka të përbashkëta tiparet kryesore të traditës popullore, si edhe respektin e posaçëm reciprok mes dy familjeve, të cilat lidhin kumbarinë. Me interes të posaçëm për shqyrtimin e këtij institucioni nga aspekti shkencor është pengesa për martesë midis familjeve që kanë lidhur kumbari. Madje, në raste të tilla ekzogamia është më eksklusive sesa brenda fisit, sidomos në ditët tona, kur përkatësia fisnore ka humbur gati krejtësisht kohezionin e dikurshëm. Nga kumbaritë e ndryshme më tepër respektohet ajo e fëmijës, kumbaria e „famullit", që zgjat e nderohet brez pas brezi. Ky është „kumbara i shpisë", njësoj si në Malësi të Gjakovës,[123] i cili gëzon respekt nga të gjithë pjesëtarët e familjes.

Vëllamia gjithashtu ka qenë një ndër zakonet e Lugut të Baranit, por kjo ngjante rrallëherë. Termi „vëllami" nuk dëgjohet në fshatrat e Kosovës, por thuhet „vllaznim", „me u vllaznue", ose „probatim", „pobratim", „me u pobratimue" — që është fjalë sllave. Vëllamia lidhej si kudo ndër ne, mes dy personave duke pirë një pikë gjak nga gishti i shoqishojt, qoftë në gotë të ujit, qoftë në kokërr të sheqerit. Prej asaj dite dy vetë të vëllazëruar në këtë mënyrë konsideroheshin si vëllezër të vërtetë. Kjo lidhje bëhej midis njerëzve të fiseve të ndryshme e jo brenda fisit, sepse njerëzit e fisit edhe pa këtë mbahen si ceremonial kusherinj dhe nuk ka nevojë për lidhje tjetër artificiale mes tyre. Me rastin e vëllezërimit njerëzit e fshatit shkonin për urime, madje, dikush bënte edhe „zjafet", duke shtruar një drekë, ose darkë për miq e fshat. Por, si e thamë, ka kohë që ky zakon është harruar fare dhe nga pleqtë, ndërsa të rinjtë vetëm kanë dëgjuar për të. Në të kaluarën mund të ketë pasur raste të motërnisë, mes femrave, përkatësisht mes vajzave. Por ky zakon nuk ka pasur asgjë të posaçme në Lug

[122] Borivoje Drobnjaković, *Etnografija naroda Jugosllavije, I*, Beograd, 1960, 139.

[123] M. Memia, *Lindja dhe kumbaria....*, 270.

të Baranit, sepse motivacioni ishte gjithkund i njëjtë e ceremoniali fare i thjeshtë dhe i përbashkët në vise të ndryshme, jo vetëm ndër ne, por edhe ndër popuj të tjerë ballkanas.[124] Kuptohet se midis familjeve të vëllezëruara në këtë mënyrë përjashtohet lidhja e miqësisë — dhënia ose marrja e vajzave.

Vdekja parashikohej në mënyrë të ndryshme. Nëse mbi pullaz të shtëpisë këndonte qyqja, besohej se atë vit do të vdiste dikush në atë familje. Nëse leh qeni si duke ulëruar, duke e dredhur zërin, edhe ky ishte një paralajmërim i vdekjes. Nëse kërcisnin trerët e shtëpisë, gjithashtu ky ishte një shenjë ugurzezë. Vdekja parashikohej edhe nga shpatulla e berrit, ose e pulës. Disa nga këto shenja shpjegohen në këtë mënyrë edhe në vise të tjera, si p.sh. në Kelmend të Malësisë së Madhe etj.[125] Nëse sëmurej fëmija, ose ndonjë pjesëtar i ri i familjes, besohej se ky rrezik shkaktohej nga „syni i keq", nga shtrigat, ose nga ndonjë gjë e ngjashme. Kundër sëmundjes luftonin me mjete primitive — shkruanin hajmali te hoxha, bënin „nezër" (dhurata) në kishë e në xhami, fiknin thëngjill druri te ndonjë jevge dhe ata ujë e pinte i sëmuri etj.

Vdekja lajmërohej në fshat me kukamë të grave të shtëpisë. Miqve e shokëve në fshatra të largëta u dërgonin lajmin me njerëz të fshatit — mik pas mikut, duke e përcjellë kështu lajmin deri te miku më i largët. Burrat nuk qajnë. Zakonet popullore të vdekjes janë të përziera shumë me adete fetare si te myslimanët, ashtu edhe ndër katolikët. Por edhe ato veprime të rastit, që kanë ngjyrën e traditës popullore, janë shumë të ngjashme në vise të ndryshme. Prandaj nuk do të ndalemi në përshkrimin e hollësive të tyre në Lug të Baranit, por do t'i cekim vetëm momentet kryesore.

Nëse vdes ndokush natën ose në mbrëmje, atë e ruajnë atë natë fqinjët. Gratë e vajtojnë derisa ta marrin për ta çuar në varr. Të vdekurin myslimanët e varrosin më shpejt se katolikët. Varrin e bëjnë „vorrtarët" — miq e e kumbarë nga fshati. Atyre nuk duhet t'u thohet „Puna e mbarë", por vetëm „A u lodhët" dhe „Zoti ua baftë sevap". Të vdekurin e ruajnë mos të kalojë kush mbi të, sidomos mos të kalojë maca, sepse „mund të çohet lugat". Varri bëhet më i thellë për gra se për burra. Deri vonë nuk përdorej arkivoli, por vihej një rend dërrasash pjerrtas në varr mbi kufomë dhe pastaj mbulohej me dhe. Gratë nuk shkonin në varrim. Të gjithë të pranishmit hudhin një grusht dhé në varr — për t'i qenë toka e lehtë të varrosurit. Pas varrimit shumë nga të pranishmit thonë: „Dritë pastë në atë jetë", „I koftë e lehtë toka", „Rahmet i pastë shpirti", „E gjetshi në ahiret" etj. Pjesëtarët e familjes së afërme rreshtohen në skaj të varreve dhe pjesëmarrësit në varrim me rend ua japin dorën, duke u shprehur ngushëllimet me „Ju shëndosh." Ndër katolikët, para se të shpërndahen,

[124] Grup autorësh, *Narodi Jugoslavije*, Srpska akademija nauka i umetnosti, Posebna izdanja, knj. CCCLXXXV, Beograd, 1965, 85.

[125] Fadil Mehmeti, *Zakone, rite e besime vdekjeje në Kelmend*. Etnografia Shqiptare, IX, Tiranë, 1980, 337.

dikush nga familja, zakonisht i zoti i shtëpisë, u shpreh falnderime me disa fjalë dhe i fton të gjithë „në darkë e cila do të jepet për shpirtin e të ndjerit N...” Për këtë darkë therret një gjedh, nëse ka vdekur i zoti i shtëpisë, therret kau i lavres.

Të nesërmen hapet e pamja. Vijnë njerëzit nga anët e ndryshme, i shprehin ngushëllimet të zotit të shtëpisë dhe meshkujve të tjerë të shtëpisë dhe të afërmëve të vdekurit me këto fjalë: „A po merziteni?”, „Qysh jini me gajret?”, „A ju dhimtë N...?” — dhe pastaj vazhdojnë fjalët ngushëlluese: „Mos merziteni, se të gjithë jemi të dekës, të gjithë jemi në atë rrugë, shyqyr që ka lanë djemtë e shpinë plot mashkuj, ju kofshi shëndosh” etj. Shumkush thotë me këtë rast vetëm „Ju sh'ndosh e zoti u dhashtë saber e kyvet.” Ai, të cilit i drejtohen këto fjalë përgjigjet sipas pyetjeve dhe ngushëllimeve që i drejtohen, e sidomos në atë „Ju shëndosh” ai thotë „Me miq e dashamirë shëndosh”, ose „Zoti u paftë e u rujtë, jau ktheshim në gëzim” etj. Në kohët e fundit, kur vijnë disa vetë përnjëherë, zakonisht flet vetëm njëri ndër ta, ai të cilin e qesin përpara për t'u prirë. Ky i drejtohet të zotit të shtëpisë: „Në emen të këtyne burrave e në emen tem, ty dhe të gjithë që janë për kryeshëndosh, zoti u lashtë shëndosh e u dhashtë gajret.” Zoti i shtëpisë përgjigjet: „Me ju lena zo' shëndosh, kofshi faqebardhë e jua ktheshim në gzime, zoti u paftë e u rujtë”. Ky zakon i ri nuk praktikohet gjithkund, megjithëse është shumë praktik dhe i arsyeshëm.

Pamja, ose „e pamja”, bëhet zakonisht në odën e mysafirëve të fqinjit, kurse gratë mblidhen në oden e miqve në shtëpinë e të vdekurit, dhe aty vajtojnë. Miqtë e largët që i zë koha e drekës në të pame, nuk rrinë aty për drekë, por i merr dikush nga fshati. Në pamje mysafirëve u jepet duhan e kafe, ndër katolikët edhe një gotë raki. Kafja më parë zihej pa sheqer, e idhët, edhe tani bëhet kështu në shumë raste, sidomos nëse i vdekuri ka qenë djalë i ri. Pamja, sipas sullit të Lugut të Baranit, zgjat zakonisht 1—2 javë, por nëse ndokush vjen edhe më vonë, sepse nuk ka dëgjuar më heret për rastin e vdekjes, i zoti i shtëpisë e pret me mirënjohje. Më parë ka qenë zakon që gratë e vajtonin të vdekurin 3 ditë, dhe për këtë rast në dërrasa, ose në dysheme, e shtronin veshjen e tij, „i qitshin teshat” në formë si t'ishte i veshur personi i vdekur, me kuti të duhanit, me qystek sahati, me armë, fyell, shkop, etj. që i mbante për së gjalli. Burrat nuk mbajnë zi me asnjë shenjë të jashtme. As gratë, sidomos ato më të moshuara, nuk vënë ndonjë shenjë të zezë për të treguar se mbajnë zi për ndonjë njeri të afërm që ka vdekur. Vetëm vajzat venë në kokë shami të zezë e mbathin çorapë të zeza, por ky është zakon i ri, i cili praktikohet në vitet e fundit si ndikim nga qyteti, zakonisht në familjet katolike. Megjithatë në familje mbretëron atmosfera e vdekjes, e dhëmbjes shpirtërore, gati një vjet — nuk bëhet gazmend, nuk këndohen këngë, nuk shkojnë në dasma etj. Ditën e tretë gratë e farefisit shkojnë „me pa me tepsi”. Tepsia nuk kthehet thatë, por me pak djath, bukë etj.

Nuk është zakon të flitet shumë për të vdekurin. Madje edhe emrin ia përmendin shumë rrallë. Kjo për arsye sepse besohet se

duke e përmendur emrin e tij, ai trazohet në varr. Por ekziston ndër shumë popuj edhe besimi se në këtë mënyrë, duke e përmendur vdekjen shpeshherë, ajo mund të vijë përsëri në familje.[126] Edhe kur e përmedin emrin e të vdekurit, gjithmonë thuhet „dritë pastë”, ose „rahmet pastë”. Varrin e vizitojnë vetëm gratë ditën e dytë të varrimit dhe pas 40 ditësh. Burrat nuk shkojnë te varri, përveç katolikët „ditën e të Shumëve” — me 1 nëntor; por kjo është festë fetare, e jo traditë popullore. Për varre popullsia e të dy besimeve nuk kanë as më të voglin kujdes, kështu që pas disa vjetësh ato rrafshohen, me vështirësi mund të dallohet vendi ku është varrosur dikush para 30—40 vjetësh, sepse shpeshherë mungojnë edhe gurët e mëdhenj që zakonisht vihen mbi varr te koka e në fund të këmbëve.

Ndryshimet bashkëkohore në zakonet e vdekjes janë fare të vogla. Por ajo që ka më tepër rëndësi është qëndrimi ndaj sëmundjes, për shërimin e së cilës tani nuk kërkon askush ndihmën e hajmalisë e të falltoreve, por në ambulancën e Baranit, ose në spitalin e Pejës. Është shkurtuar koha e shprehjes së ngushëllimeve (të pames) si edhe vajtimi i grave. Tash përdoret në shumë raste arkivoli, madje kurora mund të shihet në funeral, sidomos kur vdes ndonjë nxënës, arsimtar etj. Edhe ndikimi i fesë ka filluar të dobësohet në këto raste, kështu që në varrimin e aktivistëve shoqëroro-politikë, dhe të ateistëve të tjerë nuk marrin pjesë klerikët myslimanë as katolikë. Tani disa kanë filluar t'ua rregullojnë varrin prindërve ose fëmijëve të tyre dhe të skalitin në to tekstin përkatës në gjuhën amtare në vend të shkronjave arabe.


Bestytnitë e ndryshme deri vonë kanë qenë të përhapura shumë edhe në Lug të Baranit, si kudo në vise të tjera në popullsinë fshatare. Kuptohet se ato janë prezente edhe sot në botëkuptimin e gjeneratave të moshuara. Këto janë shumë të ngjashme, ose identike, jo vetëm në krahina e zona të ndryshme etnike, por edhe ndër popuj të ndryshëm të Ballkanit e të tjerë.

Janë të shumta besimet e kota dhe bestytnitë në lidhje me trupat qiellorë, elementet dhe dukuritë e ndryshme natyrore. Kështu toka parafytyrohet si një rrasë e rrumbullaktë, të cilën e mban mbi shpinë „kau i zi”. Ekziston edhe shprehja në të folun të popullit „këtu e deri në ka të zi” (p.sh. „Nuk mund të gjindet edhe me gropue këtu e deri në ka të zi”. Ose, kur betohen thonë edhe kështu: „E paça në qafë këtë tokë këtu e deri në ka të zi”... etj.). Termeti shkaktohet nga kau i zi — kur ai e dridh lëkurën, ose kur zemërohet e shqetësohet, dridhet toka. Hëna është motra e diellit. Kur luftojnë drangoi e kuçedra — zihet hëna, ose diell. Për t'i ndihmuar drangoit shtinin më parë me pushkë, i binin tupanit ose kantave, dërrasave etj. për të bërë zhurmë e rrapllimë sa më të madhe, me qëllim që ta trembnin kuçedren. Në traditën tonë popullore dielli konsiderohet perëndi.[127] Kur bie ndonjë

[126] Džems Frejzer, *Zlatna grana*, Studija mađije i religije, Beograd, 1937, 67. Shih edhe M. Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime*..., 113.

[127] Jani Nushi, *Mitologji e besime në Myzeqe*, Etnografia Shqiptare, V, Tiranë, 1974, 336.

komet, duke lënë bishtin e flaktë e të gjatë mbrapa, besohet se dikush në atë moment vdes, dhe njerëzit që e shohin këtë dukuri të zakonshme natyrore, pëshpërisin: „Dritë pastë", ose „Ishalla asht larg nesh". Kur bie breshër, nxjerrin në oborr gjëra metali — kaci, mashë, vargoj etj. Murmurima, vetëtima e rrufeja shkaktohen nga lufta ndërmjet kuçedres e drangoit. Në natyrë gjithmonë është prezent dualizmi — e mira dhe e keqja. Njerëzit përpiqen me veprime ose lutje të ndryshme të përkrahin të mirën.



Briri i kaut dhe patkoi mbi të, në mur pranë derës së kullës, ka funksion magjik

Edhe në botën shtazore është prezent ky dualizëm, madje e njëjta gjini e disa krijesave mund të jetë në një rast e mirë e në një rast tjetër e dëmshme, e keqe. Kështu besohet se gjarpëri ka lidhje me dreqin dhe si i tillë është i rrezikshëm për njerëz e bagëti. Mirëpo, kjo mund t'i ketë rrënjët në përrallën e biblës, kur thuhet se djalli u shëndrrua në gjarpër për ta mashtruar Adamin. Nga ana tjetër ekziston gjarpëri i parrezikshëm në çdo shtëpi, madje ai është njëfarë padroni i shtëpisë, prandaj e quajnë „roja e shpisë", ose „ora e shpisë". Këtë nuk e nguc kurrkush, sepse as ai nuk sulmon askend, sipas bindjes e cila është e përhapur në shumë popuj. Nëse ndokush e mbyt këtë gjarpër, atë shtëpi do ta gjejë e liga, sepse ia kanë mbytur orën, e cila në traditën popullore nderohet edhe tash.

Ujku gjithashtu është kafshë me tipare të jashtëzakonshme, sipas besimeve të kota. Ai është në gjendje, ta pengojë djallin që mos t'u bëjë keq njerëzve, nga ai ka frikë shtriga, lugati dhe shumë krijesa të tjera të dëmshme dhe të imagjinuara nga fantazia e njerëzve të ngarkuar me bestytni e besime të kota. Prandaj edhe tash kur plakat përmendin djallin, lugatin etj., zakonisht shtojnë „ia preftë uku udhën". Disa pjesë të trupit të ujkut të vrarë i përdorin si hajmali, sidomos për fëmijë, për t'i mbrojtur nga „syri i keq" („mësyshi"). Kështu varet në djepin e fëmijës dhëmbi, ose thonjtë e ujkut, ndërsa fëmijëve të rritur këto u qepen në kapuç, ose në rroba. Në Lug të Baranit ka pasur dikur shumë ujq, në pyjet që shtriheshin nga Turjaka e deri në Dri, në pjesen kodrinore të kësaj treve. Ato bënin dëme të mëdha në bagëti dhe ishin një rrezik i përhershëm edhe për barinjtë dhe druvarët. Kuptohet se në kushte të tilla prezenca e tyre në bestytnitë dhe në imagjinatën e fshatarit ishte shumë e theksuar.

Nga kafshet e tjera më prezente në besimet e kota të gjeneratave të vjetra janë qyqja dhe lejleku, të cilat luajnë role të kundërta: qyqja negativ, kurse lejleku pozitiv. Për qyqen thamë se është ogurzezë, kurse lejleku është „shpend i shejtë", i cili sjell „bekim e bereqet" në atë shtëpi ku e ngre qerdhen e vet. Atë nuk e vret askush, se është „gjynah i madh", madje, besohet se sikur të shtinte ndokush kundër tij, plumbi do të kthehej prapë e do ta qëllonte guximtarin. Lugu i Baranit është një zonë e preferueshme për qëndrimin e lejlekëve gjatë stinës së vapës, sepse ka shumë livadhe plot lule e bar dhe shumë ujëra me bretkoca, që për ushqimin e tyre janë më të kërkuara. Sorra gjithashtu është një shpend rreth të cilit në besimet e kota thuren atribute të ndryshme, por më i përhapur është besimi se krrokatja e sorrës së larme mbi pullaz, paralajmëron mysafirin, kurse sorra e zezë „nuk ndjell mirë". Dallëndyshja që thur çerdhen e saj nën strehë të shtëpisë, trajtohet në besimet popullore ngjashëm si lejleku, prandaj ndaj saj e ndaj çerdhes së saj kanë respekt pjesëtarët e familjes.

Nga bestytnitë e besimet e kota nuk ka ndonjë gjë specifike, të veçantë për Lugun e Baranit. Zanat, shtrigat, lugati, syri i keq, të shkelurit etj. janë elemente të njohura në traditën e shumë popujve.

Z a n a t parafytyrohen si vajza të bukura që jetojnë në male të thella. Ato janë të mira e të këqia, varësisht nga ajo si sillet njeriu ndaj tyre. Zanat kanë flokët e gjata të lëshuara deri në bel dhe deri në gju, të veshura me rrobe të bardha të holla, me një vel. Ato u ndihmojnë trimave që luftojnë për drejtësi, për të mirën. Zakonisht shihen duke pirë ujë në burime të maleve ose duke u larë në përrenj të kthjellët malorë. Zanat nuk i bëjnë keq njeriut nëse nuk i nguc, por nëse i trazon kush, ato mund ta dëmtojnë, madje edhe ta mbysin. Prandaj edhe në gjuhën e popullit, në poezinë popullore, në frazeologji, në bekime e mallkime, zana është objekt i shpeshtë i trajtimit, si p.sh. „trim si zana", „u rritsh e u bafsh si zana", „të shitoftë zana" etj.

Shtriga zakonisht bëhen plakat e këqia, gratë e veja grindavece e të mbrapshta. Shtriga bën vetëm keq. Ajo është e rrezikshme sidomos për foshnje, për fëmijë, por edhe për vajza e djem të rinj.[128] Shtriga ua ha zemrën, iu zë frymën dhe kështu i mbyt viktimat e saj. Shtrigë bëhet plaka sa është gjallë, pasi të vdesë nuk bëhet më shtrigë. Ajo mund të shndërrohet në flutur të madhe e të zezë, ose në një krijesë shpirtërore, pa trup fizik, kështu që mund të hyjë në dhomë edhe nëpër vrimë të çelësit në derë. Fshatarët zakonisht e dinë se cila plakë në fshat është shtrigë. Te katolikët „i lidhin shtrigat" natën e „të lidhunave", d.m.th. natën e krezhmeve (6 javë para pashkëve). Në mbremje pas darke i zoti i shtëpisë merr një pe të zi të leshtë dhe pranë zjarrit në oxhak lidh shtrigat. Njëri nga meshkujt e shtëpisë e pyet me radhë: „Çka po lidh aty?" Ky përgjigjet: „Po lidhi shtrigën N. N. që mos të ban dam as në mall as në rob." Duke u përgjegjur kështu ai lidh në pe një nye të fortë. Pasi t'i lidhë „të gjitha shtrigat e katundit" ai perin plot nyje e fut në një birë të cilën e shpon me turjelë në një tra ose në kosh të drithit dhe e mbyll mirë me kunj. Nga shtrigat njerëzit mbrohen me thelba hudre; ky është „ilaç" i njohur kundër këtij rreziku, kurse fluturat e mëdha i ndjekin e i mbysin, sidomos ato me krahë të zezë.

Lugati, ashtu si shtriga, është mjaft i përhapur në besimet popullore ndër popuj të ndryshëm. Ai shpjegohet e trajtohet gati njësoj në besimet e kota kudo, kështu që nuk mund të thuhet asgjë e posaçme për trevën e Lugut të Baranit në lidhje me këtë besim. Këtu mund të themi vetëm këtë se në Lug të Baranit „ka ngjarë" disa herë që të „çohet lugati", i cili rrapllon nëpër shtëpi, i frikëson njerëzit, madje edhe bën dëm në bagëti e në prodhim bujqësor. Një „lugat i tillë" bridhte nëpër fshatin Llugaxhi edhe më 1979, kur, përveç marifetllëqeve të tjera, ia fuste flakën mullarit të sanës në lëmë të disa fshatarëve. Kuptohet se „lugati" ishte ndonjë fshatar batakçi, i cili kishte hesapet e veta të cilat donte t'i realizonte në këtë mënyrë. Besime të tilla të kota ka edhe sot jo vetëm në fshatra të thella e të prapambetura, por edhe në mjedise më të përparuara. Kështu para disa vjetësh në fshatin Ripanj, i cili sot është gati një lagje e Beogradit, është shqetësuar i gjithë fshati nga „një lugat" i rrezikshëm.[129] Në fshatin Lloçikë afër Aleksincit, në Shumadi, janarin e vitit 1976 fshatarët i shqetësonte lugati, i cili paraqitej natën në një shtëpi të re ende të pakryer krejt. Ata të armatosur ruajnë natën në pusi për ta vrarë lugatin. Kur fillon dikur vonë rrapllima, ata shtien shumë herë drejt shtëpisë së re. Në mëngjes konstatojnë se „lugat" paska qenë era e fortë, e cila i ka lëkundur roletët e plastmasit duke shkaktuar zhurmë të madhe. Nga plumbat e shumtë bëhen shoshë dyer e dritare, kështu që e zoja e shtëpisë i padit në gjyq „gjahtarët e

[128] H. K. Baroha, *Veštice i njihov svet, II*, Beograd, 1979, 219.

[129] Petar Vlahović, *Običaji, verovanja i praznoverice naroda Jugoslavije*, Beograd, 1972, 128.

lugatit" duke kërkuar dëmshpërblim për shtëpinë e dëmtuar.[130] Shembuj të ngjashëm ka edhe në vise të tjera, edhe në Kosovë.

Nga lugati njerëzit mbrohen në mënyrë të ndryshme, por zakonisht duke e ngulur një hu dëllinje në varrin e atij për të cilin dyshohet se „asht çue lugat", ose duke vënë një legen ujë para derës së dhomës, sepse lugati ik nga ujët, kurse lugatin mund ta mbys vetëm „dhampiri", që është i biri i lugatit. Në raste të këtilla, për ta mbrojtur fshatin nga lugati, marrin pjesë edhe klerikët — me uratë, dovë, hajmali, bekime e ceremonial fetar. „Varret e hasallakut", Varret e shehitve", Varret e mira" (në Çeskovë, Baran etj), janë vende të bekuara dhe aty s'ka lugat.

Syri i keq, ose mësyshi është një dukuri e paidentifikuar mirë në besimet e kota popullore, sepse nuk dihet kush e ka „syrin e keq", madje as personi përkatës nuk është koshient që e ka këtë veti. Syri i keq dëmton sidomos bagëtinë, por edhe fëmijët dhe çdo gjë tjetër që është e bukur. Ai shkakton sëmundje të ndryshme, madje edhe vdekjen. Prandaj fëmijëve iu vëhet hajmalia në qafë, në rrobe, në djep etj., kurse bagëtisë, sidomos qeve të bukur, në ballë. „Syni i keq mundet edhe lisin m'e tha" — thuhet në popull. Prandaj për çdo gjë që i pelqen ndokujt, qoftë njeri, kafshë, apo send, duhet të thuhet „mashalla", ose „mos e paftë syni i keq". Edhe në Lug të Baranit shumë sëmundje e fatkeqësi konsideroheshin si pasojë e syrit të keq.

Të shkelurit është gjithashtu një besim në lidhje me vendet e rralla ku zanat, ose fuqitë e tjera mbinatyrore, kanë ndenjur, ose kanë fshehur diçka të vetën (flokët e zanave, krahrin e shtrigave etj.). Ai që shkel në një vend të tillë pëson diçka të keqe, merr sëmundje të ndryshme, sidomos sëmundje psikike. Për sëmundje të tilla thuhet se „ka të shkelun" — ai që vuan nga këto, ose „ka shkelë në mgji" (në magji). Me „të shkelunit" zakonisht shkaktohen sëmundje psikike.

Sehiret janë një veprim magjik i njerëzve të këqinj me qëllim që ta demtojnë personin e caktuar, t'i shkaktojnë sëmundje, ta hutojnë, mos t'i shkojë puna mbarë etj. Sehire bëjnë edhe shtrigat, falltoret, njerëzit „me sy të keq" etj. Disa sëmundje pra, e kanë burimin nga sehiret. Kështu për njerëz të cilët kanë ndonjë sëmundje së cilës nuk i dihet shkaku, thonë „i kanë ba sehire", „e ka prej sehireve".

Kallukanxha është një krijesë e imagjinuar, e cila nuk shihet, rrin në pyje ose në mezhda të fushave dhe vepron sidomos kur ka mjegull. Ajo nuk i mbyt njerëzit as nuk u shkakton sëmundje, por i huton, kështu që njeriu të cilin „e merr kallukanxha" e humbë orientimin, shkon rrugës tjetër e jo në atë rrugë që e ka marrë, sillet vërdallë dhe nuk di të kthehet në shtëpi. Fjala

[130] Gazeta „Politika", Beograd, 18. I. 1976.

„të ka marrë kallukanxha" (ose „e ka zanë kallukanxha") dëgjohet mjaft shpesh në shprehjet figurative në gjuhën e popullit. Ky besim, kjo bestytni, është prezente edhe në traditën e disa popujve të tjerë, ndër të cilët kallukanxha ka cilësi të tjera. Disa mendojnë se kjo ka lidhje me besime të ngjashme në kohën e romakëve.[131]

Mjekësia popullore. Kjo është një temë e gjerë dhe me interes të posaçem për studim nga aspekte të ndryshme shkencore, madje edhe nga aspekti i shkencave aplikative, sidoms i mjekësisë. Mjekësia popullore mund të trajtohet si pjesë përbërëse e kulturës shpirtërore, por edhe si element i rëndësishem i kulturës materiale të një popullit, ose të një zone etno-gjeografike. Këtë e themi për arsye se populli „mjekohet" me veprime të ndryshme magjike, por edhe me barëra e bimë të tjera, me mjete materiale, megjithëse edhe këto shpeshherë i shoqëron me disa veprime magjike. Mjekësia popullore ka shumë elemente të përbashkëta ndër popuj të ndryshëm, por edhe shumë veçori krahinore dhe etnike. Këtu nuk mund ta shtjellojmë këtë temë në suazat e kësaj monografie, sepse, si thamë, është shumë e gjerë dhe me shumë elemente të përgjithëshme e të përbashkëta me vise të tjera. Prandaj po përmendim me këtë rast vetëm disa aspekte të saj, që lidhen konkretisht me Lugun e Baranit.

Edhe këtu sëmundjet psikike „mjekoheshin" më tepër me veprime magjike, me shuarjen e thëngjillit në ujë, madje dhe me dhurata të ndryshme që u jepnin „hajrateve" (vendeve të shenjta), varrezave, faltoreve etj., si kudo, kurse për sëmundje trupore, përveç magjive, përdornin bimë të ndryshme, për thyerjen e gjymtyrëve kishte njerëz të cilët dinin ta lidhnin ashtin e këmbës, ose të dorës me dy copë dërrase të hollë, pasi ta vinin ashtin në vend. Për të sëmurin kërkonin ndihmë edhe nga të vdekurit, sidomos nga „Varret e mira", „Vorret e shehitëve" etj. Deri vonë populisia e këtyre viseve vuante shumë nga malarja, ethet. Mjekimi i tyre bëhej duke lidhur penin në ndonjë dru, kaçubë etj. pranë „ujit të mirë", pranë burimeve. Kështu në Baran edhe tash ekziston toponimi „Kroni i Etheve". Druri i frashërit gjithashtu konsiderohej si një objekt me cilësi të posaçme dhe e përdornin si hajmali për njerëz e për bagëti. Mjalta e dylli përdoreshin për plagë, por edhe „për ndishk" (për të ftohur) etj. Për të fituar mëshirën e perendisë, ose të „shpirtrave të mirë", bënin edhe sakrifica materiale, prenin edhe kurbanë, siç bëhej edhe në kohët e lashta të paganizmit.

Kur është fjala për kurbanë, me këtë rast po përmendim një zakon shumë karakteristik për këtë zonë. Madje, në Baran të Epërm ndodhet burimi „Kroni i Baranit" i cili ka shumë ujë, kështu që gati 90% të fushave ujiten me ujët e tij. Mirëpo, prej Shmitrit (8 nëntor) e deri në pranverë nuk ka ujë në të. Nga frika që mos të mbesin pa ujë edhe verës, fshatarët i blejnë katundisht 2—3 desh për kurban dhe i therrin pranë burimit, për të

[131] Petar Ž. Petrović, *Srpski mitološki rečnik*, Beograd, 1970, 165.

siguruar përkrahjen e „fuqive nëntokësore". Por, për çdo eventualitet, ata me bashkë (lëkurë) të kurbanit i mbyllin vrimat në shtratin e pusit për të mos humbur ujët. Qysh në epokën e paganizmit u ofronin perendive dhe shpirtrave të ndryshem kurbanë e dhurata të tjera materiale, për të fituar „mëshirën e tyre". Këtë zakon e pranuan pastaj edhe religjionet e reja (kristianizmi, islamizmi etj.).[132]

*

Bestytnitë ende zënë vend të rëndësishëm në vetëdijen e gjeneratave të vjetra të Lugut të Baranit, sidomos ndër gra të moshuara. Por në krahasim me të kaluarën e afërme, edhe ndër gjeneratat të vjetra kanë ndryshuar shumë këto botëkuptime. Në këtë drejtim ka ndikuar mjaft shkolla dhe mjetet e informimit, pastaj kontakti me qytetin dhe botën e jashtme, e sidomos elektrifikimi. Dikur, që nga mbrëmja e deri në mëngjes, shtëpia ishte në terr, vetëm një bishtuk bënte dritë në shtëpinë e grave (kuzhinë) dhe, eventualisht, një llambë e vogël në odën e miqve, kështu që dhomat e tjera, korridoret, pojata, oborri, të gjitha i mbulonte terri. Pranë votrës pleqtë e plakat tregonin çdo mbrëmje „ndodhi" të ndryshme për shtriga, kuçedra, lugetër etj. Të gjitha këto u futnin frikën në palcë fëmijëve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, të cilët në terr „shihnin" atë çka dëgjonin nga pleqtë, sepse „frika i ka sytë e mëdhenj". Tani drita elektrike ndriçon çdo skutë dhe „natën e ban ditë", kështu që „elektriku jau ka pre shpirtave të kqij rrugën ma mirë se uku" — siç thonë tash në katund. Fëmijët mësojnë në shkollë për trupat qiellorë e për dukuritë e ndryshme natyrore. Ata tash u shpjegojnë prindërve se si e pse zihet hëna e dielli, pse vetëtin e murmuron, si shkaktohen termetet dhe çka ngjan me njeriun pas vdekjes së tij, si shkaktohen dhe si shërohen sëmundjet e ndryshme etj. Kuptohet se shumkujt nuk i mbushet mendja „nga fjalët e fëmijëve", por mjafton që fëmijët nuk u besojnë më përrallave të gjyshit. Tash edhe ndikimi i fetar, plot misticizëm e fantazi, është shumë më i vogël se para disa dhjeta vjetësh. Shërbimi shëndetësor, i cili tash vepron edhe në fshat, gjithashtu ka kontribuar shumë që njerëzit e sëmurë të kërkojnë ndihmën e mjekut e të barnave në barnatore, e jo të falltoreve dhe të hoxhës e të priftit. Megjithëse në këtë drejtim janë arritur suksese të mëdha, prapë, siç dihet, botëkuptimi e vetëdija e njerëzve nuk ndryshon aq shpejt. Prandaj ende ngjan që herëpasherë „të bredhë lugati" nëpër fshatrat e Lugut të Baranit, ose të vdesë ndonjë fëmijë nga „dhëmbi i shtrigës". Por edhe këtyre rasteve, gjithnjë më të rralla, shpejt „do t'ua presë ujku rrugën", njëherë e përgjithmonë.

Edhe disa ndryshime në vetë ambientin gjeografik kanë ndikuar që bestytnitë e ndryshme ta humbin „bazën e tyre materia-

[132] Bronislav Malinovski, *Magija, nauka i religija*, Beograd, 1971, 52; Ričard Kevendiš, *Istorija magije*, Beograd, 1979, 45;

le". Dikur, si thamë në fillim, kodrat e Lugut të Baranit ishin të mbuluara me pyje që nga fshati Turjakë e deri në Dri. „Pylli msheh gjithëçka" — thotë populli, por ai ngacmon edhe fantazinë e njerëzve, sidomos të atyre të cilët mendojnë se në pyll mund të ketë gjithçka. Tash këto pyje gati janë zhdukur fare, e ato që kanë mbetur janë të vogla, jo të përshtatshme për t'u fshehur aty të gjitha ato „krijesa" nga fantazia plot bestytni të njerëzve, të cilët janë të ngarkuar nga e kaluara me besime të kota.

Më në fund, edhe mënyra e jetesës, e sjelljeve brenda në familje, ka ndryshuar shumë. Tani në mbrëmje nuk tregojnë pleqtë e plakat përralla si më parë, për shtriga, zana, kuçedra etj., sepse fëmijët nuk i dëgjojnë as nuk u besojnë më. Nga ana tjetër, në shumë familje tani ka televizorë, manjetofonë, ose të paktën radioaparate, kështu që të rinjtë kanë zbavitje më interesante e më të dobishme nga këto mjete teknike, sesa nga nga përrallat për shtriga e dragonj.

Emri, ose antroponimia, gjithashtu është një element i traditës popullore, një komponentë e kulturës së çdo populli. Emri nuk tregon vlerën e njeriut, këtë e tregojnë vetëm veprat, sjelljet dhe qëndrimet e tij. Mirëpo emri ka rëndësi të shumëfishtë në kulturën dhe historinë kombëtare. Ai tregon deri diku edhe zhvillimin historik e shoqëror të një krahine, ose të një vendi në përgjithësi. Në bazë të emrave të njerëzve në dokumentat e vjetra përcaktohet edhe përkatësia e tyre kombëtare, shkruhet historia e një periudhe, e një populli. Mjerisht, deri para pak vitesh, ndër shqiptarë emrit nuk i është dhënë kurrfarë rëndësie. Fëmijëve u janë dhënë, e u jepen edhe sot, emra fetarë — myslimanë e të krishterë, që janë emra të huaj dhe në gjuhën shqipe asnjë nga këta nuk ka kurrfarë kuptimi, kurrfarë domethënie. Prandaj edhe nga shumë dokumente të vjetra nuk mund të dihet në bazë të emrave se për kënd është fjala, cilit popull i takojnë ata njerëz që përmenden aty, sepse shqiptarët në ato dokumenta nuk kanë emra shqiptarë, por emra të huaj, si kanë edhe sot shumica dërmuese. Kjo rrjedh nga kushtet e vështira historike në të kaluarën, por edhe nga vetëdija e ulët kombëtare dhe primitivizmi i prindërve, e sidomos nga fanatizmi fetar dhe ndikimi i dëmshëm antikombëtar i disa hoxhallarëve e priftërinjve, të cilët me fanatizëm të verbuar luftojnë kundër emrave kuptimorë shqiptarë dhe ngulin këmbë që fëmijve t'u jepen emra të huaj — arabë e latinë.

Kjo temë është problem i përbashkët kombëtar në të gjitha viset e në çdo familje. Këtë problem me shumë rëndësi nuk e trajton shkenca as shtypi jonë, me përjashtime shumë të rralla. Kuptohet se as këtu nuk mund të merremi me të më gjatë, madje as nuk do ta kishim përmendur fare sikur mos të paraqitej në popullsinë e Lugut të Baranit me disa veçanti, megjithëse në përgjithësi edhe në këtë trevë ai i ka tiparet e përbashkëta. Fshatrat e Lugut të Baranit, si thamë më parë, përbëhen 95,35% nga popullsia shqiptare e besimit mysliman dhe katolik. Gjykuar sipas emrave, në shumë raste nuk mund të dallohen katolikët nga myslimanët sepse, edhe ata mbajnë antroponiminë myslimane. Kështu

edhe në fshatrat Gllogjan e Nepole, të përbëra nga popullsia e besimit katolik, numri më i madh i banorëve të tyre ka emra myslimanë. Madje, në këto fshatra ka katolikë edhe me emër Bajram. Në fshatin Llugaxhi, pastaj në Baran të Epërm, në Gllogjan etj. ka pasur deri para pak vitesh familje të përziera — mysliamnë e katolikë, nipa e vëllezër, por gati të gjithë pjesëtarët e familjes të besimit katolik mbanin emra myslimanë. Në të vërtetë, ata me rastin e pagëzimit në kishë si foshnje merrnin emër të krishterë (kuptohet, emër të huaj), por në shtëpi merrte emër mysliman dhe emri i krishterë nuk përmendej më fare. Kjo dukuri, si thamë edhe më parë, rrjedh nga marrëdhëniet feudale në Ballkan gjatë sundimit turk, nga një anë, kurse nga ana tjetër këtë e ka nxitur afiniteti fisnor e kombëtar që ekziston ndërmjet shqiptarëve të besimeve të ndryshme.

Në dhjetëvjetëshin e fundit, me zhvillimin e arsimit dhe me rritjen e numrit të të rinjve, të cilët merren me punë jobujqësore dhe kështu ndjekin rrugën e emancipimit, ka filluar të ndryshojë edhe në Lug të Baranit qëndrimi ndaj antroponimeve. Kështu tash një numër gjithnjë më i madh i fëmijëve kanë emra kuptimorë shqiptarë, si p.sh. Agim, Afrim, Aferditë, Bujar, Burim, Burbuqe, Bekime, Fëllanzë, Flutur, Fatmir, Dritë, Driton, Shpresë, Shpëtim, Shpend, Valbonë, Valdet etj., në vend të Hasanit, Hysenit, Hysnijes, Markut, Martinit, Marisë etj. — që janë emra të huaj dhe në gjuhën shqipe nuk kanë kurrfarë kuptimi.

Edhe këtu prindërit dëshirojnë të kenë djem, e jo vajza. Prandaj vajzat shpeshherë e kanë emrin Shkurtë, Sosë, ndoshta edhe Mbarime, që shprehin dëshirën e prindërve për t'u shkurtuar, sosur, për të mbaruar vargu i vajzave, d.m.th. të lindin djem pas tyre, e jo përsëri vajza. Gjithashtu këtu mund të takohen njerëz me emër Ukë dhe Asllan (Azllan), të cilët shprehin dëshirën e prindërve që djali i tyre të jetë shëndosh e i fortë si ujk e asllan (luan). Me kohë edhe këtu antroponimia do ta gjejë rrugën e mbarë, në të cilën qysh tash janë bërë hapat e parë. Në antroponiminë serbe e malazeze dominojnë emrat kombëtar, si p.sh. Sreqko, Dragolub, Srbolub, Sllobodan, Vlladimir, Nada etj.

Kultura materiale popullore. — Shumë elemente e përbëjnë kulturën materiale të çdo populli, por për të pasur një pasqyrë të përgjithshme nga kjo sferë e krijimtarisë në një zonë etnike, mund të merren vetëm disa nga këto elemente që bien në sy më tepër. Pa dyshim një ndër elementet e tilla është veshja popullore, pastaj arkitektura, orenditë e shtëpisë, veglat e punës, veglat muzikore etj. Të gjitha këto janë objekte që kryejnë një funksion në jetën e njeriut. Por ato njëkohësisht janë edhe dokumente të llojit të vet, të aftësisë krijuese dhe të shijes së fshatarit, i cili të gjitha këto i bën me duart e veta dhe kështu jetën e tij të vështirë e bën më të lehtë e më të bukur. Kultura popullore në përgjithësi ka rëndësi historike për çdo komb, sepse ajo është një element shumë i rëndësishëm për përcaktimin e tij si komb dhe për ruajtjen e tij nga asimilimi nga popujt e tjerë. Kultura materiale mban vulën e krahinave të ndryshme etnografike edhe brenda një

populli, por ajo zakonisht ka ndonjë element të përbashkët edhe me krahinat e zonat e tjera të një vendi. Kështu kultura materiale e çdo populli paraqitet e ndryshme nëpër krahina, por këto ndryshime, ose specifika, përbëjnë një tërësi, një mozaik të bukur kombëtar, nga i cili njeriu mund të mësojë shumë për procesin e zhvillimit të tij shoqëror e ekonomik dhe për shkallën në të cilën ndodhet tash.

Veshja popullore është pjesë e kulturës materiale popullore, e cila dallohet më tepër se çdo element tjetër i këtij lloji nga krahina në krahinë. „Veshja, nga roli i saj i dobishëm dhe funksioni shoqëror që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale. Por, e parë nga elementet e zbukurimit që ajo përmban, nga format artistike që merr, nga roli dekorativ që luan, përbën edhe një element të çmuar estetik, duke u integruar kështu edhe në kulturën shpirtërore, si pjesë përbërëse të artit popullor".[133]

Në Kosovë, marrë në përgjithësi, veshja popullore nuk paraqitet në shumë varietete, me ndryshime shumë të mëdha krahinore, kështu që ajo është mjaft uniforme, sidomos veshja e burrave, kurse e grave ka më shumë dallime.

Veshja popullore e Lugut të Baranit është identike me veshjen e pjesës veriperëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, përkatësisht të „nahijes" së Pejës e të Gjakovës, prej Urës së Fshajtë të Drinit afër Gjakovës e deri në Istog, dhe prej Junikut deri në Klinë. Kjo pra, është një zonë mjaft e madhe etnografike, në të cilën bëjnë pjesë si zona më të vogla të këtij lloji: Reka, Dushkaja, Vokshi, Lugu i Baranit, Lugu i Leshanit, Lugu i Drinit, Podguri i Pejës dhe „katundet e Strellcit" — rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, prej Peje deri në Deçan, ku fillon Reka. E njëjta veshje është edhe në rrethinat e Tropojës të Malësisë së Gjakovës në Shqipëri. Për arsye të identitetit me veshjen e këtyre zonave, nuk është e arsyeshme të ndalemi në përshkrimin e hollësishëm të saj vetëm në Lug të Baranit. Veshja e Dukagjinit duhet të studiohet në tërësi në gjithë këtë krahinë ku është e përhapur, e jo në mënyrë parciale nëpër zona të vogla etnografike, siç është Lugu i Baranit. Megjithatë, për të pasur një pasqyrë sa më komplete të kësaj zone, ndoshta nuk do të jetë e tepërt nëse këtu i shqyrtojmë veçoritë kryesore të saj, duke vënë në dukje edhe ndryshimet që janë bërë në kohët e fundit në këtë element të kulturës popullore.

Veshja e burrave deri disa vjet para Luftës së Dytë Botërore ka qenë mjaft e thjeshtë: tirq të zhgunit të bardhë me gajtanë të zinj, shokë rreth brezi, mintan basme me mëngë të gjata dhe hërka, ose xhaketa përmbi, kësula dhe opingat. Tirqit kanë qenë shumë të ngushtë, sidomos këmbëzat, dhe mjaft të shkurtër, kështu që lidheshin me rrip në kërdhokulla. Gjatë prerjeve qepeshin gajtanët. Kryefamiljarët e familjeve të mëdha, e relativisht të pasur, kanë pasur shpeshherë tirq me shumë fije gajtan. Zhgunin e

[133] Andromaqi Gjergji, *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri,* Etnografia Shqiptare, VII, Tiranë, 1976, 89.



Veshje burrash në Dukagjin para 30—40 vjetësh

blenin në Gjakovë, se konsiderohej më i mirë se i Pejës, ose e prodhonin vetë dhe e „shkelnin" në Deçan, ose në Junik, kurse i qepnin terzitë nga Peja, ose nga Gjakova, të cilët gjatë dimrit shkonin e qepnin me muaj nëpër fshatra. Hërka ishte një lloj xhakete e zhgunit me mëngë të shkurtra dhe me kapole (kapulaçë). Japanxha është pjesë e veshjes e njohur ndër ne sidomos në zona malore, por ajo përdorej edhe në vise fushore në ato fshatra që kishin shumë dele. Kjo ishte veshje e bariut, në formë të pelerinës, por e gjatë deri në fund të këmbëve (zakonisht pa mëngë). Mintani ishte dikur i zhgunit (xhamadani), por në periudhën midis dy luftërave të kaluara botërore mintani bëhej nga coha ose basma e zezë, ose ngjyrë kafeje. Në fillim edhe mintani kishte një gajtan rretherrotull skajeve. Ai mund të ishte pa mëngë dhe me mëngë të gjata. Rreth brezit burrat mbanin shokën e leshtë, prodhim i vendit në vek. Shoka ishte e gjatë dhe e ngushtë me ngjyra të mbyllta, me vija horizontale paralele dhe me thekë të gjatë. Në këmbë mbanin çorapë të leshta dhe opingë të lëkurës së lopës, kurse në kokë plisin (qeleshen) në formë vezake dhe marhamën (një shall i shkurtër) e pambuktë të lidhur rreth kokës. Të mbathurat e këmisha ishin nga pëlhura e trashë e vendit. Verës burrat shkonin vetëm në këmishë e në të mbathura, sidomos kur punonin në fushë. Kryefamiljarët, nga shtëpitë relativisht të pasura, në vend të hërkës ose xhaketës vishnin qyrkun (me gëzof qengji brenda, ana e jashtme me stof ngjyre të murme). Vetëm ndonjë burrë i njohur kishte qyrk nga lëkura e ujkut ose e dhelpres.

Veshja e grave kishte, e ka dhe sot, më shumë pjesë. Para lufte kur gratë shkonin diku jashtë fshatit, vishnin tërlik e havli — një palltë basme të zezë, me gajtanë të zez, që mbërrinte deri nën gju, dhe mbi kokë vehej një shall pëlhure, i hollë dhe i gjatë deri në gju. Kjo marhamë ishte e bardhë dhe e gjerë. Veshja e përditshme është edhe sot, si më parë, ajo më e zakonshmja: këmishë e gjatë e gjerë që arrin deri në gjunj, ose pak nën ta, dy pështjellakë (kanacë), përpara më i gjatë e më i gjerë, e „pështjellaku i mbramë" i ngushtë e i shkurtër Në kokë mbajnë „lidhcë e marhamë". Marhama është e gjerë dhe e hollë, kurse lidhca e ngushtë dhe mbulon pjesën e epërme të ballit. Skajet e tyre janë të qëndisura. Të mbathurat janë dy pjesësh — pjesa e epërme nga pëlhura, kurse pjesa e poshtme, nga gjuri e poshtë, është një lloj pëlhure e leshtë ngjyre të mbyllur, si në formë zhguni. Kjo pjesë vetëm pak futet në çorapë të trasha të zeza që janë të gjata deri në gjunj kurse pjesa tjetër nxirret e kthehet përmbi çorapë, në formë të pantollonave sportive të gjuetarëve (pufkë). Opingat i mbanin të lëkurës së lopëve dhe të punuara bukur me penj të pambuktë, ose me sixhim të hollë të bardhë (me vâj). Gratë më parë vishnin jelek, ose mintan, tani zakonisht kanë triko në vend të tyre. Mintani e jeleku i grave ishin të zbukuruara me gajtanë, sumbulla e qëndisje të ndryshme. Gratë e moshuara veshin gëzof delje, sidomos dimrit. Gëzofin e veshin edhe burrat. sidomos në ato familje që kanë dhen.



Veshje të grave të moshuara në Dukagjin

Vajzat e rritura veshen si gratë e martuara, por ato nuk vënë në kokë lidhcë e marhamë. Në vend të tyre vajzat vënë shami në kokë, të cilën e lidhin nën mjekërr. Ato gjithashtu nuk stolisen si gratë e reja me rruspa, qafore, bylyzikë etj. Veshja e tyre është nga çdo aspekt më modeste se e nuseve ose e grave të reja.

Veshja e fëmijve ishte shumë e thjeshtë: një këmishë, mintan, ose triko dhe një „pështjellc" leshi i gjatë gati deri në tokë, me të cilin mështilleshin fëmijët e vegjël në vend të pantallonave. Më vonë, kur të rriten pak, u veshin të mbathura të pëlhurës së trashë, ose pantallona, si djemve, ashtu edhe vajzave. Veshjen e fëmijëve e punojnë nënat nga pëlhura e pambuktë e nga leshi. Deri në moshën 7—8 vjeçare zakonisht veshja është njësoj për fëmijët

e të dy gjinive. Më vonë vashave në vend të mbathurave të trasha, ose pantallonave, fillojnë t'u veshin fustan. Shumë prindër edhe vajzat e vogla i veshin sidomos për ditë feste si vashat e rritura — me këmishë të gjatë, pështjellakë të vegjël e mintan ose triko, sepse kjo veshje kombëtare u rri shumë bukur fëmijëve. Por kur fillojnë të shkojnë në shkollë, zakonisht i veshin me fustan, ose si çunat — me pantallona.

Veshja popullore është një nga elementet e kulturës tradicionale, e cila pëson ndryshime të mëdha dhe të shpejta nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm që i sjell koha. Ndër këta faktorë rëndësi të posaçme ka gjendja ekonomike e përgjithëshme e një zone, përkatësisht mënyra e prodhimit. Kështu në shekullin XIX dhe në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX populisia e Lugut të Baranit mbante shumë bagëti, sidomos dele. Gati çdo shtëpi kishte mjaft lesh, jo vetëm për të punuar zhgun për pjesëtarët e familjes, por edhe për treg. Kështu, zhguni ishte deri vonë tekstil kryesor, jo vetëm për veshjen e burrave, por edhe për atë të grave. Gjatë kohës së Jugosllavisë borgjeze, si thamë edhe më parë, gjendja ekonomike e politike e shqiptarëve në përgjithësi ishte tepër e vështirë. Për të paguar tatimin e taksat e tjera të rënda, fshatari ishte i detyruar të shitte bagëtinë dhe drithin e pakët që e merrte nga arat e vogla. Por bagëtia ishte mall i cili bënte pak më shumë në tregun e Pejës. Kështu dalngadalë numri i tyre u paksua shumë, sidomos i deleve, të cilat, si kafshë e imtë, shiteshin më lehtë. Në zvogëlimin dhe varfërimin e fondit blegtoral ndikoi edhe e ashtuquajtura reformë agrare („agrari"), d.m.th. marrja e tokave nga bujqit, sidomos uzurpimi i pyjeve, përkatësisht kullotave, kështu që u bë e pamundshme mbajtja e tufës pak më të madhe të deleve. Kjo ishte një nga shkaqet që filloi të ndryshojë veshja popullore edhe në Lug të Baranit, përkatësisht filloi të përdoret gjithnjë e më pak zhguni, sepse mungonte lënda e parë — leshi, të cilin fshatarët e punonin vetë, dhe kështu veshja në përgjithësi ishte më e lirë, sidomos për ato familje që kishin tufë të mëdha të deleve.

Arsyeja tjetër për të cilën filloi të ndryshojë veshja popullore ishte ndikimi i tregut bashkëkohor në periudhën midis dy luftërave botërore, d.m.th. prodhimi industrial i tekstilit. Kështu, kah vitet 1930 e këndej fillon të depërtojë shumë shpejt stofi, basma e „bezi amerikan" (pëlhurë e bardhë) edhe në fshatra të Rrafshit të Dukagjinit, pra, edhe në Lug të Baranit. Në fillim fshatarët blenin mintana të basmës në vend të xhamadanit të zhgunit, sepse këta ishin më të lehtë dhe me çmim më të ulët. Dalngadalë filluan të veshin xhaketë në vend të hërkës, të japonxhës e të qyrkut, sepse edhe kjo ishte më praktike dhe jo aq e shtrenjtë. Këto dy pjesë të veshjes më parë i veshnin të rinjtë, ndërsa pleqtë deri vonë mbanin veshjen e vjetër. Tirqët qëndruan më tepër si element i veshjes tradicionale. Madje, kur filluan disa të rinj të vishnin pantallona, ata u bënë objekt talljeje e përqeshjeje në fshat. Por koha e bëri të veten, sidomos pas çlirimit kështu që edhe pantallonat e stofit visheshin si edhe tirqt e zhgunit. Tash





Veshje nusesh

tirqët nuk i vesh më askush nga të rinjtë, kurse edhe njerëz të moshuar ka gjithnjë më pak që i veshin. Por, bie në sy se në Lug të Baranit, dhe në fshatrat e Rekës, edhe sot ka relativisht më shumë burra që veshin tirq, sesa në çdo zonë tjetër etnografike të Kosovës. Kjo ka lidhje me faktin se në këto dy zona në përgjithësi tradita popullore ruhet më mirë, por edhe me strukturën e fondit të blegtorisë, ku delja ende zë vend të rëndësishëm. Në psikologjinë e njerëzve të moshuar të kësaj ane veshja kombëtare është një shenjë burrërie. Megjithatë, nga kjo veshje sot ka mbetur vetëm qeleshja, plisi i bardhë, me përjashtim të njerëzve të

moshuar, të cilët ende veshin tirq, kurse shumë të rinj as plis nuk mbajnë më në kokë, por shkojnë kryeshtruar, ose vënë beretë franceze në vend të qeleshes.

Veshja e grave është ruajtur mjaft mirë në këtë zonë. Madje, gratë nuk kanë ndryshuar gati asgjë nga veshja që e kanë pasur edhe para luftes, përveç opingave, të cilat më parë ishin të lëkurës së lopës, e tani janë të gomës, të blera në treg. Përkundrazi, vajzat dhe gratë e reja në kohët e fundit kanë filluar ta braktisin këmishën e gjatë të pëlhurës së trashë, pështjellakët, lidhcën e mahramën, dhe të veshin dimi e xhaketë. Tash edhe nuset shkojnë me vel të bardhë e dimi të gjëra, ndërsa në arkë i palojnë 1—2 veshje „të katundit". Kështu do të zhduken shpejt shumë elemente të veshjes kombëtare edhe ndër gra, siç janë zhdukur në veshjen e meshkujve. Serbët e malazezët vishen si në qytet, kurse gratë e tyre kanë fustan të gjatë e të gjerë ngjyrë të mbyllët ose të zezë fare. Romët ortodoks vishen si serbët e ata myslimanë si shqiptarët.

Arkitektura popullore e Rrafshit të Dukagjinit është mjaft interesante, qoftë nga aspekti i tipit të shtëpive, qoftë nga ai i funksionit të saj. Në Lug të Baranit gjithashtu vërehen shtëpi të ndryshme, por prapë bie në sy njëfarë uniformiteti më tepër sesa në disa zona të tjera etnografike të këtyre anëve. Kasolla është tipi më primitiv e shtëpisë, që deri vonë ngrihej edhe nga gardhi, të cilin e lyenin nga të dy anët me baltë dhe e mbulonin me kashtë, ose me tallë. Kjo ishte shtëpia e shtreses më të varfër, shtëpi e jevgjve dhe e shërbëtorëve të dikurshëm. Tani kasollat në Lug të Baranit mund të shihen fare rrallë, zakonisht në skaj të ndonjë fshati, ku banojnë familjet jevge, numri i të cilave është fare i vogël. Edhe tipi i shtëpisë përdhese ndeshet vetëm në raste të rralla në këtë zonë. Fshatari i Lugut të Baranit preferon të ndërtojë shtëpinë në kat, kështu që shumica dërmuese e ndërtesave të vjetra e të reja janë në një ose dy kate. Në arkitekturën popullore të Lugut të Baranit dominon kulla — tip i shtëpisë së fortifikuar, e ndërtuar në shumë fshatra të Rrafshit të Dukagjinit, të Drenicës etj. gjatë shekullit XIX dhe në dhjetëvjetshat e parë të shekullit XX, për të mbrojtur sigurinë e familjes dhe të pasurisë nga sulmuesit eventualë. Kulla është e përhapur sidomos në Rekë dhe në fshatrat rrëzë bjeshkëve të Nemuna, në Dushkajë e në Lug të Baranit. Ato janë prej mureve të trasha të gurit, ose të tullave, por, aty këtu mund të shihet edhe ndonjë kullë me mure qerpiçi. Në katin e parë kulla nuk ka fare dritare, por vetëm frengji, në katet e sipërme dritaret janë të vogla, por përveç tyre ka edhe frengji. Në katin më të epërm është vetëm oda e miqve me një korridor të gjërë përpara dhe me nevojtore në një qoshe. Nëse kulla është trikatëshe, në katin e mesëm janë qileret (oda të vogla) e çifteve bashkëshortore, kurse në katin përdhesë, në ahër mbylleshin bagëtia, ndërsa tash ky kat zakonisht është shtëpi zjarmi, ose shfrytëzohet për bodrum. Pranë kullës, nëse është familja e madhe, përkatësisht ngjitur me të, është shtëpia përdhese, ku ndodhet shtëpia e zjarmit („shtëpia e grave") dhe qileret. Kulla është tip i njohur i shtëpisë edhe në Malësi të Gja-

kovës dhe në disa vise të tjera të Shqipërisë së Veriut.[134] Edhe në këto vise në të kaluarën kulla kishte funksionin e shtëpisë së fortifikuar për mbrojtjen e familjes.[135]

Kulla në Lug të Baranit ka në çdo fshat, madje shumica e shtëpive janë kulla. Disa nga këto janë të mbuluara me rrasa guri, të cilat i marrin në grykë të Bistricës, afër Nepoles. Bie në sy se çdo shtëpi në këtë zonë është e rrethuar me mur të lartë e të fortë, i cili gjithashtu në të kaluarën kishte rol mbrojtës, ngjashëm si kulla që ndodhet brenda këtyre mureve. Gjithashtu spikat dera e madhe e oborrit, e cila në disa raste ka dimensione shumë të mëdha dhe formë të posaçme — me një hark në anën e sipërme dhe të veshura me llastër (llamarinë) të fortë. Dyert e oborrit,



Kullë prej materialit të kombinuar

muri i lartë dhe kulla e fortë në rrethin e tij përbëjnë një kompleks arkitektonik, një tërësi kompakte, e cila lë mbresa madhështore në ambientin fshatar. Në oborr të shtëpisë janë objektet ekonomike — shtalla e bagëtisë, koshi dhe hambari i drithit etj. Disa nga këto, sidomos hambari e shtyllat e koshit, janë të stoli-

[134] Koço Zheku, *Kulla kruetane*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, II, Tiranë, 1969, 205—231; Pirro Thomo, *Banesa me „qoshk" në Shqipërinë e Veriut*, Etnografia Shqiptare, VIII, Tiranë, 1976, 191—237; B. Strazimiri — P. Thomo, *Kulla e Matit*, Monumente, 1, Tiranë, 1971, 149—160; Ali Muka, *Arkitektura e banesës fshatare në Martanesh*, Etnografia Shqiptare, VII, Tiranë, 1976, 201—227; Mark Krasniqi, *Kulla në Rrafshin e Dukagjinit*, Gjurmë e gjurmime, Prishtinë, 1979, 326—362.

[135] Franz B. Nopcsa, *Haus und Hausrat im katolischen Nordalbanien*, Sarajevo, 1912.

sura bukur me gdhendje në dru. Me këtë lloj mjeshtrie stolisen shumë bukur tavanet e dhomave të miqve, kapakët e dollapave, dyert etj.

Ndryshimet bashkëkohore në arkitekturën popullore në Lug të Baranit i përmendem edhe më parë. Këtu duhet të shtojmë se këto ndryshime, të imponuara nga koha dhe kërkesat e reja të njeriut, janë të dobishme sepse tash në këtë mënyrë ndërtohen shtëpi me dritare të mëdha, me material bashkëkohor, janë komode e higjenike, kështu që vetëm në raste të rralla ende jetojnë nën një kulm njerëzit e bagëtia (në ahër të kullës). Pra, ndërtimet e reja janë shtëpi të tipit të qytetit, me disa veçanti që i kërkon jeta në fshat. Por në këtë drejtim të përparimit në ndërtimin e shtëpive bashkëkohore, merren edhe masa të tjera — adaptimi i shtëpive të vjetra, sidomos i kullave për t'ua përshtatur kërkesave dhe shijes bashkëkohore. Këtu bëhën gabime të mëdha, sepse kullat kanë konstrukcion të veçantë dhe dimensione të vogla, sidomos përsa i përket lartësisë së kateve (dhomave), kështu që nuk arrihet plotësisht qëllimi për modernizimin e tyre. Nga ana tjetër, ajo që na duket se ka rëndësi të posaçme, është fakti se disa kulla, të cilat janë raritete të arkitekurës popullore të këtij lloji, po dëmtohen e po shëmtohen pa mëshirë, duke ua zegjeruar dyert e dritaret etj., kështu që „të meremetuara e të modernizuara" në këtë mënyrë, ato humbin çdo efekt estetik të jashtëm, kurse as përbrenda nuk arrihet komoditeti i dëshiruar i banimit. Kulla duhet të mbetet kullë, ashtu si është ndërtuar nga dora e ustait dibran, edhe atëherë kur të bëhën meremetime e adaptime që i kërkon koha.

Orenditë e shtëpisë, siç dihet, në fshatrat tona kanë qenë shumë të thjeshta — disa shkamba (stola) trekëmbësh, disa rafte në „shtëpinë e zjarmit" e në odën e mysafirëve, magja, sofrat, arkat e grave dhe shtretërit shumë të thjeshtë nga dërrasat. Kështu ka qenë ky inventarë në çdo shtëpi edhe në Lug të Baranit. Të gjitha këto kanë qenë prodhime, ose mjeshtri të vendit, të fshatit. Enët gjithashtu kanë qenë shumë të thjeshta: kusi të blera në Pejë, çerepë të blerë nga çerepxhinjtë e Cërmjanit (fshat jo fort larg Lugut të Baranit, në Dushkajë, i njohur për çerepë të kualitetit të mirë), vegsha, vorba dhe sahana (çanakë) të dheut e disa korita, bludë e lugë druri. Këto janë përdorur deri në prak të Luftës së Dytë Botërore, e në shumë familje edhe pas saj. Tani këto kanë ndryshuar gati krejtësisht dhe në vend të tyre përdoren enët e metalit, tenxhere të emajluara, shporete hekuri, pjata porcelani etj., ndërsa nga orenditë përdoren shumë gjëra të blera në qytet (shtretër, tavolina, karriga,madje edhe dollapë, të cilët i blejnë për nuse në vend të arkave të dikurshme).

Veglat e punës janë gjithashtu elemente të kulturës materiale të popullit. Disa nga këto edhe tash bëhen prej druri (grabujë, tërfurq, furkë, tezgjahë-vek) etj. Por tash një pjesë e madhe e punëve bujqësore kryhet me makina, kështu që veglat e punës të prodhuara në vend nuk e kanë as rëndësinë, as bukurinë

e dikurshme. Po këtë konstatim mund ta themi edhe për veglat muzikore, të cilat, përveç çiftelisë, nuk përdoren fare, sepse vendin e tyre e kanë zënë aparatet e ndryshme elektrike (radioaparati, manjetofoni, televizori etj.).

Në studime të ndryshme të njohura shkencore është vërtetuar se tradita popullore ka luajtur rol të rëndësishëm gjatë historisë për ruajtjen e kombit shqiptar nga asimilimi, nga zhdukja si popull me tipare të veçanta kombëtare. Kultura jonë tradicionale popullore e kombëtare është një pasuri e madhe shpirtërore që ka mbajtur gjallë kombin tonë në stuhi e furtuna. Kultura popullore shqiptare është produkt material e shpirtëror i popullit




Koshi dhe hambari në oborr të shtëpisë janë objekte të rëndësishme ekonomike në fshat

shqiptar, si bashkësi etnike e kombëtare, e formuar mbi bazën e kulturës së lashtë ilire. Ajo gjatë historisë është zhvilluar e pasuruar ngadalë, kështu që me kristalizimin gradual është shndërruar në kulturë popullore kombëtare gjatë shekullit XIX e XX, kur merr hov procesi i formimit të kombit shqiptar. Ajo i ka nuancat, veçoritë lokale dhe krahinore, që rrjedhin nga kushtet konkrete shoqërore dhe natyrore të një vendi, të një zone, krahine etj. Por kultura popullore kombëtare ka ngjyrat e përbashkëta, ka frymën dhe shprehjen kryesore të kulturës së përgjithshme e të përbashkët shqiptare. Kështu, edhe në Lug të Baranit mund të ketë ndonjë element, ndonjë detaj që është një veçanti e vogël e kësaj zone, sidomos në pjesën e kulturës shpirtërore ku përfshihen zakonet, besimet e kota e bestytnitë. Këto detaje mund të konstatohen me rastin e studimeve dhe kërkimeve të hollë-

sishme etnografike në terren. Por ato duhet të jenë aq të vogla sa që në një vështrim të përgjithëshëm etnografik as nuk bien në sy.

Roli i kulturës tradicionale popullore në Lug të Baranit ka qenë shumë i rëndësishëm për ruajtjen e tipareve kombëtare, ashtu siç ka qenë i rëndësishëm roli i saj për mbarë popullin shqiptar gjatë historisë. Veshja kombëtare, arkitektura popullore, gjuha shqipe, kënga popullore etj. janë pjesë të pandashme të vetëdijes kombëtare. Oda e miqve kishte rëndësi të posaçme në kullat e Lugut të Baranit, të Rekës etj. për zgjimin kombëtar, për përgatitjen e kryengritjeve e të rezistencës kundër sundimit feu-



Mjetet e vjetra të punës i kanë zëvendësuar makinat bujqësore

dal-borgjez, si në kohën e pushtimit turk, ashtu edhe gjatë sundimit antipopullor të Jugosllavisë borgjeze. Oda e miqve ka qenë shkollë e vërtetë ku është mbajtur gjallë dhe është përcjellë brez pas brezi gjatë shekujve tradita, kultura jonë popullore deri në ditët tona.[136] Në fshatrat e Lugut të Baranit, si thamë, edhe sot një numër i madh i njerëzve të moshuar i ruan me xhelozi disa pjesë të kostumit kombëtar, sepse si e thamë më parë, veshja popullore në psikologjinë e tyre është një shenjë burrërie. Në arkitekturën popullore mbizotëron edhe sot kulla shumkatëshe, brenda mureve të cilës është kultivuar dhe ruajtur tradita popullore shekuj me radhë më mirë se në muzeume dhe galeri bashkëkohore. Aty është kalitur trimëria, besa, burrëria e mikpritja tradicio-

[136] Mark Krasniqi, *Funksioni i odës së miqve në Kosovë në epokën e Lidhjes së Prizrenit, Gjurmë e gjurmime,* Prishtinë, 1979, 434—441.

nale shqiptare, si edhe shumë elemente të tjera, të cilat janë pjesë përbërëse në mozaikun e kulturës sonë kombëtare, siç janë edukata familjare, ku zë vend të posaçëm respekti ndaj të moshuarve e ndaj prindërve, ndershmëria, altruizmi, krenaria kombëtare, modestia, zemërgjerësia dhe shumë tipare e virtyte të tjera që e cilësojnë fshatarin tonë.

Kur flasim për kulturën tradicionale popullore, në Lug të Baranit bie në sy qëndrimi mjaft indiferent i brezit të ri ndaj saj. Kuptohet se brezi i ri duhet të shkojë krahas me kohën, me hapin e saj, të pajiset me kulturë bashkëkohore dhe të ndjekë rrugën e përparimit në çdo pikëpamje. Mirëpo nuk duhet të harrojmë as kulturën e të parëve tanë, atë kulturë e cila na ka mbajtur gjallë gjatë shekujsh dhe në saje të cilës sot ekzistojmë si komb në veti. Një nga mënyrat për ta kultivuar kulturën tonë tradicionale në këtë zonë, do t'ishte formimi i një ansambli, shoqërie, ose grupi folklorik, qoftë nga fshatarët, qoftë nga nxënësit e shkollave tetëvjeçare, ose të paraleleve të shkollës së mesme të Baranit. Një grup i tillë kulturo-artistik mund të krijonte seksione të ndryshme dhe të zhvillonte një aktivitet të rëndësishëm kulturor në këtë trevë, ku nuk ka kurrfarë shenjash të jetës kulturore përjashta pragut të shkollës. Kushtet materiale e kuadrovike nuk janë aq të këqia, madje, ekziston një bazë solide për fillimin e punës së tillë. Këtu do të ruheshin dhe ngjalleshin shumë elemente të kulturës tradicionale popullore — kënga, vallet, veshja kombëtare, lojërat popullore, doket e zakonet pozitive dhe do të luftoheshin të gjitha anët negative të jetës e të traditës popullore. Kështu do të ecte më shpejtë edhe procesi i emancipimit të femres fshatare.

LUGU I BARANIT NË EPIKËN POPULLORE

Kënga popullore shqiptare është një thesar i çmueshëm i kulturës sonë tradicionale. Ajo është shprehja më e mirë e botëkuptimit, e karakterit dhe shpirtit të popullit në përgjithësi. Nëpërmes të këngës populli ynë ka shprehur në mënyrë artistike ndjenjat e tij më të thella e më të sinqerta — dashurinë ndaj vatrës, tokës së tij të lagur me gjak e djersë gjatë shekujve, ndaj lirisë e cila kaplon zemrën e tij dhe ndaj nderit, burrërisë e trimërisë, që janë pjesë të pandashme të natyrës bujare të fshatarit tonë. Njëkohësisht poezia popullore, duke shprehur krenarinë kombëtare të trimave, ajo shpreh edhe urrejtjen e pakufishme kundër armikut, i cili përpiqet ta robërojë vatrën e tij, t'ia shkelë të drejtat e tij kombëtare e shoqërore. Kënga jonë popullore ishte gjithmonë një lloj i kronikës besnike, një pasqyrë e ngjarjeve dhe një lloj dokumenti historik mbi gjendjen e popullit tonë në periudha të ndryshme. Ajo ka ngritur lart moralin e masave më të gjera popullore. Në odat e miqve, në kullat e fshatrave të Lugut të Baranit, kënga popullore, e përcjellë nga tingujt e butë të telave të çiftelisë, ka edukuar brezat e rinj në frymën e moralit të lartë të baballarëve. Bashkë me gjuhën e zakonet, kënga popullore na ka ruajtur nga asimilimi gjatë shekujve, kështu që, edhe në saje të kulturës sonë tradicionale, ne sot ekzistojmë si popull e si komb me veçoritë tona kombëtare. Kuptohet se në këtë pikëpamje rolin kryesor e kanë luajtur kushtet shoqërore-ekonomike e sidomos lufta e rezistenca e masave popullore kundër shtypjes e shfrytëzimit.

Arti ynë popullor, ku hyn edhe folklori, kënga popullore, ishte një kontribut i mirë i popullit tonë në kulturën botërore artistike, dhe njëkohësisht një nga armet kryesore të tij për t'u rezistuar pushtimeve të të huajve. Siç dihet, duke ruajtur folklorin, populli ruan veten e tij si popull e si komb, ruan të gjitha ato cilësi që e shquajnë nga popujt dhe kombet e tjerë.

Në këtë monografi nuk mund të ndalemi në studimin e hollësishëm të të gjithë folklorit, përkatësisht letërsisë gojore, të Lugut të Baranit, sepse kjo është një temë më vete, e cila duhet të shqyrtohet e të studiohet gjerësisht në kuadrin e projekteve të posaçme. Me këtë rast do të merremi me disa këngë historike, në të cilat paraqiten disa ngjarje në Lug të Baranit në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në tre dhjetëvjeshat e parë të shekullit XX, të cilat i përmendem edhe në kapitujt e mëparshëm.

Ngjarja më e rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, pas epokës së Skenderbeut (1405—1468), ishte Lidhja e Prizrenit (1878—1881), rreth së cilës u mblodh populli shqiptar, pa dallim feje e krahine, për t'i mbrojtur të drejtat e veta, të cilat i vunë në pazar fuqitë e mëdha me vendimet e Kongresit të Berlinit. Zbatimin e këtyre vendimeve ato ia kishin ngarkuar Turqisë, sepse shqiptarët këto i kundërshtonin me armë në dorë. Kënga jonë popullore i ka bërë të pavdekshme e të paharrueshme shumë beteja të përgjakshme të luftëtarëve shqiptarë të përiudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Sulltani dërgoi në këto vise pashallarë e komandantë të tjerë të ndryshem me shumë taborre të armatosura për ta shuar flakën e kryengritjeve shqiptare, duke zbatuar kështu detyrimet e turpshme, të cilat ia kishte ngarkuar Kongresi i Berlinit. Këto ngjarje historike janë zhvilluar edhe në Dukagjin, dhe në to ka marrë pjesë një numër i madh i popullsisë së kësaj treve, pra, edhe i Lugut të Baranit, fakt ky që dëshmohet edhe në folklorin e tij.

Për të shuar shpirtin revolucionar të kryengritësve shqiptarë, sulltani dërgoi edhe mareshalin Vesel pasha në Kosovë me 4 batalone, i cili arriti në Gjakovë më 4 shtator 1885 arrestoi Sulejman Vokshin, njërin nga udhëheqësit më të shquar të Lidhjes së Prizrenit. Mirëpo shpejt ngrihet një numër i madh burrash nga Reka e Malësisë, nga Rrafshi i Dukagjinit në përgjithësi, për ta shpëtuar Sulejman Vokshin. Mirëpo, Vesel pashës i vijnë në ndihmë forca të reja ushtarake nga Prishtina, dhe kështu ai arriti t'i prapsë sulmet e rrepta të kryengritësve shqiptarë.

Kënga popullore, në të cilën këndohet kjo ngjarje, fillon me vargjet

Dem Isufi e Arif Povata
kanë nisë luftën në kërshllaja,
gjunë me topa Vesel Pasha...

Dem isufi ishte nga Vokshi, kurse Arif Povota nga Strellci i Epërm (fshatra afër Lugut të Baranit). Në zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, në këngë thuhet se kryengritësit ia kanë dhënë fjalën Mon Avdisë, njërit nga udhëheqësve të kryengritësve, se do të ndërtojnë kulla në Turjakë, në Lug të Baranit, me qëllim të rrezistencës kundër turqve:

Ja dhanë besën Mon Avdisë,
ja dhanë besën në shuplakë —
t'i mbarojmë kullat n'Turjakë.[137]

Ndërkohë, Turqia u gjet në pozitë të vështirë nga shpërthimi i kryengritjes në Bullgari, e cila e shkëputi nga Turqia Rumelinë Lindore dhe ia bashkoi territorit të vet. Në një situatë të tillë, ajo lëshoi pe ndaj shqiptarëve për sa u përket disa reformave dhe mbajtjes së armëve, por, përveç kësaj, ajo qe e shtrënguar të li-

[137] Demush Shala, *Këngë Popullore Historike*, Prishtinë, 1973, 204.

ronte nga burgu udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit — Abdyl Frashërin e Sulejman Vokshin, si edhe shumë shqiptarë të tjerë të internuar si kundërshtarë të sundimit turk në tokat shqiptare.[138]

Kulla e Turjakës, që përmendet në këto këngë, është një objekt interesant jo vetëm nga aspekti historik, por edhe nga ai i arkitekturës folklorike. Kjo kullë ekziston edhe sot (1980), madje në gjendje shumë të mirë, megjithëse e ndërtuar prej qerpiçësh, në tre kat, por me mure të trasha 90 cm. Sipas këngës dhe traditës, të treguar nga Malë Shaban Krasniqi, pronar i tashëm i saj, kullën e kanë ndërtuar më 1885 tri fise të këtyre viseve — Berisha, Gashi e Krasniqja, me qëllim qëndrese kundër turqve, por edhe kundër Shalës së Isniqit, e cila donte të zaptonte toka dhe pyje në truallin e fshatit Turjakë. Këto tri fise e shfrytëzonin kullën bashkarisht, në katin e parë (përdhesën) rrinte Berisha, e cila kishte për udhëheqës Maxhun Nimanin, katin e dytë e kishte Gashi, me në krye Avdullah Hoxhën, kurse nga kati i tretë mbrohej Krasniqja, e cila kishte në krye Isuf Jahë Krasniqin dhe Lah Hysen Krasniqin.


Duket se Turjaka ishte në hall më tepër nga shqiptarët sesa nga turqit, sepse këta të parët, fshatrat e tjera, ia kishin vënë syrin pyllit të madh dhe kodrinave të gjera të Turjakës për t'i futur në dorë me dhunë. Në raste të tilla Turjaka, si fshat i vogël, mbështetej në shokët e tyre të fisit Krasniqe, në Nepole dhe në Malësi të Gjakovës, të cilët vinin menjëherë porsa dëgjonin kushtrimin e Turjakës, mbylleshin në kullë dhe nga kjo bënin rezistencë. Kështu me një rast, sipas gojëdhënës, Isniqi në krye me Shaban Sadikun, synon të fusë në dorë disa toka të Turjakës. Madje, njëfarë Muzli Bajrami zotohet se nuk do të kthehet i gjallë të paktën pa prekur derën e kullës me dorë. Turjaka shpejt e thërret Nepolen në ndihmë. Megjithëse banorët e Turjakës janë të gjithë myslimanë e ata të Nepolës të gjithë katolikë, këta shpejt nxitojnë dhe nja 100 vetë të armatosur i shkojnë në ndihmë Turjakës. Aty fillon përleshja e armatosur. Isniqi, nja 300 vetë, e rrethojnë kullën e Turjakës, dhe Muzli Bajrami e kryen zotimin e tij, por të gjithë detyrohen të ikin nga rezistenca e fortë e nja 10 turjakasve dhe 100 nepolasve. Njëri nga mbrojtësit e pyet me zë të lartë nga frengjia Shaban Sadikun: „Çka u bâ kështu, or Shaban Sadiku?!" Ky përgjigjet: „Kurrgjâ s'u bâ, kurrgjâ. Na deshtem m'e marrë Turjakën, ju nuk latë, e kurgjâ kurrkujt." Për këtë ngjarje ekziston edhe kënga popullore, në të cilën janë edhe këta rreshta:

...„Ky Pal Vata me 'i gjok plak
me dy pupa ra n'Turjakë,
niqind shokë i kish përmbas"...

Me një rast tjetër, prapë sipas traditës, Sylë Rexha nga Vranoci donte të ndërtonte një kullë në Turjakë. Ky ishte atëherë

[138] *Historia e Popullit Shqiptar, II,* Prishtinë, 1969, 204.

burrë në zë, dhe shtëpi e njohur në Rrafshin e Dukagjinit. Ramë Plana i Turjakës shkon e ankohet te Bajram Curri në Gjakovë, por ai i thotë se është marrë vesh edhe me Haxhi Zekën që të pajtohen me kërkesën e Sylë Rexhës. I dëshpëruar, Rama shkon në Malësi të Gjakovës dhe kërkon mbrojtje nga Shaban Binaku, që ishte i pari i Krasniqes, i derës së njohur Mulosmanaj. Shaban Binaku, me disa malësorë, shkon te Bajram Curri, por ai edhe këtij i thotë se për këtë punë kanë vendosur „të parët e fisit" (d.m.th. Bajram Curri e Haxhi Zeka). Shaban Binaku i zemruar i përgjigjet: „Ju jeni zotnitë e fisit, e jo të parët e fisit. Të parët e fisit



Kulla e vjetër në Turjakë e ndërtuar nga tri fiset

janë: Mulosmanajtë në Malësi, Povata i Strellcit, bajraktari i Vranocit dhe bajraktari i Radavcit". Bajram Curri e sheh se këtë problem nuk e kishin peshuar mirë më parë, dhe për mos t'u ngatërruar fisi ndërmjet veti, heq dorë nga përkrahja të cilën ia kishin premtuar Sylë Rexhës, dhe kështu evitohet konflikti, i cili përndryshe do të përfundonte me vëllavrasje.[139]

Në Turjakë janë ndërtuar edhe kulla të tjera, si kudo në Lug të Baranit, në epokën e Lidhjes së Prizrenit dhe pas saj, sidomos „në vakt të hyrjetit" (në kohën e xhonturqve) e më vonë. Mirëpo, kulla në Turjakë nuk është ndërtuar për mbrojtjen e një familjeje, si kullat e tjera. Atë e kanë ndërtuar tri fise së bashku për t'u

[139] Kallëzim i Rrustem Arifit nga Strellci i Poshtëm.

shërbyer si kështjellë e vërtetë që të mbrohet e gjithë Turjaka nga sulmet e ndryshme, siç shihet edhe nga këngët, të cilat rapsodi popullor i ka thurur rreth saj.

Ngjarjet e qershorit të vitit 1893 ishin të përgjakshme edhe në Lug të Baranit. Këtu, kryengritësit shqiptarë luftonin në krye me Haxhi Zekën, të cilit i erdhi në ndihmë edhe Bajram Curri me njerëzit e tij. Mustafë pashë Çerkezi i sulmonte me shumë ushtarë e me topa. Shqiptarët kishin zënë pozitat nëpër kodra, kanale dhe nëpër kulla. Në Vranoc Bajram Curri e Ali Bajraktari luftonin nga kulla e këtij të fundit. Ushtria turke rrahte me artileri katundet, gjylet e topave binin breshër mbi kullat e Vranocit, duke vrarë edhe gra e fëmijë. Për të mos i dëmtuar „rob e fëmijë", Bajram Curri i propozon bajraktarit që të largohen të gjithë nga kulla e cila në këtë rast do të shpëtonte pa u rrënuar. Mirëpo, bajraktari nuk pranon. Poeti popullor e përshkruan këtë situatë shumë kritike me disa vargje të shkurtra, por me domethënie të thellë:

...„Krisi pushka, krisi topi,
rrafsh me tokë u bâ Vranoci...
Bajraktari s'u korit —
për nji shoq i dogj japitë".....

Në disa këngë popullore, por edhe nga shumë pleq të Lugut të Baranit e të Dukagjinit në përgjithësi, shpeshherë përmendet Xhafer Tajari, si komandant i xhandarmërisë turke në nahijen e Pejës, i cili bënte shumë zullumë në popull, sidomos atëherë kur i shoqëronte nëpunësit e lartë turq nëpër nahije. Kështu, me një rast del pasha i Pejës (mytesarifi), i shoqëruar nga ushtria në krye me Xhafer Tajarin, nëpër Rekë e vise të tjera për t'i qetësuar fshatarët që kundërshtonin sundimin e osmanllinjve në këto anë. Mirëpo, kur arrin në Lug të Baranit, siç thotë kënga popullore, „pushka mbrapa i kërsiti —„n'Vranoc pasha kur ka shkue — pushkën mbrapa ja kanë vndue." Në raste të tilla pushka e një fshati nuk mbetej e vetmuar; kjo ishte vetëm kushtrim edhe për fshatrat e tjera, të cilat nxitonin në fushë të betejës. Kështu i ngjau edhe pashës së Pejës: „Ish dal pasha prej Vranoci — i krisi pushka tu Behoci". Përroi i Behocit, si e thamë në shqyrtimet e mëparshme, vjen nga Bjeshka e Strellcit dhe kalon nëpër disa fshatra të Lugut të Baranit. Aty pasha i qëlluar rrëzohet nga kali. Mirëpo, puna nuk mbaron me kaq, sepse edhe Kotradiqi e djeg barutin: „Po pëvet mytesarifi — Ç'janë këto pushkë prej Kotradiqi, — krejt asqerin ma kërdisi." Aty përmendet mandje edhe Rashiqi, në krye me Ali Hamzen dhe me shumë komitë të tjerë, qoftë nga Lugu i Baranit, qoftë nga Dushkaja — „Ramë Binaku, Zhuj Avdyli, Adem Rama, Myderizi — Isuf Musa, Selim Ukshini, — Ali Hamza prej Rashiqi." I ngushtuar nga të gjitha anët, pasha dorëzohet duke kërkuar mëshirë: „Në dorë tande, Mehmet Gjoni, — në dorë tande, n'mujsh me m'pshtue, — kurr mâ ngusht nuk jam qillue, — s'po muj i ngjallë në Pejë me shkue — krejt ushtrinë ma kanë farue!" Por edhe Xhafer Tajari e sheh vetën ngushtë; dhe ai në këtë situatë kërkon ndihmë nga shqiptarët:

...„Del Isufi midis livadhit,
i bërtet Xhafer Tajarit:
— Ç'dreqi t'pruni n'Lug t'Baranit?
N'Lug t'Baranit çka të ka pru?...
...Kraht me i pasë me fluturue,
t'gjallë nuk t'lshojmë n'Pejë me shkue".
Xhafer Begi, i vllai i Hakisë,
Po i çon fjalë Hazir Alisë:
N'mujsh me m'pshtue prej komitësh,
prej komitësh n'mujsh me m'pshtue,
shumë memetin ta kam çue".[140]

Kjo ngjarje është shumë e ngjashme me atë që ka ndodhur në gjysmën e parë të shekullit XIX me Asllan Pashën, i cili kish dalë në Isniq për të mbledhur „verginë" (taksat). Mirëpo, edhe atë Isniqi e kishte pritur me pushkë, kështu që memzi shpëton kokën duke kërkuar besë nga fshatarët e Isniqit: „Ndore tande, mori Shalë, — Se s'kam dalë vergi me marrë". Isniqi e Lugu i Baranit, si e thamë edhe më parë, janë fare afër, kështu që shumë halle i kanë pasur të përbashkëta, sidomos në kohët e kaluara.

Për ngjarjet në pranverën e hershme të vitit 1913, në Lug të Baranit, folëm edhe më parë. Për këto ngjarje të përgjakshme, kur ushtria e pushteti i krajl Nikollës bënë masakër në popullsinë shqiptare të Dukagjinit, për ta detyruar kështu të ndërrojë kombësin e fenë, flet më qartë e më hollësishëm rapsodi popullor në „Kangën e fesë", e cila fillon me vargje të njohura lamentacioni:

„Haj medet për Lug të Baranit,
n'kamb asht çue Savë Llazari,
Savë Batarja n'kambë â çue,
don shiptarve fenë me u ndrrue.
Në Baran t'Epërm Sava â shkue....
....katërmdhetë burra i ka bashkue,
n'shpat t'Baranit na i ka çue,
i ka shti vorret vet me i marue,
të katërmdhetët i ka pushkatue.
Kqyr tash Sava çka ka punue —
ai me topa paska gjue,
n'Vranoc gjylet na i kanë shkue,
krejt Vranoci âsht imerrue".

Në këngë ngjarja zhvillohet ashtu si e cekem edhe më parë: Savë Batarja kërkon nga bajraktari i Vranocit që ta mbledhë bajrakun e të vijë me të gjithë sa janë — i madh e i vogël për të ndërruar fenë, përkatësisht kombësinë. Bajraktari i thotë se territori i bajrakut është shumë i gjerë, por megjithatë do ta tubojë popullsinë dhe do të vijnë në Pejë solemnisht pas 3 ditësh. Kur

[140] D. Shala, *Këngë Popullore Historike....*, 207.

mbledhen ditën e caktuar, burrat këmbë e gra, pleq e fëmijë në qerre, nisen për në Pejë; por më parë e pyesin bajraktarin: „Bajraktar, ti qysh po thue?" — Bajraktari u ka kallxue: „Domë me u gri, domë me u coptue, — fe as emen s'domë me ndrrue, — të parve vorret me jau turpnue". Mandej kënga vazhdon:

„Janë ndalë burrat, janë besatue,
mandej rrugën e kanë fillue.
Këtij poplli kush i prini? —
Sali Bajraktari, Arif Halili...
...Nuk po donë në kishë me hi.
„Bajraktar, thonë, me na pri,
në të zezën Pejë po domë me hi".

Ngjarja te Ura e Gurit, në Pejë, është tragjike e tronditëse, shumë e popullarizuar edhe sot, jo vetëm ndër ata që e kanë përjetuar dhe u është skalitur në kujtesë, megjithëse atëherë këta ishin fëmijë, por edhe gjeneratat e reja e tregojnë sikur ta kishin përjetuar vetë, ashtu si i tregon edhe rapsodi popullor gjithë mizoritë që i pësoi popullsia e Lugut të Baranit nga regjimi antipopullor i atyre ditëve, duke mbrojtur përkatësinë e krenarinë e saj kombëtare dhe dinjitetin njerëzor. Zenel Binaku me triměri të rrallë, para tytave të mitralozave, i prin popullit në kundërshtim të haptë, megjithëse ishte duarthatë. Se ç'ngjau pastaj, tregon poeti popullor me pak fjalë:

...„Krisi pushka e dajaku,
rrugt e shehrit i mloi gjaku,
vajë e gjamë Peja ka marrë,
me t'u dridhë toka ndër kambë"...

Këto janë disa fragmente karakteristike nga një variant i kësaj kënge, e cila deshmon në mënyrë besnike dhe me një kronologji reale për gjendjen shumë të vështirë që mbretëronte në Lug të Baranit gjatë okupacionit të shkurtër të këtyre viseve më 1913 nga ushtria e kral Nikollës. Nga ana tjetër, edhe me këtë rast, sipas këngës në fjalë, shihet roli i institucionit të bajrakut në jetën shoqërore të fshatrave të cilat përfshiheshin në kuadrin e bajrakut të Vranocit. Terror bëhej në atë kohë edhe në vise të tjera, në të gjitha fshatrat, deri në Dri të Bardhë, për të ndërruar „emen e fe" (kombësinë e besimin), por shumë nga këto katunde kaluan më lehtë se Lugu i Baranit, Jabllanica e Dushkajës dhe Rugova. Ato formalisht iu binden urdhërit dhe „ndërruan fenë" me një fjalë goje, megjithëse edhe në fshatra të tilla ranë viktima shumë njerëz të pafajshëm.

Gjatë sundimit të Jugosllavisë borgjeze, siç dihet, qeveritë antipopullore u përpoqën ta zhdukin popullin shqiptar. „Jugosllavia e paraluftës ua ka marrë tokën shqiptarëve në mënyrë sistematike, dhe kështu ua ka dhënë shkopin e lypësit në dorë. Masat shqiptare kanë qenë krejtësisht të larguara nga puna shtetërore dhe kundër tyre përdorej presioni e shtypja, terrori i xhandarmërisë dhe dhuna e të gjitha llojeve". Çështja kombëtare edhe në përgjithësi në Jugosllavinë borgjeze nuk ishte zgjidhur. „Jugosllavia e Versajit ka qenë vendi më tipik i shtypjes kombëtare në Evropë... Maqedonët, shqiptarët e të tjerët kanë qenë të robëruar dhe të destinuar për zhdukje të plotë." Ekspeditat ndëshkimore ushtarake e policore bënin kërdi duke pushkatuar me qindra e me mijëra fshatarë shqiptarë të pafajshëm.[141] Kështu p.sh. „në masakrin e njohur në Llap u vranë më se njëmijë vetë, kurse në fshatin Dumnicë, me rastin e kalimit të një ekspedite ndëshkimore, askush nuk mbeti gjallë. Raste të tilla ka pasur në të gjitha rrethet e Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Kostë Peqanci (Vojvoda), Miliq Kërsta e të tjerët kanë vrarë pa mëshirë e pa kurrfarë shkaku dhjetra e qindra njerëz, kanë djegur fshatra shqiptare dhe kanë bërë krime të panumërta kundër shqiptarëve".[142] Kuptohet pra, se një gjendje e tillë mbretëronte edhe në Lug të Baranit.

Shumë ngjarje (të cilat nuk kanë qenë vetëm raste, por një sistem e plan i caktuar), i ka përjetësuar edhe rapsodi popullor në vargjet e tij, të cilat mbeten si dokument dhe akuzë i një periudhe të sundimit të forcës brutale dhe terrorit. Një nga këngët e tilla bën fjalë për ngjarjet e vitit 1937 me rastin e votimeve në Lug të Baranit, për të cilat folëm më gjerësisht me rastin e shqyrtimit të kushteve shoqërore në këtë zonë. Kjo këngë në popull njihet me tituj të ndryshëm, si p.sh. „Kânga e Baranit", „Kânga e votimeve", „Kânga e Manojlit" (Manojllo Manojlloviqi, ose Manojl Berisha, siç e quanin shqiptarët, që ishte një kohë të gjatë kryetar i Komunës së Baranit, si njeri i besuar i qeverisë), kurse kënga e botuar mban titullin „Demograci na domë me e bâ".[143]

Megjithëse subjekti i këngës është ngjarja tragjike me rastin e votimeve, ajo në fillim jep një pasqyrë të gjendjes së përgjithshme të mjerueshme shoqërore në fshatin tonë në atë kohë me këto vargje:

„Haj medet për shiptari,
qe izet vjet jem kânë robi,
dulë agrari shpi për shpi:
na muer tokën fi për fi,
qet porez, buxhet të ri".

Se ç'ka qenë „agrari" dhe ç'do të thoshte ai për fshatarin shqiptar, e shpjeguam më parë. Nëse e kemi të qartë se „porezi" ishte tatim tepër i rëndë, të cilin e paguanin fshatarët edhe kur ua mori „agrari" tokën, dhe nëse e dimë se „buxheti" ishte tatimi komunal, gjithashtu i rëndë, nuk do të ketë nevojë për shpjegime të tjera, sepse vargjet e rapsodit popullor e paraqesin shumë qartë gjendjen e padurueshme shoqërore e ekonomike të masave të gjera fshatare.

---

[141] Mita Miljković, *O položaju nacionalnih manjina u NR Srbiji*, Crvena zastava — Organ CK KPS, br. 2, Beograd, 1948, 29, 30.

[142] *Po aty*, 30.

[143] D. Shala, *Këngë Popullore Historike...*, 325.

Në vazhdim është interesant intervenimi i Miro Protiqit (Mira i Protës) nga Peja, i cili kërkon përkrahjen e „zhupanit" të Shkupit kryeadministrator për Maqedoni e Kosovë) që të fitojë në votime për deputet në listën e partisë radikale — qeveritare. Shqiptarët votonin për kandidatët e partisë demokratike, duke shpresuar se do të gëzonin mbrojtjen e tyre në parlament. Kjo pra, ishte parti e opozitës (në këngën popullore thuhet „pozicija"). Ndër të tjerat, ai i thotë „zhupanit":

„Ti zhupan n'më paç kumar mue,
për këtë „gllas" ti me m'nimue,
„pozicija" m'ka rrethue.
Pozicija n'koftë qi fiton,
ty ni besë ta paça dhânë:
ka m'e prishë „dërzhavën" tonë".

Ditën e votimeve, sipas këngës, Mira i Protës shkon në Baran dhe përpiqet t'i bindë shqiptarët që të votojnë për Manojlin, por nuk e dëgjon kush, sepse:

„Nisi narodi me gllasitë,
bajraktarit gjith tuj ja qitë".

Por, megjithëse i gjithë populli votoi për kandidatin e tij, Mira i Protës „krejt Manojlit po ja shkruen". Në zyrën e votimit gjendej edhe Mulla Jusufi, imam i këtyre fshatrave, i cili i thotë:

„Mo, more Mirë, kshtu mos bon!
krejt narodi kokrrat na i ka dhonë,
ti me zort qysh me na i marrë?"
Atëherë Mira shka po bon:
— Mulla Jusuf, — m'i ka thonë,
mulla Jusuf, or mjekërrzi,
rrok tespit e shko n'xhami,
se ky vend nuk osht për ty!"

Mulla Jusufi del e i tregon bajraktarit për falsifikimin e votave, por ky do ta evitojë konfliktin dhe i thotë: „Hajde hoxhë, të bajmë Bajram, — hyqymeti s'don me na dhanë". Mirëpo një nga djemt e rinj, Sokol Dërguti, reagon ndryshe:

„Yrysh boni hyni n'opshtinë,
qato lista Mirës ja shkynë.
Mrenda krisi e shkreta allti,
muer Sokolin bri më bri".

Atëherë fillon masakri i vërtetë. Shtinë xhandarët të armatosur deri në dhëmbë kundër turmes së votuesve duarthatë dhe aty u bë kasaphane e vërtetë, ku mbetën të vrarë, sipas këngës popullore:

. . .„me tefter nizet e tetë.
zo n'kta tela kush ka metë?
Met Sokoli, haj medet,
nuk ka tjetër baba i vet".

Qëndresa e fshatarëve aty ishte e pamundshme, sepse ishin pa asnjë armë, kurse xhandarët ishin shumë, dhe të gjithë të armatosur e të përgatitur qysh më parë për këtë krim. Rapsodi popullor shënon vetëm një rast të reagimit fizik dhe një verbal, megjithëse ka pasur edhe disa raste të tjera të këtilla:

„Mulla Jusufi shka po bon.
ni shtagë t'madhe n'dorë ka marrë,
ni vodnikut n'krye po i mshon,
skjurel gjaki po m'i shkon. . . .
Shum do vllazën ktu i kem lonë,
hiq per ta dertin s'e kom,
tana gjaqet kom me i marrë,
demokraci na domë me e bo".

Mjerisht, demokracinë që e dëshironin, dhe për të cilën derdhen gjakun, shqiptarët nuk do ta gëzonin edhe sikur të fitonte partia demokratike në ato votime, sepse deputetet e saj u premtonin shqiptarëve përkrahje vetëm gjatë fushatës zgjedhore, kurse në parlament nuk çanin kokën për ankesat e shqiptarëve dhe për gjendjen e tyre të mjerueshme në përgjithësi.

Lugu i Baranit ka edhe këngë të tjera, sidomos lirike, pastaj ninulla, këngë rituale, vajtime etj., por këtu folem vetëm për këngët historike në të cilat përmendet Lugu i Baranit, megjithëse edhe ato të tjerat janë me interes për shqyrtim shkencor për ta njohur kështu më mirë edhe nga ky aspekt këtë zonë etnografike. Në Vranoc, folkloristi i pasionuar Muharrem Krasniqi, ka mbledhur shumë këngë e tregime nga kjo trevë.

Nga këto 4—5 këngë popullore që i shfrytëzuam këtu pjesërisht, shihet se Lugu i Baranit ishte një nga trevat e Kosovës ku janë zhvilluar disa ngjarje të rëndësishme gjatë shekullit XIX e këtej. Nga këto këngë nuk shihen vetëm vuajtjet e popullsisë së kësaj zone, por edhe shpirti luftarak i saj, që kacafytej edhe me armikun shumë më të madh e më të fortë se ajo vetë. Në viset e tjera shpeshherë e quajnë këtë zonë „koll-Baran", që duhet të këtë kuptim të gjerë: trevë e bashkuar, e organizuar për rezistencë, bashkim etj., siç thuhet edhe në këngën popullore — „koll po i bân Rekë e Malësi". Lugu i Baranit, si trevë e vogël, në shumë raste mbështetej në Rekën e Malësisinë, por me rezistencë të organizuar dhe me trimëri nuk ishte larg tyre, siç shihet edhe nga kënga popullore historike, e cila e ndriçon një pjesë të historisë së tij.

PËRFUNDIM

Lugu i Baranit si zonë etno-gjeografike është pjesë përbërëse e Rrafshit të Dukagjinit, me disa veçori në organizimin e jetës shoqërore në të kaluarën. Hulumtimet e para arkeologjike kanë treguar se në këtë trevë kanë jetuar njerëz qysh në epokën parahistorike, përkatësisht në neolit. Në dokumentet mesjetare përmenden disa fshatra të Lugut të Baranit, kurse në defterin turk të shekullit XV ka shumë të dhëna mbi popullsinë dhe jetën ekonomike gati të të gjitha fshatrave që ekzistojnë edhe sot. Kjo do të thotë se kjo trevë ka kushte të përshtatshme për jetën dhe veprimtarinë e njeriut, kështu që tash (1981) këtu jetojnë 11.224 banorë me 1.100 familje, të shpërndara në 15 fshatra. Më se 95% e popullsisë merret me bujqësi, e cila është tepër e ngarkuar, sepse në 1 banor bie më pak se 25 ari tokë pjellore. Pas çlirimit janë elektrifikuar të gjitha fshatrat, janë hapur shkolla fillore në gjuhën shqipe (të cilat para lufte kanë qenë të ndaluara), është shtruar në asfalt rruga deri në Gllogjan, kështu që kjo trevë është lidhur me Pejën, është hapur ambulanca dhe posta në Baran dhe janë bërë disa punë të tjera në rrugën e përparimit të kësaj zone. Por kjo ka shumë nevojë për ndonjë objekt industrial për të hyrë një numër njerëzish në punë, sepse përndryshe gjendja ekonomike do të vështirësohet vazhdimisht. Kjo mund të bëhet shumë më e vështirë nëse një ditë do të detyrohen të kthehen këtu 450 punëtorë të cilët tash (1981) janë në punë të përkohëshme në botën e jashtme. Për zhvillimin e ekonomisë të kësaj treve do të ishte shumë e dobishme të lidhet me rrugë të asfaltuara edhe me Gjakovën e Klinën, duke vazhduar rrugën nga Gllogjani deri në Dri të Bardhë (rreth 7—8 km) ku kalon rruga Gjakovë-Klinë.

Jeta shoqërore e popullsisë së Lugut të Baranit, si thamë, ka disa veçori në krahasim me zonat e tjera me të cilat kufizohet. Para së gjithash, kjo trevë ka një të kaluar revolucionare, sepse këtu shpeshherë janë zhvilluar luftime të rrepta me ushtrinë e xhandarmërinë turke, kurse në kohën e sundimit të Jugosllavisë borgjeze edhe këtu vepronte Lëvizja kaçake, kështu që edhe atëherë ishin zhvilluar luftime të përgjakshme kundër organeve të pushtetit të atëhershëm. Ngjarja e vetit 1937 në Baran, me rastin e votimeve, do të mbetet në historinë e këtyre anëve si shembull i shpirtit revolucionar të kësaj treve. Organizata e bajrakut në të kaluarën gjithashtu luante rol të rëndësishem në jetën shoqërore jo vetëm të popullsisë së Lugut të Baranit, por edhe të fshatrave përreth, të cilat i takonin Bajrakut të Vranocit.

Familja në këtë trevë ruajti deri në ditët tona tiparet e familjes së madhe tradicionale patriarkale, kështu që edhe sot në disa fshatra ka familje me 20 deri 50 pjesëtarë. Por, në përgjithësi, familja patriarkale, në kushte të reja bashkëkohore është shthurur. Këtu duhet të përmendim edhe një veçori tjetër lidhur me familjen. Në disa familje (në Llugaxhi, Baran, Gllogjan) ka pasur pjesëtarë të besimit mysliman dhe katolik. Edhe kjo tregon kohezionin e madh të gjinisë së gjakut dhe tolerancën fetare të popullsisë në përgjithësi.

Kuptohet se fshati gjithmonë dhe gjithkund luan rol të posaçëm në jetën shoqërore të banorëve të tij. Edhe në Lugun e Baranit pleqtë e katundit dhe kuvendi i katundit kishte kompetenca të mëdha, sepse çdo vendim merrej „katundisht", e detyronte çdo familje. Në pajtimin e ngatërresave pleqtë e kishin fjalën e parë dhe të fundit.

Kultura materiale dhe shpirtërore e banorëve të Lugut të Baranit nuk dallohet nga viset e tjera të Rrafshit të Dukagjinit përreth. Këtu arkitektura popullore në të kaluarën i kishte karakteristikat e përbashkëta të viseve të afërme, ku dominonte kulla shqiptare si banesë e fortifikuar për mbrojtje. Edhe sot gati në të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit ka kulla tullash ose prej guri. Mirëpo, askush tash nuk e ngre shtëpinë e re në formë kulle, sepse kanë ndryshuar kushtet shoqërore, të cilat dikur e imponoin këtë tip shtëpie.

Veshja popullore, si element i rëndësishëm i kulturës materiale popullore, është në Lugun e Baranit veshja e njohur e Dukagjinit— tirqë të bardhë me gajtana të zez si karakteristikë kryesore e veshjes së meshkujve; këmisha e gjatë e bardhë, pështjellaku dhe lidhca e mahrama — veshja e grave. Mirëpo, tirqët i veshin vetëm njerëzit e moshuar, kurse të rinjtë veshen „allafranga". Gratë, përkundrazi, e kanë ruajtur kostumin popullor gati në tërësi. Veglat e punës dhe orenditë e shtëpisë deri vonë ishin prej druri dhe i punonin vetë fshatarët. Tash këtyre ua kanë zënë vendin prodhimet industriale, kështu që parmenda as nuk shihet në ara, as nuk mund të gjendet në shtëpi, të paktën si raritet muzeal. Në vend të parmendës e plugut të kuajve, tash në çdo katund larvrojnë traktorët.

Kultura shpirtërore e popullsisë së Lugut të Baranit është mjaft e pasur. Këtu para së gjithash duhet të vihet në dukje begatia e madhe e folklorit, sidomos e këngëve popullore, në të cilat këndohen ngjarjet e ndryshme të kësaj treve, luftërat kundër pushtetit turk, kundër xhandarmërisë së Jugosllavisë borgjeze etj. Doket e zakonet, besimet e bestytnitë e kësaj treve, nuk dallohen nga ato të viseve të tjera të Kosovës. Por, këto kanë mbetur kryesisht vetëm në botëkuptimin e brezave të moshuara. Zakonet prapanike banorët e Lugut të Baranit po i luftojnë vetë edhe sipas traditës së vendit — duke marrë vendime (sulle) kolektive. Me ndryshimin e strukturës sociale të popullsisë dhe me shkollimin e brezit të ri, edhe kjo trevë do të bëjë hapa më të mëdhej në rrugën e zhvillimit ekonomik dhe të përparimit kulturor.

BARANSKI LJUG

Etno-geografska monografija

Rezime

Prirodni uslovi. — Baranski Ljug je jedna manja etno-geografska celina koja se prostire u donjem toku Dečanske Bistrice, na čijoj se levoj strani nižu 15 seoskih naselja. To je dakle, jedna rečna dolina stvorena aluvijalnom erozijom, tj. usecanjem rečnog toka u jezerskoj ravni. Zapravo i sam naziv ovog kraja ukazuje na njegov morfološku genezu, jer „ljug" (lug) na albanskom znači dolina. Ova dolina je dobila ime po selu Barane, koje zauzima centralni položaj u ovoj geografskoj sredini. Sa zapadne strane uzdižu se visoke Prokletije, iznad obližnjeg Streoca i Dečana, sa severozapada je Peć, prema jugu se graniči Baranski Ljug Dečanskom Bistricom, a prema severu Pištanskim Ljugom, odnosno Pećkom Bistricom i Lješanskim Ljugom.

Reljef Baranskog Ljuga je prilično jednostavan: tu je jedna uska rečna dolina (najveća širina oko 2 km) iznad koje se uzdižu sa obe strane niska pobrđa, visine od 350 do 530 m. Klima je umerono kontinentalna, kao u čitavoj Metohiji, ali je Baranski Ljug zaštićen od jakih vetrova vencem pomenutih planina prema severozapadu, dok je prema jugoistoku otvoren prema prizrenskom bazenu, gde je obično blaža klima. Hidrografske prilike su povoljne, za veći deo naselja, jer Dečanska Bistrica ima dovoljno vode za navodnjavanje većeg dela polja koja se prostiru duž njenog toka. Kroz mnoga sela protiču „jazovi" kojima se dovodi voda iz Bistrice, ili manji potoci koji izviru mahom na ovom terenu. Potok Behoc je plahovit, jer dolazi sa visokih Prokletija, odakle posle kiša donosi velike količine šljunka i kamenja, te nanosi velike štete poljima koja su na njegovim stranama. Vodu za piće stanovništvo uzima iz bunara, čija je dubina od 5 do 8 m, ili iz izvora. Erozija Dečanske Bistrice je dosta izražena, a na ogolelim okolnim brdima stvorene su mnogobrojne vododerine privremenim potocima koji nastaju posle obilnijih kiša ili otapanja snega. Zemljište je srednje plodnosti, jer humusni sloj sadrži dosta peska u rečnoj dolini, a na brdima zemljište je siromašnije humusnim sastojcima, i prilično erodirano zbog krčevina i seče šuma. Od biljnog sveta najviše ima travnih formacija u rečnoj dolini, kao i mekog drveta (vrba, topola, jova), dok se na uzvišicama prostire sitnogorica (hrast, lešnik, razno grmlje itd.). Pre nekih 40—50 godina životinjski svet u ovom kraju bio je bogatiji, tako da je tu bilo i divljih veprova. Međutim, sada su oni potpuno nestali, a nema ni vukova ni lisica, jer su šume tokom vremena oštećene, pa dobrim delom i krčene.

Društveni uslovi. — U Baranskom Ljugu nisu vršena neka obimnija arheološka istraživanja. Međutim, vršeno je rekognosciranje terena u selu Vranocu, pri čemu se naišlo na kamene predmete (oruđa za rad), na osnovu čega se zaključuje da je tu bilo naselja još u predistorijskom periodu, odnosno u starom neolitu. U pisanim dokumentima međutim, neka naselja Baranskog Ljuga pominju se još početkom 14 veka u hrisovuljama kojima su Nemanjići darivali manastir Hilendar, Dečane i dr. U tim dokumentima ima manje podataka o ovom kraju, jer se tu radilo mahom o određivanju međa sela koje se poklanja manastiru, i nekim njegovim materijalnim obavezama prema njemu, ali su ipak to važni podaci o daljoj istorijskoj prošlosti ove geografske celine. Turski dokumenti iz XV veka pominju veći broj naselja Baranskog Ljuga, koji sadrže više podataka o stanovništvu, privredi i društvenim i imovinskim odnosima. Takav dokument je Defter popisa Skadarskog sandžakata iz 1485. godine, koji je uskoro pronađen u Istambulskim arhivima, preveden i objavljen. Iz tog deftera vidi se da je stanovništvo ovih naselja bilo mešovito, jer pored slovenskih pravoslavnih imena tu ima i albanskih katoličkih, čak i muslimanskih pa i mešovitih imena, odnosno prezimena (na pr. Radisav sin Đona i sl:). Defter podrobno ukazuje na materijalne i druge obaveze stanovništva prema spahiji, odnosno državi, iz čega se vidi težak položaj u uslovima osmanskog vojnog feudalizma. U kasnijem periodu, krajem XVII veka, ovi krajevi su se često bunili protiv takvog stanja čim se pružila prilika. Zato je stanovništvo masovno uzelo učešće u austro-turskom ratu 1689—1690, na strani austrougarske vojske; ali je ono nastradalo ne samo turskom odmazdom, nego mnogo više od epidemije kolere. Prema tradiciji, iz tog vremena su „vorret e hasallakut" („grobovi kolere") koja se i danas pominju u nekoliko naselja Baranskog Ljuga.

Devetnaesti vek je za ovaj kraj važan po tome što tada nastaje masovnije osamostalivanje ćifčija kupovinom zemlje od domaćih aga i begova iz Peći i Đakovice, ili krčenjem do tada neplodnog zemljišta. Borba protiv turske vlasti u ovom periodu je uzela šire razmere, naročito u oružanom periodu Prizrenske Lige (1878—1881), u kojoj je iz Baranskog Ljuga bilo i uticajnih ličnosti. Od 1893. pa do 1912. stanovništvo ovog kraja učestvovalo je u mnogim okršajima sa turskom vojskom, boreći se za nacionalnu slobodu i socijalna prava.

Za vreme Balkanskog rata, u proleće 1913, u zapandoj Metohiji (pećki i đakovački srez), koju je zaposela Crna Gora, vladao je neopisiv teror nad albanskim stanovništvom, koje je bilo primorano čak i na nasilno pokrštavanje. Baranski Ljug je bio u naročito teškom položaju, jer ga je ovo „krvavo krštenje" stajalo mnogo ljudskih žrtava, tako da je poznati zlikovac Sava Lazarević (poginuo kao četnik za vreme prošlog rata), komandant „perjanika" kralja Nikole, samo u selu Vranocu odjednom streljao 14 nevinih ljudi, koji su se oduprli nasilnoj promeni vere, odnosno narodnosti.

Teško stanje vladalo je u ovim krajevima, kao i na čitavom Kosovu, i za vreme buržoaske Jugoslavije, koja je imala za cilj da istrebi Albance i progna ih sa njihovih ognjišta. U tom cilju oduzimana je zemlja od siromašnog albanskog seljaka i davana je kolonistima koji su dovedeni iz Crne Gore, Srbije ili drugih krajeva Jugoslavije, a Albance su proterivali za Tursku. Tako je u Baranskom Ljugu bilo naseljeno od 1918. do 1941. oko 425 crnogorskih i srpskih porodica. Ali ipak, nijedna albanska porodica nije se otselila za Tursku. Za vreme buržoaske Jugoslavije, zbog nacional-

nog ugnjetavanja i socijalne diskriminacije, mnogi su se odmetnuli u šumu i stupili u kačačke redove, koji su se borili protiv državnih organa, na čelu sa Azem Bejtom i drugim poznatim komitama.

U društvenom životu Baranskog Ljuga veliku ulogu je igrala fisna (plemenska) pripadnost, organizacija bajraka, tradicionalna porodična zadruga, pa i samo selo kao celina. Naselja Baranskog Ljuga sastavljena su od više fisova, ali najbrojniji su Krasnići, Beriša i Gaš. Neka naselja pripadaju samo jednom fisu, kao na pr. selo Nepolje i Turjak u kojima su samo Krasnići, a u nekim su Beriše u apsolutnoj većini itd. Kao što je poznato, pripadnici istog fisa potiču od jednog daljeg pretka; njih dakle, vezuje krvno srodstvo, te je razumljivo da među njima postoji i veća solidarnost, a donedavno je u okviru fisa vladala ekzogamija.

Bajrak je za vreme Turaka bila jedna vrsta vojne organizacije, organizovana na teritorijalnoj osnovi, bez obzira na fisnu pripadnost. Turske vlasti su osnovale ovakvu organizaciju u cilju da je iskoriste u svoje vojne svrhe, a i da bi oslabili ulogu fisa, koji se uvek suprostavljao turskoj vlasti na njegovoj teritoriji, pa i u širim razmerama. Međutim, bajrak je često puta vodio borbe upravo protiv turske vlasti, a u okviru svoje teritorije igrao je važnu društvenu ulogu, pogotovu u ravničarskim predelima, kao što je Baranski Ljug, gde fisna organizacija nije imala svoju teritorijalnu celinu. U Baranskom Ljugu sve do kraja Drugog svetskog rata postojao je Bajrak Vranocki, nazvan po selu Vranocu u kome se nalazio bajraktar.

Porodica u ovom kraju je u dobroj meri i danas patrijarhalna, i to ne samo u pogledu većih, pa i apsolutnih prednosti muža, odnosno muškarca uopšte, nego i u pogledu patrijarhalne organizacije višečlanih porodica, odnosno porodičnih zadruga. Ove su poslendih 20—30 u raspadanju, ali ih i danas ima, kao na pr. u selu Českovu, sa preko 50 članova — u jednom domaćinstvu. Stanovnici ovog kraja su muslimani, a manjim delom i katolici, a pravoslavnih ima malo. Bilo je porodičnih zadruga (selo Lugadžija, Barane i dr.) u kojima je jedan deo članova bio muslimanske, a drugi katoličke veroispovesti. Zadruge su imale opravdanje svog postojanje u uslovima složenog ratarsko-stočarskog privređivanja, kao i društveno-imovinske nesigurnosti. U novim društveno-ekonomskim uslovima one moraju da iščeznu, tako da sada postoje samo retki primeri, ili pak njeni rudimenti.

Selo, kao društveno-teritorijalna organizacija u ovom kraju, ne razlikuje se od susednih ili daljih regiona. Ranije su viđenije osobe, seoski starci ili savet sela, a pogotovu zbor sela, igrali odlučujuću ulogu u upravljanju seoskim poslovima, a posebno u sređivanju međusobnih ljudskih odnosa. U Baranskom Ljugu i danas su uticajne ove tradicionalne institucije, ali razume se, glavnu ulogu igraju savremeni seoski odbornici, kao i mesna zajednica.

Društveno-ekonomske prilike posle oslobođenja u Baranskom Ljugu su iste kao u ostalim krajevima Kosova i u zemlji uopšte. Tu treba pre svega naglasiti proklamovanu nacionalnu i socijalnu ravnopravnost u novom socijalističkom društvenom sistemu, zatim ravnopravnost i emancipaciju žene, otvaranje škola na maternjem jeziku, mogućnost zapošljavanja van poljoprivrede itd. Ovde je otvoreno više osnovnih škola, a u Baranu su otvorena odeljenja srednje škole opšteg obrazovanja (prve dve godine), zatim ambulanta, pošta itd.

Naselja i stanovništvo. — Baranski Ljug ima 15 seoskih naselja. Ova etno-geografska celina počinje na zapadu sa selom Kruševac, od koga se, idući prema istoku, nižu ostala sela: Rašić, Turjak, Barane (ponekad su to dva sela: Gornje i Donje Barane), Kotradić, Vranovac, Čelopek, Kosurić, Bučane, Lugadžije, Glođane, Nepolje, Češkovo i Kpuz. Većina naselja su ravničarska i zbijenog tipa, dok su sela na brdima razbijenog, odnosno mahalskog tipa (na pr. Turjak, Češkovo, Kpuz). Naselja su mala, tako da svega 3 imaju preko 1000 stanovnika (Kruševac, Barane i Kosurić). Sva naselja su elektrificirana, a sredinom ovog kraja izrađen je i asfaltni put do Glođana, koji se, kod sela Raušića, vezuje sa putem Peć — Đakovica. U više sela otvorena su prodavnice artikala široke potrošnje.

Prema popisu od marta 1981. godine, Baranski Ljug ima 11224 stanovnika, od kojih 10702 Albanaca (95,35% od ukupnog broja stanovnika), Crnogoraca 413 (3,67%), Srba 25 (0,22%), Muslimana 75 (0,66%) i 5 (0,04%) ostalih. Između dva poslednja popisa (1971—1981), tj. u toku jedne decenije, stanovništvo ovog kraja poraslo je za 18,57%, odnosno za 1758 ljudi. To je prirodni priraštaj, jer se migracionim kretanjima u ovom periodu stanovništvo nije povećalo. Iste godine zabeleženo je 1100 domaćinstava, tako da je prosečan broj članova u svakoj porodici 10,2, što ukazuje na to da su manje porodične zadruge još uvek brojne. Stanovništvo ovog kraja je dosta vezano sa svoj posed, iako je on jako mali, jer po glavi stanovnika ne dolazi ni 25 ari obradivog zemljišta, (kosovski prosek je ispod 20 ari). Ali na to utiče pre svega veoma mala mogućnost zapošljavanja u gradu. Međutim, privremene migracije u zapadnoevropske zemlje su relativno većih razmera, jer je 1981. godine iz ovog kraja bilo zaposleno na privremenom radu oko 450 ljudi. Posle rata mnoge naseleničke porodice nisu se vratile, a od onih koje su se vratile mnoge su prodale kasnije svoja imanja (uglavnom Poljoprivrendo-industrijskom kombinatu u Peći) i preselile se u grad.

Proces urbanizacije u Baranskom Ljugu uslovljen je pre svega promenom socijalne strukture stanovništva i njegovim kulturnim nivoom. To je izrazito poljoprivredan region, sa veoma malim brojem ljudi zaposlenih u sekundarnim i tercijalnim delatnostima, a osim toga, u čitavom ovom kraju ne postoji nijedan industrijski objekat izvan grada. Ipak, elektrifikacija, asfaltni put, prosveta i taj mali broj zaposlenih — sve to doprinosi da se tradicionalni način života počeo menjati na bolje. To se vidi po mnogo čemu, kao na pr., po odeći, u kojoj ima sve manje elemenata narodne nošnje, po novim kućama, koje takođe nisu više u stilu folklorne arhitekture, po školama (osnovnim i srednjim) koje su pune muške i ženske dece, zatim po velikom broju radio aparata, televizora, kao i poljoprivrednih mašina, pre svega traktora, za koji se pre rata nije ni znalo, a sada u svakom selu ima po nekoliko komada.

Duhovna kultura. — Sa etnografskog aspekta Baranski Ljug čini sastavni deo Metohije, sa nekim manjim ostupanjima. Običaji oko rođenja deteta su vrlo slični čak i među raznim narodima, kao i mnogi drugi, u ostalom. I u Baranskom Ljugu roditelji žele da im se rodi muško dete. Kad se ta želja ostvari, radost se ranije najavljivala pucnjavom; priređuje se i sada gozba za komšije i prijatelje, a preduzimaju se razne mere, sa posebnim ceremonijalom, da se novorođenče zaštiti od uroka i zlih duhova. Ako

se rodi kći, veselju nema mesta u kući. Pa oni koji dolaze u posetu, umesto čestitanja, na neki način izjavljuju saučešće i utehu rečima „Neka vas bog drugom prilikom obraduje sinom."

Veridbu su obavljali sve do skoro isključivo roditelji, a verenici se nisu ni poznavali. Gledalo se da se nađe dobar prijatelj, dobra kuća, tj. porodica, pa je zbog toga bilo veridbi i maloletne dece. Sada su retki takvi slučajevi. Momkova porodica daje novac roditeljima verenice, koja od tog novca kupuje svu spremu koju na dan svadbe nosi sa sobom svome mužu. Iz tog običaja, neobavešteni strani autori zaključivali su da kod Albanaca postoji kupoprodaja devojaka, što svakako nije tačno. Ranije su neki roditelji uzimali manju svotu za sebe, odnosno kao naknadu za troškove oko ispraćaja devojke, ali taj običaj je bio u prošlosti samo u nekim sredinama, pa su takvi primeri i tada bili potcenjivani od ostalih. Svadba je nekada bila raskošna i trajala je 2—3 dana. Sada je to svedeno u razumnije granice, a vremenski traje svega 1 dan, negde i manje.

U Baranskom Ljugu mnoga sela su donela kolektivnu odluku kojom se određuje suma koja se može dati nevesti za spremu, vreme trajanja svadbe i okvirno broj svatova. Isto je učinjeno i u vezi trajanja saučešća, tj. koliko dana treba čekati u kući prijatelje koji dolaze na saučešće. Ovo je urađeno zbog toga što je ranije morao da bude vezan za kuću domaćin mesecima, pa i čitavu godinu, primajući saučešće, bez obzira na sezonu poljskih radova. Sada je to vreme svedeno na 10—15 dana.

Kod Albanaca na Kosovu, kao i kod Srba i drugih naroda Balkana, postoji kumstvo i pobratimstvo, koje se veoma ceni i poštuje. Kumstvo se praktikuje i sada u širokim razmerama, a pobratimstvo (i posestrimstvo) veoma je retko.

I u Baranskom Ljugu još uvek mnogi veruju u vile, veštice, vampire, karakondžule, uroke, zle oči, zmajeve, aždaje itd., a mnoge prirodne pojave pripisuju upravo tim praznovericama ili raznim duhovima. Tako na pr., pomračenje sunca ili meseca dovode u vezu sa borbom zlih i dobrih duhova, odnosno zmaja i aždaje; zemljotres nastaje kad se ogromnom „crnom biku", koji na leđima drži zemlju, naježi koža, razne bolesti dolaze od uroka, zlih očiju i zlih duhova; decu jedu veštice, pa ih treba mazati kriškom belog luka itd. No, to su sve poznate praznoverice i verovanja i kod drugih naroda. Međutim, ono što bi bilo u ovom pogledu možda karakterističnije za Baranski Ljug, to je verovanje u vampire. Naime, samo verovanje je istovetno kao i kod drugih naroda, ali je karakteristično to što se vampir u ovom kraju nešto „češće javlja", pa čak je jedan takav „tumarao" ovom dolinom i 1979. godine, a pre rata je vampir ovde bio „češći nemili gost". Iako je uobičajeno da se verovanje i praznoverice proučavaju u okviru duhovne kulture određene etničke sredine, ona su upravo odraz duhovne zaostalosti, koja nestaje prodiranjem kulture u široke anordne mase. Upravo ovaj proces je učinio da su ova verovanja i praznoverice u Baranskom Ljugu zadržana uglavnom samo u okviru određenih generacija, koje su još uvek pod jakim uticajem tradicije i uopšte duhovnog nasleđa minulih vremena.

Ipak, i iz tih vremena nasleđeni su neki pozitivni običaji i shvatanja, koja su i danas prisutna u stanovništvu ovoga kraja, iako su prilično izbledela. Naime, reč je o tradicionalnom albanskom gostoprimstvu i besi (časnoj reči), što je kroz vekove smatrano kao nešto uzvišeno. Ove dve, da kažemo — nacionalne karakteristike i danas se poštuju u Baranskom Ljugu, pa

će svakom namerniku, makar bio i nepoznat, biti otvorena kuća i biće dočekan sa „bukë e krypë e zemër" — tj. „hlebom, solju i srcem" (naići će na srdačan, iako možda siromašan, prijem). Besa je danas stvar ličnog karaktera, dok je ranije onaj koji bi je pogazio iskusio i društvene sankcije (osudu fisa, bratstva ili sela).

Usmena književnost predstavlja najveće bogatstvo duhovne kulture svakog naroda. Ona je i u Baranskom Ljugu veoma dobro razvijena i sačuvana. Posebnu važnost imaju one narodne pesme koje se odnose na događaje u ovom kraju, a takvih nije mali broj. One su svojevrsna istorija društveno-političkih prilika u pojedinim vremenskim periodima ovog regiona, u kojima se događaji iznose vrlo verno, što je inače poznata odlika albanske istorijske poezije. Tako se na pr. u jednoj pesmi iznosi tok borbi protiv Turaka za vreme Prizrenske Lige, kada je Veselj Paša na čelu turskih jedinica došao da uguši pobunu i u okolini Peći i Đakovice, pa je topovima gađao jake kamene kule i u selima Baranskog Ljuga. Događaji oko nasilnog pokrtavanja 1913. izneti su u jednoj dirljivoj pesmi, koja inače upravo faktografski iznosi tragične činjenice. Iz perioda buržoaske Jugoslavije poznat je takođe krvav događaj koji se desio u selu Baranu 21 februara 1937 godine, na dan glasanja, kada je narod ustao protiv falsifikovanja glasova od strane predstavnika vlade, čiji kandidat nije dobio podršku birača. U krvavom okršaju između golorukog naroda i velikog broja naoružanih žandarma, bilo je 30 mrtvih i ranjenih seljaka ovog kraja. Ovaj događaj je takođe opevao narodni pesnik u jednoj rapsodiji. Razume se, da pored istorijskih, ima mnoštvo ljubavnih i drugih pesama i pripovedaka bilo sa lokalnom, bilo sa opštom tematikom.

Materijalna kultura. — Ona je u ovom kraju manje originalna nego što je to duhovna kultura, jer ima zajedničke sve karakteristike sa ostalim susednim zonama ovog dela Metohije. Naime, narodna nošnja je potpuno ista kao na pr. u susednom Lješanskom Ljugu, Duškaji, ili Reci. Karakteristični metohijski čakširi od belog sukna sa nizom crnim gajtana duž šavova, i danas se mogu videti na mnogim starijim ljudima u Baranskom Ljugu, dok je od ostalih delova narodne nošnje sada u upotrebi samo još bela vunena kapa („plis", „ćelješe"). Inače muškarci se nose uglavnom „alafranga" (sako i pantalone). Ženska nošnja je bolje očuvana: dugačka bela košulja do ispod kolena, crne vunene čarape, dokolenice, dve pregače — prednja veća i zadnja manja, dva bela poveza na glavi, to su uglavnom haljetci ženske nošnje u Metohiji. Pokućstvo i oruđa za rad bila su od drveta, pa su ih seljaci sami pravili, ali sada je mnogo šta od toga zamenjeno fabričkim proizvodima. U narodnoj arhitekturi ističe se i u ovom kraju poznati tip utvrđene stambene zgrade, tzv. albanska kula, sagrađena od kamena ili pečene cigle, debelih zidova, vrlo malih prozora i vrata, a sa više puškarnica. Još danas ima kula u svakom selu, ali one su ostatak prošlosti, a nove kuće se grade po ugledu na gradsku arhitekturu.

Perspektiva daljeg razvoja. — Baranski Ljug je jedna izrazito poljoprivredan kraj, agrarno prenaselen, bez industrije ili preduzeća u kome bi se zaposlio deo viška poljoprivrednog stanovništva, koji je svake godine sve veći. Zbog svega toga, razumljivo je da ovde vlada relativno siromoštvo, koje je dosta izrazito u onim porodicama koje nemaju nikoga u nepoljoprivrednim delatnostima.

Da bi se ovaj kraj izvukao iz nezavidnog ekonomskog položaja, neophodno je da se ovde otvori neki pogon matične industrije u Peći, ili drugog nekog grada, da bi se zaposlilo barem 500—600 ljudi. Moralo bi se stimulirati dalje školovanje omladine putem stipendija za srednje i visoke škole. Takođe bi se morao povezati Baranski Ljug sa asfaltiranim putem Klina — Đakovica, a to je svega nekih 7—8 km od sela Gloćana, dokle postoji takav put kojim se ovaj kraj vezuje sa gradom. Trebalo bi još više stimulisati pojedine grane poljoprivrede (u nekim selima su vrlo povoljni uslovi za povrtarstvo, u drugim za voćarstvo, žitarice itd.) — kako bi se dobili veći prinosi. Dečanska Bistrica nanosi mnogo peska i šljunka u svom koritu, a u njenom završnom delu, gde se probija kroz klisuru, ima velikih naslaga kamenih ploča, što bi se sve moglo koristiti kao sirovina za jedan veći objekt građevinskog materijala, koji bi se mogao ovde izgraditi bez većih poteškoća. Sada je Baranski Ljug u privrednoj stagnaciji, koja se može lako pogoršati još većom agrarnom prenaselenošću i eventualnim povratkom radnika iz inostranstva. Sve to nameće potrebu preduzimanja hitnih privrednih mera.

TREGUESI I EMRAVE DHE I TOPONIMEVE

Abaz Dojaka 134
Abdyl Frashëri 164
Adem Bajraktari 100
Adem Rama 166
Adem Tahiri 41, 111
Aga i Botushës 29
„Agrari" 32, 33, 36, 95, 103, 169
Agron Fico 134
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës 10
Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve 71
Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë 54
Allbanci 176, 178, 179
Ahmet Bala 120
Aleksandrovac 107
Ali Bajraktari 26, 28, 166
Alibajramaj 81
Aliçkaj 102, 103, 106
Ali Bazhdari 119
Ali Curri 25
Ali Hadri 30
Ali Hamza 166
Ali Muka 157
Alshiqe 81, 92
Anadoll 33
Andrija Gega 60
Andrija (i biri Gjonit, më 1485) 59
Andromaqi Gjergji 150
Anton Melik 18
Aprripa (Tarakaj) 92
Arat e Begut 112
Arat e Dardhës 112
Arat e Epërme 82, 107
Arat e Fetah Agës 101
Arat e Gata 85, 87, 95, 110
Arat mbi Katund 101
Arat e Memës 95
Arat e Mëdha 103
Ara e Mikelit 92
Arat e Hysenit 95
Arat Pavada 95, 98
Arat e Sarajit 98
Arat e Zajmit 101
Arif Povata 163
Arkivi i Stambollit 54
Arnaut 33
Arsenije Çarnojeviq 26, 72
Arseni Qyrku (Qirkoviq) 36
Asllan-pasha 167
Australia 98
Atanasije Urosheviq 31
Avdyl Beka (Çeskovë) 68
Avdyl Selimi (Strellc) 36
Avdullah Hoxha 164

Babaj Bokës 37
Babin Most 98
Bafti Ndou (Rakoc) 99
Bajë (Bana) 60
Bajraktaraj 100, 102
Bajraktari i Vranocit 26
Bajraku i Vranocit 45, 46, 47
Baiqaj 100
Bajram Curri 28, 29, 36, 37, 99, 165, 166
Bajram Mustafa (Baran) 94
Bajram Taraku (Kryshec) 82
Balë 120,
Ballkani 25, 45, 54, 60, 72
Barani 14, 24, 25, 29, 33, 34, 40, 43, 44, 50, 55, 57, 61, 63, 64, 65, 66, 67, 75, 77, 90, 128, 189, 191
Bardo (Bardh) Stepani 60
Baroha Hulio Karo 144
Batallëku 92
Begllëku 115
Begollët e Pejës 46, 107
Begoviq 123
Behaxha 85, 92, 103
Behoci 18, 85, 103, 166
Bellëja 29, 44, 70, 86
Bellopoja 29, 109
Beogradi 36, 144
Benocat e Moçme 90
Beqir Krasniqi 7
Beqir Rexha 37
Berana 28, 107
Berisha 43, 44, 45, 81, 85, 92, 94, 97
Besëlidhja e Pejës (1897, 1899) 26, 90
Bezerët 85

Bigovica 85, 87
Binak 81
Birat e Dhelpnave 101
Bistrica e Deçanit 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 45, 77, 86, 87, 88, 90, 92, 98, 104
Bistrica e Pejës 12, 13, 14, 45
Bisheva 107
Bityç 4, 13, 81, 85
Bizanti 22, 25, 72, 118
Bjellopavliqi (Palabardhi) 120
Bjeshka e Deçanit 16
Bjeshka e Isniqit 16
Bjeshkët e Nemuna 12, 14, 15, 69, 109
Bjeshkët e Rekës 16
Bjeshka e Strellcit 16, 166
Bjeshka e Zhlepit 85
Blakaj 98
Blinat 101
Bogdani (i biri Gjeçit) 59
Bogdani (i biri i Plakut) 57, 94
Bogdan Shqiptari 60
Borivoje Panjevac 31
Bosnja 67, 86
Bosnja e Hercegovina 30
Boshnjakët 67, 86, 97, 123
Botushë 37, 118
Bojović B. 15
Borivoje Drobnjakoviq 138
Bostanishta 112
Boshkoviq 82
Boshtrakët 109
Bozhidari (i biri Gjonit, më 1485) 59
Bozhidari (i biri Nushës) 57
Bozhidari (i biri Preniqit) 59
Bozhidar Radiçi 91
Bozhoviq 82
Brahoviq 123
Brajeviq 92
Branko (vëllai i Gjergjit) 57
Branko (vëllai i Gjonit) 57
Brisor 102
Broja 102
Broliq 14, 23, 43, 44, 52, 55, 56, 61, 62, 65, 66, 67, 70, 75, 86
Bronislav Malinovski 147
Brovinë 37
Buc Rama (Broliq) 87
Bujanovc 38
Buqan 24, 43, 50, 57, 58, 61, 63, 64, 66, 67, 75, 78, 108
Butaja 98

Camniq 92
Car Dushani 113
Carrabreg 94
Cëravërh 36
Cërmjan 158
Crna Gora 176
Curraj 117
Cvijiq Jovan 65, 71, 91, 97, 109, 116

Çavolli Riza 15
Çejoviq 102
Çellopek 23, 33, 34, 43, 44, 61, 63, 64, 66, 67, 75, 101, 102, 103, 104
Çerret 81, 82
Çerretët 81
Çeskovë 12, 13, 14, 23, 24, 43, 52, 56, 61, 63, 64, 67, 77, 118
Çokëza 112

Dagosh (Vllah) 52
Dallama 10, 112
Damjani (i biri Nikollës) 59
Dan Sejdiu 36
Danillovgrad 100
Dardha e Grabocit 100
Dardha (Shkodër) 115
Dashinoci 12, 36, 98
Daut Kolica (Baran) 29, 49, 94
Daut Hasani (Vranoc) 100
Deçani, (manastiri i Deçanit) 12, 13, 23, 24, 25, 52, 53, 54, 56, 59, 77, 85, 86, 94, 102, 116, 118, 150, 176
Dedaçi (Deda) i biri i Gjorgjit 59
Dedë Marku 59
Dedja Jovani 59
Delanca 123
Demali Deçani 29
Demë Isufi 163
Demukaj 94
Demush Shala 163, 169
Dmitri (i biri Spanit) 57
Dnepole (Nepole) 116
Dobrodolan 59
Dolan (Gllogjan) 105
Dollova 120
Drago Arbanasi 60
Drazha Mihajlloviq 29
Drelaj (Rugovë) 107
Drenica 28, 30, 44, 47, 69, 102
Drezgë 107, 114
Drini i Bardhë 12, 13, 14 15, 16, 17, 45, 63, 77, 88, 107, 121, 183
Dubova 91
Duboviku — 6, 37, 45, 91
Dubrovniku 54
Dugojeva 114
Dukagjini 25, 37, 44, 73, 77, 112, 115 150, 163, 166
Duka Gika 59
Dumnicë 169
Dunavë 41
Dushan Nemanjiqi 23, 105, 116, 118
Dushan Dukiq 16
Dush 25
Dushkaja 12, 13, 16, 36, 90, 98, 107, 111, 115, 150, 158, 166

Enti Krahinor i Statistikës 67, 74, 81
Ereniku 13
Ereniqet 101

Evgenija murgeshë, 116, 118
Evropa 42

Fani 120
Fandë 120
Fadil Mehmeti 139
Ferizaj 31
Fermendžin E. 41
Fertova 117
Firaja 87, 98
Firinat 92
Fongishta 123
Fongje 123
Frutka e Deli Ukës 85
Fundishtat e Kpuzit 123
Fusha Gomur 82
Fushaxhi 90
Fusha e Madhe 103
Fusha e Thatë 101
Fusha e Vranocit 13

Gadimja 42
Gal Milenko Terziq (Gal Çorri nga Letina) 36
Galigjat 82
Gajnoce 103
Gash 43, 44, 81, 82, 86, 94, 164
Gecaj 92
Gedeon Jurishiq 53
Gega (i biri i Ivanit) 60
Gegë Govedari 60
Geghysen 88, 100
Gërgoc 107
Gërma 85
Gërvallë 81, 82
Gladishat 92
Gllaviçica 35, 36, 49
Gllogjani 13, 14, 23, 25, 26, 41, 43, 44, 50, 52, 57, 61, 63, 64, 65, 66, 67, 75, 113, 183
Gojkoviq 82
Gorazhdeci (Gorozhdeci) 29, 45
Grabanica 107
Graboc 45, 100
Grabocaj 102
Greqi 23, 72, 104, 105
Griqët 123
Grkoviq Milica 54,55
Gropani (i biri Leshit) 58, 108
Gropani (i biri Rajkos) 58, 108
Gruda 120
Gryka e Bistricës 13
Gryka e Deçanit 15, 69, 86
Gryka e Hajnave 115
Gryka e Kaçanikut 73
Guri i Alisë 115
Gurinat 101
Guri i Zi 123
Gurra e Shapotit 90, 95

Gjakova 19, 25, 26, 28, 31, 50, 70, 125, 171
Gjeçi (i biri Gjonit) 60
Gjergji (i biri Dimitrit) 57, 80
Gjergji (i vëllai i Radiçit) 57
Gjermania Federale 52
Gjilani 30, 31, 97
Gjini (i vëllai i Vukut) 60
Gjini (i biri i Mekshës) 59
Gjocaj 85
Gjoni (i biri Andrijes) 60
Gjon Milloshi 59
Gjoni (i biri Miomirit) 58, 108
Gjoni (i biri Nikollës) 59
Gjoni (i vëllai i Todorit) 59
Gjoni e Nikolla (bijt e Progonit) 59
Gjoni (i biri Stepanit) 60
Gjorgje Krstiq 30
Gjorgje Zllokoviq 18
Gjorgji (i biri Ajo Prendit) 57
Gjura (i biri Gjonit) 59
Gjurakoci 114

Hakif Bajrami 30, 31, 32, 34
Hajri-beu (Pejë) 33
Hamza — myslimani 57
Hasan-beu 25, 105
Hasan Prishtina 36
Hasi 131
Haxhi Bajraktari 33, 35, 45
Haxhi Jusufi 91
Haxhi Mani (Gjakovë) 86
Haxhi Zeka 26, 28, 29, 33, 69, 99, 117, 165, 166
Hazir Alija 29, 167
Hercegovina 30
Hil Desku 7
Hilendar (Greqi) 23, 104, 118, 176
Idris (vojvodë i Sanxhakut të Dukagjinit), 25
Idriz Beka (Ratishë) 36
Idhaqe 112
Ilija Krasojeviq 37
Ilixhja e Pejës 91
Ilirët 72
Instituti Etnografik i Akademisë Serbe të Shkencave 7
Irzniqi 37, 102
Iskenderi — mysliman 57, 105
„Islihati" (Komisioni i Gjaçeve) 46
Isniqi 16, 42, 83, 85, 91, 93, 164, 167
Istogu 59, 100, 131 150
Istrefaj 86
Isuf Jahë Krasniqi 164
Isuf Musa 166
Istambull 176
Ivangrad 100, 107
Iviq Pavle 55, 56
Izgareviq 82

Jabllanica (Dushkajë) 37, 168
Jabllanica (Leskovc) 38
Jak Daba 59
Jak Jovani 59
Jaku (i biri Mehmetit) 91
Jani Nushi 141
Jonuzi — mysliman (më 1485) 105
Joshanica (Klinë) 107
Jovan Cvijiq 15, 60, 61, 62
Jovan Markoviq 15
Jovan Radoniq 53
Jovani (i vëllai Vukotë Dedashit — Dedës, më 1485) 59
Jovanoviq 102
Jugosllavia 19, 29, 32, 36, 37, 38, 46, 63, 65, 81, 83, 107, 125, 176, 180, 164, 186
Juniku 26, 37, 59, 85, 150, 152

Kabashi 114
Kalinoc 111, 112
Kamenica 102, 103
Kanuni 46, 49
Kapit 92
Karadaku i Shkupit 41
Karavesh 123
Kare (Greqi) 23, 105, 113, 115, 118
Kasem Çelebiu 93
Kastrat 94
Kastratoviq 94
Katund 90
Kelmend 43, 94, 102, 103, 106, 139
Ker Sadrija (Rugovë) 37, 99
Kërdhokllat 117
Kërkisha 98
Kërnina 37
Klina 96, 107, 131
Klubi Kulturor Serb 31
Koci 41, 42, 114
Koço Zheku 157
Kodra e Baranit 13, 14, 90, 92
Kodra e Broliqit 87
Kodra e Sokolçunëve 92
Kodra e Vranocit 13, 98, 100
Kodra e Tupanit 107
Kodra e Vorreve 112
Kokadino 25
Kolicaj 94
Kolgjonaj 92, 94
Kolë Shtjefni 134
Kollonë 123
Kombinati Bujqësor i Pejës 19, 103, 108, 115
Kombinati i Lekurave dhe i Këpucëve i Pejës 130
Komuna e Baranit 34, 35, 36, 37, 169
Komuna e Gllaviçicës 36
Komuna e Gorozhdecit 36
Komuna e Isniqit (Strellcit) 37
Komuna e Pejës 66
Kongresi i Belinit 163
Konstantin Jiriçek 119
Kosova 9, 15, 23, 26, 28, 30, 31, 32, 36, 38, 42, 45, 47, 50, 51, 52, 53, 58, 60, 66, 70, 72, 73, 75, 130, 150, 155, 169, 184
Kosta Novakoviq 30, 37, 38
Kosta Peqanac (Kostë Vojvoda) 36, 169
Kosuriqi 11, 14, 23, 24, 25, 39, 40, 43, 50, 52, 55, 56, 57, (1, 63, 64, 66, 67, 75, 104, 183
Koshare 37
Kozhnjeri 16
Kpuzi 12, 13, 14. 43, 61, 63, 64, 66, 75, 77, 96, 121
Kragui (i biri i Prenkut) 57, 105
Kralan 13, 120
Krajl Nikolla 29, 195, 168, 176
Krasniqe 26, 42, 43, 44, 45, 85, 88, 92, 94, 97, 100, 117, 176
Krena 13
Kroni i Ahave 101
Kroni i Ahit 95
Kroni i Bogoshevcit 101
Kroni i Baranit 95
Kroni i Demë Danit 90
Kroni i Etheve 95, 146
Kroni i Fushës së Thatë 101
Kroni i Kallugjerit 95
Kroni i Keqes 95
Kroni i Lëbushës 82
Kroni i Lejthisë 101
Kroni i Letikave 101
Kroni i Knetave 101
Kroni i Makreshit 103
Kroni i Mark Gatës 96
Kroni i Sarushave 82
Kroni i Shekës 101
Kroni i Topiluhës 82
Kroni i Therres 85
Kroni i Vorreve 123
Kroni i Zajmit 101
Kroni i Zhavarit 115
Krstiq Gjorgje 30
Kryezi 85
Krysheci 12, 13, 14, 23, 24, 25, 33, 37 43, 44, 50, 52, 55, 57, 61, 63, 65, 66, 67, 75 77, 78, 80, 189
Kuqi 102, 107, 120
Kurshumlija 58

Lah Hysen Krasniqi 164
Larin 81, 82
Ledinaxhi 111, 112
Ledina e Tahir-begut 112
Lekë Dukagjini 46, 49
Lekaj 86
Letika 95, 101
Lekiq Vojvoda 29
Leskovc 38, 58
Leskovik 111

Lëbusha 15
Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881) 26, 28, 90, 163, 165
Lika 30
Lipjani 28
Limon Rushiti 30, 36
Lisi i Gjaçeve 98
Lisi i Kajushës 101
Lisi i Hasallëkut 98
Lisi i Kishës 82
Lisi i Rashiqit 85
Livadhet e Buta 95, 98
Livadhi i Deli Ndout 112
Livadhi i Mullinit 92
Livadhet e Poshtme 107
Livadhet e Shabanit 101
Livadhet e Thata 85
Loxha 99, 120
Luba Vuksanoviq 34
Lufta Austro-turke (1690) 25
Lufta Ballkanike 29, 38, 46
Lufta e Dytë Botërore 19, 29, 42, 45, 46, 48, 52, 65, 73, 150
Lufta e Moresë (1684) 46, 100
Lufta e Parë Botërore 26, 38, 62, 63, 65
Lugu i Baranit (përmendet gati në të gjitha faqet e këtij libri)
Lugu i Bungave 107
Lugu i Butajes 101
Lugu i Camës 117
Lugu i Currit 107
Lugu i Dembelive 101
Lugu i Drezgës 115
Lugu i Drinit 9, 120, 150
Lugu i Fellë 82
Lugu i Gllogocit 82
Lugu i Gjonit 107, 115
Lugu i Gjupajës 115
Lugu i Hafizit 95
Lugu i Hujve 90
Lugu i Isufit 101
Lugu i Kamnikut 82
Lugu i Kallabjakut 103
Lugu i Laknave 90
Lugu i Leshanit 9, 17, 18, 28, 59, 69, 80, 96, 107, 150
Lugu i Madh 115
Lugu i Mullinit 90, 95
Lugu i Ostrigave 82
Lugu i Pishtanit 9, 12, 14
Lugu i Porogonëve 107
Lugu i Qelës 101
Lugu i Saricave 107
Lugu i Shabanit 101
Lugu i Shakut 115
Lugu i Tamnikut 107
Lugu i Tërstenikut 9
Lugu i Trumajës 90, 95
Lugu i Thanave 115
Lugu i Thive 95, 101, 117
Lugu i Vneshtit 103
Lugu i Vnezhëve 123
Lugu i Vogël 115
Lugu i Vojimit 82
Lugu i Vorreve 115
Lugu i Zabërdanit 103
Lugu i Zhupanjes 117
Luma 123
Lumbardhi 81, 86, 87, 102
Lumoviq 102
Luzhë 81

Llambrini Mitrush 134
Llapi 30, 32, 169
Llapushë 12, 36, 102
Llazarevo 98
Llugaxhi 40, 41, 44, 61, 62, 63, 64, 67, 75, 111
Lluga e Bërzhenisë 101
Lluga e Madhe 101
Lluga e Malgatës 101
Llozhan 80, 114
Llozhiq 85
Llukë 40, 92
Lluka e Epërme 116

Mahalla e Kodrës 96
Mahalla e Muhaxherrëve 58
Mahalla e Poshtme 103
Malazezë 31, 32, 36, 64, 65, 66, 82, 85, 86, 87, 89, 92, 94, 97
Malaj 81
Malësia 45, 69, 70, 71, 81, 85, 100, 102, 114, 134, 165, 171, 185
Malgataj 97
Mal Shaban Krasniqi 164
Mali i Shenjtë (Greqi) 105, 118
Mali i Zi 9, 30, 38, 60, 67, 70, 81, 97, 103, 107
Manojllajt 102
Manojllo Manojlloviq (Manojl Berisha) 35, 169, 170
Maqare 110
Maqedonia 9, 30, 36, 38, 60, 72, 74, 170
Mark Krasniqi 18, 110, 141, 157, 160
Marko Milanov (Mark Milani) 120
Markoviq Jovan 18
Markoviq 82, 97, 98
Mark Noshi 117
Marko Rashoviq 120
Manastiri 28
Maxhun Nimani 164
Maznik 106
Maznikollë 106
Mehmet Dedë Mrripa 46
Mehmet Desku (Gllogjan) 49, 115
Mehmet Gjoni 166
Memaj 94
Mertur 81
Metohia (Dukagjini) 13, 25, 53, 176
Migjeni 115
Mileviq 82

Miliq Krsta (Istog) 36, 169
Mijoviq 82
Milisav Llutovac 31
Millan Jociqi 36, 37
Millosh (Vllah) 52
Millosh Millojeviq 53, 54
Milloshevë 98
Millovan Obradoviq 32, 114
Millovanoviq 29
Mina (i biri i Arbanasit) 60
Ministria e Punëve të Mbrendshme 32
Mirdita 43, 120
Miro Protiq (Mira i Protës) 34, 170
Misin Ramosi 86
Mita Kostiq 72
Mita Milkoviq 169
Mitrovica 28
Mllakishte 95
Momçillo Hajdukoviq 36
Mon Ademi 100
Mon Avdija 163
Morina 43, 120, 121
Mrasor (Podrime) 102
Mulosmanaj 165
Mulla Xhela 36
Mulliq 37
Muharrem Krasniqi 171
Murataj 92
Musli Krasniqi 29
Mustafa (i biri i Jahjasë) 25, 113
Mustafë-pashë Çerkezi 28, 99, 166
Mustafë Mahmutaj (Baran) 95
Muzli Bajrami 164
Muzhovinë 114
Myderizi 166
Myftar Memia 134, 137, 138

Nahija e Gjakovës 37
Nahija e Hoçës 59
Nahija e Pejës 54
Najgebauer V. 18
Nalloga e Qërshisë 112
Nalloga e Tulezhit 112
Nak Berisha 37
Ndue Delija (Gllogjan) 115
Ndue Sadiku (Gllaviçicë) 49
Ndrecë Zeqa (Gllogjan) 115
Nemanjiqët 22, 23, 25, 175
Nenko (i biri Dimitrit; defteri i vitit 1485) 57
Nenko (i biri Gegës) 60
Nenko (i biri Gjinit) 59
Nenko (i biri Gjurës) 57, 80
Nenko (i biri Kukës 59)
Nenko (i biri Lalës) 108
Nenko Shqiptari 59, 113
Nepole 13, 14, 23, 24, 37, 39, 43, 44, 50, 52, 55, 56, 57, 61, 63, 64, 66, 75, 116, 164
Neprobishtë (Prizren) 59
Neziraj 94
Nezir-aga 103
Nikaj 117
Nikashi (Nikë) 113
Nikodim Grujiq 36
Nikolla (i biri Mires) 59
Nikolla (i biri Nikës) 57
Nikolla (i biri Radiçit) 108
Nimon Ferizi 37
Nokshiqi 107
Novakoviq Stojan 113, 116
Novë Giliqi 36
Novipazari 97

Obradoviq Millovan 114
Obrenoviqët 58
Opoja 131
Ornica 96
Osman-aga (Pejë) 117
Osman Xhemajli (Leshan) 33

Pal Vata 164
Palaj B. 45
Panxha 39, 106
Partia Demokratike 34, 35
Partia Komuniste e Jugosllavisë 32, 35, 37, 184
Partia Radikale 34, 35
Pashiqt 107
Pauçinë (Rozhajë) 87, 106, 107, 109
Pederoll-beu 121
Pech 22
Peja 12, 15, 19, 22, 23, 25, 26, 28, 29, 31, 33, 36, 37, 41, 42, 49, 50, 51, 53, 60, 61, 72, 74, 100, 125, 150, 166, 176, 191
Peka 22
Pentza 22
Perandoria Osmane 25
Perandoria Turke 26
Perbatina e Zeqë Ferizit 110
Pergjeqaj 85
Peroviq 85, 97
Perpër Ahmeti 25
Petar Vllahoviq 144
Petar Zh. Petroviq 146
Petko (i biri Radiçit) 91
Petusha 103
Përroni i Duboçakut 82
Pinik 95
Pirro Thomo 157
Pjeter Bogdani 25, 72
Pjetër Budi 25
Pjetër Maçi 114
Pjetër Mazreku 40
Plaku (i biri Bozhidarit) 57, 94
Planë 88
Plava 67, 70, 86, 97, 107
Plenumi i Brioneve (1966) 74
Pllamenac (Vojvoda) 29
Pllugishta 85
Podrimja 68, 102

Podguri i Pejës 37, 47, 59, 150
Podet 92
Poçesta 26
Pollosajke 121
Ponoshec 37
Popoc 37
Porta e Lartë 25
Potërç i Poshtëm 59
Prapaqani 23, 52
Prebili (i biri Gjonit) 57, 91, 108
Prekorupë (Llapushë) 12, 36, 102
Prend Gika 59
Prend Marku 59
Preshevë 38
Prishtinë 10, 12, 31, 97, 100, 125. 163
Prizreni 23, 28, 31, 59
Prizrenska Liga (1878-1881) 176
Prokupja 58
„Proleter" — organi i PKJ, 32
Prroni i Bardhaniqit 16
Prroni i Behocit 95
Prroni i Belegut 16
Prroni i Broliqit 16
Prroni i Dashinocit 16
Prroni i Gjesë 16
Prroni i Kosuriqit 16
Prroni i Rupës 16
Prroni i Xhamisë 101
Prroni i Zallit 16
Ptolomeu 22
Pulaha Selami 57, 68, 91, 96, 113, 116, 119

Qel Shabani 92, 101
Qerhanet 92, 101
Qerpiqët 101
Qylnat 101

Radavc 165
Radiçi (i biri Plakut, më 1485) 59
Radiqi (i biri Bozhidarit) 91
Radiçi (i biri Gjinit) 59
Radiçi (i biri Gjonit) 119
Radiç Krasniqi 119
Radiç Vllatkoviqi 91
Radiçi (i vëllai i Haxhi Jusufit) 91 96
Radivoji (i biri Gjonit) 59
Radosavi (i biri Bozhidarit) 57
Radovanoviq 97
Radosheviq 82
Radovan Zogoviq 29
Radunët 102
Rajku 59
Rakoc 115
Rakushiq 34
Rahovec 131
Ramë Binaku (Dashinoc) 36, 37, 99, 166
Rastokë 107, 121, 123
Rashiqi 14, 43, 61, 65, 66, 67, 75, 84
Raush (Vllah) 57
Raushiq 57, 94
Reka 150, 155, 160, 163, 166, 171
Reka e Allagës (Rugovë) 102
Reposh 53
Rexhë Bajraktari 26
Rexhep Krasniqi (Ustah Xhema) 33
Riçard Kevendish 147
Ripanj 144
Rizvanollët (Gjakovë) 98
Roma 25, 26, 53
Ronishte 85, 110
Rosuja 12, 14, 39, 37, 50

Rozhaja 67, 86, 87, 97, 102, 106, 109
Rugova 10, 37, 42, 69, 99, 100, 102, 103, 107, 131, 168, 188
Rumeli 163
Rusia 54

Rracaj 111, 114
Rrafshi i Dukagjinit 9, 10, 12, 13, 15, 17, 18, 19, 20, 24, 30, 42, 46, 53, 59, 62, 69, 70, 131, 165
Rrahi i Fandës 120
Rrahije 95, 103, 107
Rrahishta 92, 98, 101
Rrezina 110
Rrihna 101
Rrok Zojzi 71
Rrustem Alija 40
Rrustem Arifi (Kryshec) 82
Rrustem Arifi (Strellc i Poshtëm) 165
Rrzhanica 120, 123

Sabit Uka 58
Sadik Rama i Gjurgjevikut 36
Salih Bajraktari 168
Sanoc 102
Sanxhaku i Dukagjinit 25
Sanxhaku i Novipazarit 67, 72, 86, 106
Sanxhaku i Shkodrës 24, 108
Sarajeva 54, 97
Saveliq 82
Savë Batarja (Llazareviq, Savë Llazari) 29, 37, 95, 99, 167, 176
Sejishtat (Sojishtat) 82, 107
Selami Pulaha 52, 54, 59, 68, 72, 106
Selaniku 129
Selim Ukshini 166
Semetishta 59
Serbët 12, 26, 31, 37, 53, 56, 60, 63, 64, 65, 66, 71, 73, 92, 97
Serbia 23, 30, 38, 67, 81, 92, 97, 102, 176
Sferka e Gashit 123
Skadarski sandžakat 176
Skendërbeu 53, 105, 163
Sllav 52, 53, 54, 56, 57, 59, 60, 70, 80, 93
Sllavonia 73

Spirantu (Spiranti, Peja) 22
Spirë Kapetani (Spiro Dobrosavleviq) 36
Srem 7
Stanisha 53
Stankoviq 82
Stefan Urosh Nemanjiqi 23
Stefan Deçanski 23, 52, 104
Stepani e Gjoni — bijt e Lekës (në Junik më 1485) 59
Stepanët (Junik) 59, 123
Stevan Duçiq 120
Stojanët 123
Stojan Novakoviq 47, 48, 101
Stojku (Buqan) 59, 109
Strazimiri B. 157
Strikoviq 92
Strellci 16, 42, 85, 150, 163, 165
Stubëll 41
Srbobran 31
Srbovac 31
Srbica 31, 98
Suhajat 82
Suharekë 40, 85
Suka e Cërmjanit (701 m, Dushkajë) 13
Sylejman Vokshi 163
Sylë Rexha 164
Sylëregjajt 100
Sylë Sejdija (Llugaxhi) 111
Sylsmajlët 123
Syrija Pupovci, 45, 47
Sveti Sava 23, 105

Shaban Binaku 165
Shaban Sadiku 164
Shala e Bajgorës 42
Shalë 42, 44, 85, 86, 94, 164, 167
Shamahet e Halil Hamzes 92
Shavarinat 92, 110
Shishmani 37
Shkodër 105, 106
Shkupi 25, 28, 170
Shllak 106
Shpati i Arave të Nikës 120
Shpati i Hijes 101
Shpati i Rrezës 101
Shpella e Gadimes 42
Shpijat e Naselenikëve (kolonistëve) 101
Shpijat e Reja 101
Shqekiq 85
Shqepanoviq 82
Shqipëria 25, 32, 38, 72
Shqiptarët 12, 30, 31, 34, 36, 37, 38, 52, 53, 56, 57, 60, 63, 66, 73, 80, 86, 89, 92, 94
Shukri Rahimi 28
Shumadia 31, 98
Shtjefën Konstantin Gjeçovi 45
Shtupel 59

Tahir Smajli 39
Tahir — beg Kastrati 115
Tarakj 81, 92
Tetaj 111, 114
Tëthorat 107
Tirana 54
Tmava 90
Toplica 58, 70
Tomoviq 82
Tredhakët 102, 106
Tropoja 150
Trubhoc 160
Tulezhe 107
Turjakë 12, 14, 43, 44, 52, 61, 63, 64, 66, 67, 75, 77, 84, 88, 90, 100, 163, 164
Turqia 30, 31, 32, 33, 73, 74, 95, 163, 176
Turqit 45, 56, 103

Thaç 42, 43, 92, 94, 102, 106, 107, 114

Uçë 59
Ufullaqe 101
Ukaj 86
Universiteti i Kosovës 130
Ura e Fshajt 150
Ura e Gurit (Pejë) 168
Ura e Sykës 101

Vasa Çubrilloviq 31
Vau i Gashit 117
Velë 114
Velimir Jojiq 34
Verrat e Llukës 26, 28
Vesel-pasha 90, 95, 99, 163
Veshoviq 30, 82
Vishaj 111
Vizhma 117
Vllah 52, 56, 97, 105
Vllahoviq 82
Vnezhdë 123
Vojno-geografski institut 13
Vojvodina 73
Vokshi 39, 40, 42, 69, 106, 150, 163
Vorret e Janiçerëve 101
Vorret e Hasallakut 26, 73, 121
Vorret e Katalikëve 120
Vorret e Mira 121, 145, 146
Vorret e Shehitëve 85, 92, 145, 146
Vranoci (i Epërm e i Poshtëm) 13, 14, 23, 26, 27, 28, 29, 33, 43, 44, 47, 63, 64, 66, 67, 75, 98, 165, 167, 176
Vuk Gjeçi 60
Vukota (i biri Dedashit — Dedës —), 59
Vuku (i biri Gjinit) 113
Vujoviq 82
Vullanoviq 82
Vushoviq 94

Xhafer-begi 167
Xhafer Tajari 95, 166
Xhems Frejzer 141

Zabeli i Hajratit 103
Zabeli i Kadisë 82
Zagrmle 98
Zallinat 98, 101
Zalli i Rupës 85
Zef Lush Marku 37
Zef Gjoka (Gllaviçicë) 49
Zefi i Vogël 37
Zilopeku 45
Zona Neutrale e Junikut (XII. 1921 — II. 1923) 37
Zojç 59
Zyra Kryesore Agrare në Shkup („Agrarari") 30

Zhivanoviq 82
Zhuj Avdyli 99, 166
Zhuj Selmani 99

Bayerische Staatsbibliothek München